




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI VJETOR

ANNUAL NEWSLETTER




2025

WWW.KLSH.ORG.AL

PËRMBAJTJA

5	Hyrje	8	Botimi nr. 1 Nëntor 2024
16	Botimi nr. 2 Dhjetor 2024	26	Botimi nr. 3 Janar 2025
36	Botimi nr.4 Shkurt 2025	46	Botimi nr. 5 Mars 2025
54	Botimi nr. 6 Prill 2025	62	Botimi nr. 7 Maj 2025
68	Botimi nr. 8 Qershor 2025	88	Botimi nr. 9 Korrik 2025
98	Botimi nr. 10 Gusht 2025	106	Botimi nr. 11 Shtator 2025
114	Botimi nr. 12 Tetor 2025	126	Botimi nr. 13 Nëntor 2025



HYRJJE

KLSH, më pranë publikut dhe grupeve të interesit

Për të garantuar një komunikim sa më efikas dhe transparent me publikun dhe grupet e interesit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nisur që nga muaji nëntor 2024 publikimin e materialit informues "Buletini Mujor". Ky format i ri komunikimi synon të afrojë më shumë institucionin me publikun, duke ofruar informacione të qarta dhe të strukturuar mbi punën e KLSH-së.

Përmbledhja vjetore që paraqitet në këtë dokument sjell në një publikim të vetëm 13 numrat e buletinit mujor (nëntor 2024 - nëntor 2025). Botimi përmban aktivitetet kryesore të institucionit, rezultatet më të rëndësishme të auditimeve, si dhe bashkëpunimet me institucionet vendase dhe ndërkombëtare të auditimit, duke ofruar një pasqyrë të integruar të punës së KLSH-së përgjatë vitit.

Buletini vjetor shërben si një instrument orientues për publikun, institucionet partnere dhe çdo aktor të interesuar dhe, njëkohësisht, si arkiv i përditësuar i veprimtarisë së të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përmes tij, institucioni synon të forcojë kulturën e informimit, të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rolin dhe misionin e auditimit të jashtëm publik dhe të avancojë më tej standardet e transparencës në qeverisjen publike.



Transparenca është një nga shtyllat kryesore të misionit tonë institucional. Nëpërmjet informimit të vazhdueshëm dhe të besueshëm, ne synojmë të forcojmë besimin e qytetarëve dhe të sigurojmë një pasqyrë të qartë mbi veprimtarinë e institucionit, proceset dhe angazhimet tona. Publikimi i buletinit mujor dhe përmbledhja vjetore e tij përfaqësojnë angazhimin tonë për të komunikuar hapur, për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një dialog të qëndrueshëm me publikun dhe grupet e interesit. Informimi i publikut nuk është thjesht detyrim ligjor, por një angazhim i qëndrueshëm për llogaridhënie dhe integritet.

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu



NËNTOR
2024

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Nëntor 2024



Kryetari i KLSH-së, gjatë raportimit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat

KLSH dorëzon në Kuvend Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2023

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022, "Për Buxhetin e vitit 2023", i ndryshuar; Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dorëzuar në datën 22.10.2024 në Kuvendin e Shqipërisë raportin "Mbi zbatimin e Buxhetit Faktit për vitin 2023".

Në datën 29.10.2024, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu raportoi në Komisionin për Ekonominë dhe Financat mbi Raportin e zbatimit të Buxhetit për vitin 2023.

Gjatë raportimit në Komision, z. Shehu theksoi se nëpërmjet paraqitjes në Kuvend të këtij Raporti, Kontrolli i Lartë i Shtetit, krahas zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, synon të nxisë transparencën, parashikueshmërinë, unitetin në menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të fondeve speciale, me qëllim përdorimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve publike, në shërbim të mirëqeverisjes dhe në funksion të përmirësimit të jetesës së taksapaguesve, qytetarëve shqiptarë.

NGA AUDITIMET QË I PËRKASIN AKTIVITETIT TË VITIT 2023 KANË REZULTUAR:

- të ardhura buxhetore të munguara në shumën **16,935 mijë lekë;**
- në fushën e shpenzimeve dëm ekonomik në vlerën prej **104,374 mijë lekë;**
- si dhe përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet i fondeve publike në vlerën gjithsej **5,205,396 mijë lekë.**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT vijon të konsiderojë risqe fiskale me impakt buxhetor çështjet që kanë të bëjnë me:

- performancën e ndërmarreve shtetërore kryesore;
- shpenzimet për kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore;
- detyrimet e prapambetura të qeverisjes së përgjithshme dhe detyrime të tjera kontigjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare.

Statistika

106 auditime të evaduar deri në muajin tetor për vitin 2024

18 auditime të përfunduara në muajin tetor 2024

55 auditime janë në proces evadimi

89 raporte auditimi të publikuara në web

Gjetjet nga auditimet në dogana, tatime dhe ISSH

Auditimi i ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

1. Deri më 31.12.2023, **fondi i Sigurimeve Shoqërore rezulton me një numër debitorësh prej 110,129 subjekte**, që i përket një vlerë detyrimesh të prapambetura prej 18,456,251 mijë lekë, të cilat zënë rreth 11 % të shpenzimeve buxhetore vjetore të realizuara, të cilat nëse do të arkëtoheshin, të ardhurat nga kontributet do të ishin tejkaluar me 14%.

Detyrimet kontributive të cilat ndiqen nga ISSH, janë në total 5,882,737,711 lekë, të cilat në krahasim me një vit më parë, janë rritur në shumën 225,014,906 lekë. Kjo kategori e debitorëve paraqet një problematikë të shtuar, pasi shlyerja e detyrimeve mund të ndërpritet për shkak të moshës, e cila bën edhe likuidimin e tyre të vështirë.

2. Nga auditimi është konstatuar mungesë bashkëveprimi e komunikimi të rregullt ndërinstytucional ndërmjet ISSH dhe DPT, problematikë e cila vijon ndër vite. **Deri në fund të vitit 2023 rezultojnë gjithsej 1,482,748 listë pagesa të munguara** (format letër) të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012.

3. Nga auditimi rezultoi se nga DIP janë **9,614 dosje të pa inspektuara dhe të pa certifikuara**, nga të cilat 8,775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020 si dhe 839 dosje që i përkasin viteve 2019–2021, për rishqyrtim. Sipas parashikimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, neni 62, pika 3, duhej të ishin marrë masa, me qëllim shmangien e efekteve financiare për ISSH-në dhe buxhetin e shtetit si rezultat i tejkalimit të afatit ligjor 3-vjeçar për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.



Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga auditimi i 200 deklaratave doganore në kodin tarifor 3304499 (*preparate bukurie dhe për kujdesin e lëkurës*) dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre në sistemin Asycuda World për kategorinë e produkteve të kujdesit të lëkurës të injektueshme, **janë evidentuar 51 deklarata doganore me produkte të injektueshme të mirëmbajtjes së lëkurës, fillera/botox**, të tipit: Ejal 40mg, Hyamino care 500mg/2mg, Chaeum Hyaluronic Acid, Nythia Injectable, Aqualyx cosmetic, Sedyfill60cc, Mesoheal, Botulax, Boneta, Profhilo H-L, ASCEplus, Gouri, PCL Booster, Exotokine, Pidiroenne, Wanna Fill H, Elastic G/D/F, Rejunox dhe të tjera, nga 9 subjekte, **me një vlerë në deklarimi totale prej 65,062 Euro dhe 75,743 Dollar, të cilat nuk rezultojnë të jenë pajisur me certifikatën për regjistrimin e pajisjes mjekësore** përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore sikurse përcakton ligji nr.89/2014 datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, neni 13, produkte të cilat janë zhdoganuar dhe kaluar për tregtim pa miratimet përkatëse si për prodhuesin dhe tregtarin, produkte këto me peshë të vogël dhe vlerë të lartë edhe pse sikurse është evidentuar, vlera e deklaruar rezulton të ketë devijime. Strukturat kontrolluese doganore nuk kanë realizuar kontrollime fizike për këto produkte me qëllim evidentimin e parregullsive. Nga 51 deklarata të evidentuara është konstatuar se 38 raste ose rreth 75% e tyre janë importuar nga Koreja e Jugut.



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nga auditimi në DPT është konstatuar se **gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milionë lekë**, që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitorë. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliardë lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliardë lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë.

Nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale Tatimore është konstatuar nuk janë filluar 109 kontrollime nga 2,982 kontrollime të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pranë DPT në 5 vitet e fundit nuk ka kryer për asnjë rast propozim kontrolli për subjektet e regjistruara si “OJF”, pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë, ku nga databaza e aktivitetit për 5 vitet e fundit, ekzistojnë OJF me qarkullim deri në 728,808,724 lekë, por gjithashtu edhe për risqet e tjera që këto biznese mbartin.

Gjatë vitit 2023 grupet e verifikimit në terren nuk kanë qenë të pajisur me sistemin elektronik të monitorimit “E-Inspektor”, i cili shërben për identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit.

Nga auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në FSDKSH, për periudhën e veprimtarisë janar-dhjetor 2023, ka rezultuar se:

1. Lista e barnave të rimbursueshme nuk është hartuar e miratuar në kohë duke mos respektuar historikun e periodicitetit të miratimit të saj, me pasoja në nivelin e financimit të rimbursimit dhe/ose me ndikim në shëndetin e popullsisë përfitues. Referuar të dhënave të administruara rezultojnë se nga mungesa e hartimit të LBR në vitin 2023 dhe nga mos përfshirja e alternativave të reja me çmim më të ulët buxhetit të do t'i ishin kursyer rreth 3,759,890 euro ose 417.3 milionë lekë.

2. Nga auditimi mbi planifikimin e shpenzimeve për rimbursimin e barnave, rezultoi nga FSDKSH nuk është argumentuar në trajtë konkrete dhe shteruese fakti i rritjes së rimbursimit të barnave në terma faktik, e ndjekur nga rritja e recetave të rimbursueshme pavarësisht uljes së çmimeve të barnave. Nga krahasimi me një vit më parë me vitin 2022, **konstatohet rritje e shpenzimeve të rimbursimit në total prej 563.9 milionë lekë më shumë.** Kjo rritje ka ardhur për shkak të rritjes së numrit të recetave të rimbursuara, rritjes së vlerës mesatare të recetës, rritjes së vlerës së rimbursimit për pacient, gjithashtu rritjes së numrit të barnave të cilat i përkasin listës së rimbursuara të rrjetit të hapur.

3. Në lidhje me financimin e kontratave PPP, ka rezultuar se në tri kontrata, vlera e financimit vjetor, si dhe parashikimet e financimit të tyre në PBA 2023-2025, janë përtej mbështetjes buxhetore të parashikuar për zbatimin e tyre, konkretisht:

a) PPP **"Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale"**. Në vitin 2022 ishin parashikuar 1,700,000 mijë lekë sipas buxhetit vjetor dhe 1,750,000 mijë lekë në buxhetin vjetor të 2023, ndërkohë që pagesat e kryera për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë në trend rritës prej 1,699,975 mijë lekë dhe 1,749,982 mijë lekë.

b) PPP **"Shërbimi i hemodializës"**, në vitin 2022 faturat e pranuar janë në shumën 807,647 mijë lekë, për vitin 2023 shuma 851,974 mijë lekë, ndërkohë projekcioni mbi mbështetjen buxhetore sipas viteve rezultojnë që për vitin 2022 ishte 786,451 mijë lekë dhe për vitin 2023 ishte 835,385 mijë lekë.

c) Përsa i përket PPP **"Shërbimi laboratorik"** ka rezultuar se në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, **numri i ekzaminimeve është rritur me 182,816 raste**, ndërsa shpenzimet buxhetore me 111,836 mijë lekë.



"Efektiviteti dhe siguria e barnave"

KLSH, në përfundim të auditimit me temë **"Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri"** doli me mesazhin:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të vijojnë punën në **garantimin e një sistemi të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së barnave, për të mbrojtur shëndetin e popullsisë** dhe përmirësuar besimin publik në sistemin shëndetësor, nëpërmjet:

- përmirësimit të legjislacionit dhe rregulloreve në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësinë dhe sigurinë e barnave;
- rritjes së kontrollit dhe përforcimit të procedurave të sigurisë;
- implementimit të teknologjive të avancuara të testimit të cilësisë së barnave;
- kualifikimit dhe trajnimit të personelit;
- forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve;
- ndërmarrjes së fushatave të ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe profesionistëve të shëndetësisë mbi rëndësinë e përdorimit të barnave të sigurta dhe të kontrolluara;
- dhe inkurajimit të raportimit nga pacientët dhe mjekët mbi efektet anësore ose defektet e mundshme të barnave.

Nga auditimi në subjektin "Agjencia për Eficencën e Energjisë" (AEE), u konstatuan parregullsi lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë së këtij institucioni me kuadrin ligjor në fuqi, më kryesoret e të cilave në mënyrë të përmblodhur janë:

1. AEE ka lidhur kontratën nr. 306/12 prot., datë 14.05.2021, me objekt "Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km smart city, rruga e energjisë së pastër", afat përfundimi 6 muaj, por kjo kontratë ende nuk ka përfunduar, duke bërë që ky projekt të mos arrijë qëllimin për të cilin është hartuar, si dhe vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar), të jetë shpenzim pa efektivitet.

Gjithashtu, me kalimin e viteve pajisjet e vendosura do të amortizohen dhe për vendosjen në punë të tyre do të kërkojnë fonde shtesë, duke rritur vlerën e investimit, si dhe duke sjellë humbje të vlerës së energjisë që duhet të prodhohin pajisjet e instaluar.

2. Sistemi i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i eficientës së energjisë, nuk ka pasur mirëmbajtje të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme, si në hedhjen e të dhënave, ashtu edhe në përpunimin e tyre. Ky sistem nuk mundëson gjenerim të raporteve të ndryshme, të cilat ishin të nevojshme për të kryer sondazhe në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

3. AEE ka nisur procedurën e prokurimit me objekt "Projekt pilot për përmirësimin e eficientës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza", në UK Durrës, me kërkesën e kësaj të fundit, por pa kërkesën dhe bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar nga AEE. Në përfundim të investimit, AEE nuk ka kryer monitorimin e eficientës së energjisë reale të arritur, duke mos përcaktuar realisht nëse investimi i kryer ja ka arritur qëllimit lidhur me rritjen e eficientës së energjisë.

Auditimi i ushtruar tek Instituti i Statistikave



KLSH, nga auditimi që ka zhvilluar në INSTAT, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri 31.12.2023, **ka konstatuar disa mangësi kryesisht mbi Projektin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave**. Nga ana e INSTAT nuk është zhvilluar Projekti i Cens-it sipas Planit Vjetor 2022, duke mos respektuar afatet e miratuara dhe duke shtyrë fazat e grumbullimit, përpunimit dhe publikimit të të dhënave, si rrjedhojë e procedurës së prokurimit publik për blerjen e tabletave dhe pajisjeve të tjera, e cila ka dështuar për shkak të mospërputhjeve në specifikimet teknike, si dhe anulimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Këto mangësi theksojnë dobësitë në planifikimin dhe zbatimin e projektit, duke çenuar përmblidhjen e detyrimeve ligjore dhe objektiveve të përcaktuara.

Gjatë auditimit të fazës parapërgatitore të Projektit të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave të zhvilluar në vitin 2023, KLSH ka evidentuar disa mangësi, në sigurimin e ambienteve për magazinimin e pajisjeve elektronike (tableta), duke rrezikuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.

TAKIME NË UNIVERSITETE PËR PLANIN E AUDITIMIT NË VITIN 2025

Workshop

Përgjatë muajit tetor-nëntor 2024, departamentet e auditimit në KLSH kanë zhvilluar takime pune në disa prej universiteteve publike lidhur me procesin e përgatitjes së temave të auditimit për vitin 2025.

Në datë 05.11.2024, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore zhvilluan në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër workshop-in "Planifikimi i veprimtarisë audituese për vitin 2025".

Fjalën përshëndetëse të këtij workshop-i e mbajti Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, e cila pasi falënderoi drejtuesit e universitetit për mikpritjen, theksoi rëndësinë e këtij takimi në vazhden e aktiviteteve të Planit Strategjik të KLSH-së.

Në fjalën e saj, znj. Gaxha u përqendrua në veprimtarinë audituese të KLSH-së, raportet përfundimtare të auditimit të cilat pasqyrohen në faqen zyrtare të institucionit për opinionin e gjerë, rezultatet e të cilave duhet të diskutohen edhe në takime me studentë e pedagogë.

Më pas, znj. Gaxha u shpreh se dyert e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë të hapura për studentët, të cilët janë të interesuar që pasi të mbarojnë studimet të konkurrojnë për t'u bërë pjesë e KLSH-së.

Rektori z. Tonin Gjuraj, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi Kryetarin e KLSH-së, z. Arben Shehu, për zgjedhjen e auditorit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" për të paraqitur punën audituese të KLSH-së.

Z. Gjuraj theksoi rëndësinë që ka ky takim për të dyja palët, pasi dhënia e mendimeve dhe diskutimeve u vlen pedagogëve e studentëve në fushën akademike, por edhe audituesve të KLSH-së në këndvështrimin e tyre për punën audituese.

Gjatë takimit u diskutua me pedagogët dhe studentët lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Takimi në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë

Në datë 01.11.2024, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH finalizoi në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë procesin e përgatitjes së temave të auditimit për vitin 2025.

Në këtë takim morën pjesë drejtues të institucionit dhe departamenteve të auditimit në KLSH, si dhe audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës.

Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, bëri një përmbledhje të gjithë procesit të realizimit, planifikimit të temave të auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Performancës, duke paraqitur dhe disa nga fushat të cilat janë propozuar të përfshihen në planin vjetor të auditimeve për vitin 2025.

Pjesëmarrës në aktivitet ishin Prof. Dr. Jaho Cana, Rektor i Universitetit "Eqrem Çabej", pedagogë dhe studentë.



Në datat 29-30 tetor, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore dhe Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvilluan në Universitetin "Fan S. Noli", workshop-in "Planifikimi i veprimtarisë audituese për vitin 2025".

Drejtorët e Departamenteve të Auditimit theksuan se tashmë ka një traditë për hartimin e planit të auditimeve, i cili bëhet detyrim pas miratimit nga Kryetari i KLSH-së dhe për efekt të transparencës publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

Aktiviteti u përshëndet nga Rektori i Universitetit "Fan S. Noli", Prof. Dr. Lenci Ekonomi dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. As. Dr. Ledina Aliolli.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe student, të cilët u inkurajuan për një pjesëmarrje aktive si dhe dhënien e mendimeve mbi perceptimin e tyre për problematikat e realitetit. Në fund të aktivitetit u shkëmbyen idetë për subjektet që duhen të përfshihen në planin vjetor të auditimeve për vitin 2025.

Progres-raporti i BE vlerëson rolin dhe punën e KLSH-së në procesin integruar

Progres-Raporti 2024 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë vlerëson rolin dhe punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit në procesin integruar.

Në seksionin që i përket analizës së kapitullit 32 mbi **"Kontrollin Financiar"**, Komisioni Evropian (KE) shprehet se cilësia e punës audituese është përmirësuar dhe është në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

"Kuatri ligjor i Shqipërisë garanton pavarësinë e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë periudhës raportuese, KLSH miratoi Strategjinë e Zhvillimit 2023-2027. KLSH ka vazhduar të përmirësojë kapacitetet e tij institucionale. Numri i stafit është rritur në 216 punonjës. KLSH vazhdon të kryejë aktivitete të zhvillimit profesional për stafin auditues, bazuar në palin vjetor. Objektivat e KLSH janë zhvendosur tek auditimet e performancës dhe ato financiare. Ndikimi i punës së auditimit ka treguar progres. Në vitin 2023 i janë dorëzuar Kuvendit 160 raporte auditimi. KLSH raporton rregullisht për zbatimin e rekomandimeve të tij," thuhet në Progres-Raportin e vitit 2024.

Në këtë dokument, KE rekomandon që Shqipëria të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm. *"Edhe pse 98% e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2022 janë pranuar, vetëm 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht deri në fund të vitit 2023. KLSH ka raportuar në Prokurori katër kallëzime penale në vitin 2022, ku përfshiheshin 16 zyrtarë. KLSH vazhdon të bashkëpunojë dhe t'i japë informacion organit të akuzës në lidhje me gjetjet e auditimeve të tij, të cilat mund të kenë elemente të veprës penale. KLSH ka përcjellë 67 materiale në Prokurorinë e Posaçme në vitin 2023,"* evidentohet në Progres-Raport.

KE thekson se rritja e përdorimit të auditimeve të KLSH-së në procesin e mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit duhet të sigurohet nëpërmjet funksionalizimit të nënkomisionit parlamentar të ngritur së fundmi. Në Progres-Raport thuhet se kërkohen përpjekje të mëtejshme për të garantuar zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe se raportimi i institucionit duhet të vlerësohet dhe përdoret në mënyrë kuptimplotë nga Parlamenti.

AKTIVITETE

KLSH-TCA intesifikojnë bashkëpunimin

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në datën 03.10.2024 priti në një vizitë zyrtare dyditore Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Metin Yener dhe delegacionin që e shoqëronte. Gjatë kësaj vizite u nënshkrua dhe një Memorandum Mirëkuptimi për vijimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve supreme të auditimit.

Kryetari i KLSH-së falënderoi z. Metin Yener për vizitën dhe shprehu vlerësimet më të larta për marrëdhënien e bashkëpunimit që është krijuar me Gjykatën Turke të Llogarive.

Z. Shehu dhe homologu turk z. Yener, shprehën angazhimin e plotë në forcimin e bashkëpunimit në çështje me interes të përbashkët.



KLSH-ZKA, takim pune në shërbim të përmirësimit të auditimit publik

Me ftesë të Auditorës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës, znj. Vlora Spanca, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, së bashku me një delegacion, zhvilloi një vizitë pune në datën 25 tetor në Prizren.

Takimi kishte për qëllim diskutimin gjithëpërfshirës të temave me interes të përbashkët, në shërbim të përmirësimit të auditimit publik në të dyja vendet.



Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH



Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë



www.klsh.org.al



E-mail: klsh@klsh.org.al
info@klsh.org.al




Orari pritjeve për publikun:
E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30
E premte: 08:00 – 14:00





**DHJETOR
2024**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Dhjetor 2024



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë takimit me Zv. Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Arben Fetai

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në vizitë zyrtare Zv. Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, z. Arben Fetai

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në datën 14.11.2024 priti në një vizitë zyrtare Zv. Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Arben Fetai me delegacionin e tij. Në këtë vizitë, Zv.Kryeministri Fetai shoqërohej nga z. Agim Mahmuti, shef kabineti i Zv.Kryeministrit dhe znj. Bardha Nasufi, këshilltare e kabinetit, si dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në RMV, z. Denion Mejdani.

Kryetari i KLSH-së falënderoi z. Arben Fetai për vizitën dhe shprehu vlerësimet më të larta për bashkëpunimin aktual me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, z. Shehu theksoi përkushtimin për intensifikimin e marrëdhënieve me institucionin homolog të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, në funksion të ndarjes së eksperiencës për kryerjen e auditimeve cilësore dhe nxitjes së përgjegjshmërisë, transparencës dhe përmirësimit të shërbimeve publike.

Z. Fetai ndau në këtë takim sfidat me të cilat përballen institucionet, duke u ndalur te rëndësia e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe rolin e institucionit suprem të auditimit në veçanti. Në përfundim të takimit, z. Shehu dhe z. Fetai shprehën angazhimin e përbashkët për vijueshmërinë e bashkëpunimeve në të ardhmen, të konkretizuara me projekte për fushat prioritare të vlerësuara me rëndësi të veçantë.



Statistika



111 auditime të evaduara deri në muajin nëntor për vitin 2024

4 auditime të përfunduara në muajin nëntor 2024

32 auditime janë në proces evadimi

89 raporte auditimi të publikuara në web

Miratohet Kodi i ri Etik i KLSH bazuar në standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

Për të garantuar besimin publik në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në mbështetje të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu miratoi në datën 15.11.2024 Kodin Etik të punonjësve**. Kodi i Etikës përmban vlerat dhe parimet që duhet të ndiqen dhe të udhëheqin veprimtarinë e të gjithë punonjësve të institucionit, në të gjitha nivelet, si dhe të personave të tjerë që punojnë në emër të këtij institucioni, për të siguruar një sjellje dhe mjedis pune që nxisin zbatimin e parimeve të etikës sipas standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Këto subjekte nga ana tjetër kanë detyrimin që t'i njohin dhe t'i zbatojnë me korrektësi parashikimet e Kodit të Etikës gjatë përmbushjes së detyrave dhe në jetën e përditshme.

Kodi u mundëson punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit që të identifikojnë, vlerësojnë e shmangin reagime apo situata që mund të kërcënojnë respektimin e parimeve themelore të etikës dhe shërben si udhëzues praktik për diskutimet dhe qëndrimet që lidhen me mëdyshjet dhe paqartësitë etike, nën frymën e akteve ligjore e nënligjore dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit, që normojnë veprimtarinë e këtij institucioni e që trajtojnë çështjet e etikës.

Kodi Etik u hartua nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 28, datë 12.3.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin e Kodit Etik të KLSH-së", të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me kontributin e trupës drejtuese, duke pasur për bazë parashikimet e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", standardet ndërkombëtare të INTOSAI-P1 "Deklarata e Limës", INTOSAI - P-10 "Deklarata e Meksikës: Mbi pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit", INTOSAI-P12 "Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit", ISSAI 130 "Kodi i Etikës", dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KLSH përfundon me sukses pilotimin e ISSAI 140, për implementimin e Sistemit Efektiv të Menaxhimit të Cilësisë, udhëhequr nga IDI



Pas një pune të vazhdueshme gati 2-vjeçare, në muajin dhjetor përfundoi me sukses projekti i Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) "Pilotimi i SAI-eve për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, në kuadër të rishikimit të ISSAI 140"[1]. Kjo nismë synon të ofrojë për të gjithë SAI-t në mbarë botën mjetet e nevojshme për të rritur cilësinë dhe efektivitetin e auditimeve të tyre dhe për të siguruar përputhjen me standardet e reja ISSAI 140 "Menaxhimi i Cilësisë së Auditimit", i rishikuar. Projekti pilot ishte një gur themeli, i krijuar për të ndihmuar SAI-et në zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të tyre të menaxhimit të cilësisë së auditimit dhe përfshiu 12 SAI-e nga rajonet anglishtfolëse respektivisht përfaqësues të EUROSAI, CAROSAI, ASOSAI dhe AFROSAI-E.



Integriteti - prioritet i KLSH

Auditimet tona udhëhiqen nga Kodi i Etikës, plotësisht në përputhje me ISSAI 130, duke siguruar që integriteti të mbetet prioriteti ynë kryesor, duke synuar:

- Të garantojmë paanshmëri dhe shmangim konfliktet e interesit në punën tonë.
- Të respektojmë dhe mbrojmë informacionin e ndjeshëm të marrë gjatë auditimeve.
- Të ruajmë profesionalizmin, duke siguruar që sjellja jonë të reflektohet pozitivisht në institucionin tonë.

Si pjesë e EUROSAI-t, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në këtë projekt me një ekip shumëdisiplinor me ekspertizë në standardet e auditimit, metodologjinë e auditimit, sigurimin e cilësisë, planifikimin strategjik dhe zhvillimin e politikave.

I udhëhequr nga IDI, ky ekip siguroi që Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SoAQM) të përputhet edhe me objektivat strategjike të KLSH-së.

Nëpërmjet pilotimit, trajnimeve të vazhdueshme online si dhe takimeve fizike, ekipi i KLSH-së, nën drejtimin e IDI-t, vlerësoi sistemet ekzistuese të kontrollit, identifikoi boshllëqe dhe zhvilloi politika për të krijuar Kornizën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, plotësisht në përputhje me ISSAI 140, të rishikuar.

Në përfundim të ciklit të trajnimeve të vazhdueshme, pjesë e programit të këtij projekti, **KLSH hartoi dokumentin e "Analizës së Nevojave dhe Politikën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në KLSH"**, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 128, datë 01.07.2024; si dhe Udhëzuesin e Menaxhimit të Riskut, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 219, datë 18.11.2024, të cilat përbëjnë Kornizën ligjore dhe rregullatore për implementimin e suksesshëm të sistemit efektiv të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me gjithë çfarë diktojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

KLSH, pjesë e auditimit global mbi “Ndryshimet klimatike”



Kontrulli i Lartë i Shtetit, në kuadër të Auditimit të Përbashkët Global mbi “Veprimet e Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike” të ideuar nga IDI dhe INTOSAI WGEA, ka realizuar një auditim performance në këtë fushë, duke ndjekur të gjitha trajnimet dhe diskutimet “on-line” nga IDI dhe INTOSAI WGEA.

KLSH propozoi dhe realizoi temën “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” (i cili lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 13).

Sa më sipër, në këtë projekt auditimi u vlerësua:

- Efektiviteti i implementimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të NAP.
- Efektiviteti i menaxhimit të fondeve për veprimet prioritare të ndërmarra mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Eficienca e strukturave të ngritura me qëllim zbatimin e NAP.

Në përfundim, grupi arriti në këtë **mesazh auditimi**:

“Gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për nxitjen e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MMT) synon marrjen e masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, MTM nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e NAP.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit lidhur me ndryshimet klimatike në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim është e rëndësishme që MTM të marrë masa me qëllim që procesi i NAP të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimëve në mënyrë periodike”.

KLSH MIRATON PROGRAMIN E VEPRIMTARISË AUDITUESE PËR VITIN 2025

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe rregulloret e brendshme të institucionit, **Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu miratoi në datën 15.11.2024 “Planin e veprimtarisë audituese për vitin 2025”.** Programi përmban **180 auditime** të llojeve të ndryshme sipas departamenteve dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

Moshimi i popullsisë - KLSH, auditim paralel me SAI-n e Izraelit

Në zbatim të vendimit të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, për të marrë pjesë në Auditimin Paralel të Performancës me temë “Moshimi i Popullsisë” i cili drejtohet nga SAI i Izraelit, **Departamenti i Auditimit të Performancës do të kryejë auditimin “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”.** Në këtë temë auditimi do të angazhohen në total 6 Institucione Supreme Auditimi (Shqipëria, Portugalia, Paraguai, Maqedonia e Veriut, Sllovakia dhe Izraeli). Auditimi është pjesë e “Planit vjetor të auditimeve për vitin 2025” dhe do të fillojë në muajin janar 2025, duke ndjekur afatet kohore të përcaktuara nga të gjithë SAI-t pjesëmarrës.

Për kryerjen e këtij auditimi, në datë 7 nëntor është zhvilluar online takimi i fillimit me pjesëmarrjen e z. Matanyahu Englman – Kryetar i SAI-t të Izraelit dhe Avokat i Popullit si dhe aktualisht President i EUROSAT-t. Për t'u angazhuar në këtë auditim paralel kishin shfaqur interes 15 SAI përfshirë edhe KLSH, konkretisht, Austria, Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Hungaria, Izraeli, Lituania, Malta, Meksika, Maqedonia e Veriut, Paraguai, Polonia, Portugalia dhe Sllovakia.

Në takim u diskutua rreth disa temave të propozuara për auditim me fokus moshimin e popullsisë në referencë të situatës dhe zhvillimeve në secilin shtet. Në përfundim të diskutimeve u përzgjedhën 5 temat si më poshtë:

1. Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim.
2. Përgatitja e sistemit shëndetësor për një popullsi në moshim. – Kujdesi për të moshuarit në bazë komuniteti.
3. Përgatitja e sistemit të mirëqenies për një popullsi në moshim. – Mirëqenia dhe cilësia e jetës pas daljes në pension.
4. Efektet e një popullate në moshim në tregun e punës dhe sistemi i mirëqenies.
5. Përgatitja e sistemit të pensioneve për një popullsi në moshim.

Lidhur me temat e propozuara, pjesa më e madhe e SAI-ve, përfshirë edhe KLSH, votuan për temën e parë “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”, duke konsideruar se auditimi për këtë çështje duhet të fillojë në nivel makro për të vlerësuar nëse qeveria ka plane e politika të miratuara dhe të mbështetura në buxhet, si dhe të dhëna.

№	Titulli i auditimit	Kategoria	Data e planifikuar
1	... (text too small to read)
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18

KLSH auditon zbatimin e rekomandimeve në 10 subjekte, pranohen 98% dhe zbatohen plotësisht 36% e masave

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit, auditori “Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme” në 10 subjektet si më poshtë:

- Universiteti Mjekësisë, Tiranë
- Universiteti Sporteve, Tiranë
- Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
- Spitali Universitar i Traumës
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
- Operatori Sistemit të Transmetimit
- Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- Hekurudha Shqiptare SHA
- Posta Shqiptare SHA
- Albpetrol SHA

Nga auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2023 (gjashtë mujori i dytë)”, niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë vijon: Nga auditimi i kryer në 10 subjekte është evidentuar një shkallë e lartë e pranimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes, ku **nga 474 masa të rekomanduara gjithsej janë pranuar 465 masa ose 98 %**, si dhe nuk janë pranuar 9 masa ose 2 %.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar për këto subjekte, rezulton sipas kësaj strukture:

- **zbatuar plotësisht 168 masa ose 36%;**
- **zbatuar pjesërisht 185 masa ose 40 %;**
- **si dhe rezultojnë 112 masa të pa zbatuara ose 24 %.**

Në mënyrë më të detajuar situata paraqitet si vijon:


Masa për përmirësime/ndryshime legjislativore

Nga 2 masa të rekomanduara janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100%. Nga masat e pranuar, 2 rekomandime ose 100 % janë zbatuar pjesërisht.

Masa organizative

Nga 314 masa të rekomanduara janë pranuar plotësisht 310 rekomandime ose 98 % dhe 4 rekomandime nuk janë pranuar ose 2 %.

Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 132 rekomandime ose 39 %; janë zbatuar pjesërisht 138 rekomandime ose 38 %, si dhe 41 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara ose 23 %.



Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”

Nga 80 masa të rekomanduara në vlerën 2,409,219,159.8 lekë, 9,579 euro dhe 60,620,807 dollarë janë pranuar plotësisht 79 rekomandime ose 99 % e tyre (në vlerën 2,409,219,159.8 lekë dhe 9,579 euro dhe 60,620,807 dollarë).

Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 20 rekomandime ose 25 % në vlerën 234,226,014.8 lekë dhe 9,579 euro, janë zbatuar pjesërisht 19 rekomandime ose 24 % e tyre (në vlerën 496,303,816 lekë, 39,247,000 \$), dhe rezultojnë pa zbatuar 40 rekomandime ose 51 % e tyre (në vlerën 2,261,491,685.8 lekë dhe 21,373,807 dollarë).

Masa shpërblym dëmi

Nga 64 masa të rekomanduara në vlerën 4,954,702,000 lekë janë pranuar plotësisht 61 rekomandime ose 96 % e tyre (në vlerën 4,939,870,302 lekë) dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime ose 4 % (në vlerën 14,831,698 lekë).

Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime ose 21 % me vlerën 3,547,275 lekë; janë zbatuar pjesërisht 20 rekomandime ose 33 % me vlerën 3,282,021,282 lekë, si dhe 28 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara me vlerën 1,754,301,745 lekë ose 46 %.

Masa disiplinore

Nga 11 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime ose 91 % dhe 1 rekomandim nuk është pranuar ose 9 %.

Nga masat e pranuar 2 rekomandime ose 20 % e tyre janë zbatuar plotësisht, 6 rekomandime ose 60 % e tyre janë zbatuar pjesërisht dhe 2 rekomandime ose 20 % e tyre rezultojnë të pa zbatuara.

Masa administrative

Nga 2 masa të rekomanduara janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100 % e tyre.

Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 rekomandim ose 50 % dhe 1 rekomandim rezulton i pa zbatuar ose 50 %.

Rekomandimet e “pazbatuara” për auditimin në Albpetrol sh.a

- Nga Albpetrol sh.a, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 1,180,887,615 lekë nga shoqëria BPA LTD, krijuar nga mospagesa e vlerës së detyrimit të konsumit të energjisë dhe kamatëvonesat për pagesat me vonesë të BPA LTD, detyrim i cili i paguhet Albpetrol për llogari të FSHU sh.a.
- Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për tërheqjen e sasisë 29,103.96 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri më 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktojë sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 14,476,000 USD dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.



Bashkëpunimi KLSH-Kuvend, nis punën Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik

Në datën 12.11.2024, u zhvillua mbledhja e parë e Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Shqyrtimi i projektbuxhetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025, si dhe prezantimi i raportit të auditimit të performancës “Kujdesi ndaj të moshuarve” ishin dy çështjet e rendit të ditës.

Nën drejtimin e kryetares së Komisionit, znj. Emilia Koliqi, u zhvillua dëgjesa për projektbuxhetin me përfaqësuesit e KLSH-së. Në këtë mbledhje morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar, znj. Brunilda Zeneli, znj. Alketa Kalleshi, Nëpunëse Zbatuese.

Znj. Gaxha sqaroi se në hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2025-2027, prioritet i institucionit është shtimi i punonjësve për shkak të kërkesave në rritje për auditime nga grupet e interesit, investimet në infrastrukturën IT në funksion të rritjes së sigurisë kibernetike, si dhe miratimi i fondit të përlogarit për kremtimin e 100-vjetorit të krijimit të institucionit.

Pas dëgjësës për projektbuxhetin, mbledhja vijoi me prezantimin e raportit të auditimit të performancës “Kujdesi ndaj të moshuarve”.

Znj. Arminda Bushi, audituese në KLSH, bëri një përmbledhje të gjetjeve kryesore të auditimit, duke evidentuar numrin e pamjaftueshëm të punonjësve që ofrojnë shërbime në qendrat rezidenciale, mungesën e infrastrukturës dhe aksesit për të kryer shërbimin sipas standardeve për të moshuarit, etj.

Gjetjet nga auditimi: Vlerësimi i kujdesit shëndetësor

Sa i përket vlerësimit të kujdesit shëndetësor dhe mjekimit të ofruar për të moshuarit rezident, disa nga problematikat e evidentuara gjatë auditimit janë:

- Mungesa e mjekëve specialist (sipas problematikave dhe nevojave të të moshuarve) në institucionet rezidenciale.
- Mungesa e një mjeku psikiatër të angazhuar në institucionet rezidenciale, pavarësisht faktit se mesatarisht 45% e rezidentëve paraqesin probleme të shëndetit mendor.
- Mungesa e një automjeti në dispozicion me qëllim transferimin e të moshuarve nga spitali pas rehabilitimit të tyre.
- Mungesa e aksesit në shërbimin dentar për të moshuarit.
- Mungesa e një liste të unifikuar të ilaçeve që mbahen në institucionet rezidenciale për raste emergjente, etj.

Departamenti për Çështjet Juridike kundër Mashtrimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, vizitë studimore në KLSH

Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit, në datat 4-5 nëntor 2024 u zhvillua në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, një vizitë studimore e drejtuesve të Departamentit për Çështjet Juridike kundër Mashtrimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (ZKA). Përfaqësuesit e ZKA-së u pritën gjatë ditës së parë të vizitës nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, znj. Marjola Llanaj dhe drejtuesit e Drejtorisë Juridike në KLSH.

Qëllimi i vizitës dyditore ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira lidhur me procesin e përcjelljes së rasteve të procedimeve penale Prokurori. Gjatë diskutimeve u trajtuan roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit në parandalimin dhe identifikimin e rasteve abuzive dhe veprave penale. Vëmëndje e veçantë iu kushtua rolit të grupit të auditimit në identifikimin e rasteve që mund të dërgohen në Prokurori, rekomandimi për kallëzim penal ose sugjerimi për trajtim të detajuar tekniko-juridik të materialeve sipas parashikimeve të Kodit Penal.



Në takim u diskutua edhe për bashkëpunimin e institucioneve supreme të auditimit me institucionet e tjera dhe Prokurorinë në luftën kundër korrupsionit.

MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME SAI-N E NORVEGJISË ZHVILLOHEN NË KLSH SESIONET E TRAJNIMIT ME EKSPERTËT NORVEGJEZË PËR AUDITIMET E PERFORMANCËS DHE IT



Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë, të nënshkruar në maj 2022, për auditimet e performancës në fushën e mjedisit dhe auditimet IT, ekspertët norvegjezë kanë zhvilluar trajnime me audituesit e KLSH-së.

Në datat 12-13 dhe 18-19 nëntor 2024, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvilluan sesionet e trajnimit të drejtuara nga ekspertët norvegjezë për auditimet e performancës. Auditimi i parë ishte ai me temë "Cilësia e ujërave në plazhe" me grupin e përbërë: nga z. Aulent Guri (përgjegjës i grupit), znj. Arminda Bushi, znj. Annavanessa Hoxhaj, znj. Vjola Kojani dhe znj. Eva Kushta dhe nën ekspertizën e ekspertëve norvegjezë: znj. Guri Andrea Lowrie dhe z. Bjørn Martin Ørvim. Auditimi i dytë i përzgjedhur ishte ai me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar" me grupin e përbërë nga: z. Klarenc Xhaferaj (përgjegjës i grupit), znj. Xhuljeta Çelaj, znj. Jorida Zhegu, znj. Arjeta Çoku, dhe znj. Brisilda Hyka, nën ekspertizën e ekspertëve norvegjezë: znj. Florina Zagragja, z. Torkel Graham-Haga dhe z. Bjørn Harald Bratli.

Fokusi kryesor i asistencës së ekspertëve norvegjezë në të dy auditimet është mbështetja ndaj grupeve të auditimit duke filluar nga hartimi i draft-programeve të auditimit, për të kaluar më tej në detaje lidhur me piramidën e pyetjeve, si dhe çështjet apo gjetjet që priten të gjenerohen për secilën pyetje deri tek proceset e hartimit, të paraqitjes vizuale të të dhënave, mbështetur në praktikatat më të mira të SAI-t të Norvegjisë.

Grupet e auditimit prezantuan të dhënat e siguruar deri më tani nga subjektet, si dhe pritshmëritë mbi gjetjet e mundshme të auditimit.



Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, i falënderoi përfaqësuesit e SAI-t të Norvegjisë për të gjithë angazhimin e tyre dhe theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të proceseve të auditimit të performancës në KLSH.

Nga ana e tyre gjithashtu, ekspertët norvegjezë shprehën gatishmërinë për të vijuar mbështetjen, referuar praktikave që ndiqen prej tyre në auditimet e performancës, si dhe intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy SAI-ve.

Trajnime për auditimet IT

Gjithashtu, në datat 28 tetor – 1 nëntor 2024, u zhvillua në KLSH trajnimi i radhës me ekspertët norvegjezë për përmirësimin e cilësisë së auditimeve IT, me fokus në Sigurinë e Informacionit dhe Qeverisjen e IT-së. Trajnimi kontribuon në përmirësimin e kapaciteteve të auditimit të IT-së, por siguron edhe që audituesit e KLSH-së, të jenë të pajisur me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për t'u përshtatur me kërkesat në zhvillim të auditimit të IT-së, duke forcuar kështu efektivitetin dhe thellësinë e praktikave në auditim.

Angazhimi i KLSH-së për zhvillimin e njohurive në auditime e Sigurisë Kibernetike dhe Financiare të IT-së mbetet një objektivi afatgjatë, i fokusuar në sigurimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe përmirësimin e metodologjive të auditimit. Me bashkëpunimin e vazhdueshëm me SAI-n e Norvegjisë për vitin 2025 janë planifikuar të realizohen 3 tema të tjera trajnime për audituesit e Teknologjisë së Informacionit.

“PËRMIRËSIMI I SHKRIMIT TË RAPORTEVE”

Workshop i organizuar nga SIGMA dhe CEF në Lubjanë me Institucionet Supreme të Auditimit kandidatë dhe kandidatë potenciale

SIGMA dhe CEF organizuan në Lubjanë, në datat 7 dhe 8 nëntor workshop-in me rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale me temë "Përmirësimi i shkrimit të raporteve". Ky workshop u mbështet gjithashtu edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO). Takimi u hap nga fjala përshëndetëse e Drejtoreshës së CEF, znj. Jana Repansek, e cila prezantoi konceptin "How public institutions can become a learning organisation", që aplikohet në CEF, si dhe znj. Bianca Breteche, Zëvendës Drejtuese e SIGMA-s. Organizatorët dhe institucionet homologe pjesëmarrëse patën mundësinë të prezantonin dhe ndanin në këtë tryezë jo vetëm parimet dhe elementët e të shkruarit efektiv të raporteve të auditimit, hartimit dhe implementimit të guidave të përdorimit të gjuhës së thjeshtë dhe miqësore me lexuesin dhe grupet e interesit, por edhe evidentimin e barrierave



në këtë proces, gjatë aplikimit, oportuniteteve dhe pozicionimin e secilit Institucion Suprem Auditimi (SAI) për të gjitha këto aspekte.

Nën dritën e eksperiencës së sjellë nga Gjykata Europiane e Llogarive (ECA), SNAO dhe SAI-t e rrjetit u ngritën tryeza diskutimi, të cilat konkluduan në përfundim me sugjerime konkrete për SAI-t dhe rrjetin me qëllim zhvillimin e praktikave të shkrimit të mirë të raporteve në vijimësi. KLSH, në këtë takim u përfaqësua nga znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm dhe znj. Xhesika Xhuveli, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.



KLSH, pjesë e aktiviteteve për 30-vjetorin e krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë

Delegacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i përfaqësuar nga znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm, z. Bledar Doracaj, drejtor i Departamentit të Vetëqeverisjes Vendore, znj. Joana Troqe, drejtor i Departamentit të Buxhetit të Shtetit, dhe z. Paolo Xhezo, drejtor i Departamentit të Departamentit të Auditimit të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Pronës Publike, mori pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 30-vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë, të cilat u zhvilluan në Zagreb, në datat 20- 21 nëntor 2024.

Gjatë fjalës hapëse të konferencës së organizuar me rastin e 30-vjetorit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe shprehu gatishmërinë për intensifikimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët me SAI-et homologe, me qëllim shkëmbimin e përvojave më të mira mbi cilësinë e auditimit.

Delegacioni i KLSH-së merr pjesë në 25-vjetorin e krijimit të Entit Shtetëror të Revizionit në Maqedoninë e Veriut

Në datat 26 dhe 27 nëntor 2024, një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit mori pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 25-vjetorit të krijimit të Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në krenim të këtij përvjetori, nën organizimin e ESHR-së dhe pjesërisht të mbështetur edhe nga EUROSAI, në Shkup u organizua konferenca me temë "Shkëmbimi i përvojave në proceset e komunikimit të Institucioneve Supreme të Auditimit me palët e interesuara – mundësitë dhe sfidat", e cila mbledhi ekspertë nga organizata ndërkombëtare të ndryshme, Institucione Supreme të Auditimit dhe organizata profesionale.

Sesioni i parë i konferencës u fokusua në transparencën dhe rëndësinë e komunikimit të qartë të gjetjeve të auditimit si bazë për ndërtimin e besimit dhe nxitjen e reagimeve në kohë, ndërsa sesioni i dytë iu kushtua zbatimit të mjeteve dhe teknologjisë inovative të komunikimit, të cilat përmirësojnë procesin e auditimit dhe rrisin transparencën.

KLSH u përfaqësua në këto aktivitete nga Kabineti i Kryetarit, znj. Marjola Llanaj dhe z. Ardian Myslimaj, si dhe z. Rysisim Xhaja, drejtor i Departamentit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja dhe znj. Xhesila Nano, audituese.

INFORMIMI I PUBLIKUT- KLSH në Facebook dhe Instagram





Në kuadër të mirëinformimit të publikut dhe grupeve të interesit, informacionet lidhur me veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ndiqen edhe në platformat Facebook dhe Instagram.

Facebook:
<https://www.facebook.com/profile.php?id=61569509802410&mibextid=ZbWKwL>

Instagram:
https://www.instagram.com/kontrolli_i_larte_i_shtetit/

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH


 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 www.klsh.org.al
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00





JANAR
2025

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Janar 2025



Nga takimi përmbyllës në Tiranë për projektin SECO

KLSH përmbyll me sukses projektin SECO. Realizohen 3 auditime pilot për kontratat koncesionare dhe të PPP-ve

Në kuadër të përmbylljes së projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) i Zvicrës, në datën 23 dhjetor 2024, në ambientet e hotel “Plaza” Tiranë, u organizua ceremonia përmbyllëse.

Në aktivitet ishte i ftuar Zv. Ambasadori zvicerian, z. Philipp Arnold, stafi drejtues i Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit e përfshirë në auditimet pilot, si dhe ekspertë nga shoqëria civile.



Në fjalën e tij, Zv. Ambasadori zvicerian theksoi rëndësinë dhe ecurinë e suksesshme të bashkëpunimit me KLSH-në në fushën e auditimit të koncesioneve/PPP-ve, si një kontribut me vlerë në auditimin e menaxhimit të fondeve publike. Ky bashkëpunim ka ndikuar në përmirësimin e teknikave të auditimit, si dhe në rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të KLSH-së.



Përfaqësuesit e KLSH-së theksuan se bashkëpunimi i frytshëm në kuadër të këtij projekti ka hedhur themele për bashkëpunime të mëtejshme, për të garantuar vijimësinë e forcimit të kapaciteteve në këtë fushë dhe më gjerë, duke mbështetur kështu edhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit publik në Shqipëri.

Në këtë takim u prezantua dhe Manuali i Auditimit të Koncesioneve/PPP-ve, si një dokument me vlerë i cili paraqet të gjitha proceset dhe teknikat e auditimit të përdorura për auditimin e kontratave të koncesionit/PPP, siç identifikohen nga praktikantët më të mira dhe rekomandohen nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Statistika



122 auditime të evaduar për vitin 2024

11 auditime të përfunduara në muajin dhjetor 2024

47 auditime janë në proces evadimi

106 raporte auditimi të publikuara në web



Projekti “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO)

Projekti “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” u zyrtarizua me firmosjen e Marrëveshjes nr. 307, datë 09.03.2020 mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ky projekt kishte për qëllim forcimin e llogaridhënies gjatë përdorimit të fondeve publike nëpërmjet promovimit të mbikëqyrjes dhe shmangies së korrupsionit në hartimin dhe implementimin e kontratave të koncesioneve dhe të PPP-ve në Shqipëri.

Ndjekja dhe implementimi i projektit u krye nga Njësia e Implementimit të Projektit, e përbërë nga znj. Valbona Gaxha, znj. Aulona Jonuzi, znj. Joana Troqe, znj. Xhesila Nano dhe z. Rodjan Alimerkaj.


Nëpërmjet këtij projekti, KLSH realizoi me sukses produktet dhe aktivitetet e parashikuara në Marrëveshje, si më poshtë:

1. Kryerjen e 3 auditimeve pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, të mbështetura në të gjitha fazat e auditimit nga eksperti i jashtëm i kontraktuar si pjesë e projektit.

2. Hartimi i “Manualit për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve”, i cili reflekton eksperiencën e fituar përgjatë kryerjes së 3 auditimeve pilot, shoqëruar me trajnimet e nevojshme.

3. Vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive, me qëllim shkëmbimin e njohurive në fushën e koncesioneve, ku rreth 20 auditues të KLSH-së mësuan nga ekspertiza e kolegëve në këtë fushë.

4. Organizimi i aktivitetit me temë “Roli i auditit të jashtëm në shmangien e korrupsionit në koncesione dhe PPP”, i cili njëkohësisht përkoji me finalizimin e gjithë kësaj pune gati 4-vjeçare, ku morën pjesë auditues, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të Ambasadës Zvicrane në Shqipëri dhe të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO). Në këtë takim u prezantuan rezultatet e projektit.



KLSH auditoi kontratat koncesionare si vijon:

(i) “Financimi, ngritja dhe operimi i **shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve** të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”.

(ii) “Dhënia me koncesion e **shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse**, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimit e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”.

(iii) **Marrëveshjet hidrokarbure.**



“Projekti SECO kishte për qëllim forcimin e llogaridhënies gjatë përdorimit të fondeve publike nëpërmjet promovimit të mbikëqyrjes dhe shmangies së korrupsionit në hartimin dhe implementimin e kontratave të koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.”

KRYETARI I KLSH-SË, Z. ARBEN SHEHU ZHVILLOI NJË TAKIM ME PËRFAQËSUESIN E GUARDIA DI FINANZA, Z. GIAMPIERO CARRIERI



Z. Shehu në takimin me z. Carrieri

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, zhvilloi në mjediset e KLSH-së, një takim me përfaqësuesin e Guardia di Finanza, Kolonel Giampiero Carrieri, ekspert për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi pranë Ambasadës së Italisë në Tiranë.

Në takim u diskutua mbi bashkëpunimin e deritanishëm institucional dhe angazhimin e përbashkët midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Guardia di Finanza. Gjithashtu, në takim u vendosën prioritetet për punën e përbashkët midis dy institucioneve për vitin 2025.

KLSH, vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive për shkëmbimin e eksperiencave në auditimin e kontratave koncensionare dhe PPP-ve



Në kuadër të zbatimit të fazës së fundit të implementimit të projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri”, financiar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), 20 auditues të KLSH-së vizituan në datat 3 dhe 4 dhjetor Gjykatën Turke të Llogarive (TCA).

Delegacioni i audituesve u mirëprit nga Presidenti i TCA-së, z. Metin Yener, i cili e përshëndeti takimin edhe në ditën e dytë të punimeve.



Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte shkëmbimi i eksperiencës së TCA-së në auditimin e kontratave koncensionare dhe të partneritetit publik privat (PPP).

Sipas axhendës së bashkëmiratuar, audituesit e KLSH-së i prezantuan kolegëve produktet e projektit nëpërmjet prezantimeve të metodologjisë së krijuar dhe tre rezultatet auditimeve të realizuara me asistencën e ekspertëve të jashtëm, si dhe u njohën me eksperiencën dhe metodologjinë e tyre në auditimin e kontratave koncensionare.

Për ta konkretizuar edhe më shumë këtë ekspertizë u zhvillua një vizitë me të gjithë përfaqësuesit në qytetin spitalor “Etilik”, një ndër tre spitalet më të mëdhenj në botë, si një nga kontratat koncensionare më të mëdha të partneritetit publik-privat në Turqi, në vitin e tretë të zbatimit të saj.



Markimi i karburanteve, auditohet kontrata koncesionare

KLSH ka audituar përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për “Markimin e karburanteve” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi ka rezultuar se:



- Propozimi i pakërkuar për dhënie me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë deri në momentin e propozimit për dhënie me koncesion të këtij shërbimi. Gjithashtu, nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitim nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi, për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballueshëm për buxhetin e shtetit dhe për të vlerësuar mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim të markimit të karburanteve.
- Referuar të dhënave të Pasqyrave Financiare rezulton se realizimi i investimeve është në masën 68%, në kundërshtim me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit, për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”.
- Grupi i auditimit zhvilloi një verifikim në terren mbi zbatimin e kontratës, ku u konstatua se procesi i markimit është tërësisht manual, hapat që ndiqen nga operatorët e GFI-së për të realizuar procesin e markimit nuk janë sipas procedurës së përcaktuar në kontratë, nuk garantohej përqendrimi i duhur (nuk ndodh homogjenizimi) i markuesit në lëndën djegëse, si dhe nuk bëhen prova apo të merren mostra për të verifikuar nëse përqendrimi i markuesit është sipas normave të përcaktuara në marrëveshje.

Auditimi i sistemeve IT në AKBN

KLSH zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), për periudhën e aktivitetit 01.01.2021-31.12.2023.


Nga auditimi ka rezultuar se:

-Sistemi informatik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore të Republikës së Shqipërisë (Revzone), si dhe sistemi i menaxhimit të licencave dhe koncesioneve (GIS) kanë mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen, përdorimin dhe vazhdimësinë e funksionimit të tyre. Megjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AKBN në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera, nisur nga fakti se zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë.

-Sistemi “Revzone” nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit në sistem me të dhëna të cilat tejkalojnë përmbushjen e afateve sipas deklarimeve që duhet të bëjnë subjektet si dhe dublikimin e informacioneve, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.

KLSH, pjesë e auditimit të përbashkët global të INTOSAI-t për ndryshimet klimatike

Auditimi “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” u zhvillua në kuadër të auditimit të përbashkët global mbi “Veprimet e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike”, ideuar nga IDI dhe INTOSAI WGEA



Në kuadër të auditimit të përbashkët global mbi “Veprimet e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike” ideuar nga Iniciativa Për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) dhe INTOSAI WGEA (Grupi i Punës i INTOSAI-t në kuadër të Auditimeve Mjedisore), KLSH ka përfunduar auditimin e performancës me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”.

Mesazhi i auditimit

Gjatë dy dekadave të fundit sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për shtimin e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të “Planit Kombëtar të Përshtatjes”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon marrjen e masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete të përshtatshme në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit të klimës në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim është e rëndësishme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa me qëllim që procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimave në mënyrë periodike.

Auditimi në Ministrinë e Brendshme

KLSH ka ushtruar auditim përputhshmërie dhe financiar në Ministrinë e Brendshme, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2021-31.12.2023. Ndër gjetjet kryesore nga auditimi janë:

1. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi pagesat e energjisë elektrike u konstatua se MB i ka lindur detyrimi prej 136,142,855 lekë, e cila përbëhet nga vlera e faturave të pa likuiduara në shumën 67,516,013 lekë dhe kamatëvonesave në shumën 68,626,842 lekë, për të cilat institucionet ka lidhur një aktmarrëveshje për shumën totale propozuar shlyerjen në 60 këste.

2. Nga auditimi u konstatua se përveç efektit negativ financiar që mbartin shlyerja e vendimeve gjyqësore për të larguarit pa të drejtë nga puna dhe mos sistemimit të tyre në organikën aktuale të MB një pasojë tjetër me kosto në buxhetin e shtetit është detyrimi që ka gjeneruar dhe rivlerësimi i listë-pagesave mujore me këta gjyq fitues në vite si rezultat i tej zgjatjes së proceseve gjyqësore. Nga verifikimi i detyrimeve të prapambetura të deklaruara në pasqyrat financiare me ato në sistemin tatimor C@TS konstatohet se Ministria e Brendshme ka detyrime në kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore detyrimet (deri më datë 06.03.2024), në vlerën 17,399,158 lekë. Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit verifikoi "moshën" e borxhit në këtë lloj tatimi si dhe arsyen e këtyre vlerave të larta, ku vetëm gjatë dhe interesat janë 10,828,310 lekë.

3. Nga auditimi u konstatua se prona me sipërfaqe 28,452 m² ku ushtronte aktivitetin ish-Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT), institucion në varësi të MB, në harkun kohor prej 24 orësh, pa u kryer paraprakisht një studim dhe vlerësim i ankesës së ardhur nga qytetarët, në raport me interesat e Ministrisë së Brendshme dhe për funksionin e rëndësishëm që QSHAMT ka në administrimin dhe riparimin e mjeteve të MB dhe DPPSH, kaluan përkatësisht në pronësi të MFE-së me sipërfaqe totale 4,122 m² (7 herë më e vogël se sipërfaqja në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT), në përgjegjësi administrimi të MB-së, me qëllim që në këtë pronë të zhvendosej QSHAMT.

Auditimi në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman

KLSH ka përfunduar auditimin në "Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman" dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

-Nga auditimi rezulton se një prej asetëve më të rëndësishme të kësaj ndërmarrje, shkalla "Kosjakova" së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin 1969 dhe amortizimi i kësaj shkalle më 31.12.2023 është në shumën 91,421,173 lekë dhe vlera e mbetur është në shumën 41,391,341 lekë ose 31%, pra tejet e amortizuar. Vlera fillestare e përcaktuar nga ekspertët vlerësues në vitin 2015 është në shumën 120,378,876 lekë. Viti i prodhimit të kësaj platforme, gjendja teknike dhe amortizimi ndër vite bën që veprimtaria e punës së KNRA-së të jetë e kushtëzuar dhe me risk për ngjarje të jashtëzakonshme. Dalja jashtë pune e shkallës përveç se rrezikon jetën dhe pronën nxjerr nga gatishmëria operationale të gjitha mjetet lundruese të Forcave të Armatosura.

- Nga auditimi u konstatua që Komanda e Forcës Detare, referuar detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura "Për planin e dokimit dhe riparimit të teknikës detare"



Ambienti ku QSHAMT kryen aktualisht veprimtarinë

Procedura e tjetërsimit të pronës është kryer jashtë çdo afati kohor të parashikuar në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndonëse nuk ka pasur asnjë emergjencë për iniciimin e këtij projekt-akti, ku për miratimin e VKM-ve do të duheshin minimalisht 10 ditë kalendarike nga propozimi te miratimi i projekt-aktit, përgjegjësi kjo e MFE dhe MB.

4. Procesi i pastudiuar i tjetërsimit të pronave ka sjellë implikime financiare për buxhetin e shtetit, përdorim të fondeve buxhetore sipas VKM nr. 980, datë 02.12.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit", në vlerën 259,699 mijë lekë, jashtë destinacionit të miratuar nga ligjvënësi dhe për pasojë është shoqëruar me vonesa të procesit të rindërtimit dhe korrigjimin në kohë të efekteve të fatkeqësisë natyrore. Ndryshimi i destinacionit të fondeve të rindërtimit nga MFE, në vlerën prej 259,699 mijë lekë dhe përdorimi i tyre për qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me korrigjimin e pasojave të tërmetit, është menaxhim joefektiv, joeficient dhe joekonomik i fondeve të buxhetit të shtetit.

dhe shkresave të Sekretarit të Përgjithshëm për buxhetin e detajuar të miratuar, nuk ka futur për riparim/dokim në KNRA të gjitha mjetet lundruese të planifikuara dhe miratuara sipas grafikut.

Rezultoni se nga viti 2016 deri në vitin 2023, nuk kanë dalë në shkallë për dokim/riparim 49 mjete lundruese. Mosdalja për riparim e 49 mjeteve lundruese ka ndikuar negativisht në arkëtimin e të ardhurave dhe në gjendjen financiare të ndërmarrjes në një vlerë prej 87,193,861 lekë pa tvsh.

- Nga auditimi konstatohet që amortizimi i llogaritur për ndërtesat dhe makineritë i pasqyruar në bilanc ka sjellë një rezultat financiar negativ për KNRA-në për të gjitha vitet e periudhës së operimit që nga krijimi i shoqërisë. Amortizimi i akumuluar prej vitit 2015 deri në vitin 2023 është në shumën 574,988,878 lekë.

Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman ka në administrim 148,860 m² tokë të vlerësuar në vlerën 823,195,800 lekë, ndërtime dhe instalime në vlerën 637,773,954 lekë. Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërmarrjes) janë 13 të tilla. Nga këto, katër godina janë në pronësi të KNRA-së, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohet nga efektivet e garnizonit turk, sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA-së, marrëveshje për të cilën KNRA nuk ka dëgjim.

Gjetjet nga auditimi në Degën Doganore Tiranë

KLSH ka përfunduar auditimin e përputhshmërisë në subjektin Dega Doganore Tiranë, për periudhën 01.01.2022 deri në 31.12.2023. *Ndër gjetjet kryesore nga auditimi janë:*

Nga auditimi i kryer pranë Degës Doganore Tiranë kanë rezultuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit sipas marrëveshjeve në fuqi që lidhen me tarifën doganore të reduktuar; mosaplikim të saktë të elementëve të vlerës së mallit për qëllime të vlerësimit doganor; procedura vlerësimi të transportit për qëllime të vlerësimit doganor jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH; raste ku për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar janë deklaruar dhe trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për t'u trajtuar si i tillë; rivlerësime të pa unifikuara për të njëjtët artikuj; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë, detyrimeve doganore për taksën kombëtare TAM të ambalazhit plastik, taksën kombëtare të hurrës, kemit të qumështit, akcizës.

Gjatë veprimtarisë doganore të regjimeve ekonomike të tipit RPA është konstatuar se vlera e mallrave dhe vlera e shpenzimeve të transportit të deklaruar rezultojnë shumë e ulët dhe për të cilat janë llogaritur rivlerësime të detyrimeve doganore me efekte në të ardhurat doganore në buxhetin e shtetit. Gjithashtu janë konstatuar problematika mbi kontrollin e tyre për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit të mallrave të ndryshëm apo shkelje të afateve gjatë veprimtarisë së tyre.

Në lidhje me regjimin e tranzitit u konstatuan mangësi lidhur me mos evidentimin dhe mos dokumentimin e vonesave të justifikuar apo incidenteve dhe masat e marra për mbikëqyrjen doganore, si dhe mos penalizimin e subjekteve për mos respektimin e afatit kohor të mbërritjes në doganën e destinacionit. Janë konstatuar mangësi të dokumentacionit ligjor të tipit "Certifikatë Veterinare" për produktet shtazore të importuara, dhe dokumenti shoqërues i tipit "Raport Analize", "Certifikatë Fitosanitare", "Certifikatë Shëndeti", "Certifikatë Origjinë" për produkte ushqimore të gatshme.



Auditimet në RTSH

Për vitin 2022 dhe 6-mujorin e parë 2023, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) ka zhvilluar 27 emisione, në cilat janë angazhuar 91 punonjës të RTSH-së dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 28,149,936 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 27,535,060 lekë, totali 55,684,996 lekë. Angazhimi i 91 punonjësve të RTSH-së jo vetëm ka krijuar një marrëdhënie juridike në shitblerjen e të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, por edhe një standard të dyfishtë në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH-së. Vlera 27,535,060 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

"FESTIVALI 61 I KËNGËS"

RTSH, për projektin artistik "Festivali 61 i Këngës" ka shpenzuar për punonjësit e saj mbi pagesën mujore të tyre, vlerën 3,153,001 lekë, duke krijuar një marrëdhënie juridike të shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, si dhe një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH-së. Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

"FESTIVALI 62 I KËNGËS"

Në të gjithë hierarkinë e veprimeve të realizimit të "Festivalit 62 të Këngës", nuk ka transparencë të plotë dhe gjurmë dokumentare, si në hartimin e projektit, përcaktimin e burimeve njerëzore (përfshirë jurinë, të ftuarit, stafi artistik dhe administrative, stafi realizues), përcaktimin e kostove dhe tarifave përkatëse, caktimin e operatorëve pjesëmarrës për realizimin e tyre me kostot përkatëse (përfshirë dhe akomodimin).

Efekti negativ financiar në vlerën totale prej 4,106,663 lekë pa tvsh përbën përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet nga RTSH.

Auditohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KLSH ka audituar Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), për periudhën 01.01.2021-31.12.2023.

Gjetjet kryesore nga auditimi janë:

Në praktikën e audituar të vendimmarrjes së KDIMDP-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, grupi i auditimit ka konstatuar 6 raste të mospërfundimit të procedurës administrative të nisur, 2 raste në të cilat Komisioneri nuk është shprehur mbi verifikimet jo të plota të grupit të inspektimit, 4 raste pa vendim përfundimtar mbi shkeljet administrative të konstatuara për të cilat legjislacioni parashikon masë administrative gjobë.

Në praktikën e audituar të vendimmarrjes së KDIMDP-së në fushën e të drejtës së informimit, grupi i auditimit ka konstatuar parregullsi në procedurën e konstatimit të kundërvajtjes administrative dhe në përmbajtjen e dokumentacionit shoqërues të vendimmarrjes së Komisionerit.

Zyra e KDIMDP-së nuk ka hartuar një rregullore të brendshme/ manual lidhur me përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive, si dhe evidentimin e punës së palëve të përfshira në proces.

Komisioneri i Zyrës së KDIMDP-së për tre vitet objekt auditimi ka akorduar shpërblime financiare për stafin, përfshirë veten e tij, pa mbajtur dhe llogaritur tatim mbi të ardhurat e përfituara për vitet 2022-2023, në kundërshtim me legjislacionin tatimor.

Komisioneri i Zyrës për KDIMDP-së ka akorduar shtesën për kualifikim për veten e tij dhe 2 drejtorët e përgjithshëm, pa plotësuar kriteret e caktuara në aktin nënligjor përkatës, me fuqi prapavepruese që nga data e fillimit të përfitimit të kësaj shtese, duke krijuar gjithashtu një detyrim të prapambetur, i cili nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të institucionit dhe në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, në kundërshtim me aktet nënligjore përkatëse.

Për periudhën objekt auditimi, të gjitha kontratat për punë publike, mallra dhe shërbime në emër të Zyrës së KDIMDP-së janë nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, në kundërshtim me legjislacionin mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Janë konstatuar parregullsi në procedurat e prokurimit publik të kryera nga Zyra e KDIMDP-së, në fazën e përcaktimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si dhe zbatimit të kontratave.



Bashkëpunimi KLSH – Gjykata Evropiane e Audituesve, një histori suksesi 10-vjeçare



Një nga bashkëpunëtorët më afatgjatë të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pa dyshim Gjykata Evropiane e Audituesve – Gardianët e Financave të BE-së.

Si një anëtar aktiv i INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, në përbushje të plotë të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të bashkëpunimit ndërinstitucional, KLSH vijon ndër të tjera, prej vitit 2014, të forcojë bashkëpunimin e suksesshëm me një nga 5 institucionet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian.

Për më shumë se një dekadë, auditues nga departamente të ndryshme të KLSH-së, nëpërmjet procedurave të suksesshme të aplikimit kanë arritur të jenë pjesë aktive e strukturave të ECA-s nëpërmjet internshipeve 5-mujore. Kjo praktikë e konsoliduar vijon të krijojë kështu një gjeneratë audituesish të rinj, të cilët përcjellin më tej në KLSH të gjithë eksperiencën dhe formimin e tyre profesional nëpërmjet standardeve dhe praktikave më të mira evropiane. ECA është një nga partnerët kryesorë dhe nga nxitësit më të fuqishëm të zhvillimit profesional të SAI-ve evropiane, veçanërisht të SAI-ve të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE, ku bën pjesë edhe KLSH.

Janë më shumë se 17 auditues të integruar nëpërmjet internshipeve në ECA për dekadën 2014-2024 dhe aktualisht po e vijnë këtë praktikë pranë këtij institucioni edhe 5 auditues të KLSH-së. Kjo eksperiencë e vyer po vijon edhe për vitin 2025 me konfirmimin e pjesëmarrjes me auditues të tjerë.

Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) të Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) kryesisht zhvillohet brenda kuadrit të strukturës së Komitetit të Kontaktit. Kjo strukturë përbëhet nga vetë Komiteti i Kontaktit, i përbërë nga drejtuesit e SAI-ve të BE-së dhe ECA-s, si dhe (Oficerët Ndërlidhës, Koordinatorët) LO's, të cilët ofrojnë një rrjet aktiv kontaktesh profesionale në mbarë Evropën, si dhe grupe pune, rrjete, për tema specifike të auditimit.

Bashkëpunimi me SAI-t e vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE

Komiteti i Kontaktit promovon dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme dhe SAI-ve të Shteteve Anëtare të BE-së me anë të disa nismave, shumica e tyre në kuadrin e Rrjetit të SAI-ve të vendeve kandidate dhe kandidate dhe ECA-s. Përveç pjesëmarrjes së drejtuesve të këtyre SAI-ve dhe LO've në mbledhjet e Komitetit të Kontaktit si vëzhgues, Grupi i Përbashkët i Punës për Aktivitetet e Auditimit (JWGAA), pasardhësi i ish-Grupit të Punës së Komitetit të Kontaktit për Vendet Kandidate, promovon në shkallë praktike, aktivitetet e bashkëpunimit.

WASHINGTON DC 2024

KLSH, pjesë e Fellowship-it të Government Accountability Office



KLSH mori pjesë në International Auditor Fellowship Program, i organizuar nga Government Accountability Office (GAO) në Washington DC, gjatë periudhës 17 prill 2024 deri më 12 korrik 2024 dhe u përfaqësua nga z. Rigels Guzi, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Angazhimi në këtë aktivitet që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve supreme të auditimit në të gjithë botën, u mundësua pas procesit konkurrues të përzgjedhjes për thelimin e njohurive në temën e propozuar "Auditimi i mashtimit, shpërdorimit dhe abuzimit, si dhe përdorimi i analizës së të dhënave si shembull i praktikave më të mira".

Në këtë sipërmarrje të Government Accountability Office ishin pjesëmarrës edhe institucione të tjera supreme të auditimit nga vende të tjera të botës dhe grupi që u angazhua në këtë eksperiencë përfshinte përfaqësues nga 16 shtete të tjera (Brazili, India, Kosova etj.).

Rritja e kapaciteteve audituese ishte planifikuar të realizohej nëpërmjet një programi intensiv trajnimi të ofruar nga drejtuesit kryesorë të Government Accountability Office në fusha që përfshinin që nga lidhshipi dhe menaxhimi i ndryshimit, e deri në shembuj konkretë të procesit të angazhimit auditues në GAO.

Në përfundim të programit, përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse të auditimit u pajisën me certifikatat përkatëse. Në ceremoninë e diplomimit të organizuar për këtë rast u zhvillua edhe një takim me Kontrollorin e Përgjithshëm të GAO-s, z. Gene Dodaro.

KLSH zhvillon workshop-in mbi Integritetin: Jo thjesht një javë ..., por një mënyrë të jetuari



KLSH merr pjesë në workshop-in VII DEA SG2 të EUROSAT-t në Lisbonë

Në datat 5-6 dhjetor 2024 u zhvillua në Lisbonë, Portugali, workshopi VII mbi projektin DEA (Data Envelopment Analysis), organizuar nga EUROSAT SG2, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë. Ky aktivitet promovoi shkëmbimin e njohurive mbi përdorimin e metodës DEA dhe metodave të tjera të avancuara të kahasimit, të cilat synojnë përmirësimin e auditimeve të performancës.

Në workshop u zhvilluan prezantime nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë mbi aplikimin e DEA-s në sektorin publik dhe kombinimin e saj me metoda të tjera të vlerësimit të efikasitetit në auditimet e performancës, duke përfshirë identifikimin e pyetjeve kyçe të auditimit, metodat e mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të tyre.

KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga znj. Aulona Jonuzi, drejtore e Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional dhe znj. Miranda Misini, audituese në këtë departament.

Në datat 10-13 dhjetor 2024, në Kontrollin e Lartë të Shtetit u zhvillua workshop-i "Java e Integritetit" nën sloganin "Jo thjesht një javë... por një mënyrë të jetuari! Përqafojmë ndershmërinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë, çdo ditë!".

Aktivitetet e organizuara në kuadër të kësaj jave, theksuan rëndësinë e integritetit dhe etikës në aktivitetet tona profesionale, duke synuar një menaxhim cilësor dhe transparent të auditimeve.

Gjatë kësaj jave u trajtuan aspekte të ndryshme të etikës profesionale, standardeve ndërkombëtare dhe metodologjive të auditimit, duke diskutuar mënyrat për t'u përmirësuar më tej dhe për të garantuar qëndrim të lartë ndaj kërkesave të integritetit në çdo fazë të auditimit.

Fjala e hapjes së aktivitetit u mbajt nga Sekretar i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, e cila foli mbi rëndësinë e integritetit në institucionet publike, duke theksuar se është e rëndësishme të ndërtojmë besimin e palëve nëpërmjet integritetit.

Në vijim u prezantua tema "Të ndërtosh një kulturë integriteti: Sfidat dhe mundësitë për audituesit" nga znj. Miranda Misini dhe më pas pjesëmarrësit u njohën me Kodin Etik të KLSH-së, prezantuar nga znj. Ermira Hoxha.







Ditët në vijim u pasuan me aktivitete dhe prezantime, si: tema "Rëndësia e integritetit – në fokus edhe institucionet publike" nga znj. Elira Cukalla; "Etika profesionale dhe roli i audituesve në ruajtjen e integritetit" nga z. Marlin Muça; "Rëndësia e integritetit – në fokus institucionet publike" nga z. Blerin Shkurti, si dhe "Shqyrtimi i praktikave të auditimit të integritetit dhe Standartet Ndërkombëtare" nga znj. Xhuljeta Celaj dhe znj. Anjeza Gjoci.

Ky workshop, me pjesëmarrje të të gjithë stafit të KLSH-së, shërbeu si një praktikë e mirë për t'u angazhuar më thellë në përmirësimin e praktikave të auditimit dhe për të siguruar qëndrueshmëri të lartë ndaj kërkesave të integritetit.

Falënderit për leximin!





Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  kontrolli_i_larte_i_shtetit
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00



**SHKURT
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Shkurt 2025



KLSH 1925-2025, rrugëtimi 100-vjeçar i kontrollit të financave publike



Viti 2025 shënon një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kontrollit të financave publike të vendit, 100-vjetorin e krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka një histori të rrënjosur thellë që daton nga data 20 maj e vitit 1925 me emërtimin Këshilli Kontrollues, duke kaluar përmes një rrugëtimi të gjatë e të vështirë formimi dhe zhvillimi institucional.

Në vijimësi, bërthama e institucionit të kontrollit të financave publike ka ardhur duke u zhvilluar dhe përmirësuar deri në momentet kur është ndërtuar një institucion i mirëfilltë kontrolli financiar. Ky përvjetor jubilar e gjen Kontrollin e Lartë të Shtetit si një institucion të konsoliduar, që udhëhiqet nga parimet dhe standardet ndërkombëtare të auditimit; bashkëpunon me institucionet homologe për të përfutur nga eksperiencat më të mira; komunikon në vazhdimësi me çdo palë interesi dhe me publikun, duke u udhëhequr nga parimi i rritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes mirëqeverisjes.

Sot, KLSH është një nga institucionet më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike, jetik për mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Për më tepër, KLSH është gjithashtu një institucion suprem aktiv i auditimit në arenën ndërkombëtare.

KLSH ka nisur përgatitjet për aktivitetet që do të zhvillohen me rastin e këtij viti jubilar. Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu ka miratuar logon e 100-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila do të përdoret në të gjitha shkresat zyrtare të gjatë vitit 2025, për të përçuar mesazhin e rëndësishëm mbi rolin që një institucion "gardian" i financave publike luan në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërinë për menaxhimin sa më të mirë dhe efikas të burimeve publike. Në kuadër të 100-vjetorit, KLSH do të organizojë një sërë aktivitetesh, ndër të cilat organizimi i një konference shkencore me përfaqësues nga institucionet homologe.

Si pjesë e aktiviteteve për këtë përvjetor jubilar janë: promovimi i librit historik "100 vjet KLSH"; përgatitja e një dokumentari për rrugëtimin historik të institucionit; emetimi e një serie të veçantë pullash postare; prezantimi i faqes së re web etj. Ndërkohë, një sërë delegacionesh të huaja nga Institucione Supreme Auditimi të ndryshme të botës, drejtues dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të auditimit, si dhe personalitete të larta në vend janë ftuar të marrin pjesë në ceremoninë zyrtare të 100-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila do të zhvillohet në datën 20 maj 2025.

Statistika



7 auditime të evaduar për vitin 2025

7 auditime të përfunduara në muajin janar

71 auditime janë në proces

13 raporte auditimi të publikuara në web

20 maj 1925

Dokumenti i parë i krijimit të Kontrollit të Lartë Shtetit

Dokumenti i parë specifik me vlera historike i formimit të institucionit të Kontrollit të Financave në Shqipëri konsiderohet Dekret-Ligji i datës 20 maj 1925 “Mbi formimin e Këshillit Kontrollues”. Ky dekret-ligj u miratua me përparësi në periudhën e Republikës Parlamentare, të drejtuar nga Ahmet Zogu dhe hyri në fuqi në datën 25 maj 1925. Në vitet e para të funksionimit, Këshilli Kontrollues i Financave u drejtua nga Fejzi Alizoti (1925-1926) dhe Kol Thaçi (1925-1930).

Këshilli Kontrollues i Financave u formua si institucion kushtetues dhe rregullohej nga artikujt nr. 93-97, pjesa C “Pushteti Përmbarues” e Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare.

Principet themelore të Statusit për Këshillin Kontrollues ishin:

Art.93 - Financat e shtetit kontrollohen prej Këshillit Kontrollues të Financave.

Art.94 - Organizimi i këtij këshilli, mënyra e ushtrimit të zyrave të tij dhe cilësitë e misëve që e përbajnë caktohen në ligjën e posaçme.

Art.95 - Të drejtat e këtij këshilli janë kontrolli parashikues (preventiv) e ndërshkues (represiv) i llogarive të gjithë administratës së shtetit si dhe ato që caktohen në ligjën e posaçme.

Art.96 - Kryetari dhe anëtarët e këtij këshilli emnohen prej kryetarit të Republikës dhe nëpunësit e tjerë, simbas ligjës.

Art.97 - Patundshmëria e Këshillit Kontrollues të Financave sigurohet në mënyrën e caktueme në këtë statut për miset e Gjyqit të Diktimit, me ndryshimin që ashtë vetëm për pesë vjetë që prej ditës së emnimit të sicilit prej tyre”.


Me ngritjen e Këshillit Kontrollues të Financave, Ahmet Zogu krijoi një strukturë ekonomike politike që e kishte nën kontrollin e tij dhe që krahas masave të tjera të ndërmarra, do t'i jepte mundësi të përqendrohej në kapërcimin e gjendjes së vështirë financiare të vendit dhe sigurimit të një aleance të jashtme të fortë për të kaluar vështirësitë ekonomike.

Ky dokument pati jehonë në shumë burime zyrtare e gazeta të asaj kohe. Gazeta “Indipendence Shqiptare” në artikullin “Këshilla Kontrolluese” ose “Cour des Comptes” në frëngjisht, shkruante:

“Formimi i Këshillit Kontrollues do t'i pres hovin çdo padrejtësie e abuzimi të bamun në dëm të arkës dhe ky hap konsiderohet si hap i parë që po hedh Republika e re në fushatën e responsabilitetit të veprave, duke i patur këto nën një kontroll tepër të ngushtë”.




Gazeta “Indipendence Shqiptare”, 12 dhjetor 1925



Dekret-Ligji i datës 20 maj 1925 për krijimin e Këshillit kontrollues



Ahmet Zogu, Mbret i Shqiptarëve, 1928-1939



Kol Thaçi, Kryetar i Këshillit Kontrollues 1925-1930

Kontrolli i llogarive sipas modelit francez “Cour des Comptes”

Zyra e Kontrollit të Llogarive që u ngrit nën qeverimin e Ahmet Zogut kishte ngjashmëri me modelin kontrollues të shtetit francez. Në zbatim të kërkesave të Statutit Themeltar të Republikës Parlamentare u përpunua dhe u përgatit legjislacioni mbi zyrën e Kontrollit të Llogarive të Shtetit, frëngjisht kjo zyrë quhej “Cour des Comptes”.

“Zyra e kontrollit është një autoritet administrativ i organizuar administrativisht për me kontrollue ata të cilët përdorjnë të hollat e shtetit njëashtu si edhe gjyqet civile kontrollojnë ata qytetas që përzehen në përdorim të pasunisë së tjetërkujt”.

Modeli i adoptuar francez u legjitimua deri në aspekte formale të identikitit të këtij institucioni. Në vulën rrethore dygjuhëshe të Këshillit Kontrollues shkruhej “Cour des Comptes”.



Vula dygjuhëshe e Këshillit Kontrollues



10 GURË THEMELI NË 100 VITE HISTORI

Viti 1925

Në vitin 1925, Asambleja Kombëtare miratoi të parin Statut Themeltar të Shtetit Shqiptar (Kushtetuta), ku përpos të tjerash, përcaktohet edhe institucioni që ngarkohet me kontrollin shtetëror të financave publike. Ajo ishte Dhoma e Deputetëve, e cila kishte atributet e një institucioni që kishte të drejtë dhe detyrë të kontrollonte qeverinë, për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të vendit.

Vitet 1928-1939
Në vitet 1928-1939, vendi drejtohet nga një monarki institucionale. Në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, kontrolli shtetëror pëson përsosje në formë dhe përmbajtje. Në këtë Statut (Kushtetutë), financat e shtetit kontrollohen nga Këshilli Kontrollues, i cili merr atributet e një organizmi të pavarur.

Vitet 1939-1944
Në vitet 1939-1944, Shqipëria pushtohet nga forcat e koalicionit nazifashist të Italisë dhe Gjermanisë. Për rrjedhojë, pezullohet i gjithë aktiviteti i këtij institucioni suprem, sikurse të gjithë institucionet e tjera shtetërore.

Viti 1945
Në vitin 1945, Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar, i cili kishte atributet e një Parlamenti, institucionalizon kontrollin shtetëror nëpërmjet një Këshilli Kontrollues. Detyra kryesore e Këshillit Kontrollues ishte: kontrolli preventiv dhe konsuntiv i shpenzimeve të shtetit, mbikëqyrja për të ardhurat shtetërore dhe ajo e veprimtarisë të nëpunësve që administrojnë paratë e materialet e shtetit.

Viti 1946
Në gusht 1946 bëhet riorganizimi tërësor i organeve të kontrollit, si në formë edhe në përmbajtje. Me ligj të veçantë të Kuvendit Popullor krijohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit.

Viti 1950
Në janar 1950, me disa ndryshime në ligjin organik, këtij institucioni i kufizohet rrethi i objektit të kontrollit. Objektivi i tij ishte vetëm kontrolli mbi llogaritë dhe shpenzimet e qeverisë dhe zbatimin e vendimeve të saj. Detyra bazë përcaktohet kontrolli preventiv dhe përfundimtar mbi llogaritë e shtetit në gjithë njësitë ekonomike, financiare e prodhuese;

ruajtja e vlerave monetare e materiale të shtetit në ndërmarrjet, kooperativat bujqësore, institucionet shtetërore dhe ato shoqërore.

Viti 1966
Në vitin 1966 suprimohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit. Ky organ riorganizohet në formën e një Inspektimi Shtetëror, të cilën e ruajti deri në vitin 1987.

Viti 1987
Në vitin 1987, me dekret të veçantë, rikrijohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit, thajse me të njëjtin organizim, objektiva dhe kompetenca që kishte ky organ në vitet e mëparshme. Komisioni i Kontrollit të Shtetit vazhdoi të veprojë deri në fund të vitit 1991.

Viti 1992
Në vitin 1992, me ligj të veçantë, krijohet institucioni suprem i kontrollit të shtetit. Ky institucion i emërtua Shërbimi i Kontrollit të Shtetit. Shërbimi i Kontrollit të Shtetit merr atributet e një organizmi të pavarur nga qeveria. Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ishte organi më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar me objekt organizimin, drejtimin dhe realizimin e kontrollit për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe administrimin e pronës shtetërore.

Viti 1997
Pavarësia e plotë, depolitizimi dhe departizimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit u realizua me miratimin e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 dhe pas miratimit të Kushtetutës në tetor të vitit 1998.

Në vitin 2014, me qëllim përafrimin e ligjit me standardet ndërkombëtare të auditimit, u hartua me mbështetjen e DG Budget, SIGMA-s dhe Delegacionit të BE-së në Tiranë ligji nr.154, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

KLSH është institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i pavarur, i cili i ushtron kompetencat e tij duke iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.





Delegacioni i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit në Kongresin e INCOSAI-t, Washington DC, tetor 1992

KLSH, pjesë e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit nga viti '92

Gjatë periudhës 1993-1996, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit krijoi lidhje të shumta me institucionet homologe dhe organizatat ndërkombëtare të auditimit. Gjithashtu, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit hartoi Kodin e Etikës për punonjësit dhe një kopje iu dërgua Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) në vitin 1993.



Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë anëtar formal i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) që nga viti 1984, dhe anëtar aktiv nga viti 1992. Anëtarësimi në këtë organizatë shtron detyra për të respektuar standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI).

Këto standarde sigurojnë cilësinë dhe profesionalizmin në punën audituese, pavarësinë e plotë të institucionit dhe besueshmërinë e tij në publik si dhe udhëheqin veprimtarinë kryesore në përmirësimin e qeverisjes publike.



Në Kongresin e fundit XXIV të INCOSAI-t (Kongresi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit), zhvilluar në datat 7-11 nëntor 2022 në Brazil, KLSH mori pjesë me një delegacion të kryesuar nga Kryetari, z. Arben Shehu. Ky kongres i organizuar nga INTOSAI bën bashkë drejtuesit e institucioneve supreme të auditimit nga e gjithë bota dhe mbahet çdo 3 vjet.

INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur, profesionale dhe jopolitike, që ka për qëllim të ofrojë mbështetje për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit; të sigurojë standarde të cilësisë së lartë të auditimit për sektorin publik; të promovojë qeverisjen e mirë, si dhe të nxisë zhvillimin e kapaciteteve të SAI-eve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës. Aktualisht kjo organizatë ka 195 anëtarë.

Anëtarësimi në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI)

Kontrolli i Lartë i Shtetit prej vitit 1993 është gjithashtu anëtar i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Në kuadër të këtij antarësimi, KLSH bashkëpunon me institucionet homologe supreme të auditimit dhe merr pjesë aktive në disa grupe pune.

Përmes bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe SAI-et homologe, përfshirë edhe pjesëmarrjen në auditime të koordinuara ose paralele, bëhet i mundur shkëmbimi i eksperiencave me synim ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit.



EUROSAI është një nga organizatat rajonale të INTOSAI-t dhe përbëhet nga 51 anëtarë (Institucione Supreme të Auditimit të vendeve të Europës dhe Gjykata Evropiane e Auditimit). EUROSAI synon të nxisë bashkëpunimin profesional, të avancojë studimin e auditimit të sektorit publik dhe të punojë drejt harmonizimit të terminologjisë në fushën e auditimit publik.

MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu pret në takim ekspertët e SAI-t të Norvegjisë

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në një takim ekspertët e SAI-t të Norvegjisë në fushën Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe të auditimeve në Industrinë Nxjerrëse.

Kryetari i KLSH-së i falënderoi ekspertët për praninë dhe të gjithë bashkëpunimin e deritanishëm, duke theksuar rëndësinë dhe vlerën e shtuar që ofron ekspertiza e tyre në fushat e dakordësuara për bashkëpunim. Z. Shehu shprehu gjithashtu vullnetin e plotë në vijimin e mëtejshëm me profesionalizëm të të gjithë stafit të KLSH-së në këtë angazhim dypalësh.

Ekspertët norvegjezë, duke falënderuar z. Shehu për takimin vlerësuan bashkëpunimin me stafin e KLSH-së, të përfshirë në aktivitetet e përbashkëta, si dhe konfirmuan vazhdimësinë e programeve të përcaktuara dhe të asistencës së tyre në auditimet IT dhe të performancës, por edhe të fushës më të re, atë të auditimeve në industrinë nxjerrëse.



Ekspertët e SAI-t të Norvegjisë zhvillojnë sesione pune në KLSH për fushën IT dhe auditimet në industrinë nxjerrëse

KLSH merr pjesë në trajnimin “Auditimi i Sistemeve të Informacionit dhe Auditimi i e-Qeverisjes” në Indi

Në kuadër të planit të përbashkët të aktiviteteve në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë, në datat 27-31 janar 2025 u zhvilluan në KLSH, sesionet e punës me ekspertët norvegjezë në fushën Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe të auditimeve në Industrinë Nxjerrëse.

Në sesionet e punës në fushën TI u trajtuan disa tema që përfshinin forcimin e sigurisë kibernetike; kuptueshmërinë e mendësisë së hackerave; zhvillimin e strategjive mbrojtëse proaktive; pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e sigurisë; mundësinë për rritje profesionale në fushën e sigurisë kibernetike etj. Në këtë aktivitet morën pjesë auditues të Departamentit të Auditimit Teknologjisë së Informacionit, si dhe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në KLSH.



Ky workshop ofroi përfitime për pjesëmarrësit, duke rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre reaguese në fushën e “Ethical Hacking” dhe “Cyber Security”. Nëpërmjet tij u mundësua përdorimi i teknikave të testimit dhe të penetrimit të brendshëm, duke i mundësuar stafit të identifikojë, por dhe të zbusë rrisqet apo vulnerabilitetet potenciale, që mund të prekin sistemet dhe rrjetin e brendshëm të KLSH-së.



Gjithashtu, në datat 28-30 janar 2025 u zhvillua workshopi mbi “Identifikimin e risqeve dhe auditimin në lidhje me menaxhimin e industrisë nxjerrëse të sektorit të naftës në Shqipëri”. Workshopi u fokusua në vlerësimin e marrëveshjes hidrokarbure Patos-Marinzë me kontraktor “Bankers Petroleum” sh.a.

Në këtë workshop u trajtuan disa çështje lidhur me marrëveshjen, si: vlerësimi i gjendjes së pellgut Patos-Marinzë në lidhje me kapacitetin e naftës së mbetur; vlerësimi i gjendjes së investimeve të kryera në vite; vlerësimi i humbjeve ose derdhjeve të naftës mbi ose nën tokë gjatë operacioneve hidrokarbure nëse janë në përputhje me standardet përgjithësisht të pranura të industrisë ndërkombëtare të naftës etj. Workshopi-i u ndoq nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, i cili është dhe përgjegjës për këtë auditim.

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Teknik dhe Ekonomik të qeverisë së Indisë, në datat 6-29 janar 2025, në Qendrën Ndërkombëtare për Sistemet e Informacionit dhe Auditimit, ICISA, në Noida, Indi, u zhvillua trajnimi ndërkombëtar “Auditimi i Sistemeve të Informacionit dhe Auditimi i e-Qeverisjes”. Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga audituesja Klara Frangaj.

Programi i Bashkëpunimit Teknik dhe Ekonomik Indian (ITEC) ofroi një platformë unike ku pjesëmarrës nga vende të ndryshme ndajnë njohuritë dhe ndërtojnë aftësitë e nevojshme për auditimet e sistemeve të informacionit dhe temave të qeverisjes elektronike.

Trajnimi 3-javor ndihmoi pjesëmarrësit për të fituar aftësi në vlerësimin dhe përmirësimin e strukturës së qeverisjes dixhitale, duke siguruar që ato të mbeten të sigurta, efikase dhe të besueshme.



Auditohen marrëveshjet hidrokarbure

Nga auditimi i ushtruar në subjektet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Albpetrol sh.a mbi "Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë", për periudhën nga identifikimi/propozimi i lidhjes së marrëveshjeve deri në datën 31.12.2023, janë konstatuar mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor të marrëveshjeve hidrokarbure.

Disa nga problematikat e konstatuara janë si vijon:

- Nga evidencat e marra për veprimtarinë në sektorin hidrokarbur rezulton se MIE, AKBN dhe Albpetrol sh.a nuk kanë programe apo plane periodike, vjetore për të ushtruar kontrollin në subjekte si zotërues të lejeve hidrokarbure.

- Nga auditimi i formularit së ofertës të paraqitur nga "EDG N. G." shpk për vendburimet "Povelcë" dhe "Frakull", në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe teknike u konstatua se kompania e mësipërme nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019, si dhe vlera e likuiditeteve të lira, gjendje në bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në sektorin hidrokarbur.

- Kompania "EDG N. G." shpk nuk disponon burimet financiare si dhe kapacitetet teknike për të përmbushur detyrimet e kontraktorit që vijnë nga lidhja e Marrëveshjes Hidrokarbure, në kundërshtim me ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për Hidrokarburet", i ndryshuar.

- "Sh. U. Albania" B.V nuk ka përmbushur detyrimin në lidhje me fondin për investime sociale prej 1,000,000 USD, si detyrim i kompanisë gjatë periudhës së pezullimit.



- Për Bllokun 4, palët, deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk kanë gjetur një zgjidhje në lidhje me statusin e kostove pezull, në vlerën 2,954,441 USD (pagesë e ekspertëve të filialeve të Shell në vende tjera për punën e kryer për llogari të Bllokut 4), si shpenzim i kryer pa ekonomikitet.

- Nga AKBN nuk është shfrytëzuar mundësia e trajnimit në institucionet ndërkombëtare të stafit të AKBN-së, e drejtë kjo që rrjedh nga neni 27.4 të KNP-së blloku "Dumrea" në vlerën 600,000 euro për vit kontraktual për periudhën e kërkimit, si dhe nuk u paraqit programi i trajnimit mbi baza vjetore i përgatitur bashkërisht (ENI dhe AKBN) si e ardhur dhe investim i munguar.

- Detyrimi i "B." për sasinë totale prej 54,009.978 ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitet 2019 - 2023 për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol sh.a (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është 18,659,033.93 USD, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara për Albpetrol sh.a.

- Konstatohet se "B. P. Albania" Ltd nuk paguan detyrimin për energjinë elektrike ndaj Albpetrol sh.a, vlerë e cila deri në 31.12.2023 është 1,654,040,397 lekë.

Auditohet projekti "Shërbimet Mjedisore" në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AZHBR

KLSH ka audituar projektin "Shërbimet Mjedisore" në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), i financuar me hua dhe grande në total me vlerën 22.8 milionë USD.

Projekti i "Shërbimeve Mjedisore" ka nisur të zbatohet më 29.01.2015 nga Ministria e Mjedisit, me objektiv bazë mbështetjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe nëpërmjet tyre rritjen e përfitimeve monetare dhe jomonetare për komunitetet kryesisht në zona të larta malore që preken nga erozioni. Projekti do të përfundonte më 30 shtator 2019, por iu nënshtrua dy ristrukturimeve, që përfshinin një zgjatje deri më 31 maj 2021. Nga ristrukturimi i projektit janë rritur dhe kostot operationale si dhe ka pasur shtyrje të afateve të realizimit të kontratave të tjera të konsulencës.

Gjatë viteve 2020 dhe 2021 janë disbursuar 11.86 milionë USD fonde, të cilat përbëjnë 57% të të gjithë fondeve të vënë në dispozicion për 4 vite (2015-2019).

Gjatë analizimit të dosjeve të aplikantëve pranë AZHBR-së vihet re përzgjedhja e aplikantëve që nuk kanë eksperiencë të mëparshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, krijimi i shoqatave në një kohë të afërt me aplikimin për thirrjen e parë ose të dytë të projektit.

Në dosjet e audituara për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve u analizua dokumentacioni i dërguar nga aplikantët fitues si dhe u verifikuan parcelat ku do të implementohej projekti.

Verifikimi u krye nga imazhe satelitore të marra nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), ku, në bazë të kërkimit nga koordinatat e dhëna, rezultuan parcela të papjellëzuara. Në total, vlera e shoqatave përfituese që është disbursuar nga AZHBR është 27,439,647 lekë. Gjithashtu, në fund të projekteve të pyllëzimit nuk është marrë asnjë hap mbi regjistrimin e këtyre zonave pyjore (sipas projektit), si një ndër qëllimet kryesore të zhvillimit të projektit "Shërbimet Mjedisore".

Në analizën studimore fillestare mbi projekt-idenë për implementimin e shërbimit projektet mjedisore, përfshihen shumë statistika në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor të Shqipërisë, si dhe mbi popullatën që banon pranë këtyre zonave. Në analizë tregohet gjendja jo e mirë e këtij sistemi.

Grupi i auditimit nuk arriti të marrë përgjigje në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor dhe të popullatës pas implementimit të projektit, nëse ky projekt ka qenë efektiv në përmirësimin e problemeve të listuara në analizën fillestare të hartuar nga Banka Botërore.

Pjesa më e madhe e financimit të projektit 22.8 milionë USD është shpenzuar për shërbime konsulence dhe për shpenzime operative.

Auditimi në Akademinë e Sigurisë

KLSH ka përfunduar auditimin në Akademinë e Sigurisë (AS), për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2023, ku konstatimet dhe gjetjet kryesore konsistojnë si më poshtë:

- Nga auditimi i kryer është konstatuar mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi. Dispozitat e parashikuara në VKM-në nr.320, datë 02.06.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj", pika 15, vijonë në kundërshtim me nenin 43, pika 4 e ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", si dhe nuk gjejnë zbatim në aktet e brendshme ligjore të Akademisë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultoi se:

- Nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 3,789 mijë lekë.

- Për kontratën me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë" u konstatuan parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, ku për rastet e trajtuara, për të cilat është bërë e mundur përlllogaritja e tyre, rezultojnë përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 9,450 mijë lekë. Gjithashtu u konstatua se në këtë kontratë është përfshirë një subjekt tjetër, i cili nuk është pjesë e marrëveshjes kuadër autoritetet/entet kontraktore, ku deri në datën 31.12.2023 është paguar vlera e shërbimit të kateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa tvsh, vlerë e cila është e pakontraktuar dhe jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Auditimi në Ministrinë e Mbrojtjes

KLSH ka përfunduar auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2021- 30.06.2023.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se:

- Mangësi në hartimin e kriterëve të procedurave të prokurimit dhe kualifikimit të operatorëve ekonomikë.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultuan pasaktësi për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 4,268,613 lekë.
- Nga auditimi i kontratës së shërbimit me objekt: "Hartim projekt-preventivi, ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë" dhe "Hartim projekt-ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA" nuk janë përmbushur parashikimet ligjore të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 15,887,636 lekë.
- Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit "Shërbime" në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtrake (IGJIU) nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së, në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe kriteret kualifikuese.
- Nga auditimi i dokumentacionit dhe procedurave të likuidimit për projektin "TO BE READY" u konstatuan shkelje të kontratave dhe mangësi në raportimin dhe justifikimin e shërbimeve të paguara, duke përfshirë pagesa të padrejta për menaxherët e projektit dhe financiarët; mangësi dhe shkelje në menaxhimin dhe në realizimin e procedurave të prokurimit. Disa kontrata për shërbime dhe prokurime janë lidhur në kundërshtim me rregulloret përkatëse dhe mungojnë dokumentacionet e nevojshme për të vërtetuar ligjshmërinë e proceseve. Janë identifikuar mospërputhje në vlerat e deklaruara për rimbursim në FLC, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 18,396,391 lekë.

Auditimi në Ministrinë e Drejtësisë

Nga auditimi tematik në Ministrinë e Drejtësisë "Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale", rezultoi se:

- Nuk ka gjetur zbatim neni 6, pika 2 e "Kushteve të Përgjithshme të Kontratës", që lidhet me pronësinë intelektuale dhe dorëzimin në fund të kontratës nga Bashkimi Operatorëve Ekonomik tek Autoriteti Kontraktor të Kodit në Burim, raporteve dhe hartave, diagrameve, skicimeve dhe çdo materiali tjetër të mbledhur ose përgatitur nga kontraktuesi gjatë implementimit të kontratës.
- Kontrata e nënshkruar për prokurimin e shërbimit me nr. 8383/10 prot., datë 21.02.2017, rezulton se nuk është e firmosur rregullisht në çdo faqe nga Nëpunësi Autorizues, ish-Sekretari i Përgjithshëm; nuk ka numër faqesh të cituar, si dhe nuk ka marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (SLA) të firmosur dhe të bashkëlidhur si aneks kontrate.
- Konstatohet se tre procesverbalet e marrjes në dorëzim janë përpiluar të gjithë brenda një dite (datë 21.03.2017), duke mos respektuar grafikun javor të ekzekutimit sipas kontratës, në kundërshtim me nenin 11 të kontratës, ligjit 10 494 datë 22.12.2011 "Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor".
- Mungon një relacion i plotë argumentues mbi mënyrën se si janë vlerësuar pajisjet përpara se të merren në dorëzim, apo testimet që janë kryer nga ana e grupit të punës. Ka vetëm tre procesverbale për marrjen në dorëzim (*byzlyk elektronikë, sistem akses kontroll, sistem kamera sigurie*) nga nëntë zërat e faturës së bashku me fletëhyrjet, si dhe një dokument trajnimi për stafin në vlerën totale 34.236.000 lekë me tvsh, ndërkohë që është kryer likuidimi pjesor në vlerën 150.000.000 lekë ose afro 63% të faturës tatimore.

Auditimi i sistemeve IT në AKBPM dhe KQZ

KLSH zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM).

Nga auditimi u konstatua se nuk ka një akt krijimi të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), që do të thotë se nuk është bërë një identifikim i të dhënave parësore të këtij sistemi, si dhe të dhënave dytësore që nevojiten për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij.

Infrastruktura “software” dhe “hardware” ku është ngritur Sistemi i Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), deri në fund të vitit 2022, ka qenë e konsideruar “Infrastrukturë Kritike e Informacionit”, bazuar në VKM nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, që i përket periudhës objekt auditimi. Tashmë i përmirësuar me emrin “Sistemi i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, nuk rezulton të jetë në listën e infrastrukturave kritike apo të rëndësishme të informacionit, megjithëse rëndësia e tij është e lartë nisur nga fakti që cenimi apo shkatërrimi i tij do të kishte impakt serioz në shëndetin e qytetarëve.

Fig.1 Fotograf e mëposhtme regjistrojnë gjendjen e dhomatë të servereve në gjatë auditimit të KQZ-it dhe sistemeve të ndërtuara në të.



Kabllimet e rrezatit për në gjatë auditimit të KQZ-it



Burrimit Grupi i Auditimit

Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk ka strukturë të posaçme (sektor TIK) apo punonjës IT në organikën e saj, të cilët kanë fushën e ekspertizës në çdo sistem dhe infrastrukturë “hardware” dhe “software” të institucionit.

AKBPM nuk ka dijeni për listën e përdoruesve të brendshëm, të jashtëm dhe të bazës së të dhënave të Sistemit të Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), të drejtat e tyre, si dhe akseset specifike për secilin prej tyre. Ky informacion u kërkua tek struktura IT e AKSHI-t, vendosur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët gjithashtu, nuk kishin dijeni. Mungesa e këtij informacioni dhe kontrolli cenon integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave që ruhen në sistemin informatik të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

KLSH ka kryer një auditim mbi Teknologjinë e Informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nga i cili janë konstatuar disa problematika, si më poshtë:

KQZ ka trajtuar dhe kërkuar të dhëna mbi foton e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, megjithëse ky informacion nuk është përcaktuar si përbërës zgjedhor në Kodin Zgjedhor. Ky veprim paraqet rrezik për shkelje të të drejtave të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Përditësimi i Aneksit I të udhëzimit nr. 465 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është modifikuar duke shtuar foton e zgjedhësve si element, megjithëse ky nuk është përcaktuar në Kodin Zgjedhor, duke shkaktuar mospërputhje me kuadrin ligjor ekzistues.

Në strukturën e KQZ-së mungon një pozicion i dedikuar për sigurinë e të dhënave, pavarësisht se institucioni administron të dhëna personale dhe sensitive. Kjo gjendje rrit rrezikun për humbje ose akses të paautorizuar në të dhënat e administruara nga ky institucion. Nuk janë implementuar politika dhe procedura për sigurinë e informacionit, çka rrit rrezikun për incidente që mund të shkaktojnë humbje, manipulim ose përhapje të paautorizuar të informacionit konfidencial.

Auditohet “Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve”







KLSH ka ushtruar auditimin financiar “Për raportimin e kryer për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri” në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), në të cilin u konstatuan disa mangësi në zbatimin e kuadrit rregullator të raportimit financiar.

Disa nga mangësitë e konstatuara janë:

AKUK akordon çdo vit subvencion për Ujësjellës-Kanalizimet që janë në vështirësi financiare dhe ekonomike. Rezultoni se për vitin 2020 janë dhënë 3 lloje subvencionesh (për energjinë elektrike, Covid dhe detyrimet tatimore), ndërsa për vitin 2021 dhe 2023 subvencioni është dhënë për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike. Rezultoni se situata financiare e ujësjellësve është jo e mirë, pasi subvencionet janë përdorur për të kryer pagesat e pagave të punonjësve, sigurimeve shoqërore dhe tatimeve të cilat janë detyrime të mbartura. Gjithashtu konstatohet se ujësjellësit kanë detyrime energjie elektrike të mbartura, duke e rënduar edhe më tepër situatën me kamatëvonesa për mos shlyerje detyrimesh në kohë.

Falëminderit për leximin!


© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00



**MARS
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Mars 2025



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Drejtuesin e SIGMA-s, z. Gregor Virant



Raporti 2024 për Shqipërinë, SIGMA vlerëson punën e KLSH-së, z. Shehu takohet me z. Virant

Në kuadër të vizitës që zhvilloi në Shqipëri për prezantimin e rezultateve të Raportit të vlerësimit për administratën publike për vitin 2024, Drejtuesi i programit SIGMA/OECD, z. Gregor Virant u takua në datën 05.02.2025 me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu.

Në takim e zhvilluar në mjediset e KLSH-së u diskutua mbi sfidat aktuale në administratën publike shqiptare, duke nisur nga transparenca e institucioneve publike, rritja e llogaridhënies dhe zbatimi i rekomandimeve. Kontrolli i Lartë i Shtetit është pjesë e Raportit të SIGMA-s për rolin e veprimtarisë audituese në përdorimin e fondeve publike.

Drejtuesi i programit SIGMA/OECD, z. Gregor Virant, duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në mbikëqyrjen efektive të administratës publike, theksoi se është shumë e rëndësishme që rekomandimet e KLSH-së të zbatohen nga institucionet e audituara. Z. Virant u shpreh se mbështetja për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit do të vijojë ngushtësisht.

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu falënderoi z. Virant për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që SIGMA, si një ndër partnerët strategjikë të institucionit, i ka dhënë Kontrollit të Lartë të Shtetit jo vetëm në fushën e auditimit, por edhe në zhvillimin e kapaciteteve profesionale etj. Z. Shehu theksoi se, përmes rritjes dhe sigurimit të transparencës, puna e institucioneve publike do të përmirësohej.

Në takim me Kryetarin e KLSH-së ishin të pranishëm edhe z. Timo Ligi, Përgjegjës i Programit SIGMA për Shqipërinë, si dhe z. Alastair Swarbrick, Këshilltar i Lartë i Politikave në këtë program.

SIGMA është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Bashkimit Evropian. Misioni i SIGMA-s është të mbështesë vendet candidate dhe candidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian në reformat e administratës publike dhe kapacitetet profesionale.

Statistika



20 auditime të evaduar për vitin 2025

13 auditime të përfunduara në muajin shkurt

66 auditime janë në proces

28 raporte auditimi të publikuara në web



Figure 54. Perception of SSAI independence among civil servants, compared to the WB average



Anketa SIGMA: Perceptimi i pavarësisë së KLSH-së mes nëpunësve publikë, krahasuar me mesataren e Ballkanit Perëndimor

Raporti i SIGMA-s: KLSH, institucion i pavarur që auditon me standarde ndërkombëtare

Sipas “Anketës SIGMA” të nëpunësve publikë mbi funksionimin e administratës publike në Ballkanin Perëndimor, perceptimi për pavarësinë e KLSH-së është në nivelin 80% në vitin 2024”.

Në Raportin e SIGMA-s për “Administratën Publike Shqiptare 2024”, është vlerësuar veprimtaria e pavarur në auditimin e fondeve publike nga Kontrolli i Lartë të Shtetit (KLSH), si një institucion që ofron sigurinë për përdorimin e burimeve publike dhe ndihmon në përmirësimin e funksionimit të sektorit publik. Në vijim paraqitet vlerësimi i raportit të SIGMA-s për KLSH-në.

KLSH është krijuar në bazë të Kushtetutës si një institucion i pavarur auditimi, e cila përcakton edhe rolin e tij në terma të gjerë. Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përcakton më hollësisht pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare të KLSH-së dhe së bashku me Kushtetutën përcakton kuadrin ligjor për KLSH-në. Kuadri ligjor është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI).

KLSH ka autoritetin për të audituar zbatimin e buxhetit dhe mbledhjen e të ardhurave, si dhe menaxhimin dhe mbrojtjen e fondeve publike dhe pronës publike ose shtetërore. Gjithashtu, KLSH ka të drejtë të auditojë, ndër të tjera, edhe përdoruesit e fondeve publike të siguruar nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare dhe grantet shtetërore për partitë politike. Mandati i auditimit është gjithëpërfshirës dhe rrallëherë kontestohet.

Anketa SIGMA: Përshtatshmëria e kuadrit ligjor për auditimin e jashtëm dhe efektiviteti e tij në praktikë

Indicator 31. Adequacy of the legal framework for external audit and its effectiveness in practice	2024 indicator value	79/100
Sub-indicators		Points
1. Constitutional, legal, organisational and managerial independence of the SAI		17.9/20
2. Adequacy and coverage of the SAI mandate and its alignment with IFPP		10/10
3. Governance and management of the SAI		9/10
4. Compliance of audit methodology with ISSAIs / Audits are conducted in accordance with the ISSAIs		9/10
5. Quality management of the SAI		9/10
6. Reporting and the follow-up of audits		9/10
7. Implementation of audit recommendations		7.8/15
8. SAI external engagement and communication		5/5
9. Use of SAI reports by the legislature		2/10

KLSH ka një Plan Strategjik Zhvillimi 2023-2027 dhe një plan veprimi, të cilët monitorohen dhe raportohen çdo vit. Objektivat përfshijnë rritjen e mbështetjes për Kuvendin përmes auditimeve efektive të fondeve publike dhe rritjen e ndikimit të punës së tyre duke përmirësuar zbatimin e rekomandimeve dhe optimizimin e kapaciteteve profesionale të stafit të tyre.

KLSH është e autorizuar të kryejë auditime financiare, të përputhshmërisë, performancës dhe Teknologjisë së Informacionit. Plani vjetor i auditimit i KLSH-së përcakton auditimet e detyrueshme dhe auditime të tjera të zgjedhura në bazë të rrezikut. Në tre vitet e fundit, KLSH ka kryer nga 118 deri në 140 auditime financiare dhe të përputhshmërisë në vit. KLSH ka vazhduar të zhvillojë kapacitetet e veta të auditimit të performancës dhe ka përfunduar 55 raporte të performancës gjatë periudhës 2021-2023.

Auditimet e performancës mbulojnë aspekte të sektorëve kryesorë, si: zhvillimi ekonomik, arsimit, mjedisi, drejtësia dhe policia, shëndetësia, administrata publike, infrastruktura dhe siguria shoqërore.

Sipas rezultateve të “Anketës SIGMA” të nëpunësve publikë për administratën publike në Ballkanin Perëndimor 2024, 70% e të anketuarve konsideruan se raportet e KLSH-së ishin të lehta për t'u kuptuar. Për më tepër, 69% deklaruan se raportet përmbajnë rekomandime relevante dhe të dobishme.

Rekomandimet e bëra në raportet e auditimit përgjithësisht pranohen nga subjektet e audituara. Nga 4631 rekomandimet e dorëzuara në vitin 2022, 97% (4494) u pranuan nga subjektet e audituara. Kjo paraqet një përmirësim në krahasim me normën e pranimin të vitit 2021 prej 80%.

KLSH synon të angazhohet me palët e jashtme të interesit (publiku, shoqëria civile dhe partnerë ndërkombëtarë) në procesin e planifikimit vjetor dhe për raporte apo tema specifike të auditimit, dhe ka publikuar një Strategji për periudhën 2022-2025, për përmirësimin e komunikimit dhe rrjedhimisht besimit në KLSH.

KLSH dhe ZKA, auditim paralel “Mbrojtja dhe Siguria e Digave” në Shqipëri dhe Kosovë



Në vijim të bashkëpunimeve dhe auditimeve të përbashkëta mes dy institucioneve audituese, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës (ZKA) do të kryejnë një auditim paralel për mbrojtjen dhe sigurinë e digave në të dyja vendet.

Për këtë qëllim, në datën 19.02.2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu zhvilloi një takim pune me Auditoren e Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca në ambientet e ZKA-së në Prishtinë.

Ky takim shënon vazhdimin e bashkëpunimit mes KLSH-së dhe ZKA-së, për të forcuar llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin e resurseve publike.



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë vizitës në SAI-n e Polonisë



Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së në SAI-n e Polonisë, me rastin e 106-vjetorit të krijimit

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, me ftesë të Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, z. Marian Banaś, ka zhvilluar në datën 7 shkurt 2025, një vizitë zyrtare pranë këtij institucioni me rastin e 106-vjetorit të krijimit të tij. Z. Shehu u prit nga Presidenti Banaś dhe drejtues të tjerë të lartë të institucionit. Pjesëmarrës në këtë takim ishte dhe Presidenti i Gjykatës Federale Braziliene të Llogarive, njëkohësisht edhe President i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Ministri Vital do Rêgo.

Presidenti Banaś falënderoi z. Shehu për pjesëmarrjen e tij në këtë ditë të shënuar për Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë.



Z. Shehu dhe Presidenti Banaś në bashkëbisedimin e tyre e vunë theksin në historinë e shkëlqyer të marrëdhënies dhe bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, të cilat do të jenë gjithnjë në zhvillim e konsolidim të mëtejshëm.

Kryetari i KLSH-së e falënderoi Presidentin Banaś për pritjen e veçantë dhe theksoi rëndësinë dhe vlerën e shtuar që ka për KLSH-në bashkëpunimi me institucionin e Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë.

Gjatë takimit u diskutua gjithashtu për tema me interes të përbashkët, si ajo e sigurisë dhe mbrojtjes civile, auditimi i projekteve të Partneritetit Publik-Privat, auditimet “ad-hoc” etj.


Z. Shehu dhe Presidenti Banaś shprehën përtej vlerësimit edhe angazhimin dhe vullnetin e plotë, në thellimin e këtij bashkëpunimi të suksesshëm.

Kryetari i KLSH-së, në fjalën e tij gjatë ceremonisë zyrtare të përvjetorit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, shprehu urimet për përvjetorin e 106-të të krijimit të tij dhe vlerësimet më të mira për nivelin e lartë të këtij institucioni. Ai theksoi se çdo punonjës i këtij institucioni ka qenë dhe është krenar që është pjesë e këtij sistemi dhe këtij populli të nderuar, i cili është simbol i rezistencës së madhe dhe ruajtjes së vlerave njerëzore.



Gjatë vizitës në Varshavë, z. Shehu zhvilloi një vizitë në “Warsaw Rising Museum”, i cili i kushtohet Kryengritjes së Varshavës në vitin 1944.

Auditimet e përfunduara në muajin shkurt 2025



Auditim "Mbi ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar" në Avokaturën e Shtetit, për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023.



Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë (CFCU), për periudhën 01.01.2021 deri më 30.06.2024.



Auditim përputhshmërie në shoqëritë OSHEE, KESH dhe OST për detyrimet e ndërsjella midis tyre, në periudhën nga data 01.01.2020 deri më 30.11.2024.



Auditim performance me temë "Mbrojtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO" ushtruar në subjektet: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, bashkitë Durrës, Rogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec.



Auditim performance me temë "Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe" ushtruar në subjektet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe degët rajonale, Bashkia Shkodër, Bashkia Lezhë, Bashkia Durrës, Bashkia Vlorë, Bashkia Himarë dhe Bashkia Sarandë.



Auditim performance me temë "Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor" ushtruar në subjektet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Bashkia Selenicë, Bashkia Skrapar, Bashkia Krujë, Bashkia Dimal dhe Bashkia Berat.



Auditim performance me temë "Orientimi për karrierë i nxënësve në Sistemin Arsimit Parauniversitar". Subjektet e përfshira në këtë auditim janë: Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP (ish-Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe Institucione të Arsimit Parauniversitar.



Auditim performance me temë "Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit".



Auditim performance me temë "Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike" ushtruar në Inspektoratin Qendror.



Auditimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në vitin 2023, në subjektet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në vitin 2023, në subjektet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Drejtësisë
- Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
- Shtëpia e të Moshuarve Shkodër
- Shtëpia e të Moshuarve Tiranë
- Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Instituti i Gjeoshkencave

Auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2024 (gjashtëmujori i parë), në subjektet:

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë
- Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

KLSH zhvillon analizat e punës për vitin 2024



Në zbatim të Urdhrit nr. 13, datë 16.01.2025, të Kryetarit të KLSH-së, "Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së departamenteve të KLSH-së, për vitin 2024", gjatë muajit shkurt 2025, departamentet e auditimit dhe strukturat e tjera në Kontrollin e Lartë të Shtetit kanë zhvilluar analizat vjetore të punës. Në këto analiza u diskutua mbi vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit 2024, planifikimin e veprimtarisë audituese si dhe objektivat për vitin 2025.

Në fjalën e tij gjatë pjesëmarrjes në analiza, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu e vuri theksin tek optimizimi i aftësive profesionale dhe njohurive inovative mbi standardet ndërkombëtare të auditimit, bashkëpunimit të vazhdueshëm me SAI-et homologe, pjesë e komunitetit INTOSAI dhe EUROSAI, trajnimeve, në mënyrë që të arrihen rezultate cilësore.

Z. Shehu falënderoi punonjësit për angazhimin e deritanishëm dhe diktoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis strukturave të ndryshme të institucionit.

Një vëmendje e veçantë në analiza iu kushtua aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 100-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku Kryetari kërkoi angazhim maksimal nga të gjitha strukturat për të shënuar këtë moment historik të institucionit.

Kryetari i KLSH-së kërkoi intensifikim të komunikimit, ndërveprimit dhe bashkëpunimit edhe me institucionet homologe dhe ato ndërkombëtare në fushën e auditimit.

Gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar intensifikimin e bashkëpunimit me SAI-et homologe, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të reja dhe trajnimeve të vazhdueshme të stafit, me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.



Solidaritët për pacientët në nevojë, stafi i KLSH-së dhuron gjak

Në vijim të traditës së krijuar ndër vite, stafi i Kontrollit të Lartë të Shtetit i është bashkuar fushatës kombëtare për dhurim vullnetar gjaku, në ndihmë të pacientëve me talasemi, të sëmurëve kronikë, si dhe personave të aksidentuar.

Në datën 24 shkurt 2025, nëpunësit e KLSH-së u bënë pjesë e një seancë dhurimi vullnetar gjaku në ndihmë të këtyre pacientëve, të organizuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku.

Punonjës të KLSH-së janë solidarizuar me këtë akt human që shpëton jetën e njerëzve në nevojë.







Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku ka falënderuar stafin e KLSH-së, që tashmë e ka kthyer në traditë dhurimin e gjakut në ndihmë të pacientëve me talasemi. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku vlerëson se solidariteti dhe tradita Kontrollit të Lartë të Shtetit ka qenë gjithmonë një ndihmë e madhe dhe e rëndësishme në kauzën e dhurimit vullnetar të gjakut.




Falënderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH


 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë - E enjte: 08:00 - 16:30 E premte: 08:00 - 14:00





**PRILL
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Prill 2025



TREGUESIT KRYESORË, VITI 2024



159 AUDITIME

Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjike institucionale, gjatë vitit 2024, KLSH ka kryer 159 auditime nga 155 të programuara, si auditime financiare, përputhshmërie, performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, auditime të kombinuara, për zbatimin e rekomandimeve dhe auditime tematike për çështje të veçanta.



194 OPINIONE/MESAZHE/KONKLUZIONE

Bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit, në vlerësim të kritereve të auditimit, materialitetit të gjetjeve dhe përhapjes së tyre, është konkluduar respektivisht me opinione/mesazhe/konkluzione auditimi, si më poshtë:



4378 REKOMANDIME

Për mangësitë, parregullsitë dhe problematikat e identifikuar në misionet e auditimit janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, të klasifikuara sipas llojit, si më poshtë:

KLSH dorëzon në Kuvend Raportin e Performancës për vitin 2024

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka depozituar në Kuvend Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2024, miratuar me vendimin nr.63, datë 28.03.2025 nga Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, KLSH, në cilësinë e institucionit të auditimit të jashtëm publik, gjatë vitit 2024 ka realizuar gjithsej 159 misione auditimi në institucionet publike, të cilat përfshijnë auditime financiare, përputhshmërie, performance, sisteme IT, auditime të kombinuara, tematike si dhe auditime verifikuese për zbatimin e rekomandimeve. Për sa i takon fushëmbulimit me auditim, në përputhje me mandatin ligjor, KLSH ka kryer misione auditimi në 205 subjekte që përfshijnë institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike me kapital shtetëror mbi 50% dhe auditime të investimeve me financim të huaj. Në përputhje me misionin e KLSH-së dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, objektivi i auditimeve është që në përfundim të tyre të konkludohet me opinionin apo konkluzionin e përgjithshëm të auditimit, shoqëruar me dhënie të rekomandimeve përkatëse, relavante për përmirësimin e situatës së subjekteve të audituara, për problematikat apo mangësitë e konstatuara.

Në auditimet e kryera gjatë vitit 2024 janë dhënë 194 opinione/mesazhe dhe konkluzione auditimi.

Opinionet apo konkluzionet e auditimit janë shoqëruar me 4378 rekomandime të cilat përfshijnë masa organizative, administrative dhe disiplinore, përmirësime të kuadrit ligjor, masa me dëm ekonomik dhe masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar. Këto masa synojnë jo vetëm plotësimin e mangësive, nxjerrjen e përgjegjëseve individuale apo menaxheriale, por, mbi të gjitha, parandalimin e përsëritjes së tyre në të ardhmen. Si një tregues i punës audituese dhe në përputhje me detyrimin ligjor, KLSH kryen auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimet e kryera u konstatua se rreth 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse. Kjo përqindje tregon se pavarësisht nivelit të lartë të pranueshmërisë (99%), me qëllim rritjen edhe të nivelit të zbatueshmërisë, KLSH ka vijuar të nxisë institucionet nëpërmjet rikërkimit të zbatimit të plotë të rekomandimeve.

Statistika



35 auditime të evaduar për vitin 2025

80 auditime janë në proces

70% zbatueshmëria e rekomandimeve

44 raporte auditimi të publikuara në web

Mesazhi i Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu

Në përmbushje të misionit tonë kushtetues dhe ligjor, edhe gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar me përkushtim ushtrimin e mandatit të auditimit të fondeve publike dhe pasurisë shtetërore, me qëllim garantimin e llogaridhënies, transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit në sektorin publik.

Në thelb të misionit të KLSH-së qëndron zbatimi rigoroz i standardeve ndërkombëtare të auditimit publik (ISSAI), me synimin që fondet publike të menaxhohen në mënyrë të ligjshme, të rregullt dhe efektive, në funksion të maksimizimit të vlerës për qytetarët. Parimi udhëheqës i punës sonë është që çdo njësi buxhetore të jetë e përgjegjshme për përdorimin e burimeve që i janë besuar, në përputhje me objektivat e politikave dhe interesin publik si standard përfundimtar.

Auditimet financiare të kryera kanë nxjerrë në pah fenomene të përsëritura të keqklasifikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, të mosregjistrimit të pasurive publike, të mosregjistrimit të plotë të detyrimeve të prapambetura dhe raportimet e pasakta të tyre.

Shumë nga këto problematika vijnë nga dobësitë në kontrollet e brendshme dhe mungesa e dokumentacionit ligjor duke shkaktuar deformim të pasqyrave financiare dhe një pasqyrim jo të drejtë të situatës financiare të institucioneve.

Në auditimet e përputhshmërisë, administrimi i pasurisë publike vijon të jetë një fushë me risk të lartë, kjo pasi janë konstatuar prona të paregjistruara, mungesë certifikatash pronësie, si dhe pasuri të amortizuara që nuk përfshihen në bilance. Në disa institucione mungojnë aktet e marrjes në dorëzim dhe nuk dihet qartë se kush mban përgjegjësi për administrimin e pasurisë publike.

Gjithashtu, vijnë të identifikohen shkelje të legjislacionit në prokurime, si: mungesë gare reale, kriterë të njëanshëm, vlerësime të pabazuara të operatorëve dhe dobësi në menaxhimin e kontratave. Janë evidentuar kontrata të realizuara me një operator të vetëm, procedura me dokumentacion të munguar, si dhe shkelje në aplikimin e kriterëve të përzgjedhjes. Në disa raste janë kryer prokurime për shërbime që mbuloreshin nga kontrata ekzistuese, duke çuar në kosto të dyfishta për buxhetin publik. Në auditimin e zbatimit të kontratave publike janë konstatuar pagesa për punime të pakryera, mungesë penalitetesh ndaj kontraktorëve etj.

Në shumë institucione publike është konstatuar planifikim buxhetor formal, pa lidhje reale me nevojat apo me prioritetet strategjike. Dokumentacioni mbështetës për kërkesat buxhetore ka qenë shpesh i pamjaftueshëm, ndërkohë që janë paraqitur projekte jashtë tavaneve të miratuara, pa argumentim të qartë.

Ekzekutimi i buxhetit ka reflektuar devijime të shumta dhe ndryshime të vazhdueshme, të cilat kanë rritur riskun për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe shtuar presionin mbi buxhetet e viteve pasuese. Në fushën e të ardhurave publike auditimet kanë zbuluar probleme me mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave doganore dhe tatimore dhe mosrikuperimin e borxhit doganor dhe tatimor. Ndërkohë ka vijuar të konstatohen klasifikime të gabuara tarifore dhe mospërdorim i masave ndëshkuese.

Një tjetër fushë që meriton vëmendje të veçantë është administrimi i burimeve njerëzore, mungesa e ndarjes së qartë të përgjegjësisë, mungesë procesesh disiplinore dhe largime të padrejta nga puna që vijnë të shoqërohen me kosto shtesë në buxhetin e institucioneve nga gjyqfituesit.

Auditimet e performancës kanë treguar se orientimi drejt rezultateve mbetet ende i kufizuar ose rezultatet janë të papërfillshme ose të pamatshme, mungojnë indikatorë të matshëm dhe shpesh koordinimi ndër-institucional mungon. Politikat mbeten formale dhe nuk shoqërohen me buxhetim të integruar ose me plane konkrete zbatimi.



Në fushën e teknologjisë së informacionit auditimet kanë nxjerrë në pah dobësi në menaxhimin e sistemeve, sigurinë e informacionit dhe përdorimin efikas të teknologjisë, mosrespektim të standardeve dhe planeve të rikuperimit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar të ndjekë në mënyrë aktive rekomandimet e lëna përmes 13 auditimeve për verifikimin e statusit të zbatimit të tyre, të cilat kanë rezultuar të zbatuara plotësisht, pjesërisht apo janë në proces zbatimi, në nivelin 70%, pavarësisht nivelit të lartë të pranueshmërisë në masën 99%. Ky tregues mbetet thuajse i njëjtë me vitin e mëparshëm, çka nënvizon se ritmi i zbatimit të rekomandimeve ende kërkon përmirësim. KLSH do të vazhdojë të ushtrorë trysni institucionale për të nxitur zbatimin e plotë dhe të shpejtë të rekomandimeve, si një mekanizëm kyç për rritjen e efikasitetit të administratës publike.

Në kuadër të rolit tonë si kontribues në luftën kundër korrupsionit, KLSH ka theksuar rëndësinë e forcimit të kontrollit të brendshëm në institucionet publike duke synuar parandalimin e fenomeneve të papërgjegjshmërisë, neglizhencës në përdorimin e fondeve publike dhe ofrimin e shërbimeve të qytetari. Kjo, duke vënë në dukje në raportet e auditimit jo vetëm shkeljet, por edhe arsytet sistematike që i bëjnë ato të përsëritshme.

Viti 2024 për Kontrollin e Lartë të Shtetit ishte një vit tjetër i vazhdimësisë në kontributin që ky institucion jep si garant i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në administrimin e fondeve publike. Në përputhje me mandatin e vet, KLSH ushtrorë një veprimtari të gjerë auditimi në institucione të të gjitha niveleve dhe kategorive duke siguruar një mbulim gjithëpërfshirës të sektorit publik.

KLSH riafirmoi edhe një herë përkushtimin e vet për të përmbushur plotësisht detyrimet kushtetuese dhe ligjore duke ruajtur besueshmërinë si një institucion i pavarur, profesional dhe në shërbim të interesit publik. Kjo, duke qenë të vetëdijshëm se besimi i qytetarëve fitohet përditë, përmes punës sistematike, objektive, analizës së paanshme dhe gjykimit të pavarur.

Përpara nesh qëndrojnë sfida të rëndësishme, përfshirë dixhitalizimin e mëtejshëm të proceseve, forcimin e rolit tonë parandalues dhe rritjen e ndikimit në mirëqeverisje dhe transparencë përmes rekomandimeve që shkojnë përtej konstatimeve.

E ardhmja kërkon që të gjithë aktorët, Kuvendi, institucionet ekzekutive, shoqëria civile dhe vetë qytetarët, të angazhohen në ndërtimin e një kulture të re qeverisjeje, një kulture ku transparenca, përgjegjshmëria dhe integriteti nuk janë objektiva të largët, por norma të pandryshueshme për një administratë efikase dhe të besueshme. Në këtë rrugë, KLSH mbetet e angazhuar të ushtrorë rolin e vet me profesionalizëm, pavarësi dhe përkushtim, duke vijuar të jetë një institucion në shërbim të publikut, një mekanizëm mbikëqyrës që ndihmon reformat dhe një zë i pavarur sa herë që interesi publik cenohet.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2024

TREGUESIT KRYESORË



159 MISIÖNE AUDITIMI

Gjatë vitit 2024, KLSH ka kryer 159 auditime nga 155 të programuara. Janë ushtruar 45 auditime financiare, 43 auditime përputhshmërie, 35 auditime të kombinuara, 15 auditime performance, 8 auditime IT dhe 13 auditime të zbatimit të rekomandimeve.



194 OPINIONE/MESAZHE/ KONKLUSIONE

Në auditimet e vitit 2024 janë dhënë 194 opinione/mesazhe dhe konkluzione auditimi, nga të cilat: 80 opinione/konkluzione financiare, 78 opinione/konkluzione përputhshmërie, 15 mesazhe auditimi performance, 8 konkluzione auditimi IT, si dhe 13 konkluzione të tjera për zbatimin e rekomandimeve.



205 SUBJEKTE TË AUDITUARA

Në përputhje me mandatin ligjor, KLSH ka kryer auditime në 205 subjekte, nga të cilat: 97 subjekte përfaqësuese të enteve publike të qeverisjes qendrore, 75 të vetëqeverisjes vendore, 13 institucione të pavarura, 20 subjekte shoqëri publike me aksioner shtetin mbi 50%.



4378 REKOMANDIME

Opinionet apo konkluzionet e auditimit janë shoqëruar me 4378 rekomandime të cilat përfshijnë: 2594 masa organizative, 28 përmirësime të kuadrit ligjor, 1059 masa disiplinore dhe administrative, 184 masa me dëm ekonomik, si dhe 513 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar.



70% ZBATUESHMËRIA E REKOMANDIMEVE

Gjatë vitit 2024 u krye verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në 97 auditime të kryera në vitin 2023. Nga auditimet mbi zbatimin e 3937 rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme u konstatua se rreth 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.



Barometri Ballkanik 2024

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal vlerëson KLSH si lider në rajon për pavarësinë dhe besimin në efektivitetin e punës

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council - RCC) ka publikuar raportin vjetor Barometri Ballkanik 2024, i cili shqyrton situatën social-ekonomike të rajonit, opinionet dhe perspektivat në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor bazuar në perceptimet e opinionit publik. Raporti është hartuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian.




Pjesë e sondazhit të Barometrit Ballkanik është edhe vlerësimi në lidhje me pavarësinë dhe efikasitetin e punës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për të kontrolluar qeveritë në interes të qytetarëve. Bazuar në rezultatet e raportit, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka ruajtur pozicionin në lidhje me pavarësinë dhe rolin e tij mbikëqyrës, duke e bërë qeverinë më llogaridhënëse ndaj qytetarëve. Krahasuar me vendet e rajonit, KLSH pozicionohet në krye të vlerësimit për pavarësinë institucionale, megjithë skepticizmin e lartë të qytetarëve në të gjitha vendet e rajonit.

Në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas gjetjeve të raportit, Shqipëria dhe Kosova janë ndër vendet me besimin më të lartë tek Institucionet Supreme të Auditimit në rajon.


Raporti evidenton se Shqipëria dhe Kosova dalin si liderë në besim, përkatësisht 53% dhe 47% të të anketuarve që shprehin opinionin se Institucionet Supreme të Auditimit mund të shqyrtojnë në mënyrë efektive punën e Qeverisë, për ta bërë atë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Sondazhet e Barometrit Ballkanik u kryen gjatë muajit mars dhe fillimit të prillit 2024 në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi.

Vlerësimi i Pavarësisë: Institucioni Suprem i Auditimit i lirë nga ndikimi politik



Fuqia e Institucionit Suprem të Auditimit për të kontrolluar Qeverinë, për ta bërë të përgjegjshme ndaj qytetarëve



Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal fokusohet në promovimin dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, me qëllim integrimin evropian dhe euro-atlantik të vendeve aspirante, si dhe synon që të nxisë zhvillimin në rajon në të mirë të qytetarëve. RCC përbëhet nga 46 vende, organizatata dhe institucione financiare ndërkombëtare. Organizata financohet nga Bashkimi Evropian dhe anëtarët e tjerë që janë pjesë e saj. Që prej muajit janar 2025, Këshilli drejtohet nga z. Amer Kapetanovic, Sekretar i Përgjithshëm.

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu pret në takim ekspertët e lartë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK)

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, priti në një takim në datën 20 mars 2025 ekspertët e lartë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK), z. Benjamin Peters, Drejtues i Komunikimit me Jashtë; z. Dan Gluckman, Menaxher i Lartë për Komunikim Dixhital; znj. Natalie Low, Menaxhere e Lartë e Auditimit, në kuadër të bashkëpunimit bilateral me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD).

NAO UK vjen për herë të parë në Shqipëri për të ofruar asistencë teknike në KLSH mbi strategjinë e komunikimit të institucionit dhe përmirësimin e teknikave dhe mënyrës së shkrimit të raporteve të auditimit. Diskutimet u përqendruan në zhvillimin e kapaciteteve të audituesve në shkrimin e raporteve të auditimit dhe vijimin e bashkëpunimit në fushën e komunikimit. Gjithashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit mbi zhvillimin e metodologjive të përparuar që ofrojnë ngritjen e standardeve profesionale.



Ekspertët e NAO-s zhvillojnë trajnime me audituesit e KLSH-së mbi shkrimin e raporteve dhe Strategjinë e Komunikimit

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe mbështetjes teknike të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD), në datat 19-21 mars në ambientet e Hotel Tirana International u zhvillua trajnimi mbi shkrimin e raporteve të auditimit dhe mbi Strategjinë e Komunikimit.

Trajnimi u realizua nëpërmjet asistencës teknike nga ekspertët e lartë në fushën e komunikimit të NAO UK, z. Benjamin Peters, Drejtues i Komunikimit me Jashtë, z. Dan Gluckman, Menaxher i Lartë për Komunikimin Dixhital dhe znj. Natalie Low, Menaxhere e Lartë e Auditimit.

Ekspertët e NAO UK nënvizuan rëndësinë e një strategjie efektive komunikimi për Institucionet Supreme të Auditimit, ndërveprimi me Parlamentin, duke u fokusuar në hartimin dhe shpërndarjen e informacionit në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, hartimin e buletineve, për të rritur transparencën dhe ndërveprimin me publikun dhe aktorët institucionalë, përdorimin e mjeteve dixhitale për të forcuar ndikimin e mesazheve publike dhe për të rritur efektivitetin e komunikimit institucional.

Ekspertët e NAO UK vlerësuan Strategjinë e Komunikimit që KLSH ka në zbatim, duke shprehur gatishmërinë për të ofruar ndihmën e tyre në përmirësimin e këtij dokumenti bazuar në praktikën e ndjekur nga NAO.

Trajnimi mbi shkrimin e raporteve të auditimit, i udhëhequr nga znj. Natalie Low, pati në fokus përmirësimin e aftësive për shkrimin e raporteve të auditimit. Përmes sesioneve praktike dhe ushtrimeve u trajtuan në mënyrë konkrete teknikat mbi përcaktimin e fushës së auditimit dhe gjetjeve kryesore, strukturës logjike në raportim dhe teknikat për një raportim efektiv. Në përfundim të trajnimit, nga pjesëmarrësit u theksua rëndësia e përdorimit të teksteve të thjeshta në raportim si dhe paraqitja grafike e të dhënave në mënyrë të përmbledhur, për të ofruar një pasqyrë të plotë dhe të qartë të punës audituese. Ky trajnim përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të audituesve dhe stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji të qëndrueshme komunikimi, duke rritur ndikimin dhe besueshmërinë e institucionit në raport me publikun dhe partnerët institucionalë.



KLSH - UN Women Albania forcojnë bashkëpunimin për barazinë gjinore



Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe UN Women Albania nënshkruan më 10 mars 2025 një "Memorandum Mirëkuptimi" për të avancuar auditimet në fushën e barazisë gjinore, duke siguruar që burimet publike t'u përgjigjen nevojave si të grave ashtu edhe të burrave. Memorandumi u nënshkrua në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit nga kryetari i KLSH-së z. Arben Shehu dhe z. Michele Ribotta, përfaqësues i UN Women në Shqipëri.

Kjo marrëveshje e dytë ndërmjet KLSH-së dhe UN Women shenjon thellimin e bashkëpunimit të suksesshëm të zhvilluar ndërmjet të dy partnerëve deri më tani në fusha me rëndësi si ajo e integritetit të perspektivës gjinore në proceset e auditimit dhe ajo e avancimit të barazisë gjinore në menaxhimin e financave publike.

Palët shprehën vullnetin e plotë për përbushjen me sukses edhe përgjatë 2-vjeçarit të ardhshëm të të gjitha angazhimeve që rrjedhin nga marrëveshja e re dypalëshe.



Auditues të KLSH-së, pjesë e trajnimeve në Gjykatën Europiane të Llogarive (ECA)



Për më shumë se një dekadë, bashkëpunimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Europiane të Llogarive nëpërmjet praktikave të trajnimit ka kontribuar në formimin profesional të audituesve të KLSH-së, për të aplikuar standardet dhe praktikat më të mira europiane në fushën e auditimit.





Në kuadër të këtij bashkëpunimi u zhvillua programi i trajnimit në Gjykatën Europiane të Llogarive në Luksemburg për periudhën 1 tetor 2024 deri në 28 shkurt 2025, ku KLSH u përfaqësua nga znj. Blerta Hima, përgjegjëse Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë; z. Fatlum Dogjani, auditues në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja; z. Erald Kojku, auditues në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja; znj. Mirela Vasil, audituese në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore; z. Blerti Shehu, auditues në Departamentin e Auditimit të Institucioneve të Sigurisë dhe Pronës Publike. Programi trajnues kishte për qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të audituesve dhe t'u ofronte atyre njohuri mbi praktikat më të mira dhe metodologjitë e përdorura nga ECA. Përfitimet kryesore nga trajnimi përfshijnë njohuri të metodologjive bashkëkohore të ECA-s, përmirësim të teknikave të vlerësimit të riskut, rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies dhe rëndësinë e një metodologjie të organizuar dhe të strukturuar në procesin e auditimit.

Bashkëpunimi i KLSH-së me ECA-n ka nisur prej vitit 2014 dhe ndër vite mbi 20 auditues kanë marrë pjesë në praktikat profesionale që ofron ky institucion për SAI-et europiane, veçanërisht të vendeve kandidatë për në BE.

Falënderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë - E enjte: 08:00 - 16:30 E premte: 08:00 - 14:00



**MAJ
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Maj 2025



KLSH nis aktivitetet për 100-vjetorin e themelimit nga qyteti i “Pavarësisë”

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka nisur nga qyteti i “Pavarësisë” aktivitetet për 100-vjetorin e krijimit të institucionit, një ngjarje e shenjuar për rrugëtimin e kontrollit të financave publike në Shqipëri. Në datën 10 prill 2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu dhe Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, znj. Vlora Spanca, së bashku me përfaqësues të të dyja institucioneve zhvilluan një vizitë në qytetin e Vlorës. Megjithëse KLSH u krijua si strukturë e plotë 13 vite pas lindjes së shtetit shqiptar, problemi financiar zinte një vend të rëndësishëm në politikën dhe veprimtarinë ekonomike të “Qeverisë së Vlorës”, të drejtuar nga Ismail Qemali.

Kujtesa historike është një nga elementët kryesorë në krijimin e identitetit të qëndrueshëm jo vetëm të një kombi, por edhe të një institucioni shtetëror. Ndaj, KLSH zgjodhi pikërisht Muzeun e Pavarësisë në Vlorë si një nga vendet më të rëndësishme historike të Shqipërisë, ku u mbajt shpallja e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, për të çelur siparin e aktiviteteve të 100-vjetorit.

Në takimin me delegacionin e ZKA-së në Muzeun e Pavarësisë u shpalos e historia e shpalljes së Pavarësisë dhe shtetformimit shqiptar, që shënon njëkohësisht momentin e krijimit të institucioneve shtetërore, zhvillimin e tyre ndër vite dhe rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të financave publike.



Drejtuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit theksuan rëndësinë e kontrollit të jashtëm të financave publike, si një shtyllë thelbësore e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies.

Duke vlerësuar trashëgiminë historike të vendit tonë, z. Shehu dhe znj. Spanca nënvizuan se për të ruajtur dhe avancuar më tej vlerat e profesionalizmit dhe integritetit në funksion të interesit publik, nevojiten institucione të përgjegjshme që punojnë me përkushtim për forcimin e shtetit ligjor dhe për një qeverisje në shërbim të qytetarëve.

Znj. Spanca përgëzoi KLSH-në për përvjetorin jubilar, duke vlerësuar kontributin 100-vjeçar të këtij institucioni në shërbim të shtetit dhe qytetarëve.

Më 20 maj 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit mbush plot 100 vite institucion që nga data e themelimit në vitin 1925 me emërtimin “Këshilli Kontrollues”.

Statistika



54 auditime të evaduar për vitin 2025

93 auditime janë në proces

19 auditime të evaduar në prill

44 raporte auditimi të publikuara në web

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në takim Ambasadorin Italian në Shqipëri, z. Marco Alberti



Ambasadori i Italisë në Shqipëri, z. Marco Alberti, së bashku me drejtuesin e lartë të Guardia Di Finanza, Giampiero Carrieri zhvilluan në datë 15 prill 2025 një takim me kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu.

Shkëlqesia e Tij shprehu vlerësimin e lartë për punën e kryer nga KLSH në fushën e kontrollit financiar të institucioneve shtetërore. Ambasadori Italian e cilësoi themelor rolën e KLSH-së në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

"Ju, zoti Kryetar, zini një vend delikat në strukturën dhe arkitekturën e shtetit, mbi të gjitha në dimensionin e negociatave për hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku transparenca, rregullsia, saktësia, përgjegjshmëria dhe sistemi i llogarive publike luajnë një rol thelbësor" - u shpreh z. Alberti. Ai theksoi se bashkëpunimi mes institucioneve shqiptare dhe atyre italiane do të intensifikohet së shpejti.

Gjithashtu, Kreu i KLSH-së, z. Arben Shehu, falënderoi Ambasadorin Alberti për vizitën dhe vlerësimin. Z. Shehu shprehu mirënjohjen e tij mbi mbështetjen e dhënë nga institucionet italiane në punën e KLSH-së dhe nënvizoi nevojën për konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe. Z. Shehu vlerësoi rëndësinë e madhe të bashkëpunimit midis dy vendeve në sektorin e hetimit financiar të institucioneve publike, duke e konsideruar atë thelbësor për forcimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit në Shqipëri. Ambasadori konfirmoi nisjen e bashkëpunimit brenda disa muajsh mes KLSH-së dhe institucioneve të rëndësishme akademike të hetimit financiar.

Gjithashtu, u komunikua për rritjen e prezencës së stafit të KLSH-së në institucionet italiane si Guardia di Finanza dhe Policia Italiane për marrjen e eksperiencave më të mira në hetimin financiar. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunimit në fushën e kontrollit financiar, si një aspekt kyç për rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.



Lufta kundër korrupsionit, ekspertët e Komisionit European takohen me z. Shehu në KLSH



Në kuadër të misionit të vlerësimit për "Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu priti në takim në datën 7 prill 2025 ekspertët e Komisionit European.

Gjatë takimit, z. Shehu nënvizoi angazhimin e KLSH-së për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore dhe institucionale, duke siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet ligjzbatuese. Kryetari i KLSH-së theksoi se institucioni është i përkushtuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë takim morën pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe përfaqësues nga Drejtoria Juridike.

KLSH-ZKA, zhvillohet takimi i parë i punës për auditimin paralel “Mbrojtja dhe Siguria e Digave”



Pas vendimit të drejtuesve të dy Institucioneve Supreme të Auditimit në Shqipëri dhe Kosovë, për të kryer një auditim paralel për mbrojtjen dhe sigurinë e digave, në datat 1 dhe 2 prill 2025 u zhvillua në mjediset e KLSH-së takimi i parë i punës i grupeve të auditimit. Grupet e auditimit të KLSH-së dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) diskutuan mbi situatën në Shqipëri dhe Kosovë, sa i përket problematikave të evidentuara lidhur me sigurinë e digave, qartësimin e kuartrit ligjor e rregullator, fokusimin në çështje me rëndësi, shkëmbimin e praktikave të mira kombëtare e ndërkombëtare etj. Në takim u paraqit vlerësimi dhe klasifikimi i digave sa i përket nivelit të riskut, praktikë kjo që nuk kryhet dhe nuk është e parashikuar në kuartrin ligjor/rregullator, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. Metodologjia dhe fushëveprimi i auditimeve të performancës në Shqipëri e Kosovë kanë ngjashmëri me afatet dhe komunikimin me subjektet nën auditim. Grupet audituese të KLSH-së dhe ZKA-së do të vijojnë komunikimin me qëllim shqyrtimin e informacioneve dhe të dhënave më të detajuara, për të konkluduar në finalizimin e programit të auditimit për mbrojtjen dhe sigurinë e digave në Shqipëri dhe Kosovë.

KLSH merr pjesë në programin pilot të Akademisë Ndërkombëtare të OECD për “Hetimin e Tatimeve dhe Krimin Financiar”

Në datat 31 mars-4 prill 2025 u zhvillua në Ostia Programi pilot i Akademisë Ndërkombëtare të OECD-së me temë “Keqpërdorimi i Teknologjisë në Krimet Financiare”. KLSH mori pjesë për herë të parë në këtë program duke u përfaqësuar me znj. Joniada Coçaj.

Ky program kishte në fokus çështjet lidhur me përdorimin e teknologjisë për të lehtësuar evazionin fiskal, pastrimin e parave dhe krime të tjera financiare; si dhe sa thelbësor është kuptimi i këtyre rreziqeve me qëllim forcimin e kapaciteteve hetimore dhe zbatimin e ligjit, mbrojtjen e financave publike dhe sigurimin e integritetit të sistemit financiar global.

Disa nga temat kryesore që u trajtuan gjatë këtij programi ishin:

- “Big Data” në Krimet Financiare: Kuptimi i rolit të tyre në identifikimin dhe parandalimin e krimeve financiare.
- Keqpërdorimi i Teknologjisë Financiare (FinTech) dhe Krimet e Reja: Si keqpërdoren teknologjitë financiare për aktivitete të paligjshme.
- Inteligjenca Artificiale dhe ChatGPT: Roli i inteligjencës artificiale në lehtësimin dhe luftimin e krimeve financiare.
- Crypto Assets and Blockchain: Analizimi i rreziqeve që lidhen me kriptovalutat, financën e decentralizuar dhe NFT-të. (“Të Pasurive Digjitalë Jo të Këmbyeshme”).
- Rreziqet e Pastrimit të Parave nga Keqpërdorimi i Kriptovalutave: Identifikimi i vulnerabiliteteve dhe zbatimi i masave efektive kundër tyre.




Gjatë programit 5-ditor u trajtuan shembuj konkretë nga vendet, si: Holanda; Britania e Madhe, Hong Kongu dhe Singapori, në lidhje me keqpërdorimin e teknologjisë në krimet financiare. Në përfundim të programit u theksua se megjithëse teknologjia ofron përfitime të mëdha në luftën kundër krimeve financiare, ajo gjithashtu krijon mundësi për krime të sofistikuara, përfshirë: shmangien e tatimeve duke përdorur platformat e financës të decentralizuara; pastrimin e parave përmes NFT-ve dhe shkëmbimeve të kriptovalutave; keqpërdorimin e inovacioneve nga Inteligjenca Artificiale dhe Fintech për fitime të paligjshme.

KLSH, pjesë e trajnimeve të Zyrës Suedeze të Auditimit (SNAO) për auditimin e performancës



Zyra Suedeze e Auditimit (SNAO) ka organizuar në datat 1-4 prill 2025 në Sarajevë bllokun e parë të programit të trajnimit për auditimin e performancës. Qëllimi i këtij programi është ofrimi i një trajnimi të strukturuar për të ndihmuar në ndërtimin e një rrjeti profesional të auditimit të performancës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Pjesëmarrës në këtë trajnim janë grupe audituesish të rinj nga Institucione Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Kosovës, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Moldavisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës. KLSH merr pjesë në këtë program me auditimin e performancës “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit”, me pjesëmarrjen e auditueseve Annavanessa Hoxhaj dhe Lorena Liçi.

KLSH ndjek e-seminarin e organizuar EUROSAT mbi “Auditimin e infrastrukturës kritike të informacionit”



EUROSAT IT Working Group

Grupi i punës i EUROSAT IT Working Group, në të cilin anëtarëson edhe KLSH, organizoi në datë 24 prill 2025 seminarin online me titull: “*Auditimi i infrastrukturës kritike të informacionit*”. Qëllimi i këtij seminary ishte eksplorimi mbi sigurinë kibernetike dhe auditimi i infrastrukturës kritike të informacionit në një mjedis gjithnjë e më të ndërlikuar dixhital, duke shkëmbyer përvoja ndërkombëtare dhe praktika të mira mes anëtarëve të EUROSAT dhe partnerëve ndërkombëtarë.


Seminari online u organizua si kombinim i ndarjes së përvojave nga SAT të ndryshme, diskutime me panel ekspertësh, si dhe pyetje e sondazhe ndërvepruese me pjesëmarrësit.

Në fjalën e hapjes, kryetari i EUROSAT - IT WG, njëkohësisht drejtues i SAT-të Estonisë, theksoi se sistemet e ngritura mbi infrastruktura kritike janë shumë të rëndësishme për funksionimin e një shteti dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Në këtë kontekst, po aq i rëndësishëm është dhe zhvillimi i auditimit IT në këto infrastruktura.

Autoriteti i Sistemit të Informacionit të Estonisë ofroi shembujt e praktikave si institucioni model në drejtim të zhvillimeve teknologjike, në të cilin standardet për sigurinë kibernetike (cybersecurity) rinovohen çdo vit duke pasur parasysh ndryshimet teknologjike të shpejta dhe përvojat e së shkuarës, me fokus riskun e sulmeve kibernetike, siç e theksoi në fjalën e tij dhe përfaqësuesi i Autoritetit të Sistemit të Informacionit të Estonisë (Estonian Information System Authority).

Në panelin e diskutimit për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në të ardhmen u ndanë mendime mbi sfida të vazhdueshme mbi standardet dhe reagimet ndaj incidenteve, qasjen ndaj riskut të sulmeve kibernetike, ndërgjegjësimin për monitorim të vazhdueshëm etj.

Pjesëmarrësit u shprehën se maturimi me qëllim menaxhimin dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike nuk është i njëjtë në shtete të ndryshme. Për këtë arsye, entet publike dhe private duhet të kenë prioritet simulimin e incidenteve kibernetike, me fokus marrjen e informacionit për situatën aktuale të infrastrukturave të tyre dhe, ku duhet të ndërhyjnë me qëllim rritjen e sigurisë.



Në vijim të seminarit, përfaqësuesi nga Zyra e Përgjithshme e Auditimit të SHBA-së (U.S GAO) zhvilloi prezantimin me temë: “*Përdorimi i auditimeve për të përmirësuar mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga kërcënimet kibernetike*”, duke bërë një pasqyrim të situatës aktuale dhe çfarë mund të përmirësohet për të zvogëluar riskun e sulmeve “ransomware”.








Në këtë kuadër, GAO ka krijuar dhe udhëzuesin për “*Auditimin e Programeve të Sigurisë Kibernetike*” (Cybersecurity Program Audit Guide), për t’u siguruar audituesve metodologjinë, teknikat, si dhe e procedurat për të bërë vlerësimet e duhura gjatë auditimeve të infrastrukturave kritike.

Në fjalën përmbyllëse, Sekretariati i IT WG njoftoi mbi planifikimin e takimit vjetor hibrid të IT WG, me fokus qeverisjen dhe shërbimet elektronike (e-government, e-service).

Ky seminar u ndoq nga audituesit e Departamentit të Auditimit IT, si dhe nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në KLSH.

Falënderit për leximin!


© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00



**QERSHOR
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Qershor 2025



KLSH feston 100-vjetorin e themelimit, Shehu: Institucioni do t'i qëndrojë besnik misionit të interesit publik

Në datë 20.05.2025, në një ceremoni solemne të mbajtur në sallën e seancave plenare të Kuvendit Republikës së Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) festoi 100-vjetorin e themelimit, një moment historik për institucionin më të lartë të auditimit në vend.

Pjesëmarrës në këtë ngjarje të rëndësishme për historinë institucionale të vendit ishin Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik, delegacione nga 19 institucione supreme auditimi në rajon dhe më gjerë, partnerë ndërkombëtarë, ministra, deputetë, drejtues institucionesh, akademikë, përfaqësues të medias, të shoqërisë civile, punonjës dhe ish-punonjës të KLSH-së etj.

Ceremonia u hap me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, i cili theksoi rëndësinë e këtij jubileu jo vetëm si përkujtim historik, por si një pikënisje për të ardhmen. *"Dua të ritheksoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit do të qëndrojë besnik ndaj misionit të tij kushtetues në sinkron me interesin e shtetit dhe në thelb të çdo shqiptari. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë interesin publik dhe të çdo shtetasi shqiptar, me përkushtim ndaj parimeve të shtetit të së drejtës dhe të mirëqeverisjes"*, - theksoi Kryetari i KLSH-së.

Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, në fjalën e saj vlerësoi Kontrollin e Lartë të Shtetit, si një instrument kyç për forcimin e demokracisë dhe luftën kundër korrupsionit, duke siguruar mbështetjen e Kuvendit për ruajtjen e pavarësisë institucionale.

Në aktivitet mbajti fjalën edhe Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian, z. Silvio Gonzato. Duke vlerësuar rolin kyç të Kontrollit të Lartë të Shtetit në forcimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës në vend, Ambasadori Gonzato theksoi se një institucion i pavarur, i besueshëm dhe efektiv është thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Gjithashtu, në ceremoni përshëndetën Presidenti i EUROSAI-t dhe Kontrollori i Shtetit të Izraelit, z. Matanyahu Englman; Presidenca e INTOSAI-it me përfaqësues z. Augusto Nardes, Ministër pranë Gjykatës së Llogarive të Brazilit; Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, znj. Vlora Spanca; Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit në Poloni, z. Marian Banaś; Zv. Presidentja e Gjykatës Greke të Auditimit, znj. Maria Vlachaki etj.

Statistika



15 aktivitete të organizuara në kuadër të 100-vjetorit të institucionit



19 delegacione nga SAI homologe pjesëmarrëse në aktivitete

Fjala e Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, në ceremoninë e 100-vjetorit të themelimit të institucionit



*E nderuar Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar përfaqësues të Kuvendit,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve partnere,
Të nderuar drejtues të institucioneve të Republikës së Shqipërisë,
Të nderuar përfaqësues të medias,
Të dashur kolegë dhe bashkëpunëtorë,
Zonja dhe zotërinj,*

Është një nder i veçantë që sot, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kremtojmë së bashku përvjetorin e 100-të të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, një institucion që për një shekull ka kontribuar në forcimin e kulturës së llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes në menaxhimin e financave publike.

Ky përvjetor përfaqëson një moment historik jo vetëm për KLSH-në, por për gjithë zhvillimin institucional të Shqipërisë moderne. I themeluar në maj 1925, në një etapë vendimtare për konsolidimin e shtetit shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë i pranishëm në çdo fazë të transformimit të administratës publike. Përgjatë një shekulli, ai ka vepruar në kushte të ndryshme historike dhe politike, nga periudha e monarkisë, te regjimi i centralizuar i pasluftës, deri te faza e tranzicionit demokratik pas viteve '90. Gjatë kësaj kohe, institucioni ka ruajtur misionin e tij thelbësor: mbikëqyrjen e përdorimit të drejtë të fondeve publike.

Pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 dhe reformave të mëvonshme, KLSH mori një rol të qartë si organ i pavarur kushtetues. Ai ka qenë aktiv në përshtatjen e standardeve të auditimit sipas modeleve më të avancuara, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare si INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe bashkëpunimi rajonal, ka ndihmuar në zhvillimin profesional të audituesve dhe në forcimin e praktikave të mira, duke rritur ndjeshëm cilësinë e veprimtarisë sonë.

Ky përvjetor është edhe një rast për të nderuar përkushtimin e brezave që e kanë ndërtuar këtë institucion. Kontributi i tyre ka lënë një trashëgimi të çmuar për administrimin e drejtë dhe efikas të financave shtetërore. Kjo trashëgimi ka ndihmuar në ndërtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet shtetërore, duke garantuar një menaxhim financiar që mbështetet jo vetëm në efikasitet, por mbi të gjitha në ndershmëri, transparencë dhe përgjegjshmëri.

Të nderuar pjesëmarrës, dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohjen time të thellë që kemi sot mes nesh përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit nga vende partnere, përfaqësues të trupit diplomatik, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, drejtues të institucioneve të pavarura dhe të administratës publike, akademikë, përfaqësues të universiteteve, organizata të shoqërisë civile, partnerët tanë institucionalë vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe në veçanti, përfaqësues të medias, e cila në Shqipëri është ngritur mes vështirësive në një nivel të vërtetë institucional dhe, për të cilën, në emër të institucionit dua të shpreh një mirënjohje të veçantë. Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet është jo vetëm një vlerësim për Kontrollin e Lartë të Shtetit, por edhe një dëshmi e mbështetjes për institucionet e shtetit shqiptar.

Të nderuar të pranishëm,

100 vite histori nuk janë thjesht një rrugëtim për t'u përkujtuar, por një bazë e fortë për të ndërtuar të ardhmen. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vazhdojë të përmirësojë kapacitetet profesionale, të adoptojë teknologji moderne dhe të qëndrojë në dobi të interesit të përbashkët.

Ky përvjetor është jo vetëm një pikë ndalese për të vlerësuar rrugëtimin tonë, por edhe një pikënisje për një angazhim të ri, për të ndërtuar një të ardhme më të përgjegjshme, më efikase dhe më të ndershme në shërbim të qytetarit.

Dua të ritheksoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit do të qëndrojë besnik ndaj misionit të tij kushtetues në sinkron me interesin e shtetit dhe në thelb të çdo shqiptari. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë interesin publik dhe të çdo shtetasi shqiptar, me përkushtim ndaj parimeve të shtetit të së drejtës dhe të mirëqeverisjes. Jam i bindur se rruga jonë e përbashkët do të vijojë me bashkëpunim të qëndrueshëm, shkëmbim të ndërsjellët dhe mbështetje reciproke për të ndërtuar institucione më të forta dhe administratë më të përgjegjshme.

Ju falënderoj edhe një herë për praninë tuaj sot, për vlerësimin që i keni bërë këtij përvjetori, dhe për mbështetjen që i ofroni vazhdimisht misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Faleminderit!

Fjala e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali



Sot Kontrolli i Lartë i Shtetit mbush një shekull jetë.

As jam historiane, as kam për qëllim të bëj histori. Por dëshiroj të them dy fjalë për rrugëtimin njëqindvjeçar të këtij institucioni të rëndësishëm të shtetit shqiptar.

Menjëherë pas themelimit, shteti i pavarur shqiptar bëri përpjekje të krijonte institucionin që do të merrej me kontrollin e financave të tij. Kuptohet, me atë vizion, perceptim e funksion që mundësonte koha.

Por qeveritë e para nuk ia dolën ta ndërtonin këtë institucion me formatin dhe përmbajtjen e vet si një instancion kushtetues. Kjo ishte e kuptueshme, nëse mbajmë parasysh kontekstin historik dhe furtnat e kohës që rrezikonin mbijetesën e Shqipërisë dhe shtetit të saj të ri.

Vetëm në Republikën e vitit 1925, pra 13 vjet pas themelimit të shtetit shqiptar, Këshilli Kontrollues i Financave u krijua dhe funksionoi si institucion kushtetues.

Nuk është një vonesë e madhe në kohë, nëse konsiderojmë historinë e shtetformimit në vende të tjera dhe kushtet historike e gjeopolitike gjatë dekadës së parë të jetës së Shqipërisë së pavarur.

Pra, ndërsa shteti bëri si bëri pa institucionin e kontrollit për më shumë se një dekadë, Republika si formë qeverisjeje e kërkoi dhe e realizoi atë si një institucion kushtetues menjëherë pas krijimit të saj.

Edhe Kushtetuta e Mbretërisë Shqiptare e sanksionoi Këshillin Kontrollues si organ të pavarur.

Gjatë regjimit komunist, organet e Kontrollit të Shtetit funksionuan si instrumente të forta audituese, kontrolluese e politike të pushtetit popullor dhe në shërbim të tij.

Në sistemin demokratik, me ulje-ngritje jo të vogla e të pakta, Kontrolli i Lartë i Shtetit u bë organi më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar dhe pavarësia e depolitizimi i këtij institucioni është sanksionuar në Kushtetutë dhe ligjin organik.

Kuvendi do të vazhdojë të mbështesë Kontrollin e Lartë të Shtetit si një institucion kushtetues, një partner në përpjekjet tona për zhvillimin dhe rritjen ekonomike, për të rritur performancën financiare, për mbështetjen e sundimit të ligjit, mirëqeverisjes dhe për të përshpejtuar ritmet e integritetit evropian të Shqipërisë.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të cilin kemi tashmë një plan të dakordësuar me institucionet europiane, është jo vetëm kurorëzimi i një procesi të nisur 35 vjet më parë, por edhe starti i një rrugëtimi të ri, kur të gjitha institucionet e Republikës do të jenë institucione të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian.

Gjej rastin të nënvizoj se Kuvendi do të vijojë të mbështesë të gjitha institucionet kushtetuese të krijuara me ligj dhe pavarësinë e tyre, për të përmbushur misionin si roje të interesit publik e qytetar.

Pavarësia e institucioneve është një përmasë jetike e mirëfunksionimit të pushteteve në sistemin demokratik, po aq sa edhe përgjegjësia, trasparenca dhe llogaridhënia e tyre. Prandaj deviza e bashkëpunimit tonë përmbledhet në tri fjalë: pavarësi, mbështetje, partneritet.

Ne vlerësojmë përpjekjet tuaja për forcimin e pavarësisë dhe profesionalizmit institucional, si një institucion kushtetues që udhëhiqet nga parimet e shtetit të së drejtës, vlerësojmë këto edhe të raporteve më të fundit të monitorimit të Shqipërisë nga OECD dhe BE.

Megjithatë, Kuvendi, por mendoj edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, ndajmë të njëjtin vlerësim se është i nevojshëm forcimi i mbikëqyrjes parlamentare, për ta bërë veprimtarinë tuaj më efektive, për të rritur trasparençën dhe ndikimin e auditimeve në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Bashkëpunimi ynë më i ngushtë e më i hapur, si edhe komunikimi më intensiv, do të fuqizojnë dimensionin parandalues të veprimtarisë së kontrollit dhe harmonizimin më të mirë me masat ndëshkimore.

Bashkëpunimi ynë më i ngushtë e më i hapur, si edhe komunikimi më intensiv, do të fuqizojnë dimensionin parandalues të veprimtarisë së kontrollit dhe harmonizimin më të mirë me masat ndëshkimore.

Sinergia midis parandalimit dhe ndëshkimit nuk është vetëm një kërkesë e Kuvendit, as vetëm e kohës sonë. Ka qenë e tillë edhe në hapat e parë të funksionimit të këtij institucioni, kur burimet e shtetit shqiptar për ta mbajtur atë ishin të kufizuara, përvoja mungonte dhe kapacitetet institucionale e burimet njerëzore po ashtu ishin modeste. Është e tillë edhe në institucionet homologe të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera demokratike.

Kuvendi është i angazhuar në luftën kundër korrupsionit dhe për këtë ka kërkuar dhe do të vijojë të kërkojë kontributin tuaj.

Por lufta korrupsionit nuk synon goditjen e punonjësve publikë si një qëllim në vetvete, por edhe mbështetjen e tyre për të menaxhuar më mirë burimet e shtetit, si dhe mbylljen e shtigjeve ligjore dhe institucionale për abuzim.

Lufta jonë e përbashkët e pakompromis, e vendosur dhe me temp në rritje kundër korrupsionit, shpërdorimit të posteve dhe abuzimeve me financat publike, nuk duhet të na stepë të dallojmë shpërdoruesit, abuzuesit dhe krimet në menaxhimin e financave, programeve e projekteve publike, nga shërbyesit korrektë, të ndershëm dhe dinjitozë të shtetit, të cilët kanë kontribuar e kontribuojnë për zhvillimin e vendit. Shqipëria është sot para deryeve të Bashkimit Evropian edhe në saj të kontributit të tyre.

Në vijim, edhe të zbatimit të rekomandimeve të Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian, ne po punojmë për forcimin e mekanizmit të zbatimit të rekomandimeve përmes dialogut dhe bashkëpunimit më të strukturuar të Kuvendit me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Ky bashkëpunim ka marrë një dimension të ri pas ngritjes së Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, një strukturë që synon të sigurojë një ndërlidhje më të ngushtë dhe më efektive ndërmjet funksionit kontrollues të Kuvendit dhe veprimtarisë audituese të KLSH-së.

Ky Nënkomision përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për mbikëqyrjen parlamentare të menaxhimit të financave publike dhe që në themelimin e tij ka dëshmuar potencialin për të sjellë një frymë të re përgjegjshmërie, transparence dhe dialogu institucional.

Konstatohet se edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka treguar angazhim për thellimin e këtij bashkëpunimi, duke marrë hapa konkretë, përfshirë krijimin e një drejtorie të posaçme të dedikuar për komunikimin me Kuvendin dhe me Nënkomisionin, në mënyrë që shkëmbimi i informacionit, trajtimi i raporteve dhe ndjekja e rekomandimeve të bëhen në mënyrë më efektive dhe të strukturuar.

Ky është një zhvillim që duhet përshëndetur dhe inkurajuar, pasi po rrit cilësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional, forcon kontrollin demokratik mbi administratën publike dhe përmirëson kulturën e llogaridhënies në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Kuvendi mbetet i përkushtuar për ta çuar përpara këtë partneritet të rëndësishëm, në funksion të interesit publik dhe të ndërtimit të institucioneve më të forta, më transparente dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Në këtë frymë bashkëpunimi të konsoliduar, Kuvendi i Shqipërisë është plotësisht i angazhuar për të fuqizuar më tej mjetet dhe mekanizmat inovativë që i shërbejnë rritjes së trasparençës dhe ndjekjes efektive të rekomandimeve të auditimit.

Një nga iniciativat më të rëndësishme në këtë drejtim është rikonfigurimi i Platformës Ndërinstitucionale Online, një instrument modern dhe gjithëpërfshirës, që synon të mundësojë një ndërlidhje më efektive ndërmjet institucioneve që prodhojnë, trajtojnë dhe zbatojnë rekomandime audituese dhe Kuvendit, si organ mbikëqyrës.

Duke i dhënë kësaj platforme një dimension të ri funksional dhe strategjik, synojmë jo vetëm të përmirësojmë monitorimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe audituesve të tjerë publikë, por edhe të nxisim aktivisht institucionet e administratës shtetërore të kontribuojnë në mënyrë të rregullt dhe të përgjegjshme në popullimin e saj.

Kuvendi do të vijojë të luajë një rol kyç në këtë proces, jo thjesht si mbikëqyrës, por si nxitës i një kulture të re bashkëpunimi e llogaridhënieje në të gjithë spektrin institucional.

Modernizimi i praktikave, zgjerimi i fushëveprimit, rritja e ndikimit të auditimeve në administratën publike, përmirësimi i trasparençës dhe komunikimit me publikun, rritja e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore, vlerësoj se janë disa nga prioritetet tuaja, të cilat mund të rrisin cilësinë e kontrollit dhe auditimit, si edhe efektivitetin e punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimit me fondet publike, për të cilat ndihma e Kuvendit as ka munguar dhe as do të mungojë.

Ambasadori Gonzato: KLSH, gur themeli për integrimin e Shqipërisë në BE

Në ceremoninë e 100-vjetorit të KLSH-së, mbajti fjalë edhe Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian, z. Silvio Gonzato. Duke vlerësuar rolin kyç të Kontrollit të Lartë të Shtetit në forcimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës në vend, Ambasadori Gonzato theksoi se një institucion i pavarur, i besueshëm dhe efektiv është thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

"Puna e tij shkon përtej auditimit, ndihmon në parandalimin e mashtrimeve, parregullsive në prokurime dhe promovon transparencën përmes përfshirjes së hapur me qytetarët dhe institucionet. Ne mbetemi të përkushtuar për të mbështetur Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndërsa Shqipëria avancohet në rrugën e saj drejt BE-së. Legjislacioni i BE-së kërkon që institucionet si KLSH të jenë të pavarura dhe të pajisura me burimet dhe mandatin e duhur për të ushtruar kontroll mbi të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e fondeve publike, përfshirë ato të Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë. Çfarëdo ndryshimesh që do të bëhen duhet të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit dhe standardeve të BE-së", - tha Ambasadori Gonzato.



Fjala e z. Matanyahu Englman, President EUROSAT dhe Kontrollor i Shtetit të Izraelit

Shkëlqesia Juaj, znj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;

I nderuar z. Arben Shehu, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Të nderuar folës, delegatë dhe të ftuar të respektuar,

Është një nder i jashtëzakonshëm dhe një kënaqësi e thellë, që në cilësinë time si President i EUROSAT-t, t'ju drejtohem sot në këtë rast vërtetë historik, për të festuar 100-vjetorin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ky nuk është thjesht një moment historik, por një dëshmi e një shekulli përkushtimi të palëkundur ndaj transparencës, integritetit dhe llogaridhënies financiare.

Dëshiroj gjithashtu të shpreh një mirëseardhje të përzemërt për kolegët tanë të nderuar dhe anëtarët e EUROSAT-t dhe INTOSAT-t nga mbarë bota, të cilët kanë udhëtuar për t'u bashkuar në këtë festim. Prania juaj këtu dëshmon për angazhimin global ndaj parimeve të qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies publike që të gjithë ne ndajmë.

Që nga themelimi i tij në vitin 1925, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm dhe thelbësor në formësimin e strukturës së qeverisjes në Shqipëri. Nëpërmjet ndjekjes së pandërprerë të përsosmërisë në auditimin shtetëror, KLSH ka mbrojtur fondet publike, ka forcuar institucionet dhe ka nxitur besimin ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve të saj. Secili prej auditimeve të panurmëta të kryera gjatë dekadave ka shërbyer si një gur themeli për llogaridhënien publike, duke siguruar që burimet të menaxhohen në mënyrë efikase dhe të përgjegjshme. Për më tepër, nën udhëheqjen e përkushtuar të z. Arben Shehu, Kryetar aktual i Kontrollit të Lartë të Shtetit, KLSH ka vazhduar të mbrojë këto vlera thelbësore dhe të arrijë suksese edhe më të mëdha.

Kjo festë njëqindvjeçare nuk është vetëm një moment për të nderuar trashëgiminë e KLSH-së, por edhe për të vlerësuar brezat e audituesve, ekspertëve financiarë dhe nëpunësve civilë që kanë kontribuar në suksesin e saj. Përkushtimi i tyre i palëkundur ka bërë të mundur që KLSH të mbetet dhe të vazhdojë të jetë një dritë udhëzuese e qëndrueshme për mbikëqyrjen, duke garantuar përdorimin etik dhe efektiv të burimeve të Shqipërisë.

Ndërsa reflektojmë mbi të kaluarën e jashtëzakonshme të KLSH-së, po aq e rëndësishme është të shikojmë drejt së ardhmes; drejt misionit në zhvillim të Institucioneve Supreme të Auditimit në një botë që po ndryshon me ritme të shpejta. Në këtë kontekst, do të dëshiroja të ndaja disa fusha kryesore, fokusi që kam theksuar në rolin tim si President i EUROSAT-t dhe si Kontrollori i Shtetit të Izraelit.



Presidenti i EUROSAT-t, z. Matanyahu Englman, Kontrollor i Shtetit dhe Avokat i Popullit të Izraelit

Këto fusha përfaqësojnë shtyllat kryesore të auditimit në sektorin publik sot, secila me qëllim forcimin e llogaridhënies, inovacionit dhe qëndrueshmërisë:

Zëri për "Ata" pa zë

Si President i EUROSAT-t, kam theksuar rolin thelbësor të Institucioneve Supreme të Auditimit në forcimin e llogaridhënies publike dhe qeverisjes së mirë.

Kam avokuar për auditimin e performancës si një mjet kyç për të garantuar transparencë dhe efikasitet në administratën publike, si dhe për t'u dhënë një "Zë atyre pa zë". Në këtë frymë, Institucioni Suprem i Auditimit i Izraelit ka punuar për të forcuar bashkëpunimin midis anëtarëve të EUROSAT-t, siç është edhe auditimi paralel që po zhvillohet mbi temën e "Plakjes së popullsisë".

Inovacioni

Përparimi i shpejtë i teknologjisë paraqet një sërë sfidash dhe mundësish të reja. E konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme që ne, jo vetëm në EUROSAT, por në gjithë komunitetin e auditimit, të mësojmë të përshtatemi dhe të përballojmë këto sfida. Një pikë kyçe në vitet e fundit ka qenë Inteligjenca Artificiale, të cilën e kam parë me rëndësi të veçantë, kur nisa auditin paralel mbi inteligjencën artificiale (AI) në bashkëpunim me anëtarët e EUROSAT-t.

Për më tepër, së fundmi kemi publikuar disa raporte mbi sigurinë kibernetike dhe taksimin e kriptomonedhave, të cilat treguan se ende ka hapësirë për përmirësim.

Vijon në faqen tjetër

Fjala e z. Matanyahu Engلمان, President EUROSAT dhe Kontrollor i Shtetit të Izraelit

Qëndrueshmëria

Kam theksuar gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të auditimeve në fusha të lidhura me qëndrueshmërinë, siç është ndryshimi i klimës, veçanërisht në kontekstin e gatishmërisë për fatkeqësitë natyrore. Ne kemi publikuar disa raporte, përfshirë raportin e posaçëm të vitit 2021 mbi "Veprimin Kombëtar për Klimën" nga qeveria e Izraelit, i cili u pasua nga një auditim vijues që u publikua vitin e kaluar. Ndër të tjera raporte të lidhura me "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm", kemi publikuar edhe një raport të veçantë mbi gatishmërinë ndaj tërmeteve, duke pasur parasysh se vendi ynë parashikohet të përjetojë një të tillë në të ardhmen e afërt.

Gjatë dekadave, audituesit e përkushtuar të KLSH-së kanë kryer auditime të panumërta; vlerësimet e tyre rigorozë dhe mbikëqyrja strategjike kanë luajtur një rol vendimtar në përmirësimin e administratës publike, mbrojtjen e burimeve kombëtare dhe sigurimin e integritetit financiar, të gjitha këto, duke forcuar besimin ndërmjet administratës publike dhe qytetarit. Në vitet e fundit, auditimet e kujdesshme të KLSH-së kanë trajtuar një sërë çështjesh urgjente, si: zbatimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, të cilat janë thelbësore për reduktimin e ndotjes mjedisore dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë. Gjithashtu, KLSH ka kryer një auditim mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave nga zonat rurale, duke nxjerrë një paralele domethënëse me një auditim të ngjashëm të fundit të kryer nga Kontrollori i Shtetit të Izraelit mbi promovimin e barazisë gjinore brenda qeverisjes vendore.

KLSH trajton gjithashtu çështje si inkurajimi i turizmit dhe menaxhimi i burimeve natyrore. Çështje të ngjashme kanë qenë objekt i auditimeve të realizuara nga Zyra e Kontrollorit të Shtetit të Izraelit. Për shembull, auditimi i kryer nga shkurti deri në nëntor të vitit 2022, i cili shqyrtoi aspekte të ndryshme të ndihmës së veçantë të dhënë për industrinë e turizmit gjatë pandemisë së Covid-19 dhe zbatimin e saj, veçanërisht në vitet 2021 dhe 2022, gjatë të cilave, pjesa më e madhe e tregut botëror rifilloi aktivitetin e rregullt dhe barra mbi vendimmarrësit në lidhje me masat urgjente dhe sistematike për përbalimin e krizës u lehtësua ndjeshëm. Gjithashtu, auditimi i kryer në vitin 2022 në lidhje me rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror, i cili shqyrtoi gjendjen e infrastrukturës së shpërndarjes, përfshirë politikën e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, ndihmën e qeverisë për kompanitë e shpërndarjes dhe për konsumatorët përfundimtarë, barrierat burokratike për zhvillimin e këtij rrjeti dhe modelin e tij ekonomik.

Roli vendimtar i audituesve të shtetit në luftën kundër mashtrimit nuk mund të theksohet mjaftueshëm, pasi ata garantojnë transparencën financiare, llogaridhënien dhe përputhshmërinë me rregulloret në institucionet shtetërore. Në të kaluarën, Shqipëria ra viktimë e një mashtrimi shumë të rëndë dhe të dëmshëm të njohur si "Skemat piramidale", që destabilizoi rëndë vendin dhe rrezikoi kohezionin social.

Çështja e mashtrimit është shqetësim i përbashkët për çdo Institucion Suprem Auditimi në Europë. Një shembull i përkushtimit tonë ndaj parandalimit të mashtrimit në sektorin publik është raporti gjithëpërfshirës i auditimit i publikuar në maj të vitit 2022, me titullin: "Parandalimi i Përvetësimeve në Ministrinë dhe Kompanitë Qeveritare". Auditimi, i cili përfshiu 74 njësi publike, nxori në pah rreziqet sistematike të lidhura me përvetësimet dhe theksoi rëndësinë e kontrolleve proaktive dhe të një kulture të qeverisjes etike. Ky raport ishte gjithashtu novator dhe kreativ në qasjen e tij; ai nuk u përqendrua vetëm në inspektime retrospektive për të identifikuar pengesat dhe mashtrimet, por edhe në shqyrtimin e mekanizmave ekzistues të kontrollit për t'i parandaluar ato që në fillim.

Raporti zbuloi boshllëqe të mëdha në praktikën e menaxhimit të riskut, përfshirë mungesën e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të riskut në nivel organizativ, përdorimin e kufizuar të mjeteve teknologjike për zbulimin e mashtrimit dhe mekanizmat e pamjaftueshëm të auditimit të brendshëm. U theksua se më shumë se 80% e rasteve të përvetësimeve përfshinin zyrtarë të lartë dhe se shumica e entiteteve publike nuk kishin mekanizma të strukturuar për raportimin e parregullsive apo incidenteve të afërta me to. Raporti bëri thirrje për kuadër më të fortë qeverisës, integrim më të mirë të menaxhimit të riskut në vendimmarrje dhe adoptimin e teknologjive inovative për të zbuluar dhe parandaluar abuzimet financiare.

Këto gjetje të rëndësishme rezonojnë thellësisht me qëllimin e këtij takimi sot, ndërsa reflektojmë mbi rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e qeverisjes së mirë dhe besimit publik. Ato theksojnë përgjegjësinë thelbësore të këtyre institucioneve jo vetëm për të zbuluar parregullsitë, por edhe për të ndihmuar qeveritë në ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme dhe transparente.

Dëshiroj gjithashtu të shfrytëzoj këtë rast për të falënderuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontributin e tij në edicionin e 28-të të Revistës së EUROSAT-t me artikullin e vlefshëm "Përmirësimi i Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit: Integrimi i Sistemit të Ri të Menaxhimit të Cilësisë me ISSAI 140 të Rishikuar". Ky kontribut forcon përpjekjet për shkëmbimin e njohurive brenda komunitetit tonë dhe vlerësohet shumë.

Në rolin tim si President i EUROSAT-t, vërej një interes në rritje mes Institucioneve Supreme të Auditimit për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira për të forcuar kapacitetet e parandalimit të mashtrimeve në rajonin tonë dhe më gjerë. Kam theksuar dhe inkurajuar shkëmbimin e njohurive mes kolegëve, siç pasqyrohet në EUROSAT SGI, të cilin e konsideroj të paçmuar për përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së auditimeve. Në këtë frymë, ne promovim auditime paralele midis anëtarëve të EUROSAT-t, siç janë auditimet e përmendura më sipër mbi "Plakjen e popullsisë" dhe "Inteligjencën Artificiale (AI)". Po ashtu, mbledhja e ardhshme e Bordit Drejtues të EUROSAT-t do të përfshijë sesione profesionale të vlefshme, për shembull mbi temën e "Bërjes së raporteve të auditimit më të qasshme për publikun". Sesione të tilla profesionale do të ndahen mes të gjithë anëtarëve të EUROSAT-t, ashtu siç kemi bërë më parë mbi temën e "Sigurisë kibernetike" në mbledhjen e kaluar të Bordit Drejtues. Kjo përfaqëson një sfidë të përbashkët dhe një mundësi të rëndësishme për komunitetin tonë global të auditorëve që të mësojmë dhe të rritemi së bashku.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe komunitetit më të gjerë ndërkombëtar të auditimit meriton të vlerësohet. Kontrolli i Lartë i Shtetit luan një rol shumë aktiv brenda EUROSAT-t; ai është anëtar i pothuajse të gjitha grupeve të punës të EUROSAT-t, duke kontribuar në shkëmbimin e njohurive, ndërtimin e kapaciteteve dhe inovacionin në auditim.

Në përmbyllje, dëshiroj të shpreh urimet më të ngrohta për Kontrollin e Lartë të Shtetit, i udhëhequr nga z. Arben Shehu, për arritjen e këtij momenti kaq të rëndësishëm. Qoftë puna e tij e paçmuar dhe jetike që të vazhdojë të ndriçojë rrugën e Shqipërisë drejt një të ardhmeje edhe më të ndritshme dhe gjithnjë e më të begatë!

Le të vazhdojmë të jemi të rëndësishëm dhe inovativë, duke siguruar një të ardhme më të ndritshme për popullin tonë dhe për brezat që do të vijnë.

Faleminderit!

Fjala e Presidencës së INTOSAI-t nga z. Augusto Nardes, Ministër në Gjykatën Federale të Llogarive të Brazilit

*Përfaqësues të nderuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit,
Anëtarë të dashur të komunitetit ndërkombëtar të auditimit,
Zyrtarë të nderuar, zonja dhe zotërinj,*

Dëshiroj të shpreh një mirëseardhje të përzemërt për të gjithë ju dhe të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për mikpritjen e ngrohtë të z. Arben Shehu.

Është një nder i madh dhe një privilegj i veçantë për mua të flas sot në emër të Ministrit Vital do Rêgo, President i Gjykatës Federale të Llogarive të Brazilit (TCU), ndërsa kremtojmë njëqindvjetorin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).

Njëqind vite përfaqësojnë më shumë se sa thjesht kalimin e kohës. Ato mishërojnë konsolidimin e vlerave thelbësore, si: transparenca, përgjegjshmëria dhe përkushtimi ndaj qeverisjes së mirë publike. Historia e KLSH-së është në të vërtetë historia e një kombi që ka kuptuar se menaxhimi efikas i burimeve publike është themel i demokracisë dhe i zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë moment solemn, është e përshtatshme të nderojmë të gjithë punonjësit dhe drejtuesit që, gjatë këtij shekulli, kanë kontribuar në ndërtimin e një institucioni të fortë, të besueshëm dhe të respektuar. Çdo individ që ka shërbyer në këtë institucion ka ndihmuar në ndërtimin e themeleve të një Shqipërie më të drejtë, më transparente dhe më demokratike.

Rruga e KLSH-së është padyshim e denjë për njohje ndërkombëtare. Në një skenë globale ku sfidat e administratës publike po bëhen gjithnjë e më komplekse, veçanërisht për shkak të ndryshimeve klimatike, transformimit dixhital dhe kërkesës së shtuar për përgjegjshmëri, puna teknike, e pavarur dhe strategjike e institucioneve supreme të auditimit është më e rëndësishme se kurrë.

Në këtë kontekst, KLSH ka spikatur jo vetëm për përpjekjet e saj kombëtare, por edhe për angazhimin aktiv në nisma shumëpalëshe, përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Kohët e fundit, ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e "Climate Scanner", një mjet novator i krijuar nga Gjykata Federale e Llogarive të Brazilit.

Përballja me ndryshimet klimatike është një sfidë komplekse që kërkon veprim të koordinuar ndërkombëtar. Nga alokimi i burimeve deri te zbatimi i politikave të zbutjes dhe përshtatjes, çdo komb duhet të veprojë me përgjegjësi dhe përkushtim.

Megjithatë, që këto veprime të jenë efektive, nevojitet një ndjekje rigorozë, dhe këtu, institucionet supreme të auditimit mund të japin mbështetje të paçmueshme. Në Brazil, ndoqem një rrugë të ngjashme me atë të KLSH-së gjatë viteve 2013-2014, duke specializuar departamentet tona dhe duke marrë drejtimin e OLACEFS-it (Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve), ku theksuam rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit me INTOSAI-n dhe institucione të tjera ndërkombëtare, si: Banka Botërore (WB) dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara (UN).

Në të njëjtën periudhë, si President i OLACEFS-it, ne zhvilluam auditimin e parë të koordinuar të zonave të mbrojtura në Amazon. Kjo iniciativë përfshiu Gjykatat e Llogarive nga shtetet Amazoniane dhe vende të Amerikës Latine që përbëjnë Amazonën ligjore, duke përfshirë Perunë, Kolumbinë, Hondurasin, Ekuadorin, Bolivinë, El Salvadorin, Kosta Rikën dhe Venezuelën. Gjithashtu, zgjeruam auditimin në vende të tjera në kontinent, përfshirë Argjentinën, Paraguajin dhe Meksikën. Rezultati ishte i jashtëzakonshëm. Ne kryem një analizë të standardizuar të 1,120 zonave të mbrojtura në të gjithë këto vende dhe u krijua "Indimapa", një tregues i dizajuar për të vlerësuar zbatimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Në vitin 2019, zhvilluam edicionin e dytë të këtij auditimi të koordinuar, duke e zgjeruar në 2,415 zona në 17 vende, përfshirë Portugalinë e Spanjën.



Përfaqësuesi i Presidencës së INTOSAI-t, z. Augusto Nardes, Ministër në Gjykatën Federale të Llogarive të Brazilit (TCU)

Ne prezantuam edicionin "Indimapa 2019", i cili, kur u krahasua me edicionin e 2014-ës, na lejoi të vlerësonim përparimin e arritur në lidhje me zbatimin dhe menaxhimin. Veçanërisht, u vërejtën përmirësime në një grup prej 1,028 zonash që u ekzaminuan në të dy edicionet.

Kryerja e auditimeve të koordinuara në zonat e mbrojtura, e kombinuar me krijimin e "Indimapa-s", hapi rrugën për zhvillimin e "Climate Scanner", një mjet i dizajnuar për të vlerësuar dhe monitoruar veprimet e qeverive lidhur me ndryshimet klimatike. Që nga lançimi i tij, "Climate Scanner" është adoptuar nga disa ISA-e, duke konsoliduar të dhënat në shkallë globale dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar në auditimin e veprimit klimatik.

Ky mjet i përshtatshëm dhe i adaptueshëm, i ndërtuar rreth një metodologjie të organizuar në tre dimensione: qeverisja klimatike, financimi klimatik dhe politikat publike të lidhura me klimën, u mundëson ISA-ve të vlerësojnë veprimet qeveritare në përgjigje të krizës mjedisore në një mënyrë të strukturuar dhe të krahasueshme. Me aplikimin e tij në vitin 2024, ne kemi tashmë të dhëna paraprake konkrete që zbulojnë sfidat e përbashkëta me të cilat përballen qeveritë dhe rrjedhimisht edhe ISA-të.

Ndër të tjera, do të theksoja mungesën e gjurmueshmërisë në financimin klimatik, si publik ashtu edhe privat, e cila pengon vlerësimin e efektivitetit të investimeve dhe kufizon aksesin në këto burime. Për më tepër, megjithëse shumë vende kanë krijuar tashmë struktura të qeverisjes klimatike, monitorimi dhe vlerësimi i politikave publike ende kërkon forcim të konsiderueshëm.

Përfshirja e popullsisë të prekshme dhe zbatimi i veprimeve në nivel lokal mbeten të rëndësishme për arritjen e drejtësisë dhe efektivitetit të politikave të përshtatjes dhe zbutjes.

Këto të dhëna nënvizojnë nevojën urgjente për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin global të veprimeve klimatike. Si President i INTOSAI-t, TCU-ja riafirmon përkushtimin për promovimin e transparencës, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në këtë luftë. Në fakt, ne kërkuam aktivisht njohjen formale nga Kombet e Bashkuara për rolin që luajnë ISA-të në këtë kontekst.

Më 19 dhjetor 2024, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën 79/231, e cila thekson rëndësinë e ISA-ve për të promovuar transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në administratën publike.

Rezoluta njeh rolin kyç të ISA-ve në avancimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), veçanërisht në adresimin e ndryshimeve klimatike, dhe thekson nevojën për të siguruar pavarësinë e tyre duke mbështetur zhvillimin e tyre përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërtimit të kapaciteteve dhe asistencës teknike.

Vijon në faqen tjetër

Fjala e Presidencës së INTOSAI-t nga z. Augusto Nardes, Ministër në Gjykatën Federale të Llogarive të Brazilit

Në nivel rajonal, kemi udhëhequr Komisionin Teknik Special për Mjedisin në kuadër të OLACEFS (COMTEMA). Midis 2018 dhe 2024, ne promovojmë iniciativa auditimi mjedisor, si Auditimi i Koordinuar i Zonave të Mbrojtura (ACAP), të cilat kanë pasur ndikime pozitive të konsiderueshme në menaxhimin e zonave kyçe për biodiversitetin dhe qëndrueshmërinë klimatike duke promovuar nisma si Auditimi i Koordinuar i Zonave të Mbrojtura (ACAP). Kjo përvojë është ndarë gjithashtu edhe me ISA-t e komunitetit të vendeve portugalishtfolëse (OISC/CPLP), ku ne shërbejmë si Sekretariat i Përgjithshëm. Ne aktualisht po mbështesim kolegët tanë në SAI Paraguaj, ndërsa ata vazhdojnë këto përpjekje në krye të COMTEMA-s.

Tani po përgatitemi për një moment të rëndësishëm: COP30 që do të zhvillohet në nëntor 2025 në qytetin e Belémit në Brazil. Ky takim do të ofrojë një mundësi të veçantë për ISA-t, për të prezantuar rezultatet e arritura përmes "Climate Scanner-it", të theksojnë sfidat e identifikuara dhe të propozojnë strategji për të forcuar qeverisjen klimatike.

Në përfundim, dua të theksoj rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve tona.

Në përfundim, dua të theksoj rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve tona. Adresimi i ndryshimeve klimatike nuk mund të mbështetet në supet e qeverive apo sektorit privat por është një përgjegjësi e përbashkët që kërkon angazhimin aktiv të të gjitha palëve, përfshirë edhe Institucionet Supreme të Auditimit. Ne duhet të vazhdojmë të forcojmë rrjetet tona, të shkëmbejmë njohuri dhe të zhvillojmë mekanizma auditimi për të siguruar që veprimi klimatik të jetë efektiv.

Dëshiroj të falënderoj singërisht Kontrollin e Lartë të Shtetit për ftesën për të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme. Ky përvjetor nuk është vetëm një festim i historisë, por edhe një rihim i përkushtimit për të ardhmen, një të ardhme ku institucionet e auditimit shkojnë përtej analizës së numrave dhe kontribuojnë në transformimin e realiteteve, duke promovuar një qeverisje publike etike dhe efikase që u shërben qytetarëve.

Urime të përzemërta të gjithë atyre që kanë kontribuar në këtë rrugëtim. Le të shërbejë ky përvjetor si pikënisje për bashkëpunim edhe më të madh teknik, inovacion metodologjik dhe ekselencë në auditim.

Faleminderit!

Fjala e Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit në Poloni, z. Marian Banaś

Z. Kryetar, kolegë të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Është një nder i madh për mua të marr pjesë në festimin e 100-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në emër të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, shpreh urimet e mia të ngrohta për arritjen e këtij përvjetori të jashtëzakonshëm.

Një shekull shërbimi publik pasqyron jo vetëm forcën dhe pavarësinë institucionale të zyrës suaj, por edhe angazhimin e saj të thellë dhe të qëndrueshëm ndaj transparencës, përgjegjshmërisë dhe parimeve të qeverisjes së mirë. Arritjet tuaja gjatë viteve janë një dëshmi e profesionalizmit dhe integritetit të brezave të audituesve që kanë shërbyer për interesin publik në Shqipëri.

Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol kyç në forcimin e besimit midis qytetarëve dhe shtetit. Ndërsa të gjithë ne ballafaqohemi me sfida komplekse globale nga transformimi digjital te krizat e shëndetit publik dhe ndryshimet klimatike, misioni ynë bëhet edhe më i rëndësishëm. Ne jemi të bashkuar në përgjegjësinë tonë për të siguruar që burimet publike të përdoren me mençuri dhe që proceset vendimmarrëse të mbeten transparente dhe të përgjegjshme.

Do të doja gjithashtu të përdor këtë mundësi për të theksuar marrëdhënien e fortë profesionale midis dy institucioneve tona. Si anëtarë të komuniteteve INTOSAI dhe EUROSAI, ne përfitojmë shumë nga shkëmbimi i njohurive, përvojave dhe praktikave më të mira.



Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit në Poloni, z. Marian Banaś

Ne vlerësojmë bashkëpunimin tonë me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe shpresojmë që ai të vazhdojë të përfordhet në vitet e ardhshme në misionin tonë të përbashkët.

Le të jetë ky përvjetor jo vetëm një kohë feste, por edhe një burim frymëzimi për të ardhmen. Në këtë ditë historike, i uroj Kontrollit të Lartë të Shtetit sukses të vazhdueshëm, rritje profesionale, dhe shumë vite të tjera shërbimi kuptimplotë ndaj qytetarëve të vendit tuaj dhe promovimin e qeverisjes së mirë.

Dua t'i shpreh urimet e mia të singërta të gjithë stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të së kaluarës dhe të së tashmes, për përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre.

Faleminderit!



Fjala e Auditorës së Përgjithshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, znj. Vlora Spanca

I nderuar Dr. Arben Shehu, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

E nderuar znj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar kolegë dhe miq,

Në këtë ditë të veçantë dhe shumë domethënëse për Kontrollin e Lartë të Shtetit në veçanti dhe Shtetit Shqiptar në përgjithësi, më lejoni të hap fjalën me ndjenjën më të thellë të respektit dhe mirënjohjes. Është privilegj i jashtëzakonshëm dhe emocion i fuqishëm për mua si Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës që, në emër të Zyrës sonë Kombëtare të Auditimit, të jem sot këtu para jush për t'ju uruar me gjithë zemër 100-vjetorin e themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

Ky përvjetor shekullor nuk është thjesht një datë në kalendar, e as vetëm 100 vite të numëruara, por është një dëshmi e qëndrueshmërisë institucionale, e besnikërisë ndaj shërbimit publik dhe përkushtimit të palodhur për forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në qeverisje publike. Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte dhe vazhdon të jetë udhëheqës i pandalshëm, shtyllë e patundur që i shërbeu interesave të qytetarëve për më shumë se një shekull.

Me çdo hap të hedhur, KLSH ndërtoi themelet e një institucioni të përgjegjshëm publik, që i shërben me ndershmëri qytetarëve, duke promovuar dhe ruajtur vlerat e llogaridhënies dhe transparencës dhe ngritur besimin e tyre të sinqertë në shtetin që i përfaqëson. Angazhimi i tillë kalon breza, ndërsa qëndron si dritë udhëzuese për të gjithë ne.

Megjithë sfidat dhe periudhat e vështira, ky institucion arriti të mbijetojë si model që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe përmirësimit e menaxhimit të parasë së taksapaguesve, duke ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe avancimin e shërbimeve publike.

Në këtë çast historik, kam nderin të theksoj se përkushtimi dhe procesi i modernizimit që shoqëruan këtë institucion përgjatë dekadave të fundit e shndërruan atë në një shembull lider të profesionalizmit, integritetit dhe pavarësisë, dëshmi kjo e qartë se çdo përpjekje e sinqertë për përmbushjen e misionit ka kulmuar me sukses. Vlerësimi më i fundit nga Barometri Ballkanik në 2024, ku KLSH u rendit ndër institucionet më të besuara nga qytetarët, e rikonfirmoi këtë realitet.

Si profesionistë të fushës, e më tepër si qytetarë të Kosovës, ne ndiejmë krenari për sukseset e KLSH-së, të afërta sikur të ishin edhe tonat. Lidhjet tona të thella dhe të rrënjësura në histori dhe kulturë të përbashkët janë dëshmi e një solidariteti të qëndrueshëm ndërmjet dy institucioneve dhe popujve tanë.

Bashkëpunimi ynë, i ngritur mbi respektin, profesionalizmin dhe përkushtimin e ndërsjellë kontribuoi në përballimin e sfidave të përbashkëta, si: digjitalizimi i shërbimeve publike dhe menaxhimi i krizave.



Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, znj. Vlora Spanca

Marrëveshja e parë ndërinstucionale dhe ndërshtetërore që ne lidhëm ishte me KLSH-në dhe shënoi fillimin e një partneriteti vizionar. Sigurisht se përmes një partneriteti të sinqertë mund të ndërtohet një model i përbashkët auditimi modern, të pavarur dhe me vlerë të shtuar për qytetarët tanë. Deri më sot bashkë me institucionin tuaj kemi zhvilluar një sërë aktivitete që shkojnë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të njohurive reciproke dhe me këtë, edhe forcimit të bashkëpunimit të qëndrueshëm.

Kemi realizuar disa auditime paralele në fusha të rëndësishme si: auditimi i menaxhimit të sistemeve të informacionit, ai në fushën e barazisë gjinore dhe së fundmi jemi duke kryer auditimin e sigurisë së digave.

Në vazhden e bashkëpunimit, po planifikojmë të zhvillojmë edhe projekte të tjera, me theks të veçantë në çështjet e barazisë dhe përfshirjes sociale, mbrojtjes dhe sigurisë e pse jo, në një të ardhme të afërme edhe projekte të tjera. Ky bashkëpunim është urë që na bashkon dhe na fuqizon për të ndërtuar institucione më të forta dhe më të përgjegjshme.

Për më shumë, e shfrytëzoj këtë rast për të shprehur mirënjohjen time të sinqertë edhe për mbështetjen e jashtëzakonshme, të dhënë pa kusht, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë anëtarësimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës në INTOSAI dhe EUROSAI. Hap ky i rëndësishëm, jo vetëm në nivelin institucional, por edhe në atë kombëtar dhe ndërkombëtar, sepse tani figurojmë anekënd botës. Ky akt, simbol i bashkëpunimit të ngushtë dhe të frytshëm ndërinstucional, mbetet pikë referimi për të gjithë ata që do të vijnë pas nesh. Suksesi i tillë është arritje e dyja institucioneve tona dhe do të ngelet në kujtesën time, dhe në atë të çdo auditori të përgjithshëm pas meje, si frymëzim për brezat e ardhshëm të auditorëve tanë.

Ndërsa kremtojmë 100-vjetorin e themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kujtojmë me krenari gjithë punën që ju solli deri këtu. Të përkushtuar për një të ardhme akoma më të ndritur, i përgjigjemi thirrjes për të vazhduar me angazhim të palodhur për një administratë publike më të fortë, më transparente dhe më të përkushtuar ndaj qytetarëve tanë. Me lidhjen e ngushtë në mes dy institucioneve dhe kombit tonë, vazhdojmë të ndërtojmë një shoqëri më të drejtë, më të përgjegjshme dhe më të bashkuar.

Në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ju urojmë një 100-vjetor të mbushur me nder dhe krenari. Një jubile ky, dëshmi e angazhimit tuaj të palodhur dhe frymëzim për të gjithë ne që të përmbushim misionin tonë fisnik për një të ardhme akoma më të ndritur.

Besnikë ndaj vlerave tona të përbashkëta, me besim dhe guxim, vazhdojmë përpara.

Faleminderit dhe gëzuar!



Fjala e Zv. Presidentes së Lartë të Gjykatës Greke të Auditimit, znj. Maria Vlachaki



Zv. Presidentja e Lartë e Gjykatës Greke të Auditimit, znj. Maria Vlachaki

*Shkëlqesitë Tuaja,
Të nderuar kolegë dhe të ftuar,*

Jam e nderuar të jem mes jush sot këtu dhe të mbaj fjalën në këtë seancë festive në 100-vjetorin e krijimit të Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përcjellë urimet më të ngrohta të Gjykatës Greke të Auditimit, në emër të Presidentes sonë, znj. Sotiria Ntouni.

Këtë vit, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit shqiptar feston themelimin e tij. Një shekull më parë, në vitin 1925, kur Kuvendi Kombëtar i Shqipërisë miratoi Kushtetutën e parë të shtetit të sapoformuar, në atë kohë shqiptar, pas shpalljes së pavarësisë nga Perandoria Osmane.

Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Greke e Auditimit u krijua në 1833, pas formulimit të shtetit të pavarur grek, i cili ndodhi sapo grekët fituan pavarësinë e tyre nga Perandoria Osmane, pothuajse një shekull më parë. Ndaj, në vitin 2033, pra tetë vjet nga tani, Gjykata Greke e Auditimit do të festojë 200-vjetorin e themelimit, dhe, në atë kohë, do të jemi të lumtur t'ju mirëpresim të gjithëve në Athinë, të festojmë së bashku dhe t'ju kthejmë mikpritjen e ngrohtë që gëzojmë këtu në Tiranë. Nuk është hera e parë që vizitohet vendin tuaj të bukur. Megjithatë, ka kaluar shumë kohë që kur kam udhëtuar për herë të fundit në Shqipëri rreth 3 dekada më parë. Dy vendet tona kanë ecur përpara shumë afër së bashku gjatë 30 viteve të fundit.

Shumë familje shqiptare kanë emigruar në Greqi, ku kanë lulëzuar me punën e tyre të palodhur dhe shpirtin inovativ në çdo pjesë të mundshme të jetës profesionale, sociale dhe publike. Në ditët e sotme nga Shqipëria vijnë jo vetëm sportistë, artistë, aktorë, poetë dhe shkrimtarë (gjenim disa nga shkrimtarët më të suksesshëm në fushën e letërsisë[1] dhe teatrit[2], me vepra të shfaqura edhe në Teatrin Kombëtar Helen), por edhe sipërmarrës, nëpunës publikë dhe gjyqtarë. Ata e kanë origjinën jo vetëm nga minoriteti vendas kombëtar grek, por edhe nga shqiptarët etnikë.

Që nga vizita ime e fundit në Shqipëri, vendi ka ndryshuar shumë; ka përparuar jashtëzakonisht shumë dhe është bërë anëtar në NATO (që prej 2009); kandidatë zyrtarë për anëtarësim në BE (në 2014); të gjitha, me inkurajimin entuziast dhe mbështetjen aktive të vendit tonë. Krahas këtyre arritjeve, Shqipëria së fundmi është bërë konkurreuese në fushën e turizmit, krahasuar me Greqinë, pasi del si një nga destinacionet më të kërkuara në mbarë botën.

Megjithatë, për të arritur objektivat e saj kombëtarë, ndër të cilat, hyrja në Bashkimin Europian është më e spikatura, Shqipëria duhet të respektojë të gjitha parakushtet në fuqi për çdo vend kandidat, si institucionet e forta demokratike, qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit.

Nisur nga të gjitha sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit thirret të luajë një rol vendimtar. Ai është i pajisur me pavarësi institucionale, një mandat të fortë që i atribuohet nga Kushtetuta shqiptare dhe një spektër i gjerë kompetencash, të shtrira në çdo fushë të financave publike të vendit, pak a shumë të ngjashme me ato me të cilat është pajisur Gjykata e Auditimit të Greqisë, si dhe me një spektër të gjerë kompetencash dhe përgjegjësisë, që i atribuohen veçanërisht titullarit të institucionit, i cili, siç e vëmë re, është i përkushtuar t'i nderojë ato.

Në mbyllje të fjalës sime, dëshiroj t'ju falënderoj për ftesën drejtuar Gjykatës Greke të Auditimit për të festuar së bashku me KLSH-në këtë moment historik, si dhe për t'ju ftuar në Athinë në vitin 2033.

[1] Christo Armando Gezo

[2] Mario Banoushi

Mesazhet përshëndetëse nga Drejtori i Përgjithshëm i IDI-INTOSAI dhe Presidentja e Gjykatës së Auditimit të Spanjës

Në ceremoninë e 100-vjetorit përcollën përshëndetjet e tyre për jubileun e KLSH-së përmes video-mesazheve edhe znj. Enriqueta Chicano Jávega, Presidente e Gjykatës së Auditimit të Spanjës dhe Sekretare e Përgjithshme e EUROSAT-t, si dhe z. Einar Gorrissen, Drejtor i Përgjithshëm, Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t.




Video-mesazhi nga z. Gorrissen

"KLSH në Shqipëri ka treguar me kalimin e viteve se mundet të mbrojë fondet publike e të menaxhojë me efektshmëri dhe me efikasitet të gjithë kontributin e qytetarëve shqiptarë. Sot, ne nuk festojmë vetëm historinë e KLSH-së së Shqipërisë por edhe aspiratat e saj për të ardhmen, aspiratat për të forcuar rolin e saj si një shtyllë llogaridhënie dhe si një mbrojtës i financave publike.

Ne në IDI jemi krenar të kemi dëshmuar rrugëtimin e KLSH-së së Shqipërisë.

Me kalimin e viteve KLSH ka punuar me IDI-n në nisma të ndryshme për shkëmbimin e njohurive dhe inovacionit. KLSH ka arritur të përmirësojë impaktin e saj, të komunikojë rezultatet në mënyrë më të mirë dhe gjithashtu të japë rekomandime më të shëndosha. KLSH ka përmirësuar standardet dhe sistemet duke treguar angazhimin ndaj besueshmërisë dhe ekselencës. Mirëqeverisja është një tjetër themel i çdo shteti demokratik. Duke marrë pjesë në Akademinë tonë, KLSH ka arritur të përmirësojë strukturat e mirëqeverisjes dhe të përballet me sfidat e të ardhmes. IDI do të vazhdojë të mbështesë KLSH dhe në anëtarësimin e saj në komunitetin global, do të vazhdojë të ndajë njohuri dhe eksperiencë me ju, në mënyrë që t'iu shërbeni sa më mirë qytetarëve tuaj."



Video-mesazhi nga znj. Jávega

"Më vjen keq që nuk erdha dot në Tiranë dhe e humba mundësinë të dëshmoja me sytë e mi punën tuaj të shkëlqyer dhe historinë tuaj të jashtëzakonshme. Puna e profesionistëve të pavarur të KLSH-së tregon rëndësinë tuaj të jashtëzakonshme në garantimin e shtetit të së drejtës. Puna jonë gjithmonë synon të mbrojë qytetarët. E kemi për detyrë të raportojmë me rigorozitet dhe transparencë. Si anëtarë të komunitetit të institucioneve të larta të auditimit, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm mbi përgjegjësinë që na është besuar, të cilën e realizojmë me krenari dhe pavarësi. Ju uroj sa më shumë sukses dhe gjykim të shëndoshtë në punën tuaj. Puna juaj do t'i sjellë përfitime të jashtëzakonshme Shqipërisë."

Fjala e Prof. Dr. Nevila Nika: Kontrolli i Lartë i Shtetit në 100-vjetorin e themelimit

Rindërtimi i kujtesës historike të institucioneve pranohet nga të gjithë si një domosdoshmëri për të bërë të mundur vlerësimin e duhur, por edhe për të mësuar nga përvoja e të së kaluarës, për të vepruar e punuar më mirë në të tashmen dhe për të mundur një të ardhme edhe më të mirë.

Nisur nga fakti i pakundërshtueshëm se për ne në veçanti është me të vërtetë i rëndësishëm ky rindërtim pasi duhet të pranojmë se kujtesa jonë vetjake, e përbashkët, e ajo institucionale ka qenë deri para pak vitesh, ndoshta vazhdon ende vende vende, e copëzuar për të mos thënë e dëmtuar rëndë. Pasojat kanë qenë jo të papërfillshme, por do të duhet të pranojmë edhe se kanë qenë të rënda.

Rindërtimi i kujtesës historike të një familjeje, fshati, qyteti apo krahine shkon në dobi të forcimit të identitetit tonë si komb, rindërtimi i kujtesës historike të një institucioni gjithashtu i jep vlerë jo vetëm institucionit, që të jenë më shumë të përkushtuar e të ndërgjeshëm punonjësve e tij, po ashtu, edhe rindërtimi i kujtesës historike të një ndërtese ku kanë jetuar personalitete e familje të mëdha, apo ku kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre institucione të rëndësishme, e bën të gjallë vetë ndërtesën, nga projektuesi e ndërtuesi, deri tek ata që jetuan apo punuan brenda saj.

Por a mundet ne të ja dalim të ndërtojmë kujtesën historike të një institucioni, pa u bazuar në dokumente, foto apo gravura autentike? Natyrisht që jo, nuk mundemi.

Por cilët janë ruajtësit, mbrojtësit e shërbyesit e provave dokumentare e imazheve audio-vizive që e bëjnë të mundur rindërtimin e kujtesës institucionale? Përgjigjja është e thjeshtë janë arkivat: aty ku ruhet kujtesa jonë kombëtare, thesari ynë kombëtar.

Por në se është e pranuar botërisht prej mijëra vjetësh, se vetë dokumenti është pushtet dhe se arkivat janë në themel të të gjitha formave të qeverisjes në mbarë botën, lidhja midis arkivit dhe institucionit që ushtron kontrollin ekonomik-financiar mbi të gjitha institucionet e tjera shtetërore është thelbësore. Pa këtë bashkëpunim, ushtrimi i kontrollit është krejt i pavlerë e do të thoja, edhe ndoshta i dëmshëm.

Në ditët tona nga arkivistët e SH.B.A.-së na vjen një shprehje "mirëqeverisje do të thotë një Arkiv i mirë dhe, një Arkiv i mirë, është luftë kundër korrupsionit".

E pikërisht, bazuar në burimet arkivore, jemi në gjendje të rrëfejme pak nga e kaluara se si ushtrohej ky kontroll i domosdoshëm në trojet tona shekuj më parë.

Nëse deri në vitin 1992, edhe pse festohej me krenari Dita e Shpalljes së Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, pas pothuaj 4 shekuj e gjysëm nën sundimin e Perandorisë Osmane, shumica e institucioneve e organizmave shtetërore u njihej si vit themelimi pas Lufta e Dytë Botërore. Nga ky rregull nuk mund të bënte përjashtim edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Por, përpara se të them pak fjalë për rigjetjen e ditës së lindjes së këtij institucioni të rëndësishëm, do të dëshiroja të flisja shkurt se si zhvillohej apo ushtrohej ky kontroll përpara shpalljes së Pavarësisë.

Trojet shqiptare vuajtën nën sundimin e tre perandorive të mëdha, asaj Romake, Bizantine e Osmane, duke përjashtuar periudhën 25-vjeçare të Gjergj Kastriotit.

Një pyetje të cilën gjithsecili prej nesh natyrshëm e mendon, vallë a ushtrohej dhe si bëhej kontrolli i të ardhurave, shpenzimeve, mbledhja e taksave e tatimeve, si veprohej në punët publike, ndërtime rrugësh, urash, ujësjellësish, ndërtesave publike etj., organizoheshin thirrje publike (sot tendera) apo gjithçka ishte në dorë të Perandorit apo kryeministrit apo vezirit të madh? A kishte rregulla a ligje për ushtrimin e kontrollit mbi këto veprimtari?



Prof. Dr. Nevila Nika

Tashmë është e provuar e pranuar nga të gjithë studiuesit se të treja këto perandori të cilat sunduan trojet tona, kanë patur sisteme kontrolli të jashtëzakonshëm në drejtim të mbikëqyrjes e kontrollit financiar.

Ende sot janë në përdorim të përditshëm në mbarë botën terma të fushës së financave që na vijnë prej antikitetit.

Gjithsesi, nuk dua t'ju mbaj një leksion të gjatë historie, por do të doja të ndalesha pak në disa burime interesante arkivore tonat, të cilat na japin të dhëna interesante në këtë drejtim.

Zbulimi i Statuteve të Shkodrës, të cilat i përkasin shekullit të 14-të, ka qenë një mundësi e artë për ndriçimin e shekujve të Mesjetës. Ky burim autentik vendas është jashtëzakonisht i vyer për shkak se, nëpërmjet 279 kërreëve ose neneve të tij, studiuesit janë në gjendje të rindërtojnë jetën e një qyteti arbëror në Mesjetë. Në këto Statute janë përfshirë të gjitha aspektet e jetës së qytetit e rrethinave të tij. Do të doja të citoja kreun 105, i cili titullohet "Mbi financierët e Komunës":

Të gjitha të ardhurat e Komunës sonë që vijnë nga doganat, duhet të mblidhen, të ruhen dhe shpenzohen ndershmërisht e me drejtësi nga financieri, për gjithë kohën që ky është në detyrë dhe sipas normave të përcaktuara nga statutet. Për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bëra, çdo tre muaj duhet raportuar pranë gjykatësve dhe këshilltarëve. Gjykatësit e radhës duhet të regjistrojnë me shkrim me anën e sekretarit, të gjithë shumën e të ardhurave vjetore, në mënyrë që kjo t'u bëhet e ditur gjykatësve dhe këshilltarëve që do të zgjidhen më pas. Gjykatësit e rinj duhet të kenë të regjistruara në fletore, nga dora e sekretarit të gjitha detyrimet, duke përcaktuar se çfarë u mbetet të paguajnë financierët e mëparshëm apo dhe borxhin që Komuna u detyrohet privatëve.."

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, natyrisht që kishte kontrole të ushtruara nga të dërguar zyrtarë në lidhje me gjendjen e përgjithshme ekonomike e politike të provincave të Perandorisë. Por, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit u krijua në zbatim të Reformave të Tanzimatit, 1831-32, dhe varej nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ushtronte jo vetëm kontroll financiar, por edhe mbi punën e zyrtarëve të të gjitha niveleve.

Dëshmi të tjera që i përkasin periudhës së para Pavarësisë na vijnë edhe komunitetet fetare të krishtera. Kontrolli i të ardhurave e shpenzimeve në këto komunitete ishte periodik e ushtrohej nga Dioqeza e Mitropolia.

Vijon në faqen tjetër

Fjala e Prof. Dr. Nevila Nika: Kontrolli i Lartë i Shtetit në 100-vjetorin e themelimit

Në komunitetin katolik vetë Arqipeshkvi, Abati apo Ipeshkvi kryenin vizita baritore nëpër famullitë e kuvendet pothuaj çdo vit dhe ushtronin kontroll të imtësishëm të dokumentacionit fetar, por edhe në atë të pasurisë së paluajtshme e atë të luajtshme, pra të ardhurat e shpenzimet. E njëjta gjë ndodhte edhe në Mitropolitë Ortodokse.

Po ashtu, burime tejet interesante janë edhe ato që na vijnë nga firmat tregtare dhe esnafet e zejeve të ndryshme.

Mendova të flisja pak për një periudhë të largët jo pa qëllim. Shpallja e Pavarësisë ka qenë një ditë e jashtëzakonshme në shumë aspekte, edhe pse të gjithë ne ende e kujtomë dhe e nderojmë vetëm si ditën ku më në fund ngritëm flamurin tonë kombëtar dhe shpallëm Mëvehtësinë, pra shkëputjen nga Perandoria Osmane. Ata burra që morën përsipër barrën e rëndë të flakjes tej të zgjedhës së huaj vinin nga përvoja të ndryshme jete. Midis tyre kishte ishnëpunës të perandorisë, kishte mërgimtarë të larguar nga atdheu për arsye ekonomike, politike e shkollimi, por që të gjithë i bashkonte një ideal: të rikthenin atdheun në gjirin e familjes europiane, prej së cilës ishin shkëputur dhunshëm prej shekujsh.

Nga ajo mbasdite e 28 nëntorit 1912 asgjë nuk do të ishte më si më parë. Qeveria e Përkohëshme, e kryesuar nga babai i Pavarësisë, Ismail bej Vlora përbëhej nga personalitet më në zë të Lëvizjes sonë Kombëtare dhe përfaqësonin të gjitha krahinat e besimet fetare, të cilëve u ra barra tejet e rëndë të nisnin ringritjen e shtetit shqiptar pas pothuaj 4 shekuj e gjysmë, nga vitet e paharruara të Gjergj Kastriotit. Të 4 vilajetet, ose thënë ndryshe provincat shqiptare, ndarje e ideuar dhe realizuar nga autoritetet osmane gjatë viteve 1912-1920, u shndërruan në një fushë të pamatë betejash midis fuqive ndërluftuese ballkanike e, më pas, të vendeve pjesëmarrëse në Luftën e Parë Botërore.

Por, për të ngritur nga e para shtetin shqiptar nuk mjaftonte vetëm ideali e dëshira, duhej shumë më tepër. Qeverisë së Ismail Qemalit i mungonte gjithçka, përveç idealit e dëshirës. Nuk kishte as një ekonomi të zhvilluar, as rrjet rrugësh apo hekurudhë, as një lloj industrie, bujqësi e artizanat në kushte të mjerueshme, as rrjet spitalesh, as shkolla e, mbi të gjitha, një mungesë të theksuar njerëzish që dinin të shkruanin e lexonin gjuhën amtare, pasi shqiptarëve iu ishte mohuar në shekuj mësimi në gjuhën shqipe.

Megjithë përpjekjet e pandërprera të personaliteteve shqiptare brenda e jashtë vendit, fillimisht për të njohur Fuqitë e Mëdha aktin e Shpalljes së Pavarësisë e, më pas, për të mbrojtur tërësinë tokësore të trojeve amtare, gjithçka do të vendosej pas mbarimit të Luftës.

E pikërisht, do të jetë janari 1920, pasi fatkeqësisht Fuqitë e Mëdha në Konferencës e Paqes në Versajë kishin vendosur përgjysmimin e trojeve e popullatës shqiptare, që shënon edhe kthesën e madhe historike.

Kuvendi historik i mbajtur në Lushnjë shënon më në fund nisjen e një etape të re në historinë tonë kombëtare. Gati 8 vjet nga ngritja e flamurit në Vlorë, personalitetet më në zë të botës shqiptare gjetën forcën për t'u bashkuar edhe pse në kushte jashtëzakonisht të vështira brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare, morën vendimin për formimin e një qeverie gjithëpërfshirëse pa mbështetje apo ndërhyrje nga jashtë.

Do të jetë ky kabinet qeveritar, që menjëherë vendosi si detyrim ligjor njohjen e gjuhës shqipe si kusht për të gjithë ata që do të punonin në administratë.

Njëkohësisht, jo vetëm u ndalua kategorikisht përdorimi i gjuhës osmane në aktet zyrtare, por u urdhërua kalimi në gjuhën shqipe të dokumenteve në formë regjistri të zyrave të hipotekave, kadastrave e ato të financave (tatimeve e taksave) në të gjithë institucionet përkatëse. Parlamenti e Qeveritë shqiptare, duke nisur nga viti 1920 e në vazhdim, do të përpiqen me të gjitha mjetet e mënyrat për të rikthyer Shqipërinë përsëri në shinat e qytetërimit europian. Miratimi i ligjeve, krijimi e organizimi i institucioneve shtetërore, organizimi i ushtrisë e xhandarmërisë, ai i institucioneve arsimore etj., ishin një pasqyrë e qartë e përpjekjeve për modernizimin e shtetit shqiptar e largimin përfundimtar nga e kaluara e sundimit Osman.

E në këtë valë ndryshimesh rrënjësore, në mars 1925 vjen për herë të parë themelimi i Bankës Kombëtare Shqiptare dhe, në maj po të 1925, ai i Këshillit Kontrollues. Dy institucione të një rëndësie parësore për shtetin e ri shqiptar.

Përpjekjet për të ngritur këtë institucion tejet të rëndësishëm kishin nisur qysh me Qeverinë e Vlorës, pasi nuk ka asnjë dyshim se për të gjithë elitën politike të atyre viteve, krijimi i tij pranohej si një domosdoshmëri. Si edhe për shumë institucione e ente të krijuara në ato vite u morën për modele ato të vendeve më të përparuara. Për Këshillin Kontrollues u mor si model ai francez, i quajtur Corte de Compets (italianët Corte dei Conti) - Gjykata e Llogarive.

Nga ky vit e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, institucioni i Këshillit Kontrollues do të kryejë funksionin e vet pa ndërprerje apo ndryshim detyrash e përgjegjësish, si institucion suprem në auditimit. Vetëm në vitet e Mbretërisë do të krijohet një institucion tjetër i quajtur Inspektoriati Mbretëror, që ishte në varësi të Ministrisë së Oborrit Mbretëror. Ky Inspektoriat kishte pothuaj të njëjtat detyra si ato të Këshillit Kontrollues, me të vetmin ndryshim, se raportonte drejtpërdrejtë Ministrisë së Oborrit Mbretëror, pra vetë Mbretit dhe jo Parlamentit.

Ndërkaq, gjatë periudhës së pas Luftës (1944-1991), kur Shqipëria shpallet Republikë Popullore, e udhëhequr e drejtuar tërësisht nga ideologjia marksiste-leniniste, institucioni do të ndërrojë disa herë emërtesën, detyrat e përgjegjësitë. Në krye të këtij institucioni tejet të rëndësishëm do të emërohen njëri pas tjetrit, deri në fund të viteve '80 drejtues që nuk kishin shkollimin e formimin e duhur, por ishin thjesht zbatues të "vijës partiake". Thënë në pak fjalë, shëndrohet në një mjet për "forcimin e konsolidimin e diktaturës së proletariatit".

Vetëm pas rënies së regjimit komunist, ky institucion u largua nga pozicioni i të qenit institucion në shërbim të diktaturës. Ai u shndërrua në mbrojtës të interesit të qytetarëve e të vetë shtetit për sa i takon mirëadministrimit të parasë publike, duke luftuar maksimalisht shpërdorimin e pasurisë kombëtare e natyrisht edhe korrupsionin e shtetarëve të të gjitha niveleve.

Gëzuar ditëlindjen!

Fjala e Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë në UT, Prof. Dr. Dorina Hoxha

E nderuar znj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

I nderuar z. Arben Shehu, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Të nderuar kolegë dhe miq,

Është një privilegj dhe kënaqësi e veçantë të jem sot këtu, në këtë moment historik të 100-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në emër të Fakultetit të Drejtësisë, më lejoni të shpreh mirënjohjen tonë për ftesën dhe të përgëzoj KLSH-në për kontributin e jashtëzakonshëm në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes financiare në Shqipëri. Ky jubile përfaqëson jo vetëm një arritje të madhe institucionale, por edhe një dëshmi të rëndësishëm së punës në garantimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

Për ne, si Fakultet i Drejtësisë, ky përvjetor merr një kuptim të veçantë, pasi kryetari aktual i KLSH-së nuk është vetëm një drejtues i respektuar i këtij institucioni të rëndësishëm, por edhe një ish-pedagog dhe koleg i nderuar i fakultetit tonë. Kontributi i tij në edukimin dhe formimin profesional të brezave të rinj të juristëve ka lënë një gjurmë në komunitetin tonë akademik, duke na bërë krenarë për arritjet e tij në drejtimin e KLSH-së.

Sot, ndërsa festojmë këtë jubile të rëndësishëm, kthejmë vëmendjen pas në kohë, një shekull më parë, kur Kontrolli i Lartë i Shtetit hodhi hapat e tij të parë si një institucion i pavarur dhe garantues i kontrollit financiar në Shqipëri. Gjatë këtyre 100 viteve, KLSH ka luajtur një rol kyç në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe në mbikëqyrjen e fondeve publike, duke ndërtuar një trashëgimi të çmuar përgjegjshmërie dhe transparence. Rrugëtimi i gjatë dhe sfidues i këtij institucioni dëshmon përkushtimin e tij për të siguruar një qeverisje të mirë dhe të ndershme, një mision që mbetet po aq aktual dhe i rëndësishëm edhe sot.

Në një kohë kur sfidat e qeverisjes dhe transparencës po bëhen gjithnjë e më komplekse, roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbetet thelbësor për sigurimin e një menaxhimi të përgjegjshëm financiar dhe institucional. KLSH, me përkushtimin e tij për llogaridhënie dhe kontroll të pavarur, vazhdon të jetë një shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës në vendin tonë. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera, përfshirë komunitetin akademik, garanton përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve dhe forcimin e integritetit publik.

Sot, ky institucion është një partner i besuar në procesin e integritetit evropian, duke garantuar që fondet publike të përdoren me përgjegjësi dhe transparencë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Një nga arritjet më të rëndësishme është përafrimi i standardeve të auditimit me ato ndërkombëtare, duke përfituar nga bashkëpunimi me organizatat e ngjashme në rajon dhe me gjerë.

KLSH ka arritur të ruajë pavaresinë dhe integritetin e tij, duke ndërtuar një traditë të respektuar të kontrollit financiar dhe të administrimit me përgjegjësi të burimeve shtetërore.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ndajnë një lidhje të natyrshme dhe të vazhdueshme përmes misionit të tyre në promovimin e shtetit të së drejtës dhe integritetit institucional. Si qendër e edukimit juridik dhe përgatitjes së profesionistëve të së ardhmes, fakulteti ynë është krenar që ka kontribuar në formimin e shumë ekspertëve dhe drejtuesve, përfshirë edhe juriste që sot japin kontributin e tyre në KLSH.

Kjo marrëdhënie bashkëpunimi është thelbësore për të forcuar më tej standardet e kontrollit dhe transparencës publike, duke krijuar një urë të qëndrueshme midis teorisë akademike dhe praktikës institucionale.



Prof. Dr. Dorina Hoxha, Dekane e Fakultetit të Drejtësisë, UT

Ky bashkëpunim është dëshmi e perkushtimit për të forcuar kapacitetet profesionale dhe akademike të studentëve, që në të ardhmen të jene kontribues aktive në institucionet e shtetit shqiptar.

Si Fakultet i Drejtësisë, ne ndiejmë një përgjegjësi të veçantë për të përgatitur brezat e rinj të juristëve dhe ekspertëve që do të kontribuojnë në forcimin e shtetit ligjor dhe do të mbështesin misionin e KLSH-së në monitorimin e administrimit të burimeve publike.

Ne besojmë se edukimi juridik nuk mund të jetë i plotë pa përfshirjen e njohurive mbi auditimin publik, etikën institucionale, si pjesë integrale e formimit profesional të studentëve tanë.

Në këtë kontekst, më lejoni të theksoj se sfidat e kohës moderne kërkojnë më shumë se kurrë ndërthurjen e dijes akademike me praktikën institucionale. Qëllimi ynë i përbashkët është ndërtimi i një kulture të re institucionale, një kulture transparence, përgjegjshmërie dhe shërbimi ndaj qytetarëve.

Në këtë udhë, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve akademike dhe atyre publike, do të jete kyç. Dijsa, kërkimi shkencor dhe angazhimi profesional do të ndihmojë në përgatitjen e ekspertëve të rinj që do të jenë garantues të shtetit ligjor dhe të përgjegjshëm publikë. Për këtë arsye, ne jemi të gatshëm të forcojmë më tej bashkëpunimin tonë me KLSH-në dhe partnerët ndërkombëtarë, nëpërmjet seminareve të përbashkëta, praktikave studentore në institucionet e auditimit dhe projekteve kërkimore që analizojnë efektshmërinë e politikave publike dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Fakulteti i Drejtësisë do të mbetet një partner i angazhuar dhe i besueshëm në përpjekjen për të edukuar një brez të ri profesionistësh, të aftë për të mbrojtur interesin publik dhe për të promovuar drejtësinë dhe llogaridhënien.

Si institucione arsimore dhe publike, është detyra jonë të forcojmë themelet e shtetit ligjor dhe të nxijmë një kulturë llogaridhënieje, ku përgjegjësia për burimet publike të jetë e pacenueshme.

Në mbyllje, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për punën e palodhur dhe përkushtimin e KLSH-së ndër vite.

Le të jetë ky 100-vjetor një pikë referimi për forcimin e mëtejshëm të institucioneve tona dhe një angazhim i përbashkët për një të ardhme më të drejtë, më transparente dhe më të përgjegjshme.

Gëzuar 100-vjetorin e KLSH-së!

Faleminderit!

KLSH mirëpret me darkë tradicionale 19 delegacione të huaja për festimet e 100-vjetorit



Më 19 maj 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit nisi festimet për 100-vjetorin e themelimit të institucionit për të mirëpritur përfaqësuesit e lartë nga delegacione të institucioneve supreme të auditimit dhe partnerët ndërkombëtarë me një darkë tradicionale shqiptare.

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, përshëndeti të pranishmit dhe u shpreh mirënjohjen për praninë në këtë përvjetor historik. Në fjalën e tij, z. Shehu vlerësoi bashkëpunimin mes institucioneve të auditimit, të cilat ndajnë një mision të përbashkët: forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë në shërbim të qytetarëve.

Mbrëmja festive u hap me shkëmbimin e dhuratave simbolike dhe u zhvillua në një atmosferë miqësore. Të pranishmit patën mundësinë të njohin nga afër vlerat shqiptare përmes mikpritjes, muzikës tradicionale, elementëve të kulturës kombëtare dhe kulinarisë karakteristike të vendit tonë.

Kjo veprimtari simbolike u kthye në një urë komunikimi mes institucioneve homologe të auditimit, duke i dhënë kështu një dimension më të gjerë festimeve të 100-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu me z. Augusto Nardes, Ministër në Gjykatën Federale të Llogarive të Brazilit (TCU)



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu me Presidentin e EUROSAT-it dhe Kontrollorin e Shtetit të Izraelit, z. Matanyahu Englman

Kryetari i KLSH-së nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Kryetarin e Dhomës së Llogarive të Azerbajxhanit

Në kuadër të vizitave zyrtare të delegacioneve të huaja për kremtimin e 100-vjetorit të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, më 19.05.2025 priti në takim Kryetarin e Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit, z. Vugar Gulmammadov.

Takimi ishte një hap i rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit midis dy institucioneve supreme të auditimit, me fokus zhvillimin institucional, auditimin e politikave publike dhe shkëmbimin e praktikave të avancuara në kontrollin financiar dhe ligjor.

Në këtë kuadër, z. Shehu dhe z. Gulmammadov nënshkruan një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU), e cila synon të forcojë bashkëpunimin nëpërmjet shkëmbimit të përvojave profesionale dhe njohurive në fusha të ndryshme të auditimit; organizimit të vizitave studimore dhe trajnimeve të përbashkëta për audituesit dhe bashkëpunimit në kuadër të iniciativave të INTOSAI-t, EUROSAT-t dhe platformave të tjera ndërkombëtare.

Në vijim të këtij bashkëpunimi u ra dakord për kryerjen e auditimeve në fushën e hidrokarbureve.

Kryetari i KLSH-së vuri në dukje rëndësinë e partneriteteve ndërinstitucionale në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të shërbimeve publike për qytetarët.



Nga ana e tij, z. Gulmammadov përgëzoi z. Shehu për 100-vjetorin e institucionit dhe shprehu vullnetin për të ndërtuar një bashkëpunim të qëndrueshëm mes dy institucioneve.

Ky takim dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit shënojnë një hap të rëndësishëm në strategjinë e ndërkombëtarizimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe në angazhimin e institucionit për të ndërtuar ura të qëndrueshme me institucionet homologe, duke promovuar standarde të përparuara në auditimin publik dhe qeverisjen financiare.

Z. Shehu zhvillon takim me përfaqësuesin e Presidencës së INTOSAI-it, z. Augusto Nardes, Ministër në SAI-n e Brazilit



Në vijim të aktiviteteve zyrtare që shënojnë 100-vjetorin e themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, më 19 maj 2025 zhvilloi një takim të veçantë me përfaqësuesin e Presidencës së Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit - (INTOSAI), z. Augusto Nardes. Z. Nardes gjithashtu mban detyrën e Ministrit në Gjykatën Federale të Llogarive të Brazilit (TCU).

Në takimin mes z. Shehu dhe z. Nardes u ndanë vizione dhe përvoja mbi sfidat dhe rolin gjithnjë në rritje të institucioneve supreme të auditimit në përbashkëtimin e çështjeve globale, si: ndryshimet klimatike, qeverisja digjitale dhe menaxhimi i qëndrueshëm i financave publike.

Një çështje e rëndësishme e diskutimeve ishte nisma globale "Climate Scanner", e mbështetur nga INTOSAI, ku Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive. U diskutuan përgatitjet për Samitin e Klimës 2025, i cili do të mbahet në Rio de Janeiro më 14-15 gusht, që synon të kthehet në një moment kyç për auditimin global të çështjeve mjedisore.

Kryetari i KLSH-së vlerësoi rolin aktiv të z. Nardes në drejtimin e nismave globale të INTOSAI-t dhe përkushtimin e tij për të orientuar auditimin publik drejt prioriteteve strategjike ndërkombëtare. Ai theksoi se pjesëmarrja e përfaqësuesve të lartë të INTOSAI-t në aktivitetet e jubileut të KLSH-së është një dëshmi e rolit gjithnjë e më të rëndësishëm të institucionit shqiptar në fushën ndërkombëtare.

Nga ana e tij, z. Nardes vlerësoi angazhimin e KLSH-së në agjendat globale të auditimit publik dhe e cilësoi 100-vjetorin e institucionit si një mundësi të shkëlqyer për të thelluar bashkëpunimin përmes projekteve të përbashkëta në fushën e trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe promovimit të inovacionit në auditim.



Kryetari i KLSH-së priti në takim Presidentin e EUROSAT-t, z. Matanyahu Englman, Kontrollor i Shtetit të Izraelit

Në datë 19.05.2025, kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu zhvilloi një takim zyrtar me Presidentin e Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT), z. Matanyahu Englman, i cili njëherazi ushtron detyrën e Kontrollorit dhe Avokatit të Popullit të Shtetit të Izraelit.

Ky takim përbën një moment të veçantë për thellimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve në frymën e partneritetit dhe dialogut profesional që karakterizon Organizatën Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT).

Në qendër të diskutimeve ishin çështje të rëndësishme, si: rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike përmes metodave moderne të auditimit, zhvillimeve teknologjike dhe qeverisjes dixhitale.

Po ashtu, u vlerësua roli i EUROSAT-t si një platformë bashkëpunimi për nxitjen e inovacionit auditues dhe ndarjen e eksperiencave të suksesshme ndërmjet institucioneve anëtare.

Kryetari i KLSH-së vlerësoi kontributin e z. Englman në drejtimin e EUROSAT-t, si dhe angazhimin e tij të vazhdueshëm për forcimin e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) dhe promovimin e integritetit në auditim.

Z. Shehu rikonfirmoi përkushtimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të zgjeruar bashkëpunimin me institucionet homologe të auditimit.



Konferenca e KLSH-së me SAI-t homologe: “Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikat e mjedisit - Një perspektivë e auditimit të jashtëm”

Në datat 6 dhe 7 maj 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi në kuadër të aktiviteteve të 100-vjetorit konferencën shkencore me temë “Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikat e mjedisit - Një perspektivë e auditimit të jashtëm”. Pjesëmarrës në konferencë ishin institucione supreme auditimi nga Kosova, Bosnje Hercegovina, Rumania, Greqia, Turqia, Azerbajxhani dhe Suedia. Gjithashtu, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë nga organizata ndërkombëtare e auditimit, IDI - INTOSAI dhe SIGMA – OECD.

Kryetari i KLSH-së vlerësoi se pjesëmarrja e gjerë e institucioneve supreme të auditimit, së bashku me kontributin e partnerëve ndërkombëtarë, është një dëshmi e qartë e vlerës së bashkëpunimit në avancimin e qeverisjes së mirë dhe forcimin e institucioneve publike.



Në fjalën hapëse të konferencës, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, duke falënderuar për pjesëmarrjen përfaqësuesit e institucioneve homologe të auditimit, theksoi se ky përvjetor i rëndësishëm është një moment historik, që shënon një shekull përkushtim ndaj transparencës, përgjegjshmërisë dhe forcimit të mirëqeverisjes në vendin tonë dhe, për të cilin, kemi zgjedhur të reflektojmë jo vetëm mbi rrugëtimin tonë, por edhe mbi sfidat dhe transformimet që po ndodhin sot në fushën e auditimit të jashtëm.

“Tema e konferencës sonë për ndërtimin e institucioneve të adaptueshme, më tepër se një diskutim teknik është një thirrje për reflektim dhe veprim, në një mjedis rregullator, teknologjik dhe institucional që po ndryshon me ritme tepër të vullshme. Kjo kërkon që institucionet të jenë të afta të përshtaten dhe të përmirësojnë vazhdimisht kapacitetet e tyre. Në këtë kontekst, roli i auditimit të jashtëm është thelbësor, jo vetëm për të evidentuar mangësitë, por edhe për të mbështetur institucionet në forcimin e menaxhimit dhe rritjen e efektivitetit në përmbushjen e mandatit të tyre”, u shpreh z. Shehu.



Gjatë kësaj konference, SAI-t prezantuan punimet e tyre lidhur me trajtimin e situatave emergjente dhe diskutuan mbi qasjet moderne në metodologjitë e auditimit, rolin e teknologjisë, menaxhimin e cilësisë dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe sfidat me të cilat përballen në procesin e punës. Përfaqësuesit e institucioneve homologe të auditimit shprehën urimet për 100-vjetorin e institucionit, duke vlerësuar arritjet ndër vite dhe vijimin e bashkëpunimit.





100 vite institucion, KLSH zhvillon leksione të hapura me studentët në Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër

Si pjesë e programit të aktiviteteve të 100-vjetorit të themelimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi përgjatë muajit maj disa leksione të hapura me studentët në katër universitete publike të vendit, me qëllim promovimin e rolit të institucionit në një moment të rëndësishëm historik.

Në datë 9 maj 2025, KLSH organizoi leksionin me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, duke sjellë më afër rolin e institucionit në forcimin e transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri.

Leksioni me temë *"100 vite besueshmëri, integritet dhe shërbim ndaj qytetarëve – Kontrolli i Lartë i Shtetit si garant i transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri"* u mbajt nga audituesja e lartë, znj. Miranda Misini.

Znj. Misini prezantoi rolin historik dhe aktual të KLSH-së si një nga institucionet më të hershme të shtetit shqiptar dhe theksoi misionin e tij në mbështetje të shtetit ligjor, përmes forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.

Si mikpritëse e aktivitetit, Dekania e Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Dr. Dorina Hoxha, falënderoi Kontrollin e Lartë të Shtetit për angazhimin në edukimin profesional të studentëve.



Më 13 maj 2025, KLSH zhvilloi leksionin e hapur me studentët e Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë.

Audituesja e lartë, znj. Miranda Misini ndau me studentët misionin, historikun dhe rolin e institucionit si organi suprem i auditimit në vend. Gjatë fjalës së saj, znj. Misini theksoi rëndësinë e auditimit të jashtëm publik si një mekanizëm thelbësor për ndërtimin e një shteti me integritet, transparencë dhe përgjegjshmëri në shërbim të qytetarëve.

Përfaqësuesit e Universitetit të Vlorës shprehën vlerësime të larta për angazhimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit profesional të brezit të ri.

Studentët patën mundësi të informohen më shumë rreth mënyrës se si funksionon KLSH dhe mbi rëndësinë e auditimit dhe kontrollit në administratën publike.

Më 22 maj 2025, KLSH zhvilloi leksionin e hapur me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Leksioni u mbajt nga znj. Xhesila Nano, audituese e lartë në KLSH. Znj. Nano i njohu studentët me historinë e ndërtimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe rolin që luan auditimi i jashtëm në menaxhimin e financave publike. Zv. Dekania për Çështjet Mësimore në Fakultetin e Biznesit, Dr. Silvana Gashi, vlerësoi kontributin e KLSH-së për edukimin profesional të studentëve dhe për angazhimin e vazhdueshëm në ndërtimin e urave të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë.




Më 23 maj 2025, KLSH zhvilloi leksionin e hapur në kuadër të 100-vjetorit me studentë dhe pedagogë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Leksioni u mbajt nga znj. Xhesila Nano, audituese e lartë në KLSH. Në aktivitet mori pjesë dhe Zv. Rektorja për Shkencën në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Prof. Dr. Blertha Dragusha, e cila falënderoi Kontrollin e Lartë të Shtetit për organizimin e këtij aktiviteti informues me studentët.

Nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me universitetet dhe organizimit të takimeve me studentët, Kontrolli i Lartë i Shtetit synon të japë një kontribut të qenësishëm në formimin e brezave të rinj të profesionistëve.



Posta Shqiptare përjetëson 100-vjetorin e KLSH-së me emetimin e dy pullave historike




Me rastin e 100-vjetorit të themelimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në datën 20.05.2025, Posta Shqiptare nxori në qarkullim një seri të re me dy pulla postare, si dhe zarfin e ditës së parë, të personalizuar me logon "100-vjetori i Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Pulla e parë paraqet portretin e z. Fejzi Alizoti, i cili ishte drejtuesi i parë i institucionit që asokohe mbante emërtimin Këshilli Kontrollues. Z. Alizoti ishte politikan, ekonomist dhe diplomat me një kontribut të spikatur në administratën publike shqiptare, duke përfshirë edhe detyrën e Ministrit të Financave. Në maj të vitit 1925, Fejzi Alizoti u zgjodh Kryetar i Këshillit Kontrollues, duke nisur një epokë të re në mbikëqyrjen financiare të shtetit shqiptar.

Pulla e dytë përmban stemën aktuale zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfaqësuar vazhdimësinë e historisë institucionale dhe misionin e pandryshuar të mbrojtjes së interesit publik.








Zarfi i ditës së parë përfshin të dyja pullat, si dhe vulën origjinale dygjuhëshe në shqip dhe frëngjisht të Këshillit Kontrollues të Financave që u përdor në vitet e para të funksionimit deri në periudhën e Mbretërisë Shqiptare, duke i dhënë vlerë filatelike dhe historike të veçantë kësaj serie.

Seria e re e pullave postare dhe zarfi i personalizuar me logon e 100-vjetorit të KLSH-së janë në dispozicion në të gjitha pikat e Postës Shqiptare, duke u kthyer në një objekt me rëndësi për koleksionistët, institucionet publike dhe qytetarët që vlerësojnë historinë dhe trashëgiminë institucionale të Shqipërisë.



Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH


 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00





**KORRIK
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Korrik 2025



Kryetari i KLSH-së priti në takim drejtuesit e lartë të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD)

Në datë 3 qershor 2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu priti në takim përfaqësuesit e lartë të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD).

Z. Shehu u takua z. Chris Levick, Drejtor Rajonal i WFD-së për Europën dhe Azinë Qendore. Gjithashtu, në takim ishin të pranishëm Zv. Drejtori Rajonal i WFD-së për Ballkanin Perëndimor, z. Damir Neziri; Drejtorja e WFD-së për Shqipërinë znj. Valbona Kuka, si dhe përfaqësues nga Ambasada Britanike në Tiranë. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK).

Gjatë takimit u dakordësua për vazhdimin e bashkëpunimit për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë NAO UK dhe homologët rajonalë.

KLSH ka implementuar me sukses disa programe trajnimi të mbështetura nga WFD, për përmirësimin e teknikave dhe metodave të hartimit të raporteve të auditimit, zhvillimin e strategjisë së komunikimit institucional etj.

Këto iniciativa synojnë hartimin e një strategjie komunikimi dhe mekanizma të përmirësuar raportimi me Parlamentin, shoqërinë civile dhe median, me fokus në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Me mbështetjen e WFD, në muajin mars 2025, ekspertë të lartë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar zhvilluan trajnime me auditues dhe specialistë të KLSH-së mbi teknikat e shkrimit të raporteve të auditimit dhe Strategjinë e Komunikimit të institucionit. Kjo ishte hera e parë që ekspertë të NAO UK ishin në Shqipëri për të ofruar asistencë teknike në KLSH. Më 20 mars 2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në takim ekspertët e NAO UK, z. Benjamin Peters, Drejtues i Komunikimit me Jashtë; z. Dan Gluckman, Menaxher i Lartë për Komunikim Dixhital; znj. Natalie Low, Menaxhere e Lartë e Auditimit. Në takim u theksua rëndësia e bashkëpunimit mbi zhvillimin e metodologjive të përparura që ofrojnë rritjen e standardeve profesionale.

Statistika



86 auditime
janë në proces

56 auditime
të publikuara në
web

**29 ankesa/
kërkesa për
informacion**

12 vende
vakante pune
të shpallura

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditime

Kontroli i Lartë i Shtetit ka përmbyllur raportin "Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme" (pjesa I) . Raporti është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, inicimi dhe zbatimi i masave korigjuese nga subjektet e audituara jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e KLSH-së në administrimin e financave publike.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv i verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve i lejon jo vetëm KLSH-së, por dhe palëve të treta, Kuvendit, Qeverisë etj., të sigurojnë në vijimësi një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Skema dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve synojnë të prodhojnë indikatorë të konsoliduar institucionalë sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj Ekzekutivit, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.




TREGUESIT KRYESORË



1641 REKOMANDIME TË LËNA GJITHSEJ

Nga verifikimet e kryera për 42 auditime lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, rezultoi se janë dhënë gjithsej 1641 rekomandime për subjektet e audituara.



1639 REKOMANDIME TË PRANUARA OSE 99%

Lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se nga 1641 rekomandime të dhëna gjithsej, 1639 masa ose 99.9% janë pranuar plotësisht dhe pjesërisht dhe nuk janë pranuar 2 masa ose rreth 0.1%.



1092 MASA TË ZBATUARA DHE NË PROCES OSE 67%

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se 1092 masa ose rreth 67% e tyre rezultuan të zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi. Në mënyrë më të detajuar janë zbatuar plotësisht 674 masa (41%), pjesërisht 243 masa (15%); janë në proces zbatimi 175 (11%).



547 MASA TË PAZBATUARA OSE 33%

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" (547 masa ose 33%) dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre. Ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



870 Masa organizative



458 Masa disiplinore



263 Efekte financiare (në numër)



38 Masa administrative



12 Masa për përmirësime ligjore

18 Auditime të kombinuara

13 Auditime përputhshmërie

9 Auditime performance

1 Auditim financiar

1 Auditim tematik

Auditimi tematik “Mbi monitorimin e HEC Sasaj”

Kontrulli i Lartë i Shtetit ka përfunduar auditimin tematik “Mbi monitorimin e HEC Sasaj”, Sarandë, për periudhën nga fillimi i koncesionit deri më 31.01.2025. Ky auditim në kohë reale nisi menjëherë pas çarjes së digës së hidrocentralit të Bunecit.

Auditimi është ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

Nga ky auditim janë konstatuar disa mangësi, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- Struktura mbajtëse, rrethuese e basenit të presionit kishte pësuar dëmtim, për pasojë derdhje të ujit të depozituar, duke shkaktuar dëme të bimësisë në rrjedhën e malit si dhe në banesa, biznese dhe infrastrukturë.
- Nga ana e AKBN-së nuk janë realizuar monitorime të mjaftueshme për hidrocentralin “Sasaj”, por dhe për HEC-e të tjerë. Mungesa e monitorimeve ka lidhje me mosrespektimin nga ana e koncesionarëve të marrëveshjeve përkatëse për paraqitje dokumentacioni në mënyrë periodike, si dhe me mangësi në inspektimet që realizohen në këto HEC-e nga ana e AKBN-së.
- Nga ana e koncesionarit nuk janë marrë masa të vazhdueshme për sigurinë e veprave përbërëse të HEC “Sasaj” dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla.
- Nga ana e AKBN-së janë inspektuar veprat përbërëse të HEC “Sasaj” pas dëmtimit, por nuk ka asnjë korrespondencë në lidhje me masat që duhet të marrë koncesionari, as me organet e pushtetit vendor dhe as me vetë koncesionarin për kompensimin e dëmeve.
- Koncesionari nuk ka realizuar punimet dhe nuk ka vënë në shfrytëzim HEC-in në kohën e parashikuar në marrëveshje, megjithatë nuk janë respektuar përcaktimet e kësaj marrëveshjeje për aplikimin e penaliteteve.
- Koncesionari nuk ka zbatuar detyrimet kontraktore në lidhje me mirëmbajtjen dhe investimet periodike që duhet të kryeshin në veprat e HEC “Sasaj”.
- Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe në objekt rezulton se fuqia e instaluar për hidrocentralin “Sasaj” është 8600 kW. Referuar përcaktimeve të kontratës koncesionare, fuqia e projektuar dhe e miratuar për këtë vepër është 5,500 kW. Ky devijim nga përcaktimet e kontratës përbën shkelje të drejtpërdrejta të marrëveshjes koncesionare dhe shoqërohet me problematika të natyrës teknike, të cilat ndikojnë në funksionimin optimal të vepërës.



Auditimi në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe AdZM Kukës, Berat, Vlorë

KLSH ka ushtruar auditim në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Kukës, Berat, Vlorë. Nga ky auditim janë konstatuar disa problematika, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- Parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues dhe në procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave nga strukturat e AdZM-ve dhe AKZM-së. Sektori i Menaxhimit në AdZM-të nuk ka përcaktuar dhe përshkruar në mënyrë specifike objektin e veprimtarisë së lejuar që do të ushtrohet në zonën e mbrojtur.
- Për periudhën janar 2022 deri më 30.09.2024 nga Drejtoria/Sektori i Monitorimit në AKZM dhe AdZM-të janë kryer 636 inspektime dhe, sipas procesverbaleve të mbajtura në vend, është vlerësuar dëm në vlerën prej 590,457,704 lekë; përkatësisht: nga zjarret, 157 raste me vlerë 260,795,000 lekë; nga veprimtaritë e kundraligjshme (prerje drurësh, gurë dekorativë etj.); 479 raste me vlerë 329,662,704 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se kjo vlerë nuk është kontabilizuar si detyrim dhe nuk është arkëtuar për periudhën objekt auditimi, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e AKZM-së.



- Deri më 30.09.2024, nga AdZM dhe AKZM janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqeve në zonë të mbrojtur. Nga auditimi u konstatua se 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë rezultuan me detyrime të papaguara dhe të pakontabilizuara. Përkatësisht: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë; 26 HEC-e me detyrime të papaguara në vlerë 367,508,531 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e AKZM-së.
- Brenda zonave të mbrojtura u konstatuan 784 ndërtime informale, të cilat janë krijuar kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. AKZM ka njoftuar institucionet ligjzbatuese, si: IKMT, Drejtorinë e Policisë dhe Prokurorinë e qarkut përkatës, për të gjitha rastet gjatë periudhës 2022-shtator 2024, prej të cilave nuk konfirmohet të kenë kthyer përgjigje zyrtare, duke mos vijuar me procedurat e mëtejshme, me qëllim ndëshkimin sipas ligjit të subjekteve/personave përgjegjës.

Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike

KLSH ka audituar Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike në ish-Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, aktualisht, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI). Në përfundim të auditimit të ushtruar për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezultoi se:

- Për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar politika dhe plane të veprimit për privatizimin e shoqërive shtetërore tregtare në sektorin strategjik dhe jostrategjik, si dhe të aseteve shtetërore.
- Nuk janë përgatitur relacione, përmbledhje apo raportime periodike lidhur me proceset e privatizimit dhe shitjes së pronës përgjatë vitit 2023.
- Strukturat e monitorimit të pronës shtetërore gjatë vitit 2023 nuk kanë kryer një proces efikas të monitorimit të kontratave të qirasë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të tyre deri në llogaritjen e mbajtjen e penaliteteve.
- Nuk janë miratuar në kohë treguesit financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërive aksionere me kapital 100% shtetëror nën administrim të Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë, të cilat në shumicën e tyre rezultojnë me humbje, e cila thellohet vit pas viti. Konkretisht, për vitin 2022 rezultojnë me humbje 8 shoqëri, në shumën 2,446,746 mijë lekë. Konstatohet mungesa e një analize për nxjerrjen në pah të faktorëve të cilët ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes financiare të këtyre shoqërive me qëllim përmirësimin e situatës.
- Nuk janë monitoruar 9 shoqëri të shpallura në likuidim, të cilat rezultojnë me humbje e në vështirësi të theksuara financiare, duke i lënë jashtë vëmendjes e vendimmarrjes institucionale, me pasoja në administrimin e pronës që ato menaxhojnë dhe të cilat administrojnë pasuri të paluajtshme në shumën 6,852,990 mijë lekë, si dhe kanë krijuar detyrime ndër vite gjithsej në shumën 2,225,667 mijë lekë, si detyrime ndaj punonjësve e këshillave mbikëqyrës, sigurimeve shoqërore dhe ndaj të tretëve.
- Vijon të mbetet dividend i prapambetur, i pa likuiduar në shumën 4,054,214 mijë lekë.



- Konstatohet një numër i lartë objektesh për të cilat evidentohet se edhe pse kanë kaluar vite që nga momenti i inicimit të procedurave për privatizim (nisur që prej vitit 2007), procesi i privatizimit nuk ka përfunduar dhe nuk ka konkluduar në shitje të pronës. Tejzgjatja në kohë e procesit të privatizimit, shoqëruar me mospublikimin e pronave në proces privatizimi për të cilat është marrë miratimi, rikon maksimizimin e vlerës së shitjes së tyre dhe përfundimin në kohë dhe me sukses të procesit të privatizimit.
- Konstatohet mungesë koherence e kuadrit ligjor si dhe problematika në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të sipërfaqeve të ndërtuara në tejkallim të lejes së ndërtimit.
- Në përfundim të auditimit rezultuan efekte negative nga mosvendosja e penaliteteve në zbatimin e kontratave të qirasë "1 euro" në shumën 102,556 mijë lekë; të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i detyrimeve të qirasë nga subjektet qiramarrëse në shumën 2,218 mijë lekë; efekte negative nga administrimi dhe shitja e pronës në shumën 43,402 mijë lekë.

Auditimi në Korporatën e Investimeve Shqiptare

KLSH ka përfunduar auditimin në Korporatën e Investimeve Shqiptare SHA, për periudhën 17.10.2019-30.06.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me njohjen e aktivitetit ekonomiko-financiar të saj dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara; vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimin e pasqyrave financiare, detyrimeve të prapambetura etj.

Në përfundim të auditimit rezultoi se:

- Planifikimi buxhetor i Korporatës së Investimeve Shqiptare (KISH) është kryer në mënyrë të pamjaftueshme dhe pa argumentim të detajuar, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë.
- Korporata e Investimeve Shqiptare nuk ka implementuar manuale, udhëzues apo metodologji të standardizuara për hartimin, seleksionimin dhe menaxhimin e projekteve, duke cenuar procesin strategjik dhe realizimin e objektivave të saj.
- Projekt-propozimet e hartuara nga Korporata e Investimeve Shqiptare gjatë viteve 2022-2024 janë realizuar pa respektuar procedurat e përcaktuara, me mungesë analizash të detajuara mbi risqet, objektivat dhe përfitueshmërinë, duke pamundësuar vlerësimin e impaktit ekonomik dhe përfitimeve të mundshme.
- Nga auditimi i veprimtarisë së KISH-së, konstatohet se në vitin 2024 ka pasur një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme, duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, edhe pse janë kryer shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e para-fizibilitetit.

- Nga auditimi i projekt-propozimeve në kuadër të zhvillimit të pronave shtetërore, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostot financiare, risqet potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, apo për hapat konkrete që do duhet të ndiqen për çdo projekt-propozim përpara shpalljes së tij, të tilla si parafizibiliteti/fizibiliteti, sikundër vepruar për projektet e periudhës 2022-2023; si dhe një analizë krahasuese nëse projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.
- KISH ka dorëzuar pasqyrat financiare dhe deklaratat e tatim-fitimit për vitet 2020-2023 me dy versione, duke tejkalluar afatet ligjore dhe duke u ekspozuar ndaj penaliteteve dhe interesave për mosrespektimin e afateve dhe ndryshimeve. Për më tepër, përgjegjësitë për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk janë të mirëpërcaktuara midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtorit të Financës, duke shkaktuar paqartësi dhe mungesë të qartësisë institucionale.
- Nga auditimi u konstatua mungesë dokumentacioni për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe strukturë e paplotë e Këshillit, përfshirë mungesën e një kryetari gjatë periudhës 2020-2023.
- Termat e shpërblimit për anëtarët e pavarur vendas nuk ishin të përcaktuara qartë, duke rezultuar në shpërblime të ndryshme me ato të anëtarëve nga institucionet qendrore.



KLSH - ZKA zhvillojnë takime pune në Shqipëri dhe Kosovë për auditimin paralel mbi sigurinë e digave



Në datat 29-30 maj 2025 u zhvillua në Prishtinë takimi i radhës midis grupeve të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) në kuadër të auditimit paralel të performancës me temë *“Mbrotjtja dhe siguria e digave”*.

Në këtë takim, në cilësinë e grupit të auditimit të KLSH-së morën pjesë drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Aulent Guri, audituesit z. Artan Topjana, z. Skënder Muça dhe Xhuljeta Çelaj. Ndërsa nga ZKA, në cilësinë e grupit të auditimit ishin drejtorja e Departamentit të Auditimit të Performancës, znj. Ariana Gjonbalaj Shala, udhëheqësja e ekipit, znj. Alba Keqa dhe znj. Kujtesa Alaj.

Grupet e auditimit diskutuan për temën e auditimit dhe objektivat e përbashkëta, për të vlerësuar menaxhimin dhe masat e sigurisë në digat e të dy vendeve, metodologjinë, dhe përputhshmërinë e planeve të auditimit, situatën parastudimore dhe çështje tjera të procesit të auditimit.

Në vijim u zhvillua edhe një vizitë studimore në digën e Liqenit të Batllavës, ku në praninë e institucioneve përgjegjëse të Kosovës të cilët shfrytëzojnë këtë digë u diskutua dhe pa nga afër gjendja në terren.

Në datat 23-24 qershor 2025, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës zhvilloi një vizitë pune 2-ditore në Shqipëri. Grupet e auditimit të KLSH-së dhe ZKA-së vizituan nga afër digën e Liqenit Artificial të Tiranës, si edhe digat e Banjës dhe Moglicës. Diga e Moglicës është edhe diga më e lartë në Shqipëri me 166.5 m lartësi dhe paraqet një rëndësi të veçantë për sektorin hidroenergetik. Kjo digë është ndërtuar në 10-vjeçarën e fundit.

Në vizitat në digat e Banjës dhe Moglicës grupet e auditimit u shoqëruan nga përfaqësues të institucioneve që mbikëqyrin sigurinë e këtyre digave. Përmes vizitave të ndërsjella në terren grupet e auditimit krijojnë një pasqyrim të plotë të situatës së digave në Shqipëri dhe Kosovë.

TAKIMI III I GRUPIT TË PUNËS SË EUROSAT-T



“Përfitimet dhe Metodologjitë e Auditimit në Kohë Reale”

U përmbyll më 6 qershor 2025 në Bukuresht takimi i tretë i Projektit Grupit të Punës së EUROSAT-t *“Mbi përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale”*.

Takimi i kryesuar nga Gjykata e Llogarive e Italisë (Corte dei Conti) kishte qëllim të nxiste shkëmbimin e përvojave mes Institucioneve Supreme të Auditimit të komunitetit EUROSAT, në lidhje me auditimin në kohë reale.

Takimi u organizua nga SAI i Rumanisë dhe në të morën pjesë 19 Institucione Supreme Evropiane të Auditimit (SAI).

Nevoja për auditime në kohë reale lindi nga trysnia që Institucionet Supreme të Auditimit kanë nga Parlamentet, publiku dhe palët e interesit për t’iu përgjigjur problematikave aktuale.

Në fjalën përshëndetëse, Kryetari i Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, z. Busuioc, solli në vëmendje se sot interesi nuk është mbi zbatimin e buxheteve apo shkeljeve në procedura prokurimesh të cilat kanë ndodhur vite më parë. *“Publiku dhe Parlamenti duan të jenë të informuar se si po përdoren aktualisht paratë e taksapaguesve dhe çfarë masash po marrin SAI-t për të parandaluar keqpërdorimin e tyre, apo nëse qeveritë po iu përgjigjen në mënyrë optimale situatave të emergjencës”*.

Nëpërmjet auditimeve në kohë reale, SAI mund të ofrojë në kohë rekomandime për përmirësime. Në përfundim të takimit u miratua edhe dokumenti mbi metodologjinë dhe përfitimet nga auditimet në kohë reale.

WORKSHOPI NË PRISHTINË



“Auditimet IT - Zhvillimet dhe Sfidat”

Në datat 29-30 maj 2025 u zhvillua në Prishtinë workshop-i rajonal me temë *“Auditimet e Teknologjisë së Informacionit – Zhvillimet dhe Sfidat”*, organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA).

Aktiviteti kishte në fokus shkëmbimin e njohurive, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) dhe trajtimin e sfidave aktuale të auditimit të Teknologjisë së Informacionit (TI) në sektorin publik.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga SAI të rajonit dhe më gjerë, përfshirë Poloninë, Portugalinë, Estoninë, Turqinë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, si dhe përfaqësues nga organizata ndërkombëtare INTOSAI, Development Initiative (IDI). KLSH u përfaqësua nga auditueset Elira Cukalla dhe Rovena Deda. Cjatë workshop-it, pjesëmarrësit ndanë praktikat më të mira në auditimet e TI-së, zhvillimet në përdorimin e inteligjencës artificiale në auditim, si dhe strategjitë për përbalimin e kërcënimeve kibernetike në administratën publike.

KLSH merr pjesë në konferencën e organizuar nga Gjykata e Europiane e Audituesve për “Mbrojtjen”



Gjykata e Europiane e Audituesve (ECA) organizoi në datën 30 qershor 2025 konferencën me temë “Mbrojtja”.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga ECA, Institucionet Supreme të Auditimit, përfaqësues të NATO-s dhe të institucioneve të tjera të Bashkimit Europian, anëtarë të parlamenteve të vendeve të ndryshme të BE-së, si dhe përfaqësues të organizatave që kanë në fokus të punës së tyre çështjet e mbrojtjes. KLSH u përfaqësua në këtë konferencë nga Sekretarja e Përgjithshme, znj. Valbona Gaxha, znj. Ermira Hoxha dhe znj. Anila Alcani.

Në konferencë u zhvilluan diskutime mbi disa çështje, si: e ardhmja e politikës mbrojtëse të BE-së, forcimi i gatishmërisë, financimi dhe auditimi, si dhe vendimmarrja nga Parlamenti.

Konkretisht, u diskutua për kontekstin gjeopolitik aktual dhe si BE po i përgjigjet urgjencës së transformimit të mbrojtjes dhe forcimit të sigurisë së saj, ku u paraqitën edhe perspektiva nga vendet anëtare apo ekspertë të NATO-s. Në aspektin e forcimit të gatishmërisë së industrisë mbrojtëse të BE-së, ekspertët diskutuan rreth situatës reale dhe sfidave të bazave industriale mbrojtëse të BE-së si në tokë dhe në hapësirë.



Në kontekstin e masave që po ndërmerren nga qeveritë, si dhe referuar tablosë së investimeve në fushën e mbrojtjes, e cila në vitet e fundit ka ndryshuar konsiderueshëm duke përfshirë si grantet e BE-së ashtu edhe kreditë, nga përfaqësues të SAI-ve u diskutua mbi perspektivat dhe sfidat e ndryshme që lidhen me auditimin.

Nga ana e përfaqësuesve të Parlamentit Europian dhe atyre të parlamenteve të vendeve anëtare si dhe ekspertëve të NATO-s u paraqit këndvështrimi parlamentar për politikën e mbrojtjes.



Auditues të KLSH-së, vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive (TCA) për auditimin në “Sektorin e Sigurisë”

Gjykata Turke e Llogarive (TCA) ka nisur programin mbi “Auditimin e Sektorit të Sigurisë” për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Programi pesëditor i trajnimit mbi “Auditimin e Sektorit të Sigurisë”, i organizuar nga TCA për delegacionin e KLSH-së, u realizua në datat 5-9 maj 2025.

Pesë auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilluan një vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive me fokus shkëmbimin e eksperiencave në “Auditimin e Sektorit të Sigurisë”.

Qëllimi i kësaj vizite studimore në Ankara ishte shkëmbimi i eksperiencës së Gjykatës Turke të Llogarive, në auditimin e “Sektorit të Mbrojtjes dhe Sigurisë”, duke lehtësuar ndarjen e njohurive dhe përvojave midis dy Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI). KLSH u përfaqësua në këtë vizitë nga audituesit, z. Aldo Kume, z. Paolo Xhezo, z. Herman Imeraj, z. Henri Axfushi dhe z. Kreshnik Petku. Grupi i audituesve të KLSH-së u mirëprit nga Zv. Presidenti i TCA-së, z. Ahmet Tezcan, i cili përshëndeti dhe takimin e punimeve.



Gjatë vizitës studimore u prezantuan auditime të realizuara për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë nga Gjykata Turke e Llogarive. Audituesit e KLSH-së u njohën me eksperiencën dhe metodologjinë e TCA-së në auditimin e fushës së sigurisë.

Si pjesë e programit, i cili u mbajt me mbështetjen e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), u organizuan vizita në terren në institucione dhe organizata të ndryshme, si: Xhandarmëria Turke dhe Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, Memoriali M. K. Atatürk në Presidencën e Turqisë, Asambleja I dhe II e qeverisë turke.

Seminari i IDI-t për vlerësimin e performancës së SAI PMF

Në datat 2-6 qershor 2025 u zhvillua në Stamboll seminari për zbatimin dhe vlerësimin e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI PMF), organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI). Ky aktivitet kishte si synim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe njohurive për metodologjinë dhe zhvillimet aktuale të Kornizës për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe njohuritë për rishikimin e pavarur të vlerësimeve në kuadër të EUROSAI-t.

Agjenda e seminarit u fokusua në analizën e thelluar të shkaqeve, duke u bazuar në të gjitha aspektet që ndikojnë në performancën e institucionit, si dhe mbi vlerësimin e integruar.

Përfaqësuesit e institucioneve homologe zhvilluan diskutime dhe prezantime, duke ndarë përvojat dhe praktikën më të mira mbi tema të rëndësishme që lidhen me procesin e vlerësimit të performancës së institucioneve supreme të auditimit, menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimet e pavarura.



KLSH bashkëpunon me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë për auditimet e performancës




Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional që Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë (NAO), Departamenti i Auditimit të Performancës zhvilloi në datat 3-5 qershor 2025 një vizitë pune në Bergen, e cila kishte në fokus auditimet që po realizohen me asistencën e audituesve norvegjezë.

Në këtë vizitë pune nga KLSH morën pjesë audituesit: z. Aulent Guri, znj. Arminda Bushi, znj. Eva Kushta, znj. Vjola Kojani, znj. Annavanessa Hoxhaj, z. Klarenc Xhaferaj, znj. Xhuljeta Çelaj, znj. Brisilda Hyka, znj. Arjeta Çoku dhe znj. Jorida Zhegu.

Vizita kishte për qëllim diskutimin dhe analizimin e ecurisë së dy auditimeve që janë zhvilluar me asistencën e homologëve norvegjezë: *"Cilësia e ujërave në plazhe"* dhe *"Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar"*. Gjatë tre ditëve të workshopi-t u diskutuan gjetjet, struktura dhe mënyra e përmirësimit të raportit, u analizuan metoda të reja për rritjen e cilësisë së auditimeve si dhe u shkëmbyen ide për forcimin e bashkëpunimit.

Grupi i auditimit për temën *"Cilësia e ujërave në plazhe"* diskutoi mbi përmbajtjen e çështjeve të trajtuara, strukturën dhe përshkrimin e tyre në raport, si dhe mbi formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve. Grupi i auditimit pati gjithashtu mundësinë të ndjekë një prezantim nga një përfaqësuese e Bashkisë së Bergenit lidhur me përvojën e kësaj bashkie në monitorimin e cilësisë së ujërave larës dhe në menaxhimin e ujërave të ndotura urbane.



Grupi i auditimit, i fokusuar në *"Shërbimin psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar"* punoi ngushtësisht me tre auditues të SAI-t të Norvegjisë për ndërtimin dhe zhvillimin e programit të auditimit, i cili u finalizua në janar 2025 dhe u mbështet mbi tri shtylla kryesore: cilësia e shërbimit të ofruar, kapacitetet ekzistuese dhe politikat institucionale në këtë fushë. Gjatë workshop-it u paraqit edhe një prezantim nga Universiteti i Bergenit mbi *"Shërbimin psiko-social në shkollë"*, për t'u njohur me mënyrën se si është i organizuar shërbimi në këtë vend dhe studimet e zhvilluara në këtë fushë.

Homologët norvegjezë kanë ndihmuar në orientimin e grupit auditues të KLSH-së drejt një qasjeje më të thjeshtë dhe të kuptueshme për një audiencë të gjerë, përfshirë publikun, median dhe Kuvendin.

Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit për të ardhmen u propozuan disa mundësi konkrete, përfshirë realizimin e auditimeve paralele me SAI-n e Norvegjisë për tema të përbashkëta, si dhe përfshirjen e audituesve shqiptarë në auditime që zhvillohen nga homologët norvegjezë.

Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë zhvillon Bllok III të Programit të Trajnimit për Auditimin e Performancës


Në datat 24-27 qershor 2025 u zhvillua në Shkup Bllok III i Programit të Trajnimit për Auditimin e Performancës, i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO). Trajnimi u zhvillua përmes një kombinimi të prezantimeve teorike, ushtrimeve praktike, punës në grupe, duke nxitur një proces të strukturuar dhe bashkëpunues.

Në këtë bllok trajnimi pjesëmarrësit ndoqën një program intensiv, i cili kishte për qëllim të forconte aftësitë analitike dhe metodologjike për përgatitjen e programit të auditimit të performancës. Ky bllok thelloi njohuritë e fituara nga dy blloqet e mëparshme, duke u fokusuar në mënyrën se si ndërtohet një program auditimi i bazuar në problem, si përzgjidhen teknikat më të përshtatshme audituese dhe si argumentohet qasja metodologjike për auditimet konkrete që grupet kishin në zhvillim. Rëndësi e veçantë iu kushtua studimeve të rasteve si një metodë thelbësore në auditimin e performancës.



Nga KLSH morën pjesë në këtë trajnim auditueset Annavanessa Hoxhaj, Lorena Liçi dhe Arjeta Çoku, të cilat po zhvillojnë auditimin e performancës me temë "Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit".

UN Women Albania - KLSH, prezantohet Udhëzuesi për Auditimin e Ndjeshëm Gjinator



Në datën 12 qershor 2025 u zhvillua sesioni i prezantimit të Udhëzuesit për Auditimin e Ndjeshëm Gjinator, përgatitur nga UN Women Albania. Ky udhëzues vjen si rezultat i punës së përbashkët me KLSH-në, në vijim të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe hartimit të planit të punës së përbashkët mbi aktivitetet që do të zhvillohen në të ardhmen.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim morën pjesë auditues dhe përfaqësues nga departamente dhe drejtori të ndryshme, me qëllim njohjen dhe diskutimin në një shkallë më të gjerë mbi udhëzuesin praktik, i cili, edhe pse kryesisht është i fokusuar në auditimet e performancës, do të mund të shërbejë gjithashtu si dokument pune edhe për llojet e tjera të auditimeve për të mundësuar përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha proceset e auditimit publik. Ky udhëzues do të shërbejë gjithashtu në zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve duke nxitur shkëmbimin e njohurive për të vlerësuar në mënyrën e duhur pabarazinë gjinore dhe për të promovuar dhe rekomanduar ofrimin e shërbimeve të duhura nëpërmjet auditimeve specifike gjinore jo vetëm në nivel kombëtar por dhe më gjerë.



Në takim u diskutua mbi fazat e procesit të auditimit, identifikimin e rasteve të pabarazisë gjinore, rolin e KLSH-së në integrimin e kësaj perspektive në procesin e auditimit.

Workshop rajonal në Prishtinë për barazinë gjinore



Me mbështetjen e organizatës UN Women, në datat 9-10 qershor 2025 u organizua në Prishtinë takimi rajonal me temë "Inicativë për auditim të ri të performancës në bashkëpunim". Aktiviteti mblodhi përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) të tri shteteve dhe partnerë të tjerë, për të diskutuar mundësitë e zhvillimit të auditimeve të përbashkëta me fokus në fuqizimin e grave në vendimmarrje dhe barazinë gjinore.

Nga KLSH morën pjesë në këtë aktivitet z. Aulent Guri, drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës dhe auditueset znj. Eva Kushta dhe znj. Arjeta Çoku.

Aktiviteti ishte pjesë e programit rajonal "Financim Transformues për Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor", i mbështetur nga Qeveria e Suedisë nëpërmjet SIDA-s dhe i zbatuar nga UN Women në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi.








Objekti kryesor i këtij takimi pune ishte diskutimi me ekipet e audituesve nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) përkatëse mbi iniciativën për auditimin e ri bashkëpunues të performancës me temë "Gratë Lidere - Gratë në Politikë, Parlament dhe në Pozicionet Lideri në Qeverinë Qendrore".

Përfaqësuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit diskutuan, ndanë praktikata dhe përvojat e tyre në kryerjen e auditimeve të lidhura me barazinë gjinore dhe ndikimin që këto auditime kanë për temën në fokus.

Bashkëpunimi me SAI homologe mundëson një analizë të thelluar të politikave ekzistuese, identifikimin e boshllëqeve në zbatimin e kuotave gjinore dhe vlerësimin e ndikimit të strategjive për barazinë gjinore.

Falënderit për leximin!



© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë - E enjte: 08:00 - 16:30 E premte: 08:00 - 14:00



**GUSHT
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Gusht 2025

European Commission

RULE of LAW
REPORT 2025

COUNTRY CHAPTER
ABSTRACTS AND
RECOMMENDATIONS

EUROPEAN COMMISSION

Strasbourg, 8.7.2025
SWD(2025) 938 final

COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT

2025 Rule of Law Report
Country Chapter on the rule of law situation in Albania

Accompanying the document

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions

2025 Rule of Law Report
The rule of law situation in the European Union

{COM(2025) 900 final} - {SWD(2025) 901 final} - {SWD(2025) 902 final} -
{SWD(2025) 903 final} - {SWD(2025) 904 final} - {SWD(2025) 905 final} -
{SWD(2025) 906 final} - {SWD(2025) 907 final} - {SWD(2025) 908 final} -
{SWD(2025) 909 final} - {SWD(2025) 910 final} - {SWD(2025) 911 final} -
{SWD(2025) 912 final} - {SWD(2025) 913 final} - {SWD(2025) 914 final} -
{SWD(2025) 915 final} - {SWD(2025) 916 final} - {SWD(2025) 917 final} -
{SWD(2025) 918 final} - {SWD(2025) 919 final} - {SWD(2025) 920 final} -
{SWD(2025) 921 final} - {SWD(2025) 922 final} - {SWD(2025) 923 final} -
{SWD(2025) 924 final} - {SWD(2025) 925 final} - {SWD(2025) 926 final} -
{SWD(2025) 927 final} - {SWD(2025) 929 final} - {SWD(2025) 930 final} -
{SWD(2025) 931 final}

Komisioni European vlerëson rolin e KLSH-së në luftën kundër korrupsionit

Komisioni European (KE) ka vlerësuar rolin aktiv dhe të qëndrueshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Në raportin më të fundit të KE-së “Sundimi i ligjit” për vitin 2025, për Shqipërinë, KLSH përmendet si një nga institucionet me performancë konkrete dhe bashkëpunim efektiv me organet e drejtësisë.

KE nënvizon se KLSH ka krijuar një praktikë solide në adresimin e shkeljeve, duke i kaluar çështjet me prioritet të lartë organeve hetimore.

“Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka një histori më të fortë sa i përket referimeve gjyqësore dhe bashkëpunimit me organet e ndjekjes penale. Në vitin 2024, KLSH referoi 13 raste me elementë penalë për ndjekje penale. Përveç kësaj, 35 referime për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme janë ndarë me organet e Prokurorisë me kërkesë të tyre”, thuhet në raportin e vitit 2025 të Komisionit e European.

KE bën thirrje për bashkëpunim të detyruar institucional midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit. KE kërkon që puna e KLSH-së të mbështetet si një shtyllë kyçe në betejën kundër korrupsionit.

Komisioni European ka vlerësuar vazhdimisht punën e KLSH-së, duke përfshirë edhe rolin e institucionit në procesin integruar. Edhe në Progres-Raportin e vitit 2024 të Bashkimit European për Shqipërinë, KE shprehet se cilësia e punës audituese është më përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

“Ndikimi i punës audituese ka treguar progres. Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm. KLSH vazhdon të bashkëpunojë dhe t’i japë informacion organit të akuzës në lidhje me gjetje të auditimeve të tij, të cilat mund të kenë elemente të veprës penale”, evidentohet në Progres-Raportin e BE-së.

“yet to be demonstrated”⁷³ Coordination between institutions in charge of corruption prevention and relevant law enforcement structures remains weak and the number of referrals further decreased. The State Audit Institution (ALSAI) has a stronger track record on judicial referrals and cooperation with criminal prosecution bodies. In 2024, ALSAI referred 13 cases with criminal elements to prosecution. Additionally, 35 referrals on issues that require further investigation were shared with prosecutorial bodies upon request⁷⁶.

Pjesa për KLSH në Raportin e Komisionit European “Sundimi i Ligjit” 2025

KLSH merr vlerësim nga OKB për evidentimin e parregullsive në prokurime




Një tjetër institucion i rëndësishëm ndërkombëtar ka vlerësuar punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit në drejtim të luftës ndaj korrupsionit. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka publikuar së fundi dokumentin "Përmbledhje Ekzekutive e ciklit të dytë të vlerësimit të Shqipërisë për zbatimin e kreut II dhe V të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC)".

Përmbledhja Ekzekutive eidenton disa piketa kryesore që lidhen me parandalimin e korrupsionit (struktura me funksione parandaluese, kuadri ligjor, prokurimi publik, konflikti i interesit, sinjalizimi, kapacitetet e administratës, marrëdhëniet ndërkombëtare, pastrimi i parave). Përmendje të lehta i referohen edhe kapaciteteve formuese dhe kualifikime të administratës, gjyqësorit, transparencja dhe e drejta informimit.

Në dokument vlerësohet puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit për evidentimin e parregullsive në procedurat e prokurimit publik.

"Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit vazhdon të raportojë parregullsi në prokurimin publik në nivel qendror dhe lokal", evidentohet në Përmbledhjen Ekzekutive të OKB-së për Korrupsionin.

Në fund të dokumentit janë lënë edhe rekomandimet për masat e mëtejshme që duhet të ndërmerren institucionet shqiptare për parandalimin e korrupsionit dhe rikuperimit të të ardhurave dhe asetëve të përfituara në mënyrë të paligjshme.



Pjesa për KLSH në Raportin e OKB-së për Korrupsionin


Çfarë është Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit - UNCAC?

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) është i vetmi instrument universal kundër korrupsionit, ligjërisht i detyrueshëm. Ajo u hartua dhe u negociua në Vjenë, Austri në vitet 2002-2003 dhe më pas u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 31 tetor 2003. Konventa është ratifikuar nga 191 vende, përfshirë edhe Shqipërinë.

Qasja gjithëpërfshirëse e Konventës dhe karakteri detyrues i shumë prej dispozitave të saj e bëjnë atë një instrument unik për zhvillimin e përgjigjeve gjithëpërfshirëse ndaj korrupsionit në nivel kombëtar, rajonal dhe global.

Konventa mbulon pesë fusha kryesore: masat parandaluese, kriminalizimin dhe zbatimin e ligjit, bashkëpunimin ndërkombëtar, rikuperimin e asetëve dhe asistencën teknike, shkëmbimin e informacionit.

Konventa shërben gjithashtu si një mjet thelbësor që çon përpara "Axhendën 2030" dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke adresuar efektet e përhapura të korrupsionit në të gjitha vlerat dhe parimet thelbësore të Kombeve të Bashkuara.



Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) janë një thirrje globale për veprim, për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur mjedisin dhe klimën në Tokë dhe për të siguruar që njerëzit, pavarësisht vendndodhjes, të mund të gëzojnë paqe dhe mirëqenie. 19 Agjenci të OKB-së punojnë së bashku për të mbështetur Shqipërinë për arritjen e OZHQ-ve.

Vitet e fundit, Kontrolli i Lartë i Shtetit është fokusuar edhe në auditimin e fushave që përfshijnë OZHQ-të, siç janë: shëndeti, mirëqenia, arsimi, barazia gjinore, uji, energjia, infrastruktura, klima etj.



Forcimi i Kompetencave të Auditimit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në kuadër të Forumit Politik të Nivelit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 2025, INTOSAI zhvilloi më 21 korrik 2025 në Nju Jork takimim me temë “Kompetencat dhe kapacitetet në rritje të Institucioneve Supreme të Auditimit për ofrimin e vlerës së auditimit për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”. Takimi, i mbajtur si pjesë e Forumit Politik të Nivelit të Lartë për Zhvillim të Qëndrueshëm (HLPF), u përqendrua në forcimin e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për të audituar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht për Objektivin 3 (Shëndet dhe Mirëqenie) dhe Objektivin 5 (Barazia Gjinore).

Takimi u organizua bashkërisht nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Komiteti i Ndarjes së Njohurive të INTOSAI-t (KSC), SAI i Brazilit si Kryetar i INTOSAI-t, Misioni i Përhershëm i Mbretërisë së Butanit në Kombet e Bashkuara në Nju Jork dhe Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara (UN DESA).

Një moment i rëndësishëm në takim ishte prezantimi zyrtar i nismës “Iniciativa e audituesve të OZHQ-ve për SAI-t”, e cila do të mbështesë SAI-t në zhvillimin e kompetencave të nevojshme të auditimit për të kontribuar në zbatimin e “Axeëndës 2030” përmes trajnimit digjital, udhëzimeve praktike dhe një fokusi të fortë në ndikimin e auditimit deri në vitin 2027.

Drejtnesit e INTOSAI-t (SAI Brazil) dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t (SAI Austria) theksuan rolin kritik që SAI-t luajnë në nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies në kuadër të “Axeëndës 2030”.

Gjatë diskutimeve u prezantua në mënyrë të detajuar nisma “SAI-t dhe auditimi i Objektivave të Qëndrueshme Strategjike”, për të fuqizuar audituesit publikë në auditimet e OZHQ-ve.

AUDITS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



Paneli i diskutimit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga SAI-e të ndryshme, por edhe përfaqësuesve nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) dhe UN Women, ndanë përvoja konkrete nga auditimet e OZHQ-ve, si dhe vendosën në dukje sfidat e vendeve të vogla në zhvillim (SIDS) dhe rëndësinë e partneriteteve për auditime gjithëpërfshirëse që zbatohen parimin: “Të mos lëmë askënd pas” (Leave No One Behind).

Trajnimi mbi “Vlerësimin e Performancës së Menaxhimit të Borxhit Publik”, organizuar nga Banka Botërore dhe Instituti Joint në Vjenë

Në datat 14-18 korrik 2025 u zhvillua në Vjenë trajnimi ndërkombëtar “Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së Menaxhimit të Borxhit Publik (DeMPA)”, i organizuar nga Banka Botërore (World Bank) dhe Instituti Joint i Vjenës (Joint Vienna Institute).

Qëllimi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të borxhit, me fokus te transparenca, efektiviteti dhe qëndrueshmëria fiskale. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë trajnim nga auditueset: znj. Joniada Goçaj dhe znj. Anjeza Gjoci.

Programi trajnues u zhvillua përmes një kombinimi të sesioneve teorike, prezantimeve nga përvoja ndërkombëtare dhe ushtrimeve praktike në grup, me fokus në:

- Kuadrin ligjor dhe institucional të menaxhimit të borxhit publik.
- Hartimin dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të borxhit (DMS).
- Koordinimin me politikat fiskale dhe monetare.
- Proceset e huamarrjes dhe menaxhimit të risqeve operacionale.
- Regjistrimin, raportimin dhe auditimin e borxhit.
- Menaxhimit e detyrimeve të kushtëzuara dhe hartimin e planeve të veprimit.

Gjatë trajnimit, përfaqësues nga vendet, si: Armenia, Gjeorgjia, Shqipëria, Indonezia, Moldavia, Uzbekistani dhe Maqedonia e Veriut ndanë eksperiencat e tyre mbi sfidat dhe praktikatat më të mira në hartimin dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të borxhit publik.



Joint Vienna Institute

THE WORLD BANK
World Bank Group



Debt Management Performance Assessment (DeMPA) Workshop
Vienna, Austria from July 14-18, 2025

Pjesëmarrësit realizuan një vlerësim të plotë DeMPA-së mbi një vend hipotetik, duke analizuar performancën sipas 15 indikatorëve kryesorë të metodologjisë dhe duke formuluar rekomandime konkrete për përmirësimin e menaxhimit të borxhit.

Pjesëmarrja në këtë trajnim shërbeu si një mundësi e vlefshme për të thelluar njohuritë teknike në fushën e menaxhimit të borxhit publik, duke forcuar kapacitetet institucionale për një auditim cilësor.

Objekti i programit të Bankës Botërore (DeMPA) i nisur në vitin 2007 është të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve të institucioneve në vendet në zhvillim, në mënyrë që ato të mund të menaxhojnë borxhin publik në një mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në afat të mesëm dhe të gjatë.

DeMPA është përdorur nga më shumë se 150 qeveri kombëtare dhe nënkombëtare në mbarë botën.

Roli i KLSH-së si SAI, burim për IDI-n



Në datat 21-25 korrik 2025 u organizua sesioni i trajnimit në kuadër të misionit mbështetës të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për Gjykatën e Llogarive të Timor Leste, ku KLSH u përfaqësua me mentor znj. Aulona Jani, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Përzgjedhja e përfaqësuesit të KLSH-së si pjesë e këtij misioni, shpreh vlerësimin që institucioni ka fituar në arenën ndërkombëtare, si një SAI i besueshëm dhe kontribues, në avancimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë së auditimit në rajon.

Misioni synon të mbështesë Gjykatën e Llogarive të Timorit Lindor (Camara de Contas) në nisjen e zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SoAQM), të bazuar në standardin e rishikuar ISSAI 140.

Për të udhëhequr dhe mentoruar këtë proces, IDI ftoi KLSH-në dhe SAI-n e Qipros, duke vlerësuar përvojën e suksesshme në fillimin e zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe aftësinë për ta kthyer këtë eksperiencë në udhëzime praktik për SAI-t partnere.

Gjatë trajnimit u ofruan njohuri të rëndësishme teknike, ku metodologjitë dhe mësimet e nxjerra nga KLSH u përdorën drejtpërdrejt si shembuj për Gjykatën e Llogarive të Timorit Lindor.

Duke ia besuar KLSH-së këtë rol, IDI e ka pozicionuar Shqipërinë si një partner aktiv rajonal në ngritjen e cilësisë së auditimit në sektorin publik.

Ky vlerësim gjithashtu hap mundësi për bashkëpunime të ardhshme dhe përforcon imazhin e KLSH-së si një SAI që përcjell dije, ekspertizë dhe lidhshmëri.

Zhvillohet sesioni i trajnimit për mentorët mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Auditim



Nga data 1 deri më 4 korrik 2025, në qytetin e Hammametit, në Tunizi u zhvillua sesioni i trajnimit me fokus "Përgatitje e Shpejtë për Mentorët në ARABOSAI". Ky aktivitet u organizua nga Iniciativa për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) në bashkëpunim me Bankën Botërore, si pjesë e projektit për mbështetjen e institucioneve më të larta të auditimit të Tunizisë dhe Algjerisë për ngritjen dhe zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SoAQM), në përputhje me standardin e rishikuar ISSAI 140.

Trajnimi përbën një hap të rëndësishëm në ndërtimin e kapaciteteve për mentorët që do të ofrojnë asistencë teknike dhe metodologjike për SAI-t përkatës gjatë gjithë ciklit të ngritjes së sistemit të ri të menaxhimit të cilësisë. Pjesëmarrja e ekspertëve nga vende të ndryshme të rajonit ARABOSAI solli një dimension ndërkombëtar dhe një shkëmbim të vlefshëm përvojash.

KLSH u përfaqësua në cilësinë e "resource person" të IDI-t nga znj. Xhuljeta Çelaj, e cila përcolli përvojën e saj praktike në zbatimin e sistemit të cilësisë duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të tyre përmes ndërhyrjeve të strukturuar dhe të qarta.

Trajnimi ishte i hartuar në shtatë sesione tematike, të cilat përfshinin të gjithë komponentët esencjalë të SoAQM-së.

Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime, ushtrime praktike dhe shkëmbim përvojash, duke mundësuar një mjedis dinamik dhe bashkëpunues. Trajnimi jo vetëm që forcoi kapacitetet individuale të mentorëve, por krijoi edhe një rrjet bashkëpunimi rajonal për zbatimin e SoAQM-së. Bashkëpunimi mes IDI-t, Bankës Botërore dhe SAI-ve përkatëse krijon një terren të favorshëm për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të menaxhimit të cilësisë në auditim.

KLSH merr pjesë në tryezën “Korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri”

Në datë 18 korrik 2025 u organizua në ambientet e “Libraria Tirana Times” në Tiranë tryeza e rrumbullakët me temë “Korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri”, ku morën pjesë përfaqësues të medias dhe të shoqatave të ndryshme në sektorin e shëndetësisë. Në këtë takim, znj. Eriselda Ndreca prezantoi gjetjet kryesore të raportit me temë “Analiza gjithëpërfshirëse të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri”.



Raporti i përgatitur nga shoqata “Together for Life” analizon praktikat korruptive të identifikuar nga media me karakter investigativ, si dhe në raportet e institucioneve të pavarura me funksion kontrolli dhe mbikëqyrjeje, ku ndër to kanë qenë edhe raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Znj. Ndreca, ndër të tjera, theksoi rolin e KLSH-së në luftën ndaj korrupsionit në sektorin e shëndetësisë dhe jo vetëm.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga z. Aulent Guri, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës. Në fjalën e tij, z. Guri bëri një përmbledhje të shkurtër të raporteve kryesore të auditimit të KLSH-së me fokus në korrupsionin në sektorin e shëndetësisë, si dhe në cilësinë e shërbimeve që strukturat shëndetësore duhet të garantojnë për qytetarët. “Është pranuar gjerësisht se korrupsioni në sektorin e shëndetësisë është një ndër shkaqet kryesore të cilësisë jo të mirë të shërbimeve shëndetësore, ndaj edhe KLSH në auditimet e saj të përputhshmërisë, por edhe të performancës, ka realizuar një sërë auditimesh që kanë identifikuar jo vetëm abuzime financiare, por mbi të gjitha kanë cenuar efektivitetin e shërbimeve shëndetësore që qytetarët shqiptarë duhet të marrin”.

Takimi vijoi me diskutime, pyetje dhe sugjerime nga të gjithë pjesëmarrësit mbi situatën aktuale si dhe nevojat për përmirësim. Në përfundim të këtij takimi, pjesëmarrësit sollën në vëmendje rëndësinë e shtimit të bashkëpunimit midis institucioneve publike, veçanërisht KLSH-së dhe grupeve të interesit, ekspertëve apo edhe shoqatave në sektorin e shëndetësisë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

MESAZHI I KLSH-SË

PËR

DITËN BOTËRORE TË POPULLSISË

11 Korriku është shpallur nga Kombet e Bashkuara si Dita Botërore e Popullsisë.

Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin për:

- Çështjet që lidhen me rritjen e popullsisë.
- Ndikimin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm, shëndetësinë dhe mirëqenien.
- Nevojën për politika publike që i përgjigjen nevojave të gjithë qytetarëve.

Në kuadër të Ditës Botërore të Popullsisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit thekson rëndësinë e qeverisjes së mirë dhe transparencës në shërbim të qytetarëve. KLSH, nëpërmjet auditimit publik siguron që fondet dhe politikat e hartuara për mirëqenien e popullsisë të ofrojnë shërbim cilësor në disa fusha:

SHËNDETËSI

ARSIM

MBROJTJE SOCIALE

MJEDIS

INFRASTRUKTURË

Në Ditën Botërore të Popullsisë, kujtojmë se çdo qytetar është në zemër të politikave publike, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies së një shoqërie. Në këtë kuadër, Kontrolli i Lartë i Shtetit riafirmon misionin e tij në shërbim të qytetarëve, përmes auditimit të pavarur dhe profesional të fondeve publike dhe pasurive shtetërore.

“ Në një botë me sfida demografike gjithnjë në rritje, mbrojtja e interesit publik, e mjedisit dhe e brezave të ardhshëm është detyrim i përbashkët. KLSH mbetet një partner i rëndësishëm për institucionet dhe qytetarët, në rrugën drejt një administrate më të ndershme dhe një shteti më të drejtë. ”

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH



<div style="display: flex; flex-direction: column; gap: 10px;"> <div style="display: flex; align-items: center;"> www.klsh.org.al </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al </div> </div>	<div style="display: flex; flex-direction: column; gap: 10px;"> <div style="display: flex; align-items: center;"> Kontrolli i Lartë i Shtetit </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> klsh_org_al </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution </div> </div>
<div style="display: flex; align-items: center;"> Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë </div>	<div style="display: flex; align-items: center;"> Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00 </div>





**SHTATOR
2025**

BOTIMI
—
NR.





Buletini mujor

Shtator 2025



Nga takimi i zhvilluar në KLSH me delegacionin e Komitetit për Kontrollin Buxhetor të Parlamentit European

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu pret në takim eurodeputetët e Komitetit për Kontrollin Buxhetor të Parlamentit European

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, në datë 17.09.2025, priti në takim një delegacion nga Komiteti për Kontrollin Buxhetor të Parlamentit European.

Takimi u zhvillua në kuadër të misionit që Komiteti për Kontrollin Buxhetor, i udhëhequr nga Kryetari Niclas Herbst, zhvilloi në Malin e Zi dhe në Shqipëri nga data 16 deri më 18 shtator 2025.

Gjatë takimit të zhvilluar në KLSH me eurodeputetët për kontrollin buxhetor u diskutua rëndësia e institucioneve të pavarura të auditimit të jashtëm, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e fondeve të ofruara nga Bashkimi European në fusha të ndryshme të ekonomisë. Në mënyrë të veçantë u theksua rëndësia dhe vlerësimi për bashkëpunimin që KLSH ka me institucionet e tjera në kuadër të arritjes së objektivave të përbashkëta.

Cjithashtu, përfaqësuesit e Komitetit të Kontrollit Buxhetor vlerësuan punën audituese të KLSH-së në mbikëqyrjen e përdorimit të drejtë të fondeve buxhetore dhe atyre evropiane, si faktor me rëndësi të veçantë në hapat drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin European. Eurodeputetët theksuan rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Gjatë misionit në Shqipëri dhe Malin e Zi, eurodeputetët vlerësuan ngritjen dhe funksionimin fillestar të mekanizmeve të rinj të kontrollit dhe auditimit të krijuar në kuadër të "Mekanizmit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (RFG)", i cili synon të garantojë menaxhimin e shëndoshë financiar të fondeve të BE-së.

Kryetari i Delegacionit, Niclas Herbst u shpreh:

Gjatë misioneve në Malin e Zi dhe Shqipëri, ne vlerësuam nëse ekzistojnë themelet për menaxhim të shëndoshë financiar, auditim të pavarur dhe një qasje me tolerancë zero ndaj mashtrimit dhe korrupsionit. Mali i Zi mbetet pararendës, megjithatë, të dy vendet kanë përparuar me përafrimin e kornizave të tyre ligjore dhe institucionale me standardet e BE-së, veçanërisht në shtetin e së drejtës, luftën kundër krimit të organizuar, rikuperimin dhe konfiskimin e aseteve, si dhe luftën kundër pastrimit të parave.

Diskutimet me Ministritë e Financave dhe koordinatorët e "Mekanizmit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor-RGF" konfirmuan se mekanizmat për kontrollin e brendshëm dhe auditimin janë krijuar dhe funksionojnë. Megjithatë, mbeten shqetësime serioze se si do të përdoren fondet e RGF-së.



Auditimi “Ndotja në Liqenin Artificial të Tiranës”



Pikat problematike të identifikuar nga grupi i auditimit gjatë verifikimit në terren.



Foto nga verifikimi në terren i grupit të auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) kreu auditimin tematik të përputhshmërisë në Bashkinë Tiranë, institucionet e saj të varësisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës. Ky auditim tematik u iniciua mbi shqetësimin publik për ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës, në të cilin janë zhvilluar disa algë me ngjyrë të gjelbër dhe të verdhë, duke mbuluar sipërfaqe të konsiderueshme dhe që emetojnë në ajër një aromë të pakëndshme dhe shqetësuese për qytetarët që frekuentojnë Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës (PMLAT).

Auditimi kishte si objekt vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse për problematikën e evidentuar mbi ndotjen ujore dhe dëmtimin e botës së gjallë, në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe mbuloi periudhën e viteve 2021-2024.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultuan mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, si në fazën e parandalimit, ashtu edhe në fazën e monitorimit dhe marrjes së masave për shmangien e ndotjes mjedisore.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë si më poshtë:

- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit është përcaktuar për t'u monitoruar për çdo vit Liqeni Artificial i Tiranës. Në këtë program përcaktohen gjithashtu treguesit që duhen analizuar gjatë këtyre monitorimeve (përfshirë treguesit fiziko-kimikë, mikrobiologjikë, pesticidet, metalet e rënda etj.) si dhe frekuenca përkatëse. Nga auditimi u konstatua se, jo vetëm për periudhën objekt auditimi (2021-2024), por edhe përtej kësaj periudhe (minimalisht që nga viti 2015), AKM nuk ka realizuar asnjëherë monitorime vjetore për Liqenin Artificial të Tiranës.
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (APR), pavarësisht se ka evidentuar dhe faktuar edhe nga rezultatet e analizave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, se në liqen shkarkohen ujëra të ndotura urbane të patrajtuara (që në muajin tetor 2024), përveç korrespondencave shkresore, nuk ka marrë asnjë masë konkrete për evidentimin e shkaktarëve të ndotjes si dhe zgjidhjen e problematikës.
- Nga verifikimi i kryer në terren nga grupi i auditimit u evidentuan se përpos 7 pikave që janë identifikuar nga APR dhe marrë mostra për analizë nga AKM, ka dhe 3 pika të tjera të kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen, të cilat ishin të dëmtuara, të bllokuara ose që kishin derdhje të ujërave të përdorura. Për këto pika nuk rezultoi të jenë marrë mostra dhe të jenë kryer inspektime. Për sa më sipër, pavarësisht se kemi pasur të bëjmë me një situatë kritike mjedisore, inspektimi i kryer nga ARM Tirana nuk ka qenë i plotë, si dhe nga ana e institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për identifikimin e ndotësve, për të vlerësuar nëse ka edhe subjekte që dispojnë leje mjedisore, për të vijuar më tej me marrjen e masave për eliminimin e shkarkimeve të ujërave të patrajtuar/ të ndotur (urbane/ industriale etj.) drejtpërdrejt në liqen.



Peshqit në sipërfaqe. Foto nga verifikimi në terren i grupit të auditimit.



- Referuar të dhënave të vëna në dispozicion, zona brenda Parkut të Madh të Liqenit Artificial nuk mbulohet nga rrjetet kanalizimesh për ujërat e ndotura urbane. Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë nuk kanë asnjë informacion, si dhe nuk kanë kryer asnjë verifikim në terren, mbi metodat e trajtimit individual të ujërave të ndotura nga subjektet që operojnë brenda territorit të Parkut të Liqenit.
- Institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë (APR, UKT Sh.a. etj.) nuk kanë informacion mbi vendndodhjen apo menaxhimin/pastrimin e gropave septike të subjekteve që ndodhen në territorin e Parkut të Liqenit, në mospërputhje me funksionet e bashkisë, të përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka një strukturë në Drejtorinë e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial, për të garantuar përmbushjen e funksioneve kontrolluese, inspektuese, evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme. Si pasojë, nuk është evidentuar asnjë problematikë mjedisore ndër vite mbi shkaqet e mundshme të ndotjes së ujit të liqenit dhe nuk është kërkuar asnjëherë kryerja e analizave specifike për të evidentuar problematika përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike.


Auditimi “Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike E-Taxation”

Vitet e fundit, në Shqipëri kanë ndodhur disa sulme kibernetike që kanë vënë në dukje dobësitë e sistemeve të sigurisë kibernetike dhe kanë shtuar nevojën për masa më të forta mbrojtëse. Sistemet e menaxhimit të të ardhurave dhe financave publike, si sistemi E-Taxation janë shënjestra të mundshme për sulme kibernetike, duke synuar destabilizimin e administratës fiskale, vjedhjen e të dhënave financiare apo manipulimin e transaksioneve.

Duke qenë pjesë e një tregu global digjital, Shqipëria ka pasur të njëjtat sfida si shumë vende të tjera për të siguruar që infrastrukturën e saj kritike të mbrohet nga rreziqet kibernetike. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe standardeve të sigurisë që mbrojnë këto sisteme nga sulmet e mundshme. Në këtë kuadër, administrata tatimore në Shqipëri dhe sistemi E-Taxation kërkojnë masa të forta mbrojtëse, për të siguruar që qytetarët dhe bizneset të kenë besim në sigurinë e të dhënave të tyre financiare. Sulmet kibernetike në sektorin e tatimeve mund të shkaktojnë humbje të mëdha financiare, të dëmtojnë stabilitetin e tregut dhe të ulin besimin në institucionet shtetërore, duke prekur drejtpërdrejt mirëqenien e shoqërisë dhe të ekonomisë së vendit. Nisur nga kjo situatë, Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin e performancës me temë “*Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike E-Taxation*”.

Auditimi ka pasur si objekt kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse, si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) mbi funksionimin dhe sigurinë kibernetike të sistemit elektronik të tatimeve E-Taxation.

Shpërndarja e incidenteve gjatë periudhës 2023-2024



Auditimi i sigurisë kibernetike për infrastrukturën kritike E-Taxation evidenti disa çështje kryesore që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator, ndarjen e përgjegjësiwe institucionale dhe zbatimin e masave të sigurisë, rritjes së koordinimit të bashkëpunimit organizativ dhe teknik ndërmjet institucioneve DPT, AKSHI dhe AKSK, si dhe rritjes së kapaciteteve teknike dhe njerëzore të reagimit ndaj incidenteve.

Nga auditimi rezultoi se në periudhën 2023-2024, për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë identifikuar 21 incidente, ku përsëriten raste të ekspozimit të kredencialeve dhe rivendosjeve të paautorizuara, çfarë tregon për mangësi në zbatimin e politikave të fjalëkalimeve. Megjithatë incidentet janë adresuar në kohë dhe nuk kanë shkakuar pasoja me impakt të lartë, ekziston një rrezik i vazhdueshëm për komprometimin e integritetit të sistemit dhe sigurisë së të dhënave, veçanërisht nëse nuk merren masa parandaluese dhe përmirësuese të qëndrueshme.

Ekspozimi dhe keqpërdorimi i kredencialeve

Incidentet tregojnë se kredencialet e privileguara dhe standarde të përdoruesve janë ekspozuar ose keqpërdorur, duke çuar në shkelje të mundshme të sigurisë. Rastet që përfshijnë përdorimin e kredencialeve të administratorit në kontekste të paautorizuara dhe rrjedhje individuale të kredencialeve sugjerojnë se kontrollet e aksesit mund të mos zbatohen siç duhet, duke i bërë sistemet kritike të prekshme. Kur kredencialet ekspozohen, sulmuesit mund t'i shfrytëzojnë ato për të fituar akses të paautorizuar, për të përshkallëzuar privilegjet ose për të nisur sulme të mëtejshme kibernetike. Këto tregojnë mungesë të mekanizmave të sigurtë të vërtetimit dhe monitorim të pamjaftueshëm të aktivitetit të kredencialeve, duke rritur rrezikun e kërcënimeve të brendshme dhe shkeljeve të jashtme.

Rrjedhja e të dhënave

Janë identifikuar raste të rrjedhjeve të të dhënave, të cilat paraqesin rreziqe serioze për konfidencialitetin dhe përputhshmërinë rregullatore. Ekspozimi i të dhënave, qoftë përmes eksfiltrimit të qëllimshëm apo rrjedhjeve të paqëllimshme, mund të ketë pasoja të rënda. Këto incidente nxjerrin në pah boshllëqet e mundshme në kontrollet e aksesit të të dhënave dhe monitorimin e pamjaftueshëm të rrjedhjeve të informacionit, duke lejuar përdoruesit e paautorizuar të marrin dhe të shpërndajnë të dhëna. Prania e incidenteve brenda kësaj kategorie tregon një dobësi sistematike në zbatimin e politikave të sigurisë rreth mbrojtjes së të dhënave.

Mesazhi i auditimit:

Megjithatë janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë kibernetike në Shqipëri, auditimi vuri në dukje nevojën e menjëhershme për forcimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor e rregullator, në veçanti përsa i përket zbatimit të masave të sigurisë në infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Mospërputhjet ligjore, mungesa e trajnimeve dhe e dokumentacionit për përdoruesit fundorë, si dhe boshllëqet në burimet njerëzore të specializuara, si në Drejtorinë e Monitorimit dhe Mbrojtjes Kibernetike, ashtu edhe në Sektorin e Sigurisë së të Dhënave, rrisin ndjeshëm ekspozimin ndaj risqeve kibernetike dhe kufizojnë kapacitetin reagues ndaj incidenteve.


Në aspektin teknik, auditimi identifikoi mungesë dokumentacioni dhe kontrolle të pamjaftueshme mjedisore në rast përmbajtjes apo zjarresh në Data Center-in qeveritar. Po ashtu, në sistemin E-Taxation të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, mungesa e politikave të enkriptimit të të dhënave, shqyrtimi jo i rregullt i log-eve dhe mungesa e kontrolleve për aksesin e jashtëm e palët e treta, paraqesin një kërcënim për sigurinë e informacionit, duke e lënë sistemin të ekspozuar ndaj aksesit të paautorizuar dhe ngjarjeve të paidentifikuara në kohë.

BASHKËPUNIMI ME SAI HOMOLOGE

KLSH, pjesë e auditimit paralel që po zhvillohet në 11 shtete për “Plakjen e Popullsisë”

Në datat 9-11 shtator 2025 u zhvillua në Shkup konferenca ndërkombëtare mbi auditimin paralel me temë “Plakja e Popullsisë”, nën organizimin e koordinatorit të kësaj iniciative, SAI-t të Izraelit, i cili mban dhe Presidencën e Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Në këtë auditim paralel marrin pjesë 11 institucione supreme auditimit nga: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Austria, Lituania, Malta, Paraguaji, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Republika Çeke dhe Izraeli.

Aktiviteti nisi me fjalën e mirëseardhjes së Auditorit të Përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski, i cili vlerësoi rëndësinë e konferencës për zhvillimin e diskutimeve dhe shkëmbimin e përvojave nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në auditimin paralel “Plakja e Popullsisë”.



Presidenti i EUROSA-it, drejtuesi i SAI-t të Izraelit, z. Matanyahu Engelman, përshëndeti pjesëmarrësit përmes një videosazhi, duke theksuar bashkëpunimin e suksesshëm ndërkombëtar në zbatimin e auditimit paralel. Në fjalën e tij, Presidenti i EUROSAI-t, z. Matanyahu Engelman u shpreh: “Le të mos harrojmë, pas auditimeve ka njerëz. Prindërit tanë. Gjyshërit tanë. Fajinjtë tanë. Vetja jonë, vetëm pak vite nga tani.”



Punimet e konferencës vijuan me prezantimin mbi aspektet demografike dhe tendencat në Maqedoninë e Veriut, por dhe të dhëna nga shtetet pjesëmarrëse. Më tej u diskutua mbi gjetjet paraprake të auditimit në disa fusha, si: planet qeveritare dhe aspektet buxhetore, mirëqenia dhe cilësia e jetës pas pensionit; përgatitja e sistemit të pensioneve; shërbimet komunitare për të moshuarit.

KLSH mbajti prezantimin mbi ecurinë e auditimit të performancës me temë “Planet gjithëpërfshirëse dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”.

Aktiviteti paraqiti një mundësi të shkëlqyer për shkëmbimin e njohurive, praktikave të mira dhe bashkëpunimin ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë të EUROSAI-t, në drejtim të mbështetjes së vendimmarrësve për t'u përballur me sfidat e plakjes së popullsisë.

KLSH organizon takim të dytë të punës mbi “Sigurinë Kibernetike”, në bashkëpunim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN)

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN), në datat 15-19 shtator 2025 u zhvillua në Vlorë workshopi II mbi “Sigurinë Kibernetike” me temë “Hakerimi Etik”. Me ftesë të KLSH-së, ekipit të ekspertëve norvegjezë dhe grupit të KLSH-së, u janë bashkuar edhe përfaqësues nga SAI të tjerë homologe, si nga TCA e Turqisë, ZKA e Kosovës, SAI i Sllovenisë, SAI i Suedisë dhe SAO e Maqedonisë së Veriut.

Me rritjen e shpejtë të dixhitalizimit, institucionet publike janë gjithnjë e më të ekspozuara ndaj sulmeve kibernetike, ndaj fokusi i këtij workshopi ishte testi i sigurisë që zhvillohet në mjediset e “Active Directory” dhe metodat e mbrojtjes. Audituesit IT duhet të jenë gjithnjë e më të kujdesshëm ndaj këtyre testeve, me qëllim verifikimin e funksionimit të masave të sigurisë në funksion të forcimit të shërbimeve dixhitale të institucioneve dhe rritjes së besimit të qytetarëve.

Gjatë workshop-it u trajtuan hapat teorikë dhe praktikë të fazave të një testi sigurie, si: mbledhja e informacionit, skanimi dhe enumerimi, shfrytëzimi i dobësive, mbajtja e aksesit dhe raportimi e rekomandimet. Gjithashtu, u ofruan sesione teorike mbi konceptet bazë dhe u përfitua përdorimi i mjeteve praktike për testimin e sigurisë në mjediset të simuluar.

Në emër të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, pjesëmarrësve në workshop, ju përcoll një përshëndetje e veçantë, duke theksuar edhe një herë, rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në zhvillimin e mëtejshëm teknologjik dhe ngritjen e kapaciteteve të duhura, me qëllim përfundimin dhe ndarjen e praktikave më të mira në këtë fushë.



BOTOHET LIBRI KONFERENCA SHKENCORE



“Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikat e mjedisit - Një perspektivë e auditimit të jashtëm”

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka botuar librin Konferenca Shkencore - “Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikat e mjedisit - Një perspektivë e auditimit të jashtëm”.

Botimi i librit vjen pas Konferencës së organizuar nga KLSH më 6 dhe 7 maj 2025 në Tiranë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucione supreme të auditimit nga rajoni dhe më gjerë, si dhe ekspertë ndërkombëtarë, akademikë dhe profesionistë të fushës. Ajo shërbeu si një platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira, për reflektim të përbashkët dhe për thellim të bashkëpunimit profesional. Në konferencë u prezantuan një sërë punimesh të nivelit të lartë, që trajtojnë tema kyçe, si: menaxhimi i cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare, digjitalizimi në auditim, kapacitetet institucionale dhe auditimet me ndikim, etj. “Ky botim përmbledh frytet e kësaj konference dhe përfaqëson një kontribut të vyer në literaturën profesionale të auditimit publik, duke u shndërruar kështu në një dëshmi konkrete të përkushtimit tonë për të çuar përpara misionin e institucionit jo vetëm përmes auditimit, por edhe përmes vizionit, mendimit kritik dhe udhëheqjes së reformave”, shprehet në fjalën hyrëse të librit, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu.

Libri është përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, me mbështetjen dhe nën kujdesin e Kryetarit të KLSH-së, Dr. Arben Shehu.

Tema e konferencës “Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikat e mjedisit - Një perspektivë e auditimit të jashtëm” erdhi si një përgjigje ndaj sfidave të reja që lidhen me transformimin teknologjik, krizën klimatike, dinamikat sociale dhe nevojën për transparencë e llogaridhënie më të thelluar në qeverisjen publike.

“Në këtë jubile të një shekulli pune dhe kontributi në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, ne nuk festojmë vetëm të shkuarën. Ne angazhohemi për të ardhmen, për një Kontroll të Lartë të Shtetit më inovator, më fleksibël, më pranë qytetarit dhe më të integruar në rrjetin global të institucioneve supreme të auditimit”, thekson në fjalën e tij në hyrje të librit z. Shehu.

Libri i Konferencës Shkencore gjendet i publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së dhe mund të aksesohet online nga çdo i interesuar.



KLSH merr pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasadori i Arabisë Saudite për kremtimin e Ditës Kombëtare të Mbretërisë



Më 18 shtator 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasadori i Arabisë Saudite në Shqipëri, Shkëlqesia e Tij, z. Faisal Ghazi Hifzi, me rastin e kremtimit të Ditës Kombëtare të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Ky event mblodhi personalitete të shquara nga fusha e diplomacisë dhe institucioneve shtetërore.

Përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në emër të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, i shprehën Ambasadorit urimet për këtë ngjarje të rëndësishme, si dhe vlerësimin për marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunuese midis Shqipërisë dhe Arabisë Saudite. Ata theksuan rëndësinë e forcimit të lidhjeve ndërkombëtare, duke përfshirë ndihmën e bashkëpunimit të vazhdueshëm në fushat e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Ky aktivitet shërbeu si një mundësi për të forcuar më tej marrëdhëniet diplomatike dhe miqësore mes dy vendeve, ndërsa KLSH vijon të angazhohet për promovimin e standardeve të larta të auditimit në nivel ndërkombëtar.



Bota e auditimit mblidhet në Egjipt, mbahet në tetor Kongresi XXV i INTOSAIT

Nga data 27 deri më 31 tetor 2025 do të mbahet në Sharm El-Sheikh, Egjipt, një nga ngjarjet më të rëndësishme të botës së auditimit të jashtëm publik, Kongresi XXV i INTOSAI-t.

Kongresi bën bashkë institucione supreme të auditimit nga e gjithë bota për të diskutuar dhe marrë vendime të rëndësishme mbi auditimin. Fokusi i Kongresit 2025 do të jenë dy çështje kryesore: "Auditimi i bankave qendore" dhe "Inteligjenca artificiale në auditim".

Autoriteti Shtetëror i Llogaridhënies (*Accountability State Authority - ASA*), si Institucioni Suprem i Auditimit të Republikës Arabe të Egjiptit është SAI pritisë XXV INCOSAI, në përputhje me miratimin që u bë gjatë XXIV INCOSAI të mbajtur në Rio de Janeiro-Brazil në nëntor 2022.

Objektivat e Kongresit:

Brenda kuadrit të detyrave të përgjithshme të Kongresit, INCOSAI XXV do të shkëmbejë në mënyrë gjithëpërfshirëse ide, njohuri dhe përvoja midis Institucioneve Supreme të Auditimit në fushën e auditimit të aktiviteteve qeveritare dhe bankave qendrore gjatë krizave financiare dhe ekonomike dhe kërkon të eksplorojë përdorimin e teknikave të inteligjencës artificiale në auditim; dy çështje që përbëjnë thelbin e dy temave teknike të INCOSAI XXV.

Në përfundim të aktiviteteve, Kongresi miraton Deklaratën e Sharm El-Sheikh. Deklarata shpreh qartë konsensusin e pjesëmarrësve të Kongresit mbi të gjitha çështjet e propozuara për diskutim dhe rekomandimet e lëna në lidhje me to. Gjithashtu, Deklarata thekson angazhimin e SAI-ve anëtare ndaj parimeve dhe themeleve që konsolidojnë misionin dhe objektivat e INTOSAI-t, si dhe ndaj vlerave të llogaridhënies dhe transparencës në auditim.

Kongresi i INTOSAI-t (INCOSAI) është niveli më i lartë organizativ i anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit në Mbretërinë e Tajlandës kremton 150-vjetorin e themelimit










Kontrulli i Lartë i Shtetit mori pjesë në datat 16 dhe 17 shtator 2025, në webinarin ndërkombëtar "Rojtarët e Përgjegjshmërisë Publike: Kultura e Auditimit dhe Evolucioni Institucional", të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Tajlandës, në kuadër të kremtimit të 150-vjetorit të auditimit publik në Tajlandë. Webinarin shërbeu si një mënyrë për të përkujtuar historinë e gjatë dhe të pasur të institucionit të auditimit publik të Tajlandës, i cili e ka origjinën në vitin 1875, kur Mbreti Chulalongkorn themeloi Zyrën e parë të Auditimit në Pallatin e Madh, duke shënuar një moment kyç në përpjekjet e vendit për t'u modernizuar dhe përafuar me standardet ndërkombëtare. Që atëherë, institucioni i auditimit i Tajlandës ka fituar njohje globale, duke përfshirë role udhëheqëse në organe si ASOSAI dhe INTOSAI.

Ky aktivitet mblodhi ekspertë dhe auditues nga e gjithë bota për të eksploruar evolucionin e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) dhe rëndësinë e tyre kulturore, duke ofruar një mundësi për të reflektuar mbi historinë, sfidat dhe ritjen e këtyre institucioneve. Webinarin synonte të nxiste dialogun mbi dimensionet historike, kulturore dhe etike të auditimit dhe, se si SAI-t janë përshtatur me ndryshimet politike, sociale dhe globale me kalimin e kohës.

Aktiviteti dyditor shërbeu si një platformë për bashkëpunim, duke përforcuar rëndësinë e llogaridhënies publike në qeverisje.

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH


 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00



TETOR
2025

BOTIMI

—
NR.





Buletini mujor

Tetor 2025



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë raportimit në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu prezanton Raportin Vjetor të Veprimtarisë për vitin 2024

Në datë 29.10.2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, prezantoi në mbledhjen e përbashkët të Komisionit Parlamentar për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, Raportin Vjetor të Veprimtarisë për vitin 2024.

Në fjalën e tij, z. Shehu paraqiti përmbledhjen e veprimtarisë së institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2024 dhe evidentoi disa nga gjetjet më të rëndësishme në auditimet e kryera.

"Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit të auditimit të jashtëm publik, ka vijuar me përkushtim ushtrimin e mandatit për auditimin e fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, me qëllim garantimin e llogaridhënies, transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit në sektorin publik. Gjatë vitit 2024, KLSH ka realizuar 159 auditime në të gjitha nivelet e qeverisjes. Për sa i takon fushëbulimit me auditim, në përputhje me mandatin, KLSH i ka kryer këto misione në 205 subjekte. Opinione apo konkluzionet e auditimit janë shoqëruar me 4378 rekomandime, nga të cilat, 2594 masa organizative, 28 përmirësime të kuadrit ligjor, 1059 masa disiplinore/administrative, 184 masa me dëm ekonomik dhe 513 masa për adresimin e parregullive me efekt negativ financiar. Këto masa synojnë jo vetëm korrigjimin e mangësive dhe nxjerrjen e përgjegjësive, por mbi të gjitha parandalimin e përsëritjes së tyre", u shpreh Kryetari i KLSH-së.

Z. Shehu garantoj se Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të mbetet një zë i pavarur dhe i besueshëm, gjithmonë në shërbim të publikut dhe interesit të përgjithshëm, për të kontribuar në forcimin e mekanizmave të qeverisjes së mirë.

Duke u ndalur në fushat e auditimit me ndjeshmëri publike, kreu i KLSH-së bëri të ditur se, përgjatë vitit 2024, janë realizuar 15 auditime performance mbi efektivitetin, ekonomikitetin dhe efikasitetin e institucioneve publike në realizimin e detyrave dhe funksioneve të tyre, në shëndetësi, arsim, kulturë, barazi gjinore, mjedis, dhe shërbimet publike.

"Në tërësi, auditimet e performancës të kryera gjatë vitit 2024 kanë evidentuar se orientimi i institucioneve publike drejt rezultateve dhe matja e ndikimit të programeve apo politikave nuk janë ende të konsoliduara si praktika menaxheriale. Dobësitë në koordinimin ndërinstucional, planifikimin, monitorimin dhe përdorimin e burimeve tregojnë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin e programeve / politikave / strategjive publike, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe në nivelin e besimit të qytetarëve ndaj administratës publike." - tha Kryetari i KLSH-së.

Më pas, z. Shehu dhe stafi i KLSH-së iu përgjigjën pyetjeve të ndryshme të deputetëve, lidhur me gjetjet e auditimeve për kontratat koncesionare në fushën e shëndetësisë, hidrokarbureve, infrastrukturën rrugore, auditimet në pushtetin vendor, zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të pazbatuara etj. Duke vlerësuar kërkesat e paraqitura nga deputetët për auditime specifike, Kryetari i KLSH-së shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me komisionet parlamentare në trajtimin e çështjeve të audituara, zbatimin e rekomandimeve të lëna në institucionet përkatëse, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, në funksion të një administrate më transparente, efikase dhe në shërbim të qytetarëve.

Fjala e Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Veprimtarisë 2024, në Komisionin për Ekonominë dhe Komisionin për Mbikëqyrjen Institucionale

Të nderuar Kryetarë të Komisioneve,
E nderuar znj. Ekonomi,
I nderuar z. Xhafaj,
Të nderuar anëtarë deputetë,

Në përputhje me detyrimin kushtetues e ligjor të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të raportuar periodikisht në Kuvend, më lejoni t'ju falënderoj për mundësinë e paraqitjes së raportit vjetor për vitin 2024. Ky komunikim nuk është thjesht një përmbledhje e veprimtarisë së kryer, por edhe një pasqyrë e gjetjeve kryesore, sfidave të ndeshura dhe mësimëve të nxjerra, të cilat synojnë të forcojnë llogaridhënien, transparencën dhe cilësinë e qeverisjes publike.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në cilësinë e institucionit të auditimit të jashtëm publik, ka vijuar me përkushtim ushtrimin e mandatit për auditimin e fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, me qëllim garantimin e llogaridhënies, transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit në sektorin publik.

Gjatë vitit 2024, KLSH ka realizuar 159 auditime në të gjitha nivelet e qeverisjes - qendrore, pushtetit vendor, institucionet e pavarura dhe në ndërmarrjet shtetërore. Sipas llojit të auditimeve janë kryer: 45 auditime financiare, 43 auditime përputhshmërie, 35 auditime të kombinuara, 15 auditime performance, 8 auditime të teknologjisë së informacionit (IT) dhe 13 auditime mbi zbatimin e rekomandimeve. Për sa i takon fushëmbulimit me auditim, në përputhje me mandatin, KLSH i ka kryer këto misione në 205 subjekte: 97 njësi të enteve publike në nivel qendror, 75 njësi të vetëqeverisjes vendore, 13 institucione të pavarura dhe 20 shoqëri publike ku shteti zotëron mbi 50% të aksioneve.

Në përputhje me misionin e KLSH-së dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, objektivi i çdo auditimi është që, në përfundim, të jepet opinion/konkluzion i përgjithshëm, i shoqëruar me rekomandime relevante për adresimin e problematikave të konstatuara. Nga auditimet e kryera gjatë vitit 2024, janë dhënë 194 opinione/mesazhe/konkluzione auditimi: 80 financiare, 78 përputhshmërie, 15 mesazhe performance, 8 konkluzione IT dhe 13 konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve.


Sa i përket cilësisë së opinionëve, në 29 raste është dhënë opinion i pamodifikuar, pra, pasqyrat financiare kanë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare dhe rezultatin e veprimtarisë, në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit financiar. Në 7 raste, për shkak të mangësisë materiale, thelbësore dhe të përhapura, është dhënë opinion i kundërt. Pjesa tjetër përbëhet nga opinione të kualifikuara, ku pasqyrat financiare paraqesin gabime materiale por jo të përhapura.

Opinionet, apo konkluzionet e auditimit janë shoqëruar me 4,378 rekomandime, nga të cilat, 2,594 masa organizative, 28 përmirësime të kuadrin ligjor, 1,059 masa disiplinore/administrative, 184 masa me dem ekonomik dhe 513 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar. Këto masa synojnë jo vetëm korrigjimin e mangësisë dhe nxjerrjen e përgjegjësive, por mbi të gjitha parandalimin e përsëritjes së tyre. Në përmbushje të detyrimit ligjor, KLSH ka kryer auditime verifikimi të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjatë vitit 2024 u verifikuan 97 auditime të vitit 2023 dhe u konstatua se rreth 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces. Megjithatë niveli i pranueshmërisë është i lartë (99%), për të rritur zbatueshmërinë, KLSH ka vijuar të nxisë institucionet për zbatim të plotë.

Sa i takon gjetjeve kryesore, për të cilat janë formuluar dhe paraqitur rekomandimet përkatëse në raportet përfundimtare të auditimit, të grupuara sipas fushave, ato paraqiten si vijon:

Çështje që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare

U evidentuan problematika që prekin cilësinë e raportimit financiar dhe përputhshmërinë me parimet dhe standardet e kontabilitetit, të tilla si: keqklasifikimi i shpenzimeve dhe të ardhurave (p.sh. shpenzime investimesh të regjistruara si operative, apo njohje e të ardhurave jashtë periudhës); mungesë dokumentacioni mbështetës dhe dobësi të kontroleve të brendshme. U konstatuan mosregjistrime të plota të pasurive dhe mungesë dokumentacioni pronësor, veçanërisht për pasuritë e paluajtshme; mosregjistrim në regjistrat kontabël, mungesë certifikatash pronësie dhe mos amortizim të aseteve. Ka pasur probleme të përsëritura në marrjen në dorëzim dhe klasifikimin e aktiveve, duke rritur riskun e tjetërsimit të pasurive publike.



Në disa raste, mungesa e harmonizimit midis sistemeve të kontabilitetit dhe të dhënave të Thesarit ka krijuar pasiguri në saktësinë e pasqyrave.

Gjithashtu, u konstatua shkelje e parimeve të kontabilitetit në regjistrimin e detyrimeve debitore apo kreditore, pasqyrim në periudha të ndryshme nga lindja e tyre dhe mungesë regjistrash të plotë dhe të përditësuara (p.sh., detyrime ndaj furnitorëve dhe vendime gjyqësore). Në disa bashki mungojnë evidencat për detyrimet e prapambetura, nuk llogariten kamatëvonesat dhe nuk regjistrohen detyrime të njohura me vendim gjykate. Për institucionet me struktura varësie u konstatua mungesë konsolidimi ndërmjet njësjive; shkelje afatesh të dorëzimit të pasqyrave; mungesë rakordimesh ndërvjetore dhe mospërfshirje e të gjitha transakcioneve.

Në përmbledhje, fenomenet e përsëritura në auditimet financiare, të tilla si keqklasifikimi, mosregjistrimi i aseteve, raportimi jashtë afateve dhe mungesa e rakordimeve, diktojnë nevojën për përmirësime të mëtejshme në sistemet e menaxhimit financiar publik.

Çështje që lidhen me përputhshmërinë e aktivitetit të institucioneve publike

Auditimet e përputhshmërisë dhe të kombinuara evidentuan mosrespektim të kuadrin ligjor dhe rregullator në prokurime, raportim fiskal dhe zbatimin e kontratave. U konstatua mungesë disipline buxhetore në të gjitha hallkat: planifikim, miratim, ekzekutim dhe raportim. Ka pasur rialokime fondesh drejt projekteve pa vlerësim të plotë, përdorim joefikas të fondeve dhe mangësi në planifikimin buxhetor (kërkesa jo të plota, kërkesa shtesë mbi tavanet).

Janë shkelur afatet ligjore të regjistrimit të urdhrave të prokurimit, kontratave dhe likuidimit të faturave në SIFQ, fenomen i përhapur sidomos në nivel vendor, por i pranishëm edhe në nivel qendror dhe në shoqëritë publike. Në PPP/koncesione u konstatuan shkelje të kriterëve të financimit, mangësi në monitorim dhe vlerësimin e efekteve afatgjata; u vijua me pagesa për shërbime të pakryera ose të realizuara në vëllime më të ulëta, përfshi raste në shëndetësi me tejkallim buxhetesh dhe likuidim në kundërshtim me përmbajtjen kontraktore, përfshirë TVSH.

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e aktivitetit të institucioneve të administrimit të të ardhurave fiskale, auditimet në fushën doganore evidentuan shkelje në klasifikimin tarifor, vlerësimin doganor dhe llogaritjen e detyrimeve: nga trajtimi i padrejtë i çmimeve të mallrave të importuara dhe përdorimi selektiv i metodës së vlerës së transakcionit, të keqklasifikimi i produkteve dhe shmangia nga pagesa e taksave. Sa i takon rregullshmërisë së kontroleve tatimore, si instrument i monitorimit dhe zbatimit të ligjshmërisë fiskale, u konstatua mosrealizimi i plotë i planit vjetor të kontroleve, si dhe problematika në kontrollin e kryera, veçanërisht në përzgjedhjen mbi bazë risku, dokumentimin e procedurave dhe konkluzioneve përkatëse.

Në nivel vendor u konstatuan mospërputhje midis të ardhurave të raportuara dhe atyre të arkëtuara realisht; mungesë rakordimi me Thesarin dhe regjistrat e pagesave; përdorim i të ardhurave jashtë destinacionit ligjor; menaxhim i pamjaftueshëm i aseteve publike.

Vijon

Në institucionet që administrojnë kolaterale dhe kredi të falimentuara, si në rastin e Agjencisë për Trajtimin e Kredive, u konstatua mungesë dokumentacioni, mosregjistrim i pasurive të konfiskuara dhe pamundësi identifikimi/vlerësimi të tyre; sistemet e të dhënave të paplota dhe mungesë ndjekjeje ligjore ndaj debitorëve.

Në disa auditime të kombinuara janë konstatuar probleme me regjistrimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat janë raportuar në mënyrë të fragmentuar ose të pasaktë në pasqyrat financiare, duke u reflektuar në periudha të mëvonshme dhe duke ndikuar në planifikimin real të buxhetit.

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2024, konstatuan problematika në fushën e prokurimeve, të përhapura në institucione të administratës qendrore dhe vendore, universitete, spitale dhe ndërmarrje publike. Ato lidhen kryesisht me planifikimin joefektiv të prokurimeve, kufizimin e konkurrencës, parregullsitë në hartimin dhe zbatimin e kontratave, si dhe me mungesën e kontrollit të brendshëm. Ndërkohë, janë konstatuar vonesa në zbatimin e kontratave, mungesë aplikimi penalitetesh, pagesa për punime të pakryera apo të realizuara në mënyrë të pa plotë. Strukturat përkatëse përgjegjëse për të kryer mbikëqyrjen teknike dhe administrimin e kontratave shpesh mungojnë në subjektet e audituara ose nuk funksionojnë siç duhet.

Në administrimin e burimeve njerëzore u evidentuan largime të padrejta nga puna, mungesë dokumentacioni mbështetës dhe shkelje të Kodit të Punës dhe ligjet specifike të shërbimit civil, duke sjellë kosto shtesë buxhetore. U konstatuan mbivendosje funksionesh dhe mungesë ndarjeje të qartë të përgjegjësisë.

Një tjetër problem sistematik është mungesa e kapaciteteve dhe efektivitetit të njësive të auditimit të brendshëm. Në disa institucione, veçanërisht në nivel vendor, njësia e auditit të brendshëm nuk është funksionale, raportet janë formale ose nuk mbështeten në analiza të riskut. Njësitë e auditimit nuk kanë ushtruar funksionet e tyre të plota gjatë vitit. Në tërësi, auditimet e kombinuara kanë dëshmuar se problemet me përputhshmërinë dhe ato me pasqyrat financiare janë shpesh të ndërthurura dhe ndikojnë ndërsjellas në pasaktësitë në raportim, mungesën e transparencës dhe keq menaxhimin e pasurive, detyrimeve dhe fondeve buxhetore që institucionet kanë në dispozicion. Gjetjet dëshmojnë edhe një herë nevojën e rritjes së kapaciteteve institucionale, forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, rritjes së llogaridhënies dhe vlerësimit të mekanizmave ekzistues të mbikëqyrjes dhe monitorimit.

Sa i takon auditimeve të performancës, gjatë 2024, KLSH realizoi 15 auditime performance mbi efektivitetin, ekonomikitetin dhe efikasitetin e institucioneve publike në realizimin e detyrave dhe funksioneve të tyre, në fusha me ndjeshmëri publike, si: shëndetësi, arsim, kulturë, barazia gjinore, mjedisi, dhe shërbimet publike.

Në fushën e shëndetësisë janë konstatuar problematika në menaxhimin e pajisjeve mjekësore, veçanërisht për shkak të mungesës së inxhinierëve bio-mjekësorë në spitale si QSUNT dhe Spitali i Traumës, duke sjellë varësi nga shërbimet e jashtme, kosto të larta dhe menaxhim të pasigurt të burimeve. Po ashtu, shpërndarja e pajisjeve nuk përputhet me nevojat reale të popullsisë. Përkujdesja për pacientët me probleme të shëndetit mendor mbetet e pamjaftueshme, ku u evidentua mungesa e një qasjeje gjithëpërfshirëse për trajtimin e tyre, ndërkohë që spitalet psikiatrike përballen me mungesa serioze në kapacitetet e akomodimit dhe shërbimeve.

Në fushën e mjedisit, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe spitalore paraqet probleme serioze, sidomos në Bashki si Durrësi dhe Vlora, ku mungesa e infrastrukturës dhe praktikave të sigurta rrezikon shëndetin publik dhe ndot mjedisin. Ndryshimet klimatike mbeten një sfidë madhore, përballë së cilës angazhimi institucional është ende i kufizuar, me mungesë të fondeve, planeve konkrete dhe kapaciteteve për zbatim.

Në fushën sociale dhe të barazisë gjinore, procedurat për birësime janë të ndërlikuara dhe shpesh nuk garantojnë interesin më të lartë të fëmijës. Ndërkohë, gratë në zonat rurale përballen me mungesë të aksesit në shërbime bazë, duke penguar fuqizimin e tyre ekonomik dhe shoqëror.

Në fushën e arsimit dhe kulturës, në menaxhimin e Fondit të Ekselencës, është konstatuar mbivendosje kompetencash ndërmjet institucioneve përgjegjëse, duke sjellë mungesë koordinimi dhe transparence në procesin e administrimit të tij. Gjithashtu, orientimi në karrierë për të rinjtë në sistemin arsimor parauniversitar është një tjetër aspekt ku mungesa e mekanizmave të qëndrueshëm dhe funksionale e ka bërë procesin joefikas.

Në kulturë, pasuritë kulturore shqiptare të listuara në UNESCO, si Berati dhe Gjirokastra, përballen me mungesë planesh menaxhuese dhe fondesh, duke rrezikuar gjendjen e tyre fizike dhe statusin ndërkombëtar.

Në fushën e menaxhimit të hapësirave publike, plazhet publike nuk përmbushin standardet bazë të sigurisë dhe aksesit. Rritja e sipërfaqeve të kontraktuara nuk është reflektuar në të ardhura dhe investime të qëndrueshme, duke kufizuar ndjeshëm përfitimin e qytetarëve nga këto hapësira publike.

Në tërësi, auditimet e performancës të kryera gjatë vitit 2024 kanë evidentuar se orientimi i institucioneve publike drejt rezultateve dhe matja e ndikimit të programeve apo politikave nuk janë ende të konsoliduara si praktika menaxheriale. Dobësitë në koordinimin ndërinstytucional, planifikimin, monitorimin dhe përdorimin e burimeve tregojnë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin e programeve / politikave / strategjive publike, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe në nivelin e besimit të qytetarëve ndaj administratës publike.

Në 8 auditimet e teknologjisë së informacionit me fokus në siguri, funksionalitet, integritet dhe efikasitet të sistemeve publike, u evidentua mungesa e politikave dhe procedurave për menaxhimin e IT-së dhe kontrollit e aksesit; dokumentacioni i pamjaftueshëm për menaxhimin e privilegjeve dhe roleve kritike; mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe trajnimeve në fushën e sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të sistemeve; mungesë e trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe certifikimeve për stafin IT; dobësi në administrimin dhe sigurinë e të dhënave, si dhe në ruajtjen e kopjeve rezervë; mungesë transparence dhe pasiguri në sistemin e administrimit të kundërvajtjeve rrugore e-Cjoba dhe në sistemin e lejeve të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit; mungesë kontrollesh teknike, testimesh dhe dokumentacioni në ndryshimet e kodeve burimore; sisteme që pranojnë të dhëna të pasakta për shkak të mungesës së mekanizmave të kontrollit të inputit (p.sh., sistemi i ndihmës ekonomike, sistemi i lejeve minerare); pajisje të amortizuara dhe mungesë investimesh në infrastrukturë, sidomos në institucionet vendore.

Në përmbyllje, gjetjet pasqyrojnë mangësi në infrastrukturën e IT-së që cenojnë qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e shërbimeve publike dixhitale.

Në kuadër të detyrimit ligjor dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë, gjatë vitit 2024, KLSH ka dërguar 13 kallëzime penale, të cilat përfshijnë rastet ku auditimi zbuloi veprime ose mosveprime me shkelje të Ligjit Penal. Përveç kallëzimeve, KLSH ka përcjellë me kërkesë të organeve ligj zbatuese, edhe 35 materiale të tjera informuese për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme.

Një komponent i rëndësishëm i punës së KLSH-së është trajtimi i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave të qytetarëve, organizatave dhe institucioneve të ndryshme, të cilat shqyrtohen me shpejtësi, profesionalizëm dhe seriozitetin e duhur. KLSH i konsideron këto sinjalizime si një burim të vlefshëm informacioni për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me institucionet publike dhe median luan një rol të rëndësishëm në identifikimin e problematikave me interes publik, të cilat më pas vlerësohen si prioritete potenciale për përfshirje në programin e auditimit.

Përveç misionit kryesor të auditimit, gjatë 2024, KLSH ka vijuar me përkushtim zbatimin e funksioneve mbështetëse për forcimin e kapaciteteve, komunikimin me publikun dhe bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, me institucionet e brendshme dhe me organizatat ndërkombëtare të auditimit, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023–2027.

Viti 2024 shënoi një hap tjetër të qëndrueshëm në rrugëtimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si garant i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në administrimin e fondeve publike. KLSH ushtroi veprimtari të gjerë auditimi në të gjitha nivelet e administratës, duke siguruar mbulim gjithëpërfshirës dhe duke konfirmuar rolin e tij si institucion i pavarur në shërbim të interesit publik.

Me përkushtim të palëkundur ndaj misionit, ne vijojmë të rrisim komunikimin me qytetarët nëpërmjet vlerësimit të paanshëm dhe gjyqimit profesional. Në kohë sfidash dhe transformimesh, jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe rolin që luan KLSH në forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe parandalimit.

E ardhmja kërkon angazhim më të madh për të realizuar detyrimet institucionale. Në këtë rrugë, jemi të vendosur për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Me vizion të qartë për të ardhmen, ne do të do të përshpejtojmë procesin e digjitalizimit, do të forcojmë rolin parandalues të auditimeve dhe do të rrisim ndikimin përmes rekomandimeve që shkojnë përtej konstatimeve: duke ofruar zgjidhje, duke nxitur reflektim dhe duke mbështetur reformat.

KLSH mbetet një zë i pavarur dhe i besueshëm, gjithmonë në shërbim të publikut dhe interesit të përgjithshëm. Ne jemi të vendosur për zbatimin e ligjit dhe për të kontribuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe menaxherial, forcimin e mekanizmave të qeverisjes së mirë dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, në funksion të një administrate më transparente, më efikase dhe në shërbim të qytetarëve.

Faleminderit!



Auditimi tematik “Mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale”

KLSH ka ushtruar auditimin tematik “Mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale”, i cili ka përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM).

Nga auditimi është evidentuar se nga institucionet e përfshira në auditim, nuk janë ezauruar në mënyrë të plotë veprimet e ndërmarra në kuadër të sigurimit të disponibilitetit të barnave të përdorura në trajtimin e sëmundjeve tumorale, veçanërisht në kuadër të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjetjet kryesore të konstatuara nga auditimi paraqiten si vijon:

- Nga shqyrtimi i 25 rasteve të miratimit të autorizimit të tregtimit për barnat antitumorale u konstatua se procedura aktuale e parashikuar në nenin 12, të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, është e gjatë dhe joefikase. Vonesat pengojnë reagimin e shpejtë institucional në situata kur kërkohet vendimmarrje urgjente, veçanërisht për barnat antitumorale.
- Nga auditimi rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e protokolleve të praktikës klinike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” datojnë prej vitit 2014, me mungesë përditësimesh sistematike gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar potencialisht negativisht në cilësinë e trajtimit të pacientëve.
- Nga verifikimet e kryera në datë 28.02.2025 në Farmacinë Qendrore dhe në datë 13.03.2025 në Biloqet Farmaceutike, në kuadër të kontrollit të inventarëve fizikë dhe krahasimit me të dhënat në sistem për barnat që përdoren në trajtimin e sëmundjeve tumorale, u konstatua se për barin Doxorubicin 50 mg (2mg/ml) – flakon, ndonëse sasia fizike rezultoi në përputhje me regjistrimet në sistem, data e skadencës e shënuar në sistem nuk përputhej me atë të verifikuar fizikisht për shkak të mosrespektimit të parimit FIFO.
- Nga auditimi i kryer në Sektorin e Kapave në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, u konstatua se ky sektor disponon vetëm pajisje manuale dhe jo pajisje të specializuara dhe të automatizuara për përgatitjen, dozimin dhe përzierjen precize të barnave citostatike. Për më tepër, pajisjet teknike të sektorit nuk janë mirëmbajtur apo kalibruar që nga momenti i futjes së tyre në inventar.
- Nga testimet e kryera mbi barnat e kampionuara: *Erlotinib, Carboplatin, Ifosfamide, Mesna, Trastuzumab Biosimilar ose Origjinator, Trasutuzumab Emtasine, Methotrexate, Daratumumab, Cisplatin, Etoposide, Vincristine Sulphate, Irinotecan Hydrochloride Trihydrate, Gemcitabine, Doxorubicin dhe Cetuximab*, janë evidentuar raste me sasi të shkarkuar më të ulët se sasia e kërkuar nga Shërbimet pranë QSU “Nënë Tereza”. Nga testimet rezultuan receta të dublikuara gjatë ditës, mungesa shënimesh të plota dhe të sakta, shkarkime të gabuara të barnave në pacientë të tjerë, mungesa barnash nisur nga raporti sasi e kërkuar-sasi e shkarkuar, kërkesa të përsëritura dhe të paplotësuara në më shumë se 1 herë për të njëjtin pacient, periudha me gjendje progresive në sistem barnash, ndërkohë që inventari i datës rezultoi zero (diferenca në sasi gjendje progresive – inventar sistemi) etj.
- Nga testimet e kryera mbi barnat e kampionuara: *Erlotinib, Carboplatin, Ifosfamide, Mesna, Trastuzumab Biosimilar ose Origjinator, Trasutuzumab Emtasine, Methotrexate, Daratumumab, Cisplatin, Etoposide, Vincristine Sulphate, Irinotecan Hydrochloride Trihydrate, Gemcitabine dhe Doxorubicin*, janë evidentuar raste të periudhave me gjendje progresive në sistemin elektronik “Pentaho”, ndërkohë që inventari i datës rezultoi zero (diferenca në sasi gjendje progresive – inventar sistemi). Këto diferencë, pavarësisht se janë argumentuar si artificiale nga QSUNT, posedojnë riskun e paraqitjes jo të drejtë të të dhënave për përdoruesit e sistemit. Sa i takon barit Actinomycin D, nga verifikimet në sistem për periudhën 2022-2025, gjendja paraqitet 0 (zero) dhe nuk paraqiten kërkesa për këtë bar. Megjithatë, pavarësisht kësaj, në 5 prej recetave të analizuar në mënyrë analitike ku është kërkuar bari Mesna rezultoi të jetë kërkuar dhe bari Actinomycin D, duke sjellë mospërputhje mes kërkesave analitike dhe sintetike në sistem.
- Evidentohet se 19 flakonë Ifosfamide 1 g dhe 602 flakonë Methotrexate në dy formëdoza: tretësirë për injeksion dhe infuzion x 500 mg (në 10 ml ose 20 ml) me 372 flakonë dhe injeksion dhe infuzion x 50 mg / 2 ml me 230 flakonë, pavarësisht se kanë skaduar rezultojnë ende në sistemin “Pentaho” duke paraqitur risk për mbajtjen e stoqeve të skaduar duke rritur artificialisht gjendjen e barnave në sistem.
- Nga auditimi i masave të marra për sigurimin e barit *Daratumumab 400 mg* (i cili konsiderohet pa zëvendësues), edhe pse u rilidh kontrata e vitit 2025 për barin në sasinë totale 4000 flakonë, sërish janë evidentuar mangësi në planifikim, bashkëpunim dhe përcaktimin e kushteve të kontratës, së bashku me mekanizma të dobët të kontrollit duke ndikuar në periudha të pambuluara me medikamente.



- Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore për blerje mallrash dhe shërbimesh, për programin “Shërbimi i kujdesit spitalor dytësor” bazuar në dokumentacionet e shqyrtuara si dhe korrespondencat zyrtare të vetë institucioneve, buxheti i akorduar për sektorin shëndetësor (përkatesisht për barna) rezultoi në nënfinancuar, çka sjell riskun e mungesës së barnave, e për pasojë, dhe vijimin e terapisë në përputhje me protokollin e trajtimit të sëmundjeve.
- Nga kryqëzimi i të dhënave midis kontratave trepalëshe dhe LBR-së për vitin 2024, u konstatua se për 39 barna antitumorale mungojnë kontratat ndërmjet FSDKSH-së dhe importuesve farmaceutikë. Si rrjedhojë, këto barna nuk janë siguruar për përdorim në sistemin shëndetësor publik.
- Nga Sektori i Inspektimit i AKBPM dhe gjatë periudhës 2022-2024, nuk është kryer asnjë inspektim në farmacitë e rrjetit të mbyllur (spitalore).
- Nga auditimi u konstatua se Laboratori i Kontrollit në AKBPM-së, nuk ka kryer analiza laboratorike për barnat antitumorale të dorëzuara për autorizim tregtimi gjatë viteve 2021, 2023 dhe 2024, përveç 8 analizave të evidentuara në vitin 2023.
- Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Shpërndarjes mbi importin e barnave, rezultoi se nga 253 barna antitumorale të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, 116 prej tyre ose në masën 46%, nuk janë importuar asnjëherë gjatë periudhës së auditimit, janar 2021 – mars 2025.
- Nga auditimi i kryer mbi menaxhimin dhe disponueshmërinë e medikamentit *Actinomycin D 0.5 mg* në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, i cili nuk rezultoi të ketë një kontratë apo autorizim tregtimi, evidentohet mungesa e marrjes së masave për sigurimin e barit Actinomycin D dhe barnave të ngjashëm, e cila pamundëson trajtimin e pacientëve, duke cenuar parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtës për kujdes shëndetësor bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 55.
- Për periudhën objekt auditimi, bari Actinomycin D 0.5 mg është siguruar përmes donacionit. Në kushtet kur për marrjen në dorëzim të barit nuk është evidentuar procesverbal, ka qenë e pamundur të verifikohet fizikisht sasia e mbetur e barit duke qenë se nuk është bërë hyrje në inventar.
- Nga auditimi në lidhje me barin *Pertuzumab + Trastuzumab* në formëdozat 1200 mg + 600 mg – 15 ml dhe 600 mg + 600 mg – 10 ml, evidentohen raste kur gjendja ka qenë 0 për periudha më të gjata se 1 javë, apo paraqitet sasi e ulët e pandryshuar për minimalisht një javë përpara furnizimit, duke evidentuar mungesa të barit apo sasi minimalisht të ulëta të cilat riskojnë trajtimin e pacientëve. Referuar testeve të kryera, edhe në rastin e barit Phego në të dyja formëdozat janë evidentuar raste të recetave të dublikuara dhe të ngatërime mes pacientëve. Gjithashtu, janë evidentuar raste të përdorimit/shkarkimit të barit *Trastuzumab (Herceptin)* në raste kur është kërkuar në recetë *Pertuzumab + Trastuzumab (Phego)*. Rezultoi se nuk ka një përcaktim/ndarje të qartë në protokollin zyrtar të mjekimit të kancerit të gjirit lidhur me shkallën e efektivitetit të njërit bar në krahasim me tjetrin, megjithatë në shkresën nr. 900/7 prot., datë 15.06.2023. dërguar nga PAI Onkologjik drejt Shërbimit Farmaceutik, citohet efektiviteti i këtij bari përkundrejt mjekimeve të tjera.
- Nga auditimi mbi masat e marra nga struktura përgjegjëse të FSDKSH-së, u konstatua se në 49 raste vonesash në furnizimin me barna antitumorale nga importuesit farmaceutikë, të pajustificuara me dokumentacion shoqëruar, Drejtorja e Kontrollit ka ndërmarrë masa vetëm në dy raste. Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike nuk ka zbatuar një mekanizëm të rregullt dhe funksional monitorimi, duke vepruar në mënyrë selektive dhe jashtë një plani të miratuar kontrolli. Për rastet e audituara, penalitetet që duhej të ishin aplikuar janë të një vlere totale prej 49,000,000 lekë për 49 subjekte.

Auditimi i performancës “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin”



KLSH ka realizuar auditimin e performancës me temë “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin”, i cili është ushtruar për periudhën data 01.01.2020 deri më 31.12.2024.

Auditimi “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin” kishte si objektivi kryesor vlerësimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre, lidhur me garantimin e cilësisë së ujit që hidhet në treg për qytetarin. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëpërmjet identifikimit të mangësive, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për të përmirësuar proceset me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Kuadri rregullator, në dhënien e lejeve për ambalazhim bazohet në kriterin sasi shishesh të përpunuara në orë, nuk përfshin përdorimin e autoboteve/boteve apo enë të tjera të cilat nuk konsiderohen ambalazh standard. Në basenet ujore Shkumbin dhe Seman evidentohen katër raste të lejeve të miratuara për ujin nëntokësor për ambalazhim (me bot). Për aplikimet në këto raste janë përdorur formularë për ujin nëntokësor të pijshëm për ambalazhim. Tregtimi i ujit të pijshëm me autobot/bot nuk parashikohet në rregulloren për cilësinë e ujit, e cila përcakton qartë përdorimin tij vetëm në raste emergjencash, ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme. Procesi i tregtimit por edhe transportimit me autobot/bot zhvillohet jashtë mbikëqyrjes së organeve që garantojnë sigurinë shëndetësore dhe atë ushqimore. Kjo, pasi, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSH) nuk kryejnë kontrolle/monitorime në terren për ujin e pijshëm të ambalazhuar nga ana tjetër edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) i kryen inspektimet nëpërmjet një procesi të parapërcaktuar në ambientet e subjekteve tregtare. Në këto kushte, vazhdimësia e këtij lloji aktiviteti paraqet risk për cilësinë e produktit dhe sigurinë e konsumatorit.

Gjatë periudhës 2021-2024, AKU ka trajtuar raste të ujit të pijshëm të ambalazhuar që kanë rezultuar jo konform për tregues mikrobiologjikë ose organo-shqisore, por ndjekja e tyre ka qenë e fragmentuar, jo konsistente dhe me mangësi procedurale. Në vitin 2021 dhe 2022, në dy raste të identikuara, përkatësisht në DRAKU Elbasan dhe Durrës, ndonëse u morën masa për bllokim produkti dhe gjobitje, AKU nuk zhvilloi një analizë gjurmueshmërie për të identifikuar shkakun e ndotjes dhe nuk bashkëpunoi me laboratorin për rianalizim, duke vepruar në mënyrë të pjesshme dhe pa ezauruar të gjitha etapat. Në vitin 2024, në rastin e identifikuar në DRAKU Tiranë, për aromën jo karakteristike në ujë, megjithëse u kryen disa masa në terren dhe u rikthyen sasi të produktit, nuk u ndërmor asnjë analizë e rrisht, nuk u vendosën masa ndëshkuese, dhe nuk u orientua subjekti për veprime korrigjuese. Krahasuar me raste të tjera të trajtuara më rreptësisht, kjo situatë tregon për trajtim të pabarabartë të subjekteve, mungesë transparence dhe dobësi në mekanizmat e kontrollit zyrtar, duke ulur ndjeshëm besimin në mbrojtjen institucionale të konsumatorit.

Laboratorët AKU, NJVKSH dhe ISHP nuk janë të certifikuar/akredituar

Sipas rregullores për ujin e pijshëm, laboratorët që kryejnë analizat duhet të përdorin metoda sipas standardit ndërkombëtar ISO dhe, rrjedhimisht duhet të zotërojnë laboratorë të akredituar. Nga pyetësorët/intervistat e kryera gjatë auditimit, rezultoi se asnjë nga institucionet publike përkatëse që kryejnë analizimin e cilësisë së ujit të pijshëm përfshirë AKU, institucion nën varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, NJVKSH dhe ISHP, nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk zotërojnë aktualisht laboratorë të akredituar për të gjithë parametrat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Sipas të dhënave dhe intervistave të zhvilluara në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, rezultoi se AKU, gjatë periudhës 2020-2024, nuk ka realizuar analiza mikrobiologjike të ujit të pijshëm të ambalazhuar në laboratorët e tij rajonalë. Kjo, pasi, laboratorët e AKU-së nuk kanë kapacitete laboratorike për të kryer analiza mikrobiologjike të ujit të pijshëm të ambalazhuar.

Në rregulloren e ujit të pijshëm dhe urdhrat për ujin mineral parashikohet analizimi i mbetjeve pesticide, disa metale të rënda dhe farmakologjike.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit mbi realizimin e analizave laboratorike për ujin e pijshëm të ambalazhuar, për periudhën 2020-2024, rezultoi se përmbajtja e analizave të kryera është e kufizuar kryesisht në disa tregues kimiko-fizikë bazikë, si: fortësia, bikarbonatet, kalciumi, magnezi dhe lënda e thatë, ndërkohë që Ligji për Ushqimin, VKM-ja në fuqi për ujin e pijshëm dhe urdhrat e posaçëm për ujin mineral, përcaktojnë detyrimin për të analizuar tregues, si: metale të rënda, pesticide, arsenik, fluor, mangan e të tjera. Kjo tregon se analizat aktuale nuk përmbushin standardin e plotë ligjor.

Direktiva evropiane (BE) 2020/2184 përcakton analizimin e rreth 51 treguesve analitik për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar, VKM nr.379/2016 parashikon 48 tregues, urdhrat e ujit mineral përcaktojnë rreth 23 tregues analitikë e ujit të pijshëm të ambalazhuar. Kapacitetet e ISHP-së mbulojnë me analiza 43 nga 51 tregues të kërkuar nga Direktiva (BE) 2020/2184. NJVKSH-të kryejnë analizimin për rreth 13 tregues, kryesisht mikrobiologjik dhe fiziko-kimik, ndërsa AKU kryen analiza për vetëm 9 tregues fiziko-kimikë bazë. Aktualisht, AKU dhe NJVKSH-të nuk disponojnë kapacitetet e nevojshme laboratorike për të kryer analizat për metale të rënda dhe pesticide. Evidentohet se, kapacitetet e ISHP nuk janë shfrytëzuar nga institucionet të cilat kanë pasur mungesë kapacitetesh për mbikëqyrjen e plotë laboratorike të cilësisë së ujit të ambalazhuar. Ky institucion ka kryer një numër të konsiderueshëm analizash për mostra uji me kërkesë të vetë subjekteve dhe, në pak raste, të adresuara prej institucioneve shtetërore, AKU apo NJVKSH-të.

Mesazhi i auditimit

Pyetja kryesore: A siguron sistemi i ngritur cilësinë e ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin ?

Sistemi i ngritur nuk ka arritur të garantojë qytetarin për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg. Megjithëse konsumi i këtij produkti ka pësuar rritje të vazhdueshme çdo vit, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sa i përket kontrollit, monitorimit e analizimit të tij. Ndryshimet e kompetencave në strukturat shtetërore kanë krijuar paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kanë ndikuar në funksionimin e fragmentuar të sistemit. Kuadri ligjor e rregullator paraqitet i paharmonizuar dhe në disa raste kontradiktore, nuk mundëson konkurrencë mes projekteve për përdorimin e burimit ujor dhe ka kriterë të dobëta për dhënien e lejeve dhe licencave. Nga ana tjetër, mangësitë e institucioneve në drejtim të analizimeve laboratorike, bashkëveprimeve ndër-institucionale si dhe informimit të publikut, nuk kanë garantuar cilësinë e ujit të ambalazhuar dhe sigurinë e nevojshme për qytetarin.

Kryetari i KLSH-së zhvillon një takim me përfaqësues të Njesisë Speciale Antikorrupsion të Guardia di Finanza

Në datë 29.10.2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, zhvilloi një takim me Gjeneralin B. Giovanni Salerno, Komandant i Njesisë Speciale Antikorrupsion të Guardia di Finanza dhe përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë në administratën publike, si dhe Kolonelin Giampiero Carrieri, ekspert i Guardia di Finanza për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi, pranë Ambasadës së Italisë në Tiranë.

Gjatë takimit, z. Shehu shprehu falënderimet për vizitën dhe gjithashtu theksoi vlerësimin e tij maksimal për institucionet italiane dhe mbështetjen që ato i kanë ofruar institucioneve shqiptare. Në veçanti, ai theksoi vlerën e shtuar të bashkëpunimit ndërmjet Guardia di Finanza dhe KLSH-së.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Guardia di Finanza, vlerësuan punën që po zhvillon KLSH në drejtim të evidentimit të parregullsive në administrimin e menaxhimin e buxhetit të shtetit, në veçanti në fushën e prokurimeve publike dhe dëmit ekonomik, si dhe shprehën dëshirën që marrëdhëniet tashmë shumë të mira të bashkëpunimit, të mund të përparojnë gjithnjë e më tepër.

Institucionalisht u shpreh gatishmëria për të organizuar e zhvilluar aktivitete të ndërsjella, me qëllim shkëmbimin e metodologjive dhe eksperiencave më të mira midis Guardia di Finanza dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke theksuar edhe një herë vlerësimet e tij për këtë njësi speciale antikorrupsion në fushën e parandalimit të këtij fenomeni, në veçanti në kontekstin e prokurimit publik, z. Shehu shprehu vullnetin dhe angazhimin e plotë për të vijuar këtë iniciativë të përbashkët duke përfutur nga ekspertiza më e mirë italiane në fushat me interes të veçantë.



Konferenca “Integriteti, Transparenca dhe Inovacioni në Prokurimin Publik”, KLSH ndan përvojën në fushën e prokurimeve publike

Më 24 tetor 2025 u mbajt në Leçe, Itali, konferenca ndërkombëtare me temë “Integriteti, Transparenca dhe Inovacioni në Prokurimin Publik”, ku u paraqit modeli italian dhe një krahasim me sistemin shqiptar”.

Kjo konferencë u zhvillua në kuadër të projektit “A.C.T. – Kundër Korrupsionit në Tendera”, i financuar nga Programi Interreg IPA South Adriatic.

Projekti synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, për parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e transparencës në prokurimet publike, përmes krijimit të mjeteve të përbashkëta, trajnimit të zyrtarëve dhe përhapjes së praktikave të mira administrative dhe ligjore.

Në këtë aktivitet, KLSH u përfaqësua nga audituesit Delor Prosi dhe Klaidi Tefik, të cilët prezantuan materialin me temë “Roli i KLSH-së në forcimin e integritetit dhe mbikëqyrjes në prokurimet publike”. Në referimin e mbajtur, audituesit e KLSH-së dhanë një pasqyrë të aktivitetit institucional të KLSH-së në fushën e prokurimeve publike.

Audituesit referuan se si digjitalizimi i prokurimeve publike nëpërmjet “Sistemit të Prokurimeve Elektronike” ka mundësuar gjenerimin, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave, për të identifikuar elemente risku dhe materialiteti, si dhe “flamuj të kuq”, për t’u konsideruar në planifikimin vjetor të aktivitetit auditues të KLSH-së ose në auditime të tjera specifike.

Më tej, audituesit dhanë një pasqyrë të problematikave kryesore të evidentuara përgjatë auditimit të procedurave të prokurimit publik, duke përfshirë parregullsitë e konstatuara në hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe ndjekjen dhe zbatimin e kontratave.



Ndër të tjera, u theksua bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me institucione të tjera, si: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm etj.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet shfaq edhe njëherë angazhimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për bashkëpunim me organet publike lokale dhe ndërkombëtare, për të promovuar integritetin dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike.

Nisin aktivitetet për planifikimin e Programit të Auditimit 2026, KLSH zhvillon takim me studentë dhe pedagogë në Universitetin “Fan Noli” Korçë

Në kuadër të aktiviteve për planifikimin e “Programit auditues për vitin 2026”, Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi në datë 31.10.2025 një takim të hapur me studentë dhe pedagogë në Universitetin “Fan Noli”, Korçë.

Në takim morën pjesë Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, Sekretari i Përgjithshëm, znj. Valbona Gaxha, auditues nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, rektori i Universitetit, Prof. Dr. Lorenc Ekonomi dhe ish-deputetja Ensemvera Zake.

Takimi kishte në fokus rolin e institucionit më të lartë të auditimit publik në vend, rëndësinë e bashkëpunimit me universitetet, qytetarët dhe transparencën në komunikim me publikun.

Z. Shehu vlerësoi rëndësinë që ka bashkëpunimi me universitetet dhe me qytetarët në përgjithësi. Kryetari i KLSH-së u ndal në raportin e ngushtë që institucioni ka me nevojat dhe problematikat e shoqërisë, duke theksuar se vetëm përmes dialogut të hapur dhe dëgjimit të drejtpërdrejtë të zërit të qytetarëve, mund të rritet efektiviteti i auditimeve publike.

“Ne kemi një detyrim të veçantë institucional që të jemi në një komunikim të vazhdueshëm me qytetarët, me të gjitha njësitë administrative të Shqipërisë, por me Korçën kemi një detyrim tejet të veçantë. Historia e Korçës është e lidhur me themelet e shtetformimit shqiptar, historia e Korçës është e lidhur me shkronjat shqipe, me gjuhën, me kulturën, me sakrificat e të gjithë atyre njerëzve që dhanë gjithçka kishin në jetën e tyre për t’u dhënë një rrugë të denjë shqiptarëve dhe shtetit shqiptar. Kuptohet që detyrimet institucionale janë të ndërlidhura me nevojat dhe problematikat e shoqërisë, dhe marrja më e mirë e dijenisë për të gjitha këto nevoja mund të bëhet nëpërmjet konstatimeve të qytetarëve.” – u shpreh Kryetari i KLSH-së.



Z. Shehu vlerësoi se universiteti është një partner i rëndësishëm në forcimin e transparencës dhe edukimit qytetar.

Në takim u zhvillua bashkëbisedim me studentët dhe pedagogët lidhur me procesin auditues dhe vijimin e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë.

Në fjalën e tij rektori, Prof. Dr. Lorenc Ekonomi përshëndeti takimin, duke vlerësuar bashkëpunimin me KLSH-në, e veçanërisht, nisma të tilla si mjaft të rëndësishme për të rinjtë, të cilët marrin njohuri edhe më të zgjeruara në fushën e kontrollit financiar, kontabilitetit, auditimit etj.

Ky aktivitet është pjesë e planit të takimeve që KLSH zhvillon në vijimësi në universitete të ndryshme publike të vendit me qëllim promovimin e rolit të institucionit dhe forcimin e komunikimit me grupet e interesit.



Drejt inovacionit dhe standardeve të larta në auditimin publik, KLSH përfaqësohet në Kongresin INCOSAI XXV



Kontrulli i Lartë i Shtetit mori pjesë në punimet e Kongresit të 25-të të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), i cili u zhvillua më 27-31 tetor në Sharm El-Sheikh, Egjipt. Kongresi INCOSAI XXV u organizua në një kontekst global të karakterizuar nga transformime të thella, zhvillime të përsheptuara teknologjike dhe sfida ekonomike e financiare me ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e "Agjendës 2030" të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm.

INCOSAI XXV shërbeu si një platformë e rëndësishme për dialog, reflektim, inovacion dhe bashkëpunim ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t. Pjesëmarrësit, mes të cilëve edhe KLSH, bashkuan vizionin dhe angazhimin e tyre për të forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit në përballjen me sfidat e reja globale, duke promovuar profesionalizmin, pavarësinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë. Në përfundim të punimeve, anëtarët e INTOSAI-t miratuan një vizion të përbashkët strategjik që synon rritjen e ndikimit të auditimit publik në zhvillimin e qeverisjes dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek institucionet. U vu theksi mbi nevojën për të ruajtur dhe forcuar pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit, përmes krijimit të një mjedisi ligjor që e njeh dhe e mbrohet këtë pavarësi. Në këtë kuadër u vlerësua nisja e Projektit Global për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), që synon forcimin e besimit në institucionet publike.

Kongresi u përqendrua në dy tema teknike të një rëndësie të veçantë. Tema e parë trajtoi rolin e SAI-ve në auditimin e bankave qendrore gjatë krizave financiare dhe ekonomike. Diskutimet u përqendruan në mënyrën se si auditimi mund të garantojë qëndrueshmëri, transparencë dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e fondeve publike, duke theksuar rëndësinë e përcaktimit të qartë të mandateve ligjore për auditimin e bankave qendrore, forcimin e koordinimit me institucionet e mbikëqyrjes financiare dhe zhvillimin e kornizave të qëndrueshme ndaj krizave.

Tema e dytë kishte në fokus përdorimin e inteligjencës artificiale (AI) në auditim, duke e konsideruar atë si një mjet për të rritur efikasitetin dhe saktësinë e punës audituese, për të përmirësuar cilësinë e gjetjeve dhe për të identifikuar devijimet në mënyrë më të shpejtë.



Pjesëmarrësit theksuan se përdorimi i inteligjencës artificiale duhet të bazohet në parime etike, në një qasje të përgjegjshme dhe nën një kuadër të qartë qeverisës që garanton sigurinë e të dhënave dhe parandalon paragjykimet algoritmike. U evidentua rëndësia e kombinimit të efikasitetit të teknologjisë me përvojën profesionale të audituesit dhe nevoja për zhvillimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë.

Gjatë sesioneve plenare të Kongresit u prezantuan raportet e institucioneve drejtuese dhe komiteteve të përhershme të INTOSAI-t, përfshirë raportin e Presidentit të INTOSAI-t (Egjipt), të Komitetit Mbikëqyrës për Çështje Emergjente (Brazil), të Sekretarit të Përgjithshëm (Austri), të Komitetit për Politika, Financa dhe Administrim PFAC (Arabi Saudite), të Bashkëpunimit të Donatorëve të INTOSAI-t (Arabi Saudite), të Komitetit për Standardet Profesionale (Gjykata Evropiane e Auditorëve), të Komitetit për Ndërtimin e Kapaciteteve (Afrika e Jugut) dhe të Komitetit për Ndarjen e Njohurive (Spanjë). Gjithashtu, prezantuan raportet e tyre edhe organizatat rajonale: AFROSAI, ASOSAI, CAROSAI, OLACEFS, ARABOSAI, EUROSAI dhe PASAI, duke ndarë përvojat dhe arritjet e tyre në kuadër të zbatimit të objektivave të përbashkëta të organizatës.

Në kuadër të procesit zgjedhor të Kongresit, u zgjodhën organet e reja drejtuese të INTOSAI-t, anëtarët e Bordit Drejtues si dhe audituesit e jashtëm të organizatës. Anëtarët e INTOSAI-t miratuan Deklaratën e Sharm El-Sheikh, e cila përcakton angazhimin e përbashkët të komunitetit global të auditimit për të ndërtuar institucione supreme më të forta, më të pavarura dhe më të qëndrueshme, të afta për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes. Deklarata nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, të inovacionit në auditim dhe të përdorimit të teknologjive të avancuara për të forcuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe ndikimin e auditimit publik në zhvillimin e qëndrueshëm.

Ceremonia përmbyllëse e Kongresit u karakterizua nga ndarja e çmimeve ndërkombëtare për kontribute të shquara në fushën e auditimit publik, përfshirë Çmimin e së Ardhmes INTOSAI, Çmimin Elmar B. Staats, Çmimin Kimi Makwetu dhe Çmimin e Udhëheqësve të Rinj të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Në fund të punimeve, u konfirmua se Kongresi XXVI i INCOSAI-t do të zhvillohet në Indonezi, ndërsa Kongresi XXVII do të organizohet nga Mbretëria e Arabisë Saudite.

Përgjatë aktiviteteve të Kongresit, përfaqësuesit e KLSH-së, drejtori i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, znj. Joniada Goçaj, drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Aulent Guri dhe drejtori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Xhesila Nano, zhvilluan një sërë takimesh me përfaqësues të SAI-ve të tjera.

KLSH merr pjesë në takim me Presidentin e Gjykatës së Përgjithshme të Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite

Gjatë aktiviteteve shoqëruese të Kongresit INCOSAI XXV, përfaqësuesit e KLSH-së, përkatësisht, drejtori i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, znj. Joniada Goçaj, drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Aulent Guri dhe drejtori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Xhesila Nano, morën pjesë në takimin e institucioneve përfitues të Fondit Saudit për Përmirësimin e Performancës së SAI-ve (FISP), organizuar nga Gjykata e Përgjithshme e Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI).

Në këtë takim, u prezantuan rezultatet e arritura dhe ndikimi i fondit në rritjen e performancës institucionale. Nga ana e përfaqësuesve të KLSH-së u shpreh vlerësimi për mbështetjen e ofruar përmes këtij fondi, i cili ka kontribuar në përmirësimin e punës së përditshme audituese dhe më tej.

Në fund të sesionit të përgjithshëm, përfaqësuesit e KLSH-së patën një takim të veçantë me Presidentin e Gjykatës së Përgjithshme të Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Dr. Hussam Alangari, ku në emër të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, ata shprehën vlerësimin mbi forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe konkretizimin e bashkëpunimit institucional. Nga ana e z. Alangari u shpreh gatishmëria për vijimin dhe forcimin e këtyre marrëdhënieve përmes kontributit të ndërsjellë.



DEKLARATA E SHARM EL-SHEIKH

Sharm El-Sheikh Declaration

Issued at the Conclusion of the 25th Congress of the International Organization of Supreme Audit Institutions (INTOSAI)
Sharm El-Sheikh, Arab Republic of Egypt | October 27-31, 2025

The members of INTOSAI convened in Sharm El-Sheikh at the XXV INCOSAI, in a global context characterized by drastic transformations and exponentially rapid technological developments, and amid complex financial and economic challenges that cast their repercussions on the United Nations' 2030 Agenda for Sustainable Development. This Congress served as a vital and active platform for dialogue, reflection, innovation and cooperation among the INTOSAI community.

The members of INTOSAI concluded Congress with a unanimous comprehensive general vision that crystallizes their shared will and strategic objectives to confront emerging challenges through professionalism, standard setting, capacity building, knowledge sharing, and maximize the impact of SAIs and the value of INTOSAI by:

- Enhancing the impact of public audit on governance development, and enhancing trust in institutions.
- Promoting innovation in audit practices.
- Promoting inclusiveness and equality, and elevating dialogue and cooperation among INTOSAI members.
- Enhancing professional competence and qualification.
- Emphasizing the core principles of Independence, transparency and accountability.

The members of INTOSAI concluded with recommendations that include:

- (1) Enhancing SAIs' independence.
- (2) Ensuring any mandates regarding central bank audits are appropriate and clearly defined in legislation to support SAIs to audit relevant central bank activities effectively.
- (3) Developing crisis-resilient audit frameworks.
- (4) Strengthening coordination with financial oversight institutions.
- (5) Adopting a proactive approach to anticipating and preventing crises.
- (6) Promoting the efficient application of audits to crisis contexts.

Deklarata e Sharm El-Sheikh përfaqëson angazhimin e përbashkët të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për të forcuar pavarësinë, profesionalizmin dhe ndikimin e auditimit publik në nivel global. Deklarata thekson rëndësinë e inovacionit në auditim, rritjes së kompetencës profesionale dhe përdorimit të teknologjive të avancuara, përfshirë inteligjencën artificiale, në mënyrë etike dhe të përgjegjshme. Ajo gjithashtu nënvizon rolin e SAI-ve në adresimin e krizave financiare dhe ekonomike, promovimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe kontributin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Deklarata përmbledh perspektivat, arritjet dhe rekomandimet më të rëndësishme strategjike INCOSAI XXV, së bashku me përcaktimin e një vizioni që rrit frymën e inovacionit dhe profesionalizmit, si dhe ndikimin global të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Në Deklaratën e Sharm El-Sheikh, anëtarët e INTOSAI-t përfunduan me rekomandime që përfshijnë:

- (1) Rritjen e pavarësisë së SAI-ve.
- (2) Sigurimin që çdo mandat në lidhje me auditimet e bankave qendrore është i përshtatshëm dhe i përcaktuar qartë në legjislacion, për të mbështetur SAI-t, për të audituar në mënyrë efektive aktivitetet përkatëse të bankave qendrore.
- (3) Zhvillimin e kuadrit rimëkëmbës të auditimeve në situatat e krizave.
- (4) Forcimin e koordinimit me institucionet e mbikëqyrjes financiare.
- (5) Miratimin e një qasjeje proaktive për parashikimin dhe parandalimin e krizave.
- (6) Promovimin e auditimeve eficiente në situata krizash.

KONFERENCA RAJONALE

“Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit”



Në kuadër të krenimit të 25-vjetorit të themelimit të institucionit, Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnje dhe Hercegovinës organizoi në datat 8-9 tetor 2025, konferencën rajonale mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit”. Fokusi i aktivitetit ishte shkëmbimi i eksperiencave, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve supreme të auditimit dhe trajtimi i sfidave aktuale në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit në sektorin publik.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga institucione supreme të auditimit të Suedisë, Polonisë, Kroacisë, Turqisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Gjeorgjisë, Malit të Zi, Moldavisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, si dhe përfaqësues nga organizata ndërkombëtare, si SIGMA/OECD. Konferenca kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave mbi zbatimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë në auditim; diskutimin e sfidave dhe praktikave më të mira në sigurimin e cilësisë së punës audituese, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të SAI-ve në përputhje me ISSAI 140, i rishikuar.

Gjatë konferencës, pjesëmarrësit ndanë eksperiencat, opinionet dhe strategjitë e tyre më të mira në implementimin e standardeve për menaxhimin e cilësisë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 140.

Pjesëmarrja e KLSH-së në këtë konferencë shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të njohurive.

WORKSHOP



Vetëvlerësimi i integritetit institucional sipas IntoSAINT

Konrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në workshopin mbi trajnimin e moderatorëve për instrumentin e vetëvlerësimit të integritetit IntoSAINT, i zhvilluar në Bukuresht, Rumania, nga data 7 deri më 10 tetor 2025.

Ky trajnim mbledhi së bashku 22 përfaqësues nga 12 shtete anëtare të EUROSAT-t, ku KLSH u përfaqësua nga znj. Ermira Hoxha, drejtor i Burimeve Njerëzore dhe znj. Xhesila Nano, drejtor i Komunikimit dhe Marrëdhënive me Jashtë, në një program intensiv me fokus të veçantë në forcimin e kapaciteteve për moderimin e vetëvlerësimit të integritetit institucional sipas metodologjisë IntoSAINT.

Aktiviteti u përshëndet nga z. Matanyahu Engلمان, President i EUROSAT-t dhe znj. Mirela Călugăreanu, Presidente e Gjykatës së Llogarive të Rumanisë.








Trajnimi ishte i pari në formatin e përditësuar dhe të digjitalizuar të IntoSAINT dhe u udhëhoq nga tre trajnues me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit të Norvegjisë dhe Hollandës.

Në vijim të trajnimit, pjesëmarrësit do të ndjekin një fazë të mëtejshme të kualifikimit, përmes përvetësimit të platformës “Questback”, e cila është thelbësore për të qenë të certifikuar dhe të aftë për të udhëhequr në mënyrë të pavarur proceset e vetëvlerësimit IntoSAINT.

Si pjesë aktive në iniciativa të tilla ndërkombëtare, KLSH vazhdon të përforcojë angazhimin për të mbështetur etikën dhe integritetin në institucion duke ndjekur praktikat më të mira dhe duke zhvilluar kapacitetet e brendshme për të siguruar zbatimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00



NËNTOR
2025

BOTIMI

—
NR.





Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë raportimit në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu prezanton në Komisionin për Ekonominë “Raportin e zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin 2024”

Më 4 nëntor 2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, paraqiti “Raportin e zbatimit të buxhetit për vitin 2024” në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

Për hartimin e raportit, KLSH është bazuar në auditimet e kryera në Ministrinë e Financave, njësitë e saj të varësisë, përgjegjëse për administrimin e të ardhurave, fondeve speciale, si dhe në rezultatet e auditimeve që i përkasin aktivitetit ekonomiko-financiar të disa njësive shpenzuese për vitin 2024, gjithsej 106 auditime.

Kryetari i KLSH-së veçoi disa nga problematikat e konstatuara në auditimet për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2024, si: tejkalime afatesh ligjore në disa hallka të procesit, ndryshime të shpeshta të buxhetit fillestar përmes akteve normative, ndryshime në prioritetet e përzgjedhjes së projekteve të reja, lidhja e kontratave përtej fondeve në dispozicion, rritja e detyrimeve të borxhit tatimor dhe doganor, mangësi në administrimin e pronës dhe dhënie e saj në përdorim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, buxheti i nënfinancuar për sektorin e shëndetësisë etj.

“Risqet fiskale mbeten të larta, duke qenë se ekspozimi ndaj ndërmarrjeve publike, veçanërisht energjia, është rritur për shkak të detyrimeve të ndërsjella, të pushyera dhe të parakorduara. Ndërkohë, stoku i detyrimeve të prapambetura dhe çështjet gjyqësore kontingjente, po ashtu mbeten në nivele të larta.”

Stoku i detyrimeve, deri në fund të muajit dhjetor 2024, rezulton 7.32 miliardë lekë, nga të cilat, detyrimet e qeverisë qendrore janë rreth 2.66 miliardë lekë, detyrimet e qeverisë vendore janë rreth 3.26 miliardë lekë dhe detyrimet për rimbursimin e tvsh-së janë rreth 1.4 miliardë lekë.

Detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së raportohen në vlerën rreth 18 milionë euro, e cila i takon 10 vendimeve, të cilat janë në tejkalim të afatit 3-mujor dhe rrezikojnë pagesa interesi për likuidim të vonuar. Ndërsa raportimet e Vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit deri në fund të vitit 2024, për detyrimet faktike dhe kontingjente paraqiten në vlerën rreth 180 milionë euro. Sa i takon kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, u konstatuan mospërputhje në plan pagesa dhe raportime, financim i fragmentuar jashtë programeve përkatëse, monitorim i pamjaftueshëm për pagesa për volume të parealizuara dhe mungesë e raportimit vjetor të performancës.”- raportoi Kryetari i KLSH-së.

Z. Shehu theksoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë ushtrimit të mandatit kushtetues dhe ligjor, nëpërmjet rekomandimeve vijon të promovojë bashkëpunimin ndërinstucional dhe miradministrimin e buxhetit të shtetit, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Fjala e Kryetarit të KLSH-së, në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat mbi “Raportin e zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin 2024”

E nderuar Kryetare e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të Komisionit, I nderuar z. Ministër,

Kontrulli i Lartë i Shtetit ka përgatitur raportin “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2024”, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 164 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 9936/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar.

Ky raport është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), si: në Deklaratën e Limës, e cila është udhërrëfyese i auditimit qeveritar, ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, ISSAI 4000 “Standardet e auditimit të përputhshmërisë”, si dhe në parime e standarde të tjera të auditimit të jashtëm të sektorit publik.

Në këtë kuptim, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me paraqitjen në Kuvend të “Raportit për zbatimin e buxhetit 2024”, së bashku me konkluzionin përkatës përmbush detyrimin kushtetues e ligjor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe afatin përkatës.

Raporti i KLSH-së për zbatimin e buxhetit të vitit 2024 ka si objektiv shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit të përgatitur nga Ministria e Financave “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2024” dhe të raportit mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe mbi borxhin publik.

Kontrulli i Lartë i Shtetit ka kryer auditime në Ministrinë përgjegjëse për Financat, njësitë e saj të varësisë, përgjegjëse për administrimin e të ardhurave, njësitë përgjegjëse për administrimin e fondeve speciale, si dhe në rezultatet e auditimeve individuale që i përkasin aktivitetit ekonomiko-financiar të disa njësive shpenzuese për vitin 2024, gjithsej 106 auditime. Për hartimin e raportit kanë shërbyer rezultatet e auditimeve për çështje të të ardhurave, shpenzimeve, deficitit buxhetor dhe financimit të tij, detyrimeve të prapambetura dhe atyre kontingjente, çështjet e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, miradministrimit të fondeve publike, duke përfshirë dhe fondin rezervë dhe kontigjencën, borxhin publik, kontrollin e brendshëm financiar publik, auditimin e brendshëm, si dhe çështje të lidhura me kontabilitetin, menaxhimin e financave publike etj.

Bazuar në rezultatet e këtyre auditimeve, shkallën e materialitetit dhe përhapjes së tyre, mbi zbatimin e Buxhetit për vitin 2024, janë veçuar problematikat e konstatuara si më poshtë:

• Në fazën e planifikimit të dokumenteve të PBA 2024–2026 dhe projektbuxhetit 2024, u konstatuan tejkalime afatesh ligjore në disa hallka të procesit, dokumentacion jo i përditësuar dhe kërkesa buxhetore mbi tavanet e përcaktuara, pa një analizë të unifikuar të prioriteteve dhe veçanërisht të shpenzimeve kapitale.

• Vijnë të evidentohen ndryshime të shpeshta të buxhetit fillestar përmes akteve normative, përgjatë gjithë vitit buxhetor, me një përqendrim të lartë në muajin dhjetor, veprime që kanë cenuar cilësinë e planifikimit, menaxhimin e likuiditetit dhe disiplinën buxhetore në marrjen dhe regjistrimin e angazhimeve për projekte investimesh.

• Konstatohen ndryshime në prioritetet e përzgjedhjes së projekteve të reja të parashikuara në PBA apo projekte të propozuara rishtas pa kaluar në procesin e planifikimit dhe miratimit të investimeve në këtë dokument, çelje projektsh jashtë rregullit 20/30/30, të shtrira në një periudhë shumëvjeçare.



Këto veprime kanë rritur rrezikun e mos avancimit të projekteve në vazhdim, ku për disa prej tyre është konstatuar se vlera e angazhimit të investimit është shtyrë përtej buxhetit 3-vjeçar të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, me efekt krijimin e detyrimeve të prapambetura të reja.

• Sa i takon monitorimit të buxhetit, konstatohet mungesë në drejtim të rishpërndarjes së fondeve të angazhuara në projekte me realizim të ngadaltë dhe jo sipas planit të pagesave apo me zero realizim drejt projekteve apo sektorëve të tjerë prioritarë të ekonomisë, në nevojë për këto fonde buxhetore apo për pagesa në favor të uljes së stokut të detyrimeve të prapambetura.

• Në 23 raste nga projektet e audituara, autoritetet kontraktore kanë iniciuar procedurat e prokurimit për vlera më të larta se fondet në dispozicion sipas shpërndarjes 3-vjeçare të buxhetit të miratuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50 të ligjit “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”. Në 20 raste nga projektet e audituara, procedura e prokurimit/angazhimit është kryer përtej afatit ligjor 15 tetor, si afati i fundit për ndërmarrjen e angazhimeve të reja në zbatim të nenit 51 të ligjit “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”. Në 19 raste, nga projektet e audituara është konstatuar lidhja e kontratave përtej fondeve në dispozicion, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50 për menaxhimin e sistemit buxhetor.

• Sipas Udhëzimit Standard për Zbatimin e Buxhetit, detajimet/rishikimet e fondeve buxhetore në apo ndërmjet projekteve bëhen të vlefshme dhe prodhojnë efekte për periudhat në vijim vetëm pas regjistrimit në SIFQ. Nga auditimi u konstatuan regjistrime të këtyre rishikimeve me data kontabël retrospektive nga datat e akteve normative me të cilët janë formalizuar këto rishikime. Për më tepër, konstatohen regjistrime për ndryshime të planit buxhetor gjatë muajve dhjetor 2024 deri në shkurt 2025, në të njëjtën kohë apo dhe në tejkalim të afatit të fundit të përcaktuar për kryerjen e shpenzimeve, kjo, jo në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

• Në fushën e të ardhurave, realizimi total paraqitet nën plan, kryesisht për shkak të mosrealizimit të të ardhurave doganore dhe granteve, ndërkohë që në raportimin e tyre vijnë të përfshihen arkëtime për parapagime të palidhura me një detyrim tatimor apo dhe zëra të tjerë jo tatimorë, në saktësinë, krahasueshmërinë dhe analizën e realizimit të treguesve fiskalë. Gjithashtu, në planin e të ardhurave nuk rezultojnë që të jenë marrë në konsideratë efektet nga arkëtime të borxhit tatimor e doganor, të cilat, pavarësisht pagesave të kryera gjatë vitit, respektivisht shfaqin një rritje vjetore prej 7.4 miliardë lekë për borxhin tatimor dhe rreth 1 miliard lekë për borxhin doganor.

• Sa i takon kontributit të njërive të vetëqeverisjes vendore në të ardhura u konstatuan mangësi në administrimin e pronës dhe dhënien e saj në përdorim nëpërmjet kontratave të qirasë, pasaktësi në taksën e ndikimit në infrastrukturë, mosarkëtim i debitorëve për të gjitha kategoritë, familjarëve apo subjekteve dhe mbledhjen e detyrimeve të tjera jotatimore nën administrimin e njërive vendore.

• Fondet speciale shfaqin problematika në lidhje me mosdeklarimin dhe mospagesa të plota apo në kohë të listëpagesave të dorëzuara nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme dhe entet publike, me efekt rritje të stokut të detyrimeve të subjekteve ndaj skemave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku njëkohësisht, administrimi i borxhit në fund të vitit 2024 nuk është shoqëruar me masa të standardizuara për ndjekje dhe ekzekutim.

• Të ardhurat nga kontributet për ISSH, pavarësisht realizimit, nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve qytet dhe fshat, duke rezultuar me deficit të vazhdueshëm, i cili krahasuar me 2023 paraqitet në rënie.

• Nga auditimi mbi debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore është konstatuar një rritje e ndjeshme e tyre, veçanërisht nga sektori privat, duke reflektuar vështirësi në mbledhjen e detyrimeve dhe rrezik për qëndrueshmëri dhe skemës. Janë evidentuar mangësi në bashkëpunimin ndërinstytucional midis ISSH-së dhe DPT-së, probleme në transmetimin e të dhënave dhe mbledhjen e listëpagesave, si dhe mungesë inspektimesh në disa drejtori rajonale.

• Nga auditimi në skemën e pensioneve u konstatuan problematika në lidhje me planifikimin dhe financimin e bonusit të pensioneve, devijimin nga planifikimi për shkak të rishpërndarjes së fondeve dhe zhvendosjen e peshës së shpenzimit nga indeksimi i pensioneve, te bonusi për pensionistët, si dhe përlllogaritja e indeksimit në një nivel më të ulët se viti paraardhës.

• Buxheti i akorduar për sektorin e shëndetësisë rezultoi i nënfinancuar, me vonesa procedurale, kombinuar me parregullsi përgjatë procesit të administrimit të barnave, mbikëqyrjes së furnizimeve, si dhe mungesës së monitorimit nga organet përgjegjëse.

• Nga auditimi i zhvilluar mbi procesin e administrimit dhe kontrollit të Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) për vitin 2024, rezultoi se FSDKSH dhe strukturat e saj zbatuese nuk kanë garantuar një mekanizëm efektiv të mbikëqyrjes dhe monitorimit të zinxhirit të furnizimit dhe qarkullimit të barnave. U evidentuan mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe kontraktuale, përfshirë mosverifikimin e çmimeve të referencës dhe mungesën e kontrollit fizik të faturave, çka ka bërë të pamundur vlerësimin objektiv të përputhshmërisë dhe zbatimit e dispozitave për ndërprerjen e kontratave në rast shkeljesh të përsëritura. Procesi i inventarizimit në depot farmaceutike rezultoi i pasaktë dhe jo i dokumentuar, me mospërputhje ndërmjet të dhënave fizike dhe atyre elektronike në sistemin "e-Depo", si dhe me përdorim të gabuar të kodeve të barnave dhe deklarime të pasakta të gjendjeve, duke rritur rrezikun e pasaktësive dhe mungesës së transparencës. Gjithashtu, mungesa e kontrolleve të rregullta në depot farmaceutike, e penaliteteve për shkeljet kontraktuale dhe e verifikimeve për barnat spitalore të shpërndara në rrjetin e hapur, dëshmon për dobësi të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mungesë të reagimit administrativ ndaj devijimeve të përsëritura.

• Fondi i Kontigjencës dhe Fondi Rezervë nuk janë përdorur plotësisht sipas qëllimeve për të cilat ato krijohen, por për mbulim të shpenzimeve të cilat kanë qenë të parashikueshme.

• Në fazën e zbatimit të buxhetit u konstatuan problematika në regjistrimin e shpenzimeve në sistemin e Thesarit SIFQ, jo në përputhje me rregullat e disiplinës fiskale.

Konkretisht, u konstatuan regjistrime të kontratave përtej afatit ligjor 5-ditor, vonesa përtej afatit ligjor 30-ditor në dorëzimin e faturave në Thesar, kryerje e pagesa pjesore të faturave etj.

Gjithashtu, janë konstatuar klasifikime të gabuara ndërmjet zërave të shpenzimeve korentë dhe atyre për investime si në rastin e projekteve të financuara nga Fondi i Rindërtimit apo të projekteve me financim të huaj.

• Deficitit buxhetor ka qenë i projektuar në një nivel më të lartë dhe është rishikuar në ulje me akte normative për shkak të pritshmërisë në rritjen e të ardhurave dhe pritshmëritë në ulje për disbursimet nga huamarrja e huaj. Ndërkohë, realizimi i deficitit vetëm në muajin dhjetor është kushtëzuar nga përqendrimi i shpenzimeve në këtë muaj, ku janë kryer 21% e totalit vjetor. Gjithashtu, në këtë rezultat kanë ndikuar dhe disa trajtime të paunifikuara kontabël si të ardhura të transfertës nga shpronësimet dhe transferimit të rezultatit financiar të ISSH-së.

• Gjatë vitit 2024, në lidhje me nënhuanë, garancitë shtetërore dhe kreditë e tjera, auditimi konstatoi se të drejtat e shtetit për t'u arkëtuar ndaj përfituesve, kryesisht në sektorin e energjisë, ujësjellës-kanalizimeve dhe njërive të vetëqeverisjes vendore, vijuan të rriten, pasi një pjesë e konsiderueshme e subjekteve nuk kanë respektuar kushtet kontraktuale të shlyerjes dhe nuk kanë ndërmarrë masa efektive për rikthimin e detyrimeve. Si pasojë, janë kryer pagesa nga buxheti i shtetit për të mbuluar paaftësinë paguese të përfituesve nëpërmjet garancive buxhetore duke rritur ekspozimin fiskal.

Pavarësisht krijimit të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, mangësitë në ndjekjen administrative dhe ligjore, mungesa e një metodologjie të unifikuar për monitorimin e marrëveshjeve të nënhuasë, vonesat në rakordime, si dhe mungesa e mekanizmave efektivë të sigurimit, kolateralit dhe të sanksioneve të zbatueshme në kohë, nuk kanë mundësuar rikuperimin e këtyre detyrimeve. Kështu, gjatë vitit 2024 janë paguar nga buxheti i shtetit 40.5 miliardë lekë principal dhe interes për llogari të kredisë dhe garancisë shtetërore.

• Sa i përket likuiditetit, megjithëse gjendja e TSA-së në datë 31.12.2024 rezultoi brenda kufirit të miratuar, me përfshirjen edhe të llogarive speciale, ky limit tejkalohet me rreth 25.1 miliardë lekë. Përgjatë vitit u shënuan mbajtje të tepcave të larta të likuiditetit, humbje nga kursi i këmbimit edhe nga investimet në depozitë, kufizime të instrumenteve operacionale të disponueshme, mungesë njoftimesh nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për transfertat në valutë mbi prag, shoqëruar me mungesa të analizave mbi mënyrën optimale të përdorimit dhe konvertimit të monedhave.

• Në aspektin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, pavarësisht detyrimit të parashikuar në nenin 63 të ligjit "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor", pasqyrat e konsoliduara vjetore të transaksioneve financiare të shtetit për vitin 2024 nuk janë hartuar dhe nuk janë dorëzuar, çka e ka bërë të pamundur shprehjen e një opinionit auditues financiar mbi to. Pavarësisht këtij kufizimi, në auditimet financiare individuale të kryera nga KLSH, përveç mangësive në formë dhe afate të përgatitjes së pasqyrave financiare nga institucionet e audituara janë konstatuar dhe klasifikime të gabuara në pozicionet e pasqyrave financiare, jo vetëm për shkak të mungesës së dokumentacionit kontabël, por edhe të mungesës së kuadrit rregullator për raportimin financiar.

• Risqet fiskale mbeten të larta, duke qenë se ekspozimi ndaj ndërmarrjeve publike, veçanërisht energjia, është rritur për shkak të detyrimeve të ndërsjella të pashlyera dhe të parakorduara. Ndërkohë, stoku i detyrimeve të prapambetura dhe çështjet gjyqësore kontingjente po ashtu mbeten në nivele të larta. Stoku i detyrimeve deri në fund të muajit dhjetor 2024 rezulton 7.32 miliardë lekë, nga të cilat, detyrimet e qeverisë qendrore janë rreth 2.66 miliardë lekë, detyrimet e qeverisë vendore janë rreth 3.26 miliardë lekë dhe detyrimet për rimbursimin e tvsh-së janë rreth 1.4 miliardë lekë. Detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së raportohen në vlerën rreth 18 milionë euro, e cila i takon 10 vendimeve të cilat janë në tejkallim të afatit 3-mujor dhe rrezikojnë pagesa interesi për likuidim të vonuar.

Ndërsa raportimet e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit deri në fund të vitit 2024 për detyrimet faktike dhe kontingjente paraqiten në vlerën rreth 180 milionë euro.

Sa i takon kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore u konstatuan mospërputhje në plan pagesa dhe raportime, financim i fragmentuar jashtë programeve përkatëse, monitorim i pamjaftueshëm për pagesa për volume të parealizuara dhe mungesë e raportimit vjetor të performancës.

► Në fushën fiskale dhe të administrimit tatimor, nga auditimi u konstatuan trajtime të gabuara të përjashtimit nga tvsh, pa autorizim të punimeve ndërtimore, mospërputhje ndërmjet inventarit fizik dhe kontabël, mungesë të analizës financiare për detyrimet ndaj ortakëve, deklarim të ulët të pagave, shitje nën kosto dhe çmime tregu pa justifikim, si dhe kreditim i gabuar i tvsh-së për karburantin. Gjithashtu, evidentohen mangësi në monitorimin e subjekteve me diferenca në deklarime tatimore, humbje të përsëritura, vonesa në dorëzimin e pasqyrave financiare, penalitete të paaplikuara, risk për shmangie tatimore dhe përfitime të padrejta nga tvsh.

► Nga auditimi në administratën doganore u konstatua aplikim i pasaktë i elementëve të vlerës së mallit, përdorim i gabuar i vlerës së transaksionit pa dokumentacion të plotë, rivlerësime jo koherente për të njëjtin subjekt dhe artikull, deklarim të çmimeve nën koston të lëndës së parë, mospërfshirje të skontove në vlerën doganore dhe mungesë të kontrollit dokumentar dhe fizik gjatë importit. Gjithashtu, janë evidentuar trajtime jo të unifikuara të shkeljeve doganore, keqklasifikime tarifore që ndikojnë në detyrimet për taksën e ambalazhit plastik, mosrespektim i afateve në regjimet e tranzitit dhe magazinimit, si dhe mospërfshirje e artikujve në listat e referencave për vlerësimin doganor.

► Në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u konstatua se shërbimi i auditimit të brendshëm nuk ka qenë i shtrirë në të gjitha njësitë e fushës së ligjit dhe në disa raste ka munguar dokumentimi i plotë i marrëveshjeve ndërinstitucionale për mbulimin e shërbimit. Kapacitetet njerëzore dhe profesionale kanë rezultuar të pamjaftueshme, me mungesa në mbulim dhe në certifikim, me plane auditimi të dorëzuara dhe miratuara jashtë afateve ose pa analizë të dokumentuar të riskut. U konstatua realizim i ulët i planit të auditimeve të performancës dhe të IT-së, si dhe zbatim i ulët i rekomandimeve të dhëna. Në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimet e cilësisë janë kryer pa afate të qarta dhe me një mbulim të ulët vjetor, në raport me numrin e vlerësimeve që kryhen çdo vit dhe kërkesës ligjore për periodicitetin e kryerjes së këtyre vlerësimeve.

Për sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson se, rritja e cilësisë së planifikimit dhe raportimit buxhetor, në funksion të përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së shpenzimeve publike, si dhe përmirësimi i monitorimit të buxhetit në tërësi, menaxhimit dhe miradministrimit të risqeve fiskale në rritje, duke përfshirë dhe çështjet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, janë të rëndësishme për sigurimin e financave të qëndrueshme publike dhe besueshmërisë së kuadrit fiskal.

KLSH, në mandatin e tij, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik-financiar jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim parandalimin e problematikave dhe mangësive të konstatuara, duke kërkuar:

► **Përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor** dhe forcimin e disiplinës fiskale nëpërmjet respektimit të afateve ligjore në hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit vjetor, argumentimin e kërkesave të reja apo të shtuara buxhetore, bazuar në një monitorim të vazhdueshëm dhe jo formal të ecurisë së shpenzimeve për investime.

► **Shmangien e ndryshimeve të shpeshta të planit buxhetor me akte normative**, respektimin e tavaneve buxhetore për të mos **zhvleftësuar** të gjithë procesin planifikues, si element i rëndësishëm për menaxhimin e burimeve publike në dispozicion, sipas destinacionit dhe prioriteteve të vendosura në planet afatmesme dhe ato strategjike.

► **Adresimin e problematikave në regjistrimin e transaksioneve në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë**, nëpërmjet përmirësimeve në sistemet e kontrollit të integruar, me qëllim parandalimin e marrjes së angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël, shmangien e vonesave në regjistrim dhe të mosrespektimit të radhës së disiplinës buxhetore. Në veçanti, për njësitë e qeverisjes vendore rekomandohet një monitorim më i kujdesshëm mbi të drejtën për të kryer shpenzime në kuadër të të ardhurave të trashëguara nga të ardhurat e veta apo transferat buxhetore.

► **Reflektimin në treguesit fiskalë të konsoliduar** të çdo plani të shpërndarë me VKM përgjatë vitit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të siguruar koherencë ndërmjet tabelave të ligjit, krahasueshmëri dhe financim në kohë të nevojave dhe harmonizim me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.

► **Vëmendje e shtuar për menaxhimin e borxhit tatimor dhe doganor**, hartimin e planeve konkrete për uljen e tij, për të shmangur humbjet nga parashkrimi i këtyre detyrimeve.

► **Detajimin e fondeve** sipas angazhimeve ekzistuese dhe kalendareve kontraktuale.

► **Vëmendje e shtuar nga ana e institucioneve për inventarizimin, administrimin e pronës publike** dhe kryerjen e regjistrimeve me qëllim paraqitjen e drejtë në pasqyrat financiare të institucioneve.

► **Përshpejtimin e procesit të miratimit dhe implementimit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit Publik (SKKP)** me qëllim hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit.

► **Përmirësimin e menaxhimit të borxhit publik** dhe ekspozimit fiskal ndaj kredisë shtetërore dhe garancive shtetërore nga Ministria e Financave dhe struktura përgjegjëse e ngritur për këtë qëllim duke siguruar ndjekje efektive të këtyre detyrimeve të përfituesve të nënhuasë, me mekanizma efektivë për rikuperimin e tyre.

► **Analizimi dhe evidentimi i nevojave për forcimin e sistemit të kontrollit farmaceutik, spitalor dhe kontratave koncesionare**, për garantimin e integritetit të të dhënave elektronike dhe zbatimin e mekanizmave të sanksionimit për subjektet që shkelin kushtet kontraktuale.

► **Forcimin e strukturave të njëjësive të auditimit të brendshëm** në të gjitha nivelet e qeverisjes, nëpërmjet një monitorimi më efektiv nga struktura përgjegjëse mbikëqyrëse, për forcimin e kapaciteteve audituese dhe nëpërmjet kryerjes së proceseve të vlerësimit, si mekanizëm për identifikimin e dobësive.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbetet garantimi i përdorimit me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike, forcimi i përgjegjshmërisë publike dhe i transparencës në menaxhimin e financave të shtetit.










KLSH, gjatë ushtrimit të mandatit kushtetues dhe ligjor, nëpërmjet rekomandimeve, vijon të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe miradministrimin e buxhetit të shtetit, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Faleminderit!

Dëmi ekonomik 2024

Përmbledhja e dëmit ekonomik dhe efekteve financiare negative për buxhetin 2024

Dëm ekonomik	SHPENZIME	<u>21,029</u>	Në mijë lekë
Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore	1,186		
Shpenzime të tjera	506		
Zbatim punimesh / investime	19,337		
	TË ARDHURA	<u>121,700</u>	
Të ardhura nga aktiviteti doganor	73,534		
Të ardhura të tjera	48,166		
TOTALI		<u>142,729</u>	

Efekte financiare negative	SHPENZIME	<u>1,886,258</u>	Në mijë lekë
Shpenzime për investime	301,089		
Shpenzime operative	508,358		
Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore	109,985		
Shpenzime të tjera	966,826		
	TË ARDHURA	<u>8,493,409</u>	Në mijë lekë
Të ardhura nga keqadministrimi i pasurisë shtetërore / palët e treta	397,014		
Të ardhura nga aktiviteti doganor	565,974		
Të ardhura nga aktiviteti tatimor	370,180		
Të ardhura të tjera	5,881,658		
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen vendore	1,278,583		
TOTALI		<u>10,379,667</u>	



Kryetari i KLSH-së raporton në Kuvend mbi veprimtarinë e institucionit, miratohet Rezoluta për vitin 2024



Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, raportoi në seancën plenare të datës 06.11.2025 të Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2024.

Në fjalën e tij, z. Shehu paraqiti përmbledhjen e punës së institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2024, duke u fokusuar në veprimtarinë audituese, rezultatet, gjetjet, masat dhe rekomandimet e lëna.

"Gjatë vitit 2024, KLSH ka realizuar 159 auditime në të gjitha nivelet e qeverisjes: në qeverisjen qendrore, pushtetin vendor, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet shtetërore, në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Manualeve, si dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit, duke u bazuar në vlerat universale të Institucioneve Supreme të Auditimit, si pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparencja. Sipas llojit të auditimeve, janë kryer: 45 auditime financiare, 43 auditime përputhshmërie, 35 auditime të kombinuara, 15 auditime performance, 8 auditime të teknologjisë së informacionit dhe 13 auditime mbi zbatimin e rekomandimeve. Për sa i takon fushëmbulimit me auditim, këto misione janë kryer në 205 subjekte: 97 njësi të qeverisjes qendrore, 75 njësi të vetëqeverisjes vendore, 13 institucione të pavarura dhe 20 ente publike. Kjo shtrirje territoriale dhe institucionale tregon përpjekjen e vazhdueshme të KLSH-së për të siguruar një mbulim të plotë e të balancuar të sektorit publik me auditim." - u shpreh Kryetari i KLSH-së.

Duke u ndaluar në fushat e auditimit me ndjeshmëri publike, kreu i KLSH-së bëri të ditur se gjatë vitit 2024 janë realizuar 15 auditime performance, të cilat janë zhvilluar në sektorë me ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët, si: shëndetësi, arsim, mjedis, kulturë dhe barazi gjinore.

"Auditimet e kryera kanë treguar se institucionet publike ende nuk kanë konsoliduar një strategji të qëndrueshme drejt orientimit për rezultate dhe vlerësimin të ndikimit të programeve apo politikave si praktikë standarde menaxheriale. Mangësitë në koordinimin ndër-institucional, planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e burimeve reflektojnë një nivel të ulët efieciencie dhe efektiviteti në zbatimin e programeve, politikave dhe strategjive publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe në perceptimin e qytetarëve për besueshmërinë e administratës." - theksoi Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditime, z. Shehu tha se niveli i pranueshmërisë së rekomandimeve, të verifikuara në 97 auditime të evaduar në vitin 2023, ka arritur në masën 99%, çka tregon një ndikim të shtuar të punës së KLSH-së në forcimin e menaxhimit dhe monitorimit të financave publike. Rreth 70% e këtyre rekomandimeve kanë rezultuar të zbatuara plotësisht, pjesërisht ose në proces zbatimi.

Gjatë vitit 2024, KLSH ka depozituar 13 kallëzime penale, të cilat përfshijnë rastet ku auditimi ka konstatuar veprime ose mosveprime me shkelje të Ligjit Penal. Në kuadër të detyrimit ligjor si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë, KLSH ka përcjellë 35 materiale për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme.

Në fund të fjalës së tij dhe përgjigjes së pyetjeve të deputetëve, z. Shehu garantoj se institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të jetë i angazhuar maksimalisht për të kryer detyrimet kushtetuese dhe ligjore duke vlerësuar gjithashtu çdo komunikim me qytetarët dhe mediat që trajtojnë problematika të ndryshme, në shërbim të publikut dhe interesit të përgjithshëm, për të kontribuar në forcimin e mekanizmave të qeverisjes së mirë. Pas diskutimeve u miratua Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2024.

SEANCA DËGJIMORE



KLSH paraqet në Kuvend kërkesat për projektbuxhetin 2026

Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqiti në seancën dëgjimore të zhvilluar më 13.11.2025 nga Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, kërkesat për projektbuxhetin e vitit 2026.

Në mbledhje mori pjesë Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, i shoqëruar nga drejtorja e Burimeve Njerëzore, znj. Ermira Hoxha, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, z. Elton Bodini dhe znj. Alketa Kalleshi nga Sektori i Financës.

Në këtë dëgjesë u prezantua nga KLSH shkalla e realizimit të buxhetit për vitin 2025, ecuria e zbatimit të rekomandimeve, si dhe u paraqitën disa kërkesa për shtesa mbi tavanet buxhetore, për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024.

KLSH theksoi se miratimi i kërkesave buxhetore për vitin 2026 do t'i mundësojë institucionit të përmbushë detyrimet ligjore dhe kërkesat nga Kuvendi i Shqipërisë për kryerjen e auditimeve në fusha specifike që përfshijnë kontratat koncesionare, marrëveshjet hidrokarbure, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, zhvillimin e auditimeve paralele me institucionet homologe, digjitalizimin e procesit të punës etj.

Komisioni Evropian vlerëson punën e KLSH: Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

Komisioni Evropian vlerëson sërish Kontrollin e Lartë të Shtetit për punën dhe rolin e institucionit në procesin integruar të Shqipërisë. Edhe në Raportin e vitit 2025, të publikuar më 04.11.2025, evidentohet se cilësia e punës së auditimit vazhdoi të ishte në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

“Ndikimi i punës së auditimit përparoi. 99% e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2024 u pranuan, nga të cilat, 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht.” – thuhet në Progresraport.

Komisioni Evropian thekson se Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

“Nënkomisioni Parlamentar për Auditimin ka mbajtur disa seanca dëgjimore gjatë periudhës raportuese dhe ka nxjerrë rezoluta në lidhje me një numër auditimesh nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjë që është një trend pozitiv.” – shkruhet në dokumentin e Komisionit Evropian.



Planifikimi i “Programit të Auditimit 2026”, Kryetari i KLSH-së diskuton propozimet me departamentet



Në Kontrollin e Lartë të Shtetit përgjatë muajit nëntor 2025 u zhvilluan takimet mbi planifikimin e veprimtarisë audituese për vitin 2026. Takimet u realizuan në ambientet e KLSH-së me Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Departamentin e Auditimit të Performancës, Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike si dhe Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Në këto takime, nga Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu u theksua rëndësia e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes strukturave të KLSH-së për të siguruar një program auditimi sa më efektiv dhe të orientuar drejt risqeve, me qëllim final përmbushjen e misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në mbrojtje të interesit publik.

Departamentet shqyrtuan propozimet për programin auditues të vitit 2026, të paraqitura në kuadër të detyrimit institucional të çdo audituesi për të identifikuar nevojat dhe problematikat që synojnë rritjen e efektivitetit të auditimeve publike. Audituesit prezantuan propozimet e tyre, të shoqëruara me argumente konkrete dhe sugjerime për forcimin e procesit të planifikimit.



Përfaqësuesit e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale takohen me Kryetarin e KLSH-së

Më 18 nëntor 2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu dhe përfaqësues të KLSH-së pritën në takim delegacionin e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, në kuadër të Misionit të tyre në Shqipëri lidhur me monitorimin e zbatimit të Kartës Evropiane të Vetë-qeverisjes Vendore. Gjatë takimit, anëtarët e delegacionit vlerësuan kontributin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në forcimin e qeverisjes së mirë financiare, rritjen e transparencës dhe garantimin e llogaridhënies publike në nivel qendror dhe vendor.

Diskutimet u fokusuan gjithashtu te zbatimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe Rekomandimit nr. 468/2021 të Kongresit, gjendja financiare e bashkive dhe qarqeve, si dhe procedurat e mbikëqyrjes financiare në nivel lokal. U theksua rëndësia e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH-së, si një mjet i domosdoshëm për përmirësimin e performancës dhe menaxhimit financiar në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Misioni TAIEX i Komisionit Evropian zhvillon vizitë pune në Kontrollin e Lartë të Shtetit



Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu dhe përfaqësues të KLSH-së zhvilluan një takim pune me ekipin e Misionit të Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian.

Takimi u zhvillua më 21 nëntor 2025 në mjediset e KLSH-së, në kuadër të mbështetjes që Bashkimi Evropian po ofron për forcimin e garancive ligjore e institucionale që garantojnë pavarësinë e bankave qendrore në vendet candidate. Ekspertët ndërkombëtarë ndanë përvoja dhe praktika evropiane mbi funksionimin optimal të institucioneve supreme të auditimit në raport me bankat qendrore.

Diskutimet u përqendruan në rolin dhe fushëveprimin e auditimeve të KLSH-së mbi Bankën e Shqipërisë në situatën aktuale, ashtu edhe në kuadrin e detyrimeve të ardhshme të Shqipërisë pas anëtarësimit në BE, si dhe në raportin ndërmjet llogaridhënies së bankës qendrore dhe respektimit të pavarësisë së saj institucionale, funksionale dhe financiare, duke vlerësuar modelet më të suksesshme të vendeve të BE-së.

Gjatë takimit, z. Ger Bom, Këshilltar i Lartë Ligjor pranë Bankës së Holandës dhe z. Hans Weenink, Këshilltar i Lartë për Çështjet e Bankave Qendrore, vlerësuan punën, profesionalizmin dhe rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si garant institucional i transparencës dhe qeverisjes së mirë në Shqipëri, duke theksuar kontributin e rëndësishëm të auditimeve për forcimin e integritetit dhe besimit publik në institucionet shtetërore.

Kryetari i KLSH-së, z. Shehu, shprehu gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin me ekspertët e BE-së dhe institucionet homologe, me qëllim integrimin e plotë me standardet evropiane të auditimit publik.

TAIEX është një instrument i Bashkimit Evropian për ndërtimin e kapaciteteve institucionale duke ofruar mbështetje për administratat publike në vendet candidate për në BE dhe më gjerë.



Kryetari i KLSH-së priti në takim Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar



Në datë 13 nëntor 2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu dhe përfaqësues të tjerë të institucionit zhvilluan një takim me delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadër të Misionit të tyre në Shqipëri.

Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë dhe rolin e institucioneve të pavarura të auditimit të jashtëm, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, në forcimin e qeverisjes së mirë financiare dhe garantimin e llogaridhënies publike.

Shefja e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, znj. Anke Weber, vlerësoi kontributin e KLSH-së në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike, si dhe në përmirësimin e menaxhimit të burimeve financiare të shtetit.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjetjeve dhe problematikave të konstatuara gjatë auditimeve të llogarive të buxhetit të shtetit, si dhe ndikimit të tyre në planifikimin dhe administrimin e financave publike.

Palët shkëmbyen gjithashtu mendime mbi sfidat që shoqërojnë zbatimin e buxhetit të shtetit, me fokus në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e mekanizmave të kontrollit e raportimit financiar.

Vizitë pune nga delegacioni i Autoritetit të Llogaridhënies së Emirateve të Bashkuara Arabe

Më 14 nëntor 2025, një delegacion nga Autoriteti i Llogaridhënies së Emirateve të Bashkuara Arabe (UAE) zhvilloi një vizitë pune në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Delegacioni nga UAE përfshinte z. Khaled Abdulla Al Habsi, drejtor i Departamentit të Çështjeve të Entiteteve Sovrane dhe Strategjike, z. Hussain Juma Hassan Abdulla, kryetar i Seksionit të Çështjeve të Komunitetit dhe Humanitare, z. Abdulla Al Jabeti, analist i lartë, znj. Fatima Alhemeiri, specialiste e Çështjeve të Evropës, z. Mohammed Faisal Albannay, praktikant i diplomuar – Seksion i Çështjeve të Evropës dhe znj. Reem Al Kaabi, praktikante e diplomuar – Seksioni i Parë i Kërkimit dhe Hetimit.

Delegacioni u prit fillimisht në një takim nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu. Gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë për të forcuar marrëdhëniet midis dy institucioneve.

Në fjalën e tij, z. Shehu shprehu vlerësimin e tij për liderhipin dhe arritjet profesionale të Presidentit të UAEAA-së, Shkëlqesisë së Tij, z. Humaid Abushibs, duke njohur kontributin e vlefshëm të UAEAA-së në komunitetin rajonal dhe ndërkombëtar të auditimit.

Drejtuesit e departamenteve të auditimit në KLSH dhe delegacioni i UAE-së zhvilluan më pas një takim teknik, ku u prezantuan strukturat e përgjithshme organizative, mandati dhe fusha e veprimtarisë së institucioneve respektive. Gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin midis dy institucioneve, duke përfshirë fushat me interes të ndërsjellë.



Takimi teknik përfundoi me angazhimin e përbashkët për të vazhduar dialogun dhe për të ruajtur lidhje të ngushta profesionale, duke përfunduar partneritetin midis KLSH-së dhe UAE-së.



Mbahet në Stamboll workshopi rajonal “Për Ndërtimin e Kapaciteteve në Menaxhimin Financiar të Projekteve (PFM)” nga Banka Islamike për Zhvillim

Në datat 18 – 20 nëntor 2025 u zhvillua në Stamboll, workshop-i “Për Ndërtimin e Kapaciteteve në Menaxhimin Financiar të Projekteve (PFM)”, i organizuar nga Banka Islamike për Zhvillim (IsDB) dhe Qendra e Bashkëpunimit Shumëpalësh për Financimin e Zhvillimit (MCDF).

Projektet e financuara nga Banka Islamike për Zhvillim realizohen nga Agjencitë Ekzekutuese (EA) dhe Njësitë e Menaxhimit të Projekteve (PMU) në vendet anëtare. PMU-të dhe Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) shpesh janë përballur me sfida të ndryshme në lidhje me kërkesat e menaxhimit financiar dhe auditimit, duke përfshirë pajtueshmërinë në funksionimin e kontrolleve të brendshme, si dhe përgatitjen dhe finalizimin në kohë të auditimeve.

Workshop-i u fokusua në shqyrtimin e çështjeve të menaxhimit financiar dhe pajtueshmërisë së auditimit në projektet e mbështetura nga IsDB.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Njësitë e Menaxhimit të Projekteve, Institucionet Supreme të Auditimit, Bankat Shumëpalëshe të Zhvillimit (MDB), si dhe partnerë globalë si PEFA dhe IDI.

Aktiviteti shërbeu si një platformë për dialog dhe shkëmbim eksperiencash mbi praktikatat e mira në administrimin financiar dhe auditimin e projekteve zhvillimore.

Diskutimet u fokusuan në sfidat aktuale të Njësisë të Menaxhimit të Projekteve dhe SAI-ve, duke integruar përvoja të mëparshme, praktika të konsoliduara dhe zhvillimet e fundit teknologjike në fushën e menaxhimit financiar të projekteve dhe auditimit.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të identifikojnë sfida praktike nga zbatimi i projekteve dhe të diskutojnë qasje të reja për përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe mbikëqyrjes së projekteve të financuara nga Banka Islamike për Zhvillim.



KLSH u përfaqësua në këtë workshop me znj. Joniada Goçaj, drejtor i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, e cila, ndër të tjera, paraqiti edhe një ekspozitë të organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, si dhe sfidat dhe planet e ardhshme për forcimin e mbikëqyrjes.

ANALIZA E TË DHËNAVE

KLSH merr pjesë në workshop-in e EUROSAT-t “Data Envelopment Analysis (DEA) dhe metodat e tjera të krahasimit”

Projekt-grupi i EUROSAT-t për “Data Envelopment Analysis (DEA) dhe metodat e tjera të krahasimit” zhvilloi në datat 27-28 nëntor në Bukuresht, workshop-in VIII të tij. DEA është një projekt i EUROSAT-t me bashkëdrejtues Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë, në kuadër të Objektivit Strategjik nr. 2 të EUROSAT-t, “Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale”.

Metoda DEA është një mjet që përdoret në kryerjen e auditimeve të performancës, për të vlerësuar eficiencën e institucioneve publike në fusha të ndryshme të veprimtarisë. Workshop-i ofroi informacion teorik edhe aplikim në praktikë të programeve specifike për vlerësimin e eficiencës.



Gjatë dy ditëve u prezantuan rezultatet e auditimeve të kryera nga disa SAI në fusha të arsimit dhe të mjekësisë duke përdorur metodën DEA në vlerësimin e performancës së institucioneve. Gjithashtu, pjesëmarrësit praktikuan përdorimin e programeve specifike në analizimin e të dhënave të përshtatura për qëllime trajnimit.

Në aktivitet merrnin pjesë përfaqësues nga SAI të ndryshme të Europës. KLSH u përfaqësua nga znj. Ermira Hoxha, drejtoresh e Burimeve Njerëzore, znj. Arminda Bushi, kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike dhe znj. Laura Lila, këshilltare.

Zhvillohet në KLSH workshop-i mbi përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës me asistencën e ekspertëve të Zyrës së Auditorit të Norvegjisë



Në kuadër të aktiviteteve të parashikuara në bashkëpunim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, si një angazhim që buron nga marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit, u zhvillua në datat 25–27 nëntor 2025 në mjediset e KLSH-së, workshop-i 3-ditor mbi përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës, nën asistencën e ekspertëve norvegjezë Torkel Graham-Haga dhe Bjørn Martin Ørvim.

Takimi pati në fokus modernizimin dhe përmirësimin e Manualit të Auditimit të Performancës, një dokument thelbësor për orientimin metodologjik të audituesve të KLSH-së.

Gjatë tri ditëve të workshop-it u analizua zbatimi aktual i manualit, sfidat e hasura dhe u i identifikuan elementet që kërkojnë përditësim, për të reflektuar praktikatat bashkëkohore dhe standardet ISSAI.

Diskutimet u fokusuan në qartësimin e metodologjisë së auditimit, standardizimin e procesit të dokumentimit, si dhe përmirësimin e formateve të Programit dhe Raportit të Auditimit të Performancës.

Në vijim, workshop-i u përqëndrua në hartimin e një strukture të re për manualin e përditësuar, bazuar në një qasje më të qartë, më të thjeshtë dhe më të orientuar drejt praktikës. Palët dakordësuan një plan pune me afate të qarta për finalizimin e dokumentit të ri të manualit.

Grupet e punës konfirmuan angazhimin për të vazhduar bashkëpunimin në këtë proces të rëndësishëm, me synim përgatitjen e një manuali bashkëkohor, të dobishëm dhe plotësisht të harmonizuar me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit publik.

Në takim u diskutua edhe mbi bashkëpunimin për auditimin e ri që do të mbështetet nga SAI i Norvegjisë.

IDI PUBLIKON RAPORTIN GLOBAL

“Veprimet e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike”, pjesë e auditimit edhe KLSH

Grupi i Punës i INTOSAI-t për Auditimin Mjedisor (WGEA) në bashkëpunim me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) nisi një projekt auditimi të përbashkët global “Veprimet e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (CCAA)”. Në saj të këtij projekti është publikuar në muajin nëntor raporti i përbashkët “Auditimet Globale të Përshtatjes ndaj Klimës për një të Ardhme Rezistente: Gjetje dhe rekomandime nga Institucionet Supreme të Auditimit”.

Si pjesë e këtij projekti, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar auditimin e performancës “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, raporti i të cilit mund të aksesohet në linkun: <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-auditimi-zbatimi-i-planit-kombetar-per-pershtatjen-ndaj-ndryshimeve-klimatike/>

Në raportin e përbashkët të publikuar nga IDI, ndër të tjera, theksohen edhe gjetjet e auditimit të kryer në Shqipëri.



“Shqipëria ka një Plan Kombëtar Adaptimi që përfshin një kornizë strategjike për veprimet e adaptimit ndaj klimës; megjithatë, plani mungon në detaje operative, është i fragmentuar dhe nuk është institucionalizuar. Nga auditimi u konstata se mungesa e vazhdimësisë dhe integritimit dobëson përpjekjet afatgjata të adaptimit.” - citohet në raport.

Raporti i përbashkët “Auditimet Globale të Përshtatjes ndaj Klimës për një të Ardhme Rezistente: Gjetjet dhe rekomandime nga Institucionet Supreme të Auditimit” gjendet në linkun: <https://www.environmental-auditing.org/media/ss5kffp1/261025-ccaa-global-publication.pdf>

Forumi “Bashkë për parandalimin e kancerit të gjirit – ekzaminimi i rregullt i gjirit shpëton jetë”



Në vijim të fushatës “Tetori Rozë”, e cila këtë vit është zgjeruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deri në muajin nëntor për shkak të rëndësisë së veçantë që mbart, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) Tiranë, organizuan më 26 nëntor 2025 forumin me temë “*Bashkë për parandalimin e kancerit të gjirit – ekzaminimi i rregullt i gjirit shpëton jetë*”.

Aktiviteti u zhvillua në ambientet e KLSH-së. Në të morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria Rajonale OSHKSH Tiranë, Instituti i Shëndetit Publik, si dhe profesionistë të fushës mjekësore, përfshirë mjekë onkologë, gjinekologë, imazheristë, si dhe punonjëse të KLSH-së.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, e cila falënderoi përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore që inicuan këtë aktivitet dhe Kryetarin e KLSH-së, z. Arben Shehu, për promovimin dhe kujdesin në organizimin e eventit. Znj. Gaxha theksoi se kjo tematikë ka një rëndësi të veçantë për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku 47% e stafit janë punonjëse femra. Për më tepër, në thelb të punës audituese qëndron funksioni parandalues i mangësive, ku parandalimi është kryefjala edhe e kësaj fushate.








Drejtorja e Shëndetit Publik dhe Edukimit Shëndetësor në Drejtorinë Rajonale OSHKSH Tiranë, znj. Haxhire Kasaj, në fjalën e saj përshëndetëse falënderoi Kryetarin e KLSH-së për gatishmërinë në organizimin e aktivitetit.

Znj. Kasaj theksoi se tashmë çdo muaj, gjatë gjithë vitit, do të jetë “rozë” në qytete të ndryshme të vendit. Më pas mjekët, Dr. Naun Sinani, Dr. Ariela Malaj, Dr. Ilir Qefalia, znj. Edlira Klosi, znj. Ardita Ibraj, znj. Entela Todhe ndanë këshilla dhe dhanë informacione ndërgjegjësuese për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, rëndësinë e kontrolleve mjekësore, mënyrat e diagnostikimit dhe trajtimit etj. Ata theksuan dhe apelan rëndësinë e kryerjes të sa më shumë kontrolleve periodike të mjekët, duke bërë të mundur diagnostikimin në kohë, parandalimin e avancimit të sëmundjes, rritjen e jetëgjatësisë dhe uljen e rasteve fatale.

Si pjesë e këtij aktiviteti u realizua kryerja e mamografisë për një grup punonjësesh të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00

Website:

www.klsh.org.al

Adresa:

Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

Email:

klsh@klsh.org.al